

KRYEREDAKTOR:
BLENDI KAJSIU
N.R. 4
VJESHTE 2007

NDER KOMBETARET & DEMOKRATIZIMI

'Kështu Foli Evropa' - Mbi Ndërtimin dhe Përdorimin e
Europianizimit në Ligjërimin Zyrtar dhe Politik
ODETA BARBULLUSHI

Internacionalizimi i të Drejtës Kushtetuese:
Klauzolat Kushtetuese të Integritimit të Shqipërisë
PROF. DR. AURELA ANASTASI

Demokratizim Pa Politikë: Baza Konceptuale e
Qasjes Ndërkombëtare në Shqipëri
BLENDI KAJSIU

Ndërkombëtarët si Pala e Tretë: Një Udhëtim Bashkë me
Ndërkombëtarët nëpër Tranzicionin Shqiptar 1990 - 2002
HENRI CILI

Politikat e Bashkimit Evropian Ndaj Kërcënimit të Krimin të Organizuar
Shqiptar: Një Shqetësim Real Apo i Hiperbolizuar?
ILIR KALEMAJ

Ndikimi i Ndërkombëtarëve Nëpërmjet Organizatave
Jo-Fitimprurëse në Procesin e Zhvillimit
BLERTA PICARI

Shqipëria ose Europianizimi i Vështirë
SOKOL LLESHI

Kosova: Shteti i Paprecedent
LULZIM PEÇI, LEON MALAZOGU, ILIR DUGOLLI



**Universiteti
European i
Tiranës**



NR. 4/2007

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

Revistë shkencore e departamentit të shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare

KRYEREDAKTOR:

BLENDI KAJSIU

REDAKTOR:

HENRI ÇILI

ELDAPAPA

KONSULENTË

Prof. As. Dr. Romeo Gurakuqi

Dr. Ermal Hasimja

Prof. As. Dr. Tonin Gjurarj

Adri Nurellari

Dërgoni shkrime reçensa librash, përmbledhje punimesh shkencore, monografi, studime në redaksinë e revistës POLIS.

Ato do të shqyrtohen nga redaksia me rigorozitet shkencor.

Dërgoni në format Word në adresën e mëposhtme:

polis@universitetieuropean.com

NDËRKOMBËTARËT DHE DEMOKRATIZIMI

PËRMBAJTJA

- 7-14 'Kështu Foli Evropa!' - Mbi ndërtimin dhe përdorimin e Europeanizimit në Ligjërimin Zyrtar dhe Politik **ODETA BARBULLUSHI**
- 15-24 Internacionalizimi i të Drejtës Kushtetuese: Klauzolat Kushtetuese të Integritimit të Shqipërisë **PROF. DR. AURELA ANASTASI**
- 25-40 Demokratizim Pa Politikë: Baza Konceptuale e Qasjes Ndërkombëtare në Shqipëri **BLENDI KAJSIU**
- 41-60 Ndërkombëtarët si Pala e Tretë: Një Udhëtim Bashkë me Ndërkombëtarët nëpër Tranzicionin Shqiptar 1990 - 2002 **HENRI ÇILI**
- 61-78 Politikat e Bashkimit Evropian Ndaj Kërcënimit të Krimit të Organizuar Shqiptar: Një Shqetësim Real Apo i Hiperbolizuar? **ILIR KALEMAJ**
- 79-90 Ndikimi i Ndërkombëtarëve Nëpërmjet Organizatave Jo-Fitimprurëse në Procesin e Zhvillimit **BLERTA PICARI**
- 91-109 Shqipëria ose Europeanizimi i Vështirë **SOKOL LLESHI**
- 111-122 Kosova: Shteti i Paprecedentë **LULZIM PEÇI
LEON MALAZOGU
ILIR DUGOLLI**
- Teori Politike*
- 123-140 Liberalizmi dhe Rënia e Filozofisë Politike **SHELDON S. WOLIN**
- 141-149 Demokracia, Republika, Përfaqësimi **JACQUES RANCIÈRE**
- Recenca*
- 151-152 Recencë e librit "Shoqëria Periferike" të Artan Fugës **BLERTA HYSKA**
- 153-154 Recencë e librit "Një rrëfenjë me ndërkombëtarë" të Ylljet Alickës **ALBA CELA**

'KËSHTU FOLI EVROPA!' - MBI NDËRTIMIN DHE PËRDORIMIN E EUROPIANIZIMIT NË LIGJËRIMIN ZYRTAR DHE POLITIK¹

ODETA BARBULLUSHI *

Abstrakt: Evropianizimi është kthyer tashmë në një ligjërim dominant në sferën publike shqiptare që përfshin si procesin e integritit në Bashkimin Evropian ashtu edhe procesin e shndërrimit demokratik të identiteteve politike e komëbtare të vendeve candidate apo aspirante. Duke u rrekur të problematizojë këtë ligjërim në vend që t'i përfaqesht si një skelet neutral teorik, kjo ese ngre pyetjen se c'farë nevojash legjitimiteti të brendshëm dhe të jashtëm si të elitave politike ashtu dhe të vetë shtetit shqiptar ligjërimi i Evropianizimit përmbush.

“Askush s'mund të jetë më kurrë vetvetja” -Libri i Zi, Orhan Pamuk

HYRJE

Në punimin e tij *Simulacra and Simulation* (1994) Jean Baudrillard sjell shembullin e protagonistëve të një *reality show* të tipit Big Brother apo Kafazi i Artë të cilët, megjithëse e dinë që janë nën kundrimin e syrit të kameras sillen sikur kamera nuk është aty. Të luajturit e lojës “sukur” është më shumë sesa një subversion i *reality show*-t; në të vërtetë është vetë arsyeja e vazhdimin të saj. Kamera kërkon që protagonistët të sillen ‘sukur’ kamera nuk do të ishte aty. Teatraliteti i protagonistëve të saj është i domosdoshëm për vazhdimësinë e lojës. Shembulli i përmgjason rastit të televizionit të punimeve të parlamentit; vëzhgimi i ngultë i kameras ka dy funksione njëherësh: nga njëra anë i zhvesh protagonistët nga spontaniteti dhe nga ana tjetër i detyron ata të sillen sikur vetë kamera nuk është aty.

Për një moment mund të imagjinojmë Parlamentin si metaforë e të gjithë sferës politike. Shembulli i televizionit dhe shfaqjes *live* të seancave parlamentare është domethënëse në kontekstin tonë për sa kohë që mund të shërbejë për të nxjerrë në pah dyfishësinë e të gjithë praktikave politike. Në të vërtetë sociologë si Erving Goffman² apo Elizabeth Burns e kanë shtjelluar që në vitet ‘70 problemin e sjelljes së dyfishtë, dmth përfaqësimin e vetvetes ndryshe në jetën publike nga jeta private në përgjigje të asaj c'ka konceptohet si pritshmëri e audiencës, qoftë kjo shoqëria apo familja apo kolektivi i punës. Burns (1972) prezanton konceptin e ‘teatralitetit’ për të shpjeguar këtë dyfishësi në sjelljen e aktorit në jetën sociale. Loja në skenë e marrë këtu si arena politike nuk mund të ketë pra kuptim pa ekzistencën e një audience, bile pa ndërgjegjësimin e protagonistëve se po ndiqen nga kjo audiencë dhe pa njëfërë ndërgjegjësimi të tyre mbi pritshmëritë e kësaj audience. Është kjo audiencë që në kontekstin politik nënkuptin burimin legjitimitetin e praktikave politike dhe e debatit politik.

¹ Kjo ese bazohet mbi një referat të paraqitur në “Dilemas of the Post-Communist Condition” Conference, organizuar nga HAGRI (History and Governance Research Institute), Universiteti i Eölvhampton, Angli, 23-24 qershor 2005 dhe mbi një tjetër të paraqitur në ASN Conference: Globalization, Nationalism and Ethnic Conflicts in the Balkans and its Regional Context. Beograd 28-30 Shtator, 2006. Autorja i është mirënjohëse Gëzim Alpionit dhe Ozlem Demirtas-Bagdonas për leximin e drafteve të mëparshme dhe për komentet e vlefshme.

* Autorja është Candidate Doktrature pranë Institutit Kërkimor Evropian, Universiteti i Birminghamit, Mbretëria e Bashkuar në degën e Studimeve Ruse dhe të Evropës Lindore. Përpara fillimit të doktoraturës, Odeta Barbullushi ka studiuar dhe në Universitetin e Sussex, Angli dhe në Universitetin e Evropës Qendrore, Hungari. Jep një seri leksionesh në kursin “Europe in the World” në Institutin Kërkimor Evropian, Universiteti i Birminghamit.

² Falenderoj Stephanie Schëandner-Sievers që ma solli në vëmendje punën e Goffman dhe konceptin e teatralitetit.

Arrijmë kështu në zemrën e problemit që ky edicion i POLIS shtjellon: tek burimi i legjitimitetit politik të elitave dhe i praktikave politike. Roli i komunitetit ndërkombëtar në proceset e demokratizimit në vend mund të kuptohet vetëm brenda kontekstit të legjitimitetit të kufizuar të brendshëm dhe të jashtëm të elitave politike si dhe të identitetit të pakonsoliduar demokratik të shtetit shqiptar. Në këtë kontekst do saja të zbërtheja interpretimet dhe ngjyresat e përdorimit të 'Evropës' si në ligjërimin zyrtar ashtu dhe në debatin politik në lidhje si me demokratizimin e brendshëm ashtu dhe në lidhje me politikën e jashtme të shtetit shqiptar vecanërisht në periudhën pas 1997-ës.

Si demokratizimi i brendshëm dhe ai i jashtëm bashkohen në një pikë: në identitetin demokratik të shtetit shqiptar³, i cili përbën dhe shqetësimin e vërtetë të kësaj eseje. Identiteti i shtetit lidhet shumë më direkt me dinamikën e brendshme politike sesa mund të mendohet lehtësisht: rregullat e ligjërimin zyrtar të integritetit Euro-Atlantik si edhe e politikës së jashtme si e bazuar në 'Orientimin Euro-Atlantik' të shqiptarëve dhe të shtetit shqiptar janë të negocuara dhe të fiksuara në debatin vendas mbi Evropën dhe Perëndimin. Për këtë arsye marrëdhënia mes demokratizimit të brendshëm dhe demokratizimit të marrëdhënies me jashtë nuk kanë sesi të mos shihen si të lidhura ngushtë. Kjo ese nuk merr përsipër ta shpjegojë këtë lidhje por në të kundërt të nxjerrë në pah tensionet që kjo lidhje përmban dhe të cilat garantojnë dhe vazhdimësinë e ligjërimin evropianizues dhe rrjedhimisht dhe problemet e legjitimitetit të brendshëm dhe të jashtëm që këto tensione ngrëthejnë në vetvete. E nis diskutimin me një shikim kritik të Evropianizimit si diskurs akademik duke qënë se te ky diskurs kërkohet shpesh të gjinden të gjitha zgjidhjet e gatshme për demokratizim dhe reforma, për të vijuar me një analizë empirike të ndërtimit të autoritetit dhe legjitimitetit të Evropës nëpërmjet interpretimeve që i vishen nga aktorët politikë vendas qoftë në lidhje me politikën e jashtme, ashtu dhe në lidhje me politikën e brendshme. Të dyja sferat ndërlidhen te identiteti i shtetit shqiptar. Tensionet dhe kontradiktat që mbarsin interpretimet e ndryshme të Evropës nuk kanë sesi të mos pasqyrohen edhe tek ky identitet.

LIGJËRIMI I EVROPIANIZIMIT: MES SKELETIT TEORIK DHE LIGJËRIMIT TË PUSHTETIT

Në debatin akademik, gjuha e Evropianizimit nënkupton si procesin e reformës së brendshme si pasojë e procesit të afrimit me Bashkimin Evropian ashtu dhe brendësimin e vlerave evropiane dhe perëndimore nga aktorët vendas. Në zemër të Evropianizimit qoftë si ngrehinë teorike apo dhe si ligjërim politik qëndron nevoja dhe aspirata e ndryshimit. Cladio Radaelli e ka definuar qartë Evropianizimin si:

Proceset e (...) a) sendërtimit, b) përzierjes [diffusion] dhe c) institucionalizimit të rregullave formale dhe jorformale, procedurave, paradigmeve të politikëbërjes, stileve dhe "mënyrës të të bërit të gjërave" si dhe e besimeve dhe normave të përbashkëta të cilat përkufizohen dhe konsolidohen në procesin e politikave të BE-së dhe pastaj ndërfuten në logjikën e ligjërimin të brendshëm (kombëtar apo lokal), në strukturat politike dhe në politikat publike. (Radaelli, 2004:3)

Ky përkufizim kaq i gjerë i rrok të dy proceset e përmendura më lart, pra si implementimin e 'imponuar' në një farë mënyre i politikavë të BE-së ashtu edhe brendësimin e normave dhe vlerave të BE-së,

³ Në këtë kontekst duke u bazuar në literaturën e gjerë konstruktiviste të marrëdhënies ndërkombëtare preferoj të mos përdor "imazhi i shtetit" sic përdoret rëndom në ligjërimin politik dhe zyrtar. Ndërkohë që "imazhi i shtetit" thekson me tepër përfaqësimin e shtetit përsëjashmi, termi i "identitetit të shtetit" është më i gjerë sesa thjesht reflektim përsëjashmi sepse përfshin dhe dinamikën e brendshme të krijimit dhe ri-ndërtimit të këtij reflektimi. Për një diskutim të konceptit shih Stephanie Ortman "Russian Collective Identity Formation and the Problem of Identity in IR Theory", Referat i mbajtur në Fifth Pan-European International Relations Conference, Hagë, 9-11 Shtator 2004, fq. 3.

derisa aktorët vendas nuk kanë më nevojë t' i referohen manualit dhe raporteve të BE-së për t' u sjellë si anëtarë pa u bërë ende të tillë. Ky ndryshim në sajë të ndërftues së normave, vlerave dhe politikave të BE-së mund të ndodhë në tre plane përmjeherësh: në planin e politikave, të politikës si dhe të identiteteve politike dhe kombëtare. Shkalla sipërore e Evropianizimit në kuptimin e mësimit dhe brendësimit të normave do t' i përngjasonte sjelljes së protagonistëve në *reality show*-n e përmendur në hyrje: aktorët vendas do sillleshin *demokratisht* jo vetëm nën monitorim nga Evropa por edhe sikur Evropa të mos ishte aty: dmth demokratizimi dhe kryerja e reformave duhet të paraqiten jo si sforcim por si sjellje natyrale.

Sa më afër që është vendi në procesin e integritimit, aq më të dukshme dhe të thella janë dhe efektet e evropianizimit. Ka ndër ata që ngulmojnë edhe që përdorimi i Evropianizimit qoftë si skelet teorik apo dhe si ligjërimit për vendet jo-anëtare të Bashkimit Evropian është krejt i pavend; në këtë rast do të ishte më e saktë të flitej për BE-izim [EU-isation] (shih Diez et; al. 2005). Me të vërtetë, Evropianizimi i parë nga akademikët dhe politikëbërësit perëndimorë mund të ketë rigorozitet dhe koherencë kur aplikohet si kategori analitike vetëm në rastin e vendeve anëtare ose kandidatë të BE-së. Por parë nga larg Brukselit, gjuha e Europianizimit gëzon një status gati hegjemonik në debatet publike nacionale. Mungesa e dallimit të Evropianizimit si skelet teorik nga njëra anë dhe si ligjërimit modernizimi me anë të të cilit synohet krijimi i identiteteve demokratike nga ana tjetër është tipari kryesor si i ligjërimit zyrtar ashtu dhe i debateve politike mbi Evropën dhe integritimin Evropian në vende si Shqipëria.

Duke iu kthyer, skeletit teorik të evropianizimit, përkufizimi i Radaellit e zgjeron vërtet thelbësisht të kuptuarit të Europianizimit si një proces ndryshimi që vjen si pasojë e presionit të ushtruar nga BE-ja, sic sugjerojnë Thomas Risse dhe Tanja Borzel (Borzel e Risse, 2000). Por edhe në rastin e konceptualizimit të Radaellit, problemi kryesor ngelet relativisht i njëjtë si tek analiza e Borzel dhe Risse dhe e autorëve të tjerë të Evropianizimit: BE merret si aktor i dhënë, një herë e mirë e krejt i vecueshëm prej planit kombëtar, dmth i jashtëm dhe i dallueshëm prej aktorëve dhe proceseve që ndodhin në kontekstin e brendshëm kombëtar të vendit në fjalë. Proceset e interpretimit të vetë Evropës nuk merren parasysh ashtu si nuk merret parasysh që Evropa është rrallë aktor me identitet të saktë dhe të mirëpërcaktuar: të fiksuarit e vetë kuptimit të Evropës dhe të kufijve të saj identitarë dhe politikë është c'ka përcakton sot për sot debatet politike në vendet si brenda ashtu dhe jashtë BE-së.

Në rastin e vendeve jashtë BE-së, ose në priferinë e saj Evropa nuk është vetëm model demokracie apo qendër gravitacioni, por dhe strategji legjitimimi jo vetëm i programeve dhe alternativave politike por mbi të gjitha i të konceptuarit të politikës si asaj të brendshme dhe asaj të jashtme. Por kjo Evropë aq sa shërben për legjitimimin e politikave të ndryshme, aq dhe percaktohet, definohet dhe kuptimësohet në sajë të përdorimit që aktorët lokalë u bëjnë disa principeve bazë të marra qoftë nga doktrinat nacionaliste, apo qoftë nga ato moderniste apo si në shumicën e rasteve të vendeve të Evropës Juglindore ku këto dy lloj platformash të fund shekullit të XIX-të/fillim shekullit të XX-të përputhen, tek të dyja. Dhe këto procese interpretimi dhe kuptimëzimi nuk mund të shpjegohen brenda shtratit të ngushtë të Evropianizimit. Ajo c'ka sugjeroj është të parit me sy kritik të vetë gjuhës së Evropianizimit: në vend të një ngrehine të palëvizshme teorike apo kategorie analitike unë do sugjeroja ta merrim si një ligjërimit i cili përcakton pozicionet e autoritetit nga të cilat akademikët, politikë-hartuesit dhe politikanët interpretojnë "Evropën" dhe njëharazi marrëdhënien me të. Në këtë kuptim, Evropa i ngjan vërtet një 'fushë-beteja ligjërimore' (Diez, 2001) ku ndeshen aktorë politikë, akademikë e intelektualë. Synimet e këtyre ndeshjeve mund të jenë vërtet afatshkurtra e në fakt jo me shumë interes për këtë diskutim të këtushëm: c'ka del nga këto ndeshje është më domethënëse dhe më afatgjatë: dalin identitete jo vetëm të atyre që ndeshen por përvijëzohen dhe kufijte e asaj fushë-beteje ku luftohet. Në varësi të së dytës kristalizohen dhe të parat.

Duke u bazuar në metodologjinë e Analizës Kritike Ligjërimore [Critical Discourse Analysis] të themeluar nga Norman Fairclough dhe Ruth Wodak, pjesa që vijon prezanton rezultatet e përvijëzuara nga një

analizë tekstesh të ligjërimit zyrtar që nga fillimet e viteve 90' e deri më sot. Fokusi i analizës është përdorimi i 'Evropianizimit' si proces demokratizimi të brendshëm dhe të jashtëm dhe i "Orientimit Euro-Atlantik" si kurs i politikës së jashtme por dhe si identitet kombëtar që jo vetëm mbështet, por që i jep përmbajtje identitetit të shtetit shqiptar. Kështu, i përqasem Evropianizimit si një ligjërimit i cili është gjithmonë i kontestueshëm e në të njëjtën kohë asimilon brenda vetes të gjitha kundërshtitë e shërben kështu si bazë legjitimiteti si për identitetet shtetërore ashtu dhe për ato politike.

EVROPIANIZIMI I BRENDSHËM DHE EVROPIANIZIMI I JASHTËM: PROBLEME LEGJITIMITETI

Për të lexuar përdorimet e ndryshme të Evropës dhe të Evropianizimit na duhet ta kufizojmë debatin politik si debat kombëtar: temat dhe kategoritë konceptuale të debatit mundet të jenë më të gjera sesa kombëtare por kriteret e legjitimitetit të artikullimit të këtyre temave nga aktorët vendas mund të gjehen vetëm në repertorin vendas. Sic sugjerojnë Ole Waever dhe Lene Hansen (2001) bashkë me 'kombin' dhe shtetin', ose 'popullin' 'Evropa' është ndër konceptet bazë rreth të cilave organizohen sot debatet kombëtare politike. E megjithatë marrëdhënia mes këtyre tre koncepteve është e ndryshme nga njëri vend në tjetrin sepse dhe vetë interpretimi i këtyre koncepteve është i ndryshëm nga njëri kontekst kombëtar tek tjetri. Për më tepër, dhe brenda - përbrenda debatit politik kombëtar, përdorimi i 'Evropës' merr kuptime dhe ngjyime të kundërta në varësi të shtratit ideor dhe interesave të secilit aktor apo grup aktorësh që përfshihen në një debat të tillë.

Nga Brenda...

Për të kuptuar sesi interpretohet roli i Evropës dhe specifikisht i Bashkimit Evropian në demokratizimin e brendshëm të vendit, kam analizuar në vecanti sesi aritkullohet procesi i integritimit në Bashkimit Evropian. Duke qënë se procesi i Evropianizimit është proces reformimi të përgjithshëm që synon të afrojë vendin me Perëndimin, gjuha e Evropianizimit është pashmangërisht një gjuhë modernizimi, në të cilën *Tjetri* nuk përcaktohet në terma hapsinorë por në terma kohorë: tjetri është e Shkuara (Waever cituar në Hatzopoulos 2003: 32) Si rrjedhojë, elementë të vetë gjuhës modernizuese që Europa përdor për të *Tjerët* duke ndërtuar kështu njëkohësisht dhe identitetin e vet ndërfuten në repertorët kombëtare modernizues sic është psh korpusi i teksteve të Rilindjes Kombëtare. Kemi kështu një kombinim të ligjërimit modernizues të kombit-shtet me elementë të ligjërimit të qeverisjes demokratike të importuar nga raportet e BE-së, gjuha tekniko-akademike e specialistëve të politikave evropiane dhe ligjërimit më universal të ekonomisë së tregut dhe liberalizimit.

Portretizimi i BE-së si një mësuese e rreptë por e drejtë që korrigjon detyrat e bëra nga vendet candidate apo aspirante është imazhi që i përgjigjet më saktë marrëdhënies së kushtëzuar (conditionality) mes të dy palëve. Kjo metaforë përdoret si nga 'specialistë dhe ekspertë ligjorë dhe ekonomikë të procesit, ashtu dhe nga politikanët dhe zyrtarët e lartë. Ndërkohë që në rastin e përdorimit nga specialistë të çështjeve evropiane, kjo metaforë bën thirrje për 'eficiencë', 'sakrifica' dhe 'përkushtim', në rastin e përdorimit në debatin politik dhe në ligjërimin e aktorëve politikë metafora e BE-së si mësuese dhe gjyquese objektive thekson nevojën e harmonizimit të të gjithë zërave brenda spektrit politik në mbështetje të procesit të integritimit si dhe në mbështetje të reformave të ndërmarra nga qeverisa. Kjo thirrje për konsensus shoqëror për një proces që rëndom cilësohet dhe si mision historik (demonstrim ky i qartë ky i përkthimit të gjuhës së integritimit në gjuhën e modernizimit të shtetit-komb të fillim shekullit të 20-të), kërkohet në emër të Evropës dhe në emër të popullit ose herë-herë dhe të kombit përkundrejt 'klasës politike'. Ironia qëndron në atë që vetë aktorët politikanë kërkojnë konsensus mes-vedi dhe një lloj premtimi konsensusi të përgjithshëm popullor për integritimin në emër të popullit dhe të Evropës dhe në kundërvënien ndaj "klasës politike".

Kemi kështu një lloj dyfishësie rolesh të të njëjtëve aktorë: të folurit në emër të njerëzve dhe në emër të Evropës dhe të bërit thirrje klasës politike për të vënë interesat e tyre politike dhe ekonomike mënjane në emër të integritimit nga njëra anë dhe të vazhduarit të të qenit brenda skenës politike si pjesëtar i asaj klase politike që de-legjitimohet si konfliktuale dhe penguese e proceseve të integritimit. Kështu, Evropa interpretohet si e pozicionuar nga ana e popullit, e njerëzve dhe gjuha e Evropianizimit nga gjuhë teknike e cila ka një bazë shumë të hollë legjitimiteti politik kthehet në gjuhë ‘rezistence’ ose në ligjërime kontestues të pushtetit. Ky lloj interpretimi i Evropës qoftë si gjyqtare apo mësuese nga njëra anë apo qoftë si mbështetëse e ‘njerëzve’ kundër klasës së tyre politike është dominant dhe krejt i zakonshëm dhe në media. Perifrazimi i gjuhës së raporteve të BE-së dhe i deklaratave të zyrtarëve të huaj në termat e (BE/Komisioni Evropian/Parlamenti Evropian/Doris Pack etj.) “paralajmëroi”, “detyroi të ulen në tavolinë”, “bëri thirrje” përforcojnë këtë portretizim të BE-së dhe më në përgjithësi të “komunitetit evropian”. Po të huazonim terminologjinë e Norman Fairclough mbi “zërin e tretë” (Fairclough 1995) që është kurdoherë i pranishëm në tekstet e medias dhe që megjithëse jo i cituar fjalë për fjalë shërben për të legjitimuar apo de-legjitimuar fjalët e protagonistëve të ngjarjes së lajmit, ky “zë i tretë” do të ishte Evropa dhe “komuniteti ndërkombëtar”.

Kontradikta themelore këtu është se janë vetë aktorët politikë, dhe pjesëmarrësit në politikën e përditshme që kontrobuojnë në krijimin e një ligjërimi të tillë Evropianizimi. Përfundimi i kësaj dyfishësie është asimilimi i alternativave të vërteta kundrejt politikave të vecanta dhe de-legjitimimi i aktorëve të tjerë socialë, si sfera e biznesit (kujto debatin në të përditshmen *Shekulli* në 2004 rreth marrëveshjes së qeverisë së atëhershme me AlbAmbient, kur gjuha zyrtare iu kundërvu gjuhës së “biznesit” në emër të Evropës) apo e kulturës (kujto parehatinë e politikanëve me debatet identitare që shpesh herë nuk kanë lidhje direkte me debatet politike). Gjuha e evropianizimit kthen kështu ligjërimet e cdo fushe tjetër në ligjërime politik, ndërkohë që vetë alternativat politike i privon nga baza ideore.

Nga Jashtë...

Megjithë antagonizmin ekstrem mes dy grupimeve kryesore politike në Shqipëri, Partisë Socialiste dhe asaj Demokratike aktorët politikë të të dy krahëve kanë përsëritur vazhdimisht që ‘Orientimi Euro-Atlantik’ i vendit është pika më e qëndrueshme dhe që i bashkon të gjitha forcat politike në vend. Përpjekjet e zyrtarëve shqiptarë për të përcuar idenë e bashkimit dhe unitetit kombëtar si dhe harmonisë mes të gjithë forcave politike nuk mund të kuptohen krejt jashtë ligjërimin ballkanik të Perëndimit si dhe lenteve me anë të të cilave problematika e shteteve dhe shoqëri të Ballkanit është parë në vitet 90 nga Perëndimi: institucione të dobëta dhe shoqëri të ndara. Të dy faktorët kanë qënë dhe mbesin të lidhur pazgjidhmërisht me njëra-tjetrën: mungesa e konsensusit mes forcave politike dhe segmenteve të ndryshme shoqërore mund të minojë përpjekjet për ndërtim dhe konsolidim institucionesh demokratike, sic e ka demonstruar shume qartë rasti i Shqipërisë. Ajo c’ka është me interes në kontekstin e këtushëm është sesi dialogu dhe bashkëpunimi mes palëve politike është theksuar vazhdimisht nga vetë palët politike si një normë themelore e diktuar nga Evropa ose nga “ndërkombëtarët” si bazë si për stabilitetin dhe demokratizimin e brendshëm të Shqipërisë ashtu dhe për njohjen e saj nga jashtë si shtet demokratik dhe perëndimor. Në këtë linjë, dialogu dhe bashkëpunimi i brendshëm paraqiten si garancia më e fortë kundër devijimeve të mundshme nga rruga e Evropianizimit dhe nga “Orientimi Euro-Atlantik”.

Duke pasur parasysh retorikën e përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare në vend por dhe më gjerë, ligjërimin perëndimor të “përcarjeve etnike” në Ballkan (shih Hansen 2006) apo të luftës mbi terrorizmin të pas 11 shtatorit, arrij në përfundimin se dy mund të ishin alternativat më ekstreme të rrugës së Evropianizimit: politika nacionaliste nga njëra anë dhe radikalizimi i identiteve fetare nga ana tjetër. Mënyra që është ndjekur për të siguruar Evropën dhe “komunitetin ndërkombëtar” se Shqipëria nuk do të devijonte nga rruga e evropianizimit ka qënë ri-ndërtimi i disa narrativave bazë të identitetit kombëtar dhe rrjedhimisht të identitetit

të shtetit shqiptar. Këto narrativa kanë qënë të pranishme si në rastin e qeverisjes së majtë dhe në atë të qeverisjes së djathtë, megjithë zbejhen apo theksimin e tyre në momente kyce si në rastin e pas-1997 apo pas 11 shtatorit. Këto dy narrativa identitare do i vecoja si: narracioni i *tolerancës* dhe ai i *pragmatizmit* si tipare themelore të përbërjes kulturore-etnike të kombi shqiptar dhe rrjedhimisht dhe si parime që udhëzojnë politikën e jashtme të shtetit shqiptar.

Teza e pragmatizmit ka shërbyer si gur themelor i ligjërimit zyrtar të qeverisjeve socialistetë pas 1997-ës. Duke pasur parasysh si shkatërrimin ekonomik që pasoi përmbyshjen e piramidave por edhe rrënimin e legjitimitetit të jashtëm të shtetit shqiptar, qeverisja e re e majtë lëvizi nga gjuha e “mosndërhyrjes në punët e brendshme” që kishte karakterizuar deri atëherë ligjërimitin zyrtar, sidomos gjatë acarimit të marrëdhënive me Departamentin Amerikan të Shtetit në 1996 dhe me Greqinë në 1993-4. Kjo lëvizje nuk ishte thjesht ndryshim nga gjuha zyrtare por dhe nga gjuha që vetë të majtët kishin përdorur në fillim të viteve ‘90’s, dmth gjuha e “dyerve të hapura por jo të shqyera” (Nano, *ZP*, 21.06.1992). Theksi te ekonomia si koncept organizativ i ligjërimit zyrtar të majtë të pas 97-ës u shoqërua me kalimin nga “kombi” si nocion bazë i ligjërimit zyrtar të para 1997 në nocionin e “rajonit” dhe në krijimin kështu të një identiteti rajonal si shtyllë përbërëse e identitetit të shtetit shqiptar. Kjo nuk do të thotë se rajoni dhe demokratizimi i hapësirës ballkanike nuk ishte i pranishëm dhe në ligjërimitin zyrtar të demokratëve. Përkundrazi, duke iu referuar çështjes së Kosovës, Presidenti i atëhershëm Sali Berisha u shpreh qartë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës brenda dinamikës së demokratizimit të hapësirës ballkanike (Sali Berisha i cituar te Kola, 2003:309). Megjithatë vetëm pas 1997, “Ballkani” u bë i domosdoshëm për krijimin e një bazë legjitimiteti të jashtëm, dmth nga Perëndimi. Identiteti i shtetit shqiptar filloi të artikulohej në ligjërimitin zyrtar si pararendës i demokratizimit dhe Evropianizimit të rajonit.

Qëllimi ishte, sipas fjalëve të Ministrisë të atëhershëm të Punëve të Jashtme të kthehej Shqipëria nga “burim destabiliteti në partneri i Komunitetit Evropian” (Milo, *Punimet e Kuvendit Popullor*, 1997:247). Në këtë linjë, vetëm një politikë pragmatiste ndaj çështjes kombëtare në përgjithësi dhe asaj së Kosovës në vecanti sillej si opsioni i mundshëm për krijimin e kësaj lidhjeje partneriteti. Por duke e paraqitur pragmatizmin jo vetëm si tipar të shtetit shqiptar (dmth si cilësues i politikës së jashtme), por edhe si tipar etno-kulturor të kombit shqiptar, ligjërimiti zyrtar socialist synonte ruajtjen e idesë së iniciativës së shtetit shqiptar: dmth, megjithëse politika shtetërore do të ndiqte vijën e Komunitetit Evropian në lidhje si me politikën e jashtme dhe çështjen kombëtare në rajon, ndjekja e kësaj vije nuk ishte e imponuar si ndërhyrje nga jashtë, por e imponuar nga karakteri perëndimor dhe “orientimi Euro-Atlantik” i kombit shqiptar (shih p.sh. Nano, *Punimet e Kuvendit Popullor*, 1998:1323).

Në funksion të ndërtimit të këtij identiteti të shtetit shqiptar si i pajtueshëm me normat dhe vlerat evropiane është dhe teza e tolerancës. Megjithëse kjo tezë është përforcuar më shumë në kontekstin e pas-11 shtatorit (në variantin e tolerancës fetare), teza e tolerancës është artikuluar nga zyrtarët shqiptarë sidomos pas 1997 për ta vecuar shtetin dhe kombin shqiptar nga konteksti i dinamikës konfliktuale në rajon dhe rrjedhimisht për të nxjerrë në pah potencialin e Shqipërisë për të luajtur rolin e kepit emancipues dhe demokratizues të Ballkanit Frika e dhënies së idesë së simulimit, pra e ‘luajtjes sikur’ e normave dhe rregullave të BE-së ka shtyrë përpara një proces ndërtimi jo vetëm të një identiteti demokratik të shtetit por edhe një ri-interpretim të disa narrativave identitare të kombit për t’i dhënë përmbajtje këtij identiteti të shtetit.

E megjithatë secili krah politik është rrekur të de-legjitimojë kundërshtarin politik në sytë e Evropës dhe të ‘komunitetit ndërkombëtar’ me anë të atyre alternativave që janë cilësuar nga vetë ligjërimiti zyrtar si devijime nga rruga e Evropianizimit dhe nga ‘Orientimi Euro-Atlantik’. Të dy alternativat, si ajo e radikalizimit të identiteteve fetare dhe ajo e nacionalizmit radikal është kërkuar te kundërshtari politik. Kështu për shembull, anëtarësimi në Organizatën e Konferencës Islamike në 1992 shkaktoi reagimin e ashpër nga opozita socialiste që e interpretoi këtë hap si demonstrim i radikalizmit fetar të grupit politik në qeverisje. Po kështu, socialistët janë akuzuar vazhdimisht nga opozita demokratike gjatë 1992-1997 për kahje jo kombëtare dhe për mbështetje ndaj Serbisë dhe Rusisë në dëm të orientimit perëndimor të vendit. Në një moment a një tjetër secila palë ka

akuzuar palën kundërshtare për ndjekje të shembullit të Slobodan Milloshevicit. Ajo c'ka ka rëndësi këtu është se cdo alternative apo cdo delegitimim i kundërshtarit politik është bërë në emër të popullit dhe të Evropës, ose më mirë në emër të Evropianizimit të vendit dhe të Evropianizimit të popullit shqiptar. Kundërshtia këtu qëndron mes përpjekjeve nga njëra anë për të ndërtuar një identitet demokratik dhe përëndimor të shtetit shqiptar nga njëra anë dhe përpjekjeve për akumulim legjitimiteti të jashtëm nga ana e akotëve dhe partive politike duke de-legjitimuar kundërshtarit si mbartës i devijimeve të mundshme nga rruga e Evropianizimit. Kjo mospërputhje qëndron në themel (dhe rrjedhimisht minon nga themelet) te përpjekjet e aktorëve politikë për krijimin e një identiteti demokrat të shtetit shqiptar në periudhën pas-komuniste.

Ky mospajtim i ligjërimit zyrtar me ligjërimin politik nuk mund të shpjegohet me audiencat e ndryshme sic mund ta shpjegojnë Elizabet Burns (1972) me konceptin e saj te teatralitetit apo Wolfgang Iser me konceptin e tij të “lexuesit të nënkuptuar” (1984) Në këtë mes nuk shtrohet çështja nëse uniteti dhe harmonia mes palëve politike del në pah vetëm në ligjërimin zyrtar sepse audiencia për këtë ligjërimi është ajo e komunitetit ndërkombëtar (i.e. Evropa) ndërsa audiencia e ligjërimit politik është elektorati vendas. Unë mendoj se audiencia në të dy rastet është ajo ajo e komunitetit ndërkombëtar. Madje do ta shtyeja dhe me tej këtë sugjerim duke shtuar se në të vërtetë është ndjeshmëria ndaj vëzhgimit të Evropës dhe të “komunitetit ndërkombëtar” që i krijon të dyja ligjërimet e kundërta. Kështu Evropa apo ‘komuniteti ndërkombëtar’ i ngjan atij Syrit që ndjek pas kudo dhe i jep vetë identitetin personazhit kryesor, të *Librit të Zi* të Orhan Pamukut (2006:113). Kështu dhe Evropa kthehet njëkohësisht si në burim ashtu dhe në nevojë të përhershme legjitimiteti për aktorët politikë.

MENDIME PËRMBYLLËSE

Për ta përfunduar këtë diskutim aty ku e nisëm, do na duhej të pyesnim nëse këto përpjekje për krijimin e një identiteti demokratik të shtetit shqiptar dhe rindërtimin e një identiteti kombëtar perëndimor mund të ishin të ndryshme nëse audiencia, i.e. Evropa dhe ‘komuniteti ndërkombëtar’ nuk do të ishte *aty*. Kur e fillova diskutimin me konceptin e teatralitetit shqetësimi kryesor ishte loja “sikur” e politikanëve në skenën e brendshme dhe të jashtme politike: nga njëra anë sikur janë nën monitorim të përhershëm nga Syri i kudogjindshëm i Evropës dhe më gjerë i ‘komunitetit perëndimor’ dhe në të njëjtën kohë, sjellja sikur normat dhe vlerat e Evropës janë brendësuar tashmë dhe aktorët do të sillleshin në përputhje me identitetet e tyre demokratike dhe në përputhje me identitetin demokratik të shtetit edhe sikur Evropa të mos ishte më *aty*. Ajo c'ka duhet të pranohet është se njohja e një realiteti të ndryshëm nga ai ku prania dhe autoriteti i Evropës ndërtohet dhe përforcohet përditë si nga ligjërimi zyrtar ashtu dhe nga ai politik (dhe mediatik) është i pamundur. Ajo c'ka u përpoqa të bëj në këtë ese ishte të paraqitja sesi procesi i ndërtimit të një identiteti demokratik të Shqipërisë është pazgjidhshmërisht i lidhur me këtë proces ndërtimi të vazhdueshëm të autoritetit të Evropës. Përpjekjet e aktorëve politikë për të portretizuar kundërshtarit politik si mbartës të alternativave devijuese nga Evropianizimi duhet të shihen vetëm si përcapje për maksimizim të legjitimitetit të jashtëm të palës politike në fjalë por edhe si hapa minus të vetë kongruencës mes “klasës politike”, “shtetit” dhe “kombit”/“popullit” si kriter bazë i suksesit të projektit të integritimit evropian.

Ajo c'ka Tony Judt ka pasë parashikuar në lidhje me temën e identitetit Evropian sipas të cilit ai “ka zëvendësuar me të shpejtë diskursin politik të një minoriteti të ndërkryer intelektualësh, duke zënë kështu hapësirën që në një situatë tjetër duhet të zinin projekte liberale dhe demokratike...” (Judt, cituar te Mueller 2002:183) mund të perfrazohet lehtësisht dhe për “Evropën” dhe procesin e Evropianizimit në përgjithësi. Përdorimi i kudohershëm i Evropës si mjet legjitimes i cdo lloj argumenti politik nuk është provë evropianizimi: në rastin më të mirë është provë e asaj c'ka Thomas Diez e quan “Evropianizim ligjërimor” [Discursive Europeanization] dhe në rastin më të keq shkakton një tallazitje konceptuale rreth termit të përdorur dhe bën të padallueshme kriteret e legjitimitetit të politikave apo alternativave politike të cilat legjitimohen me anë të ‘Evropës’.

BIBLIOGRAFI

Baudrillard, Jean (1984) *Simulacra and Simulation*. Ann Arbor, MI: University of Michigan Press

Börzel Tanja A. and Thomas Risse, "When Europe Hits Home: Europeanization and Domestic Change" *European Integration online Papers (EIoP)* Vol. 4 (2000) N° 151 marë nga: <http://eiop.or.at/eiop/texte/2000-015a.htm>

_____. (1999) "Towards Convergence in Europe? Institutional Adaptation to Europeanisation in Germany and Spain" *Journal of Common Market Studies* 37:4 fq. 573-596

Burns, Elizabeth (1972) *Theatricality*, Londër: Longman.

Diez, Thomas; Apostolos Agnantopoulos; Alper Kaliber (2005) Turkey, Europeanization and Civil Society: Introduction, South European Society and Politics, Vol. 10: 1, fq. 1-15.

_____. (2001) Europe as a Discursive Battleground. *Cooperation and Conflict*, Vol. 36, Nr. 1, fq. 5-38.

Fairclough Norman, (1995) *Media Discourse*. Londër: Edward Arnold.

Hansen L. (2006) *Security as Practice. Discourse Analysis and the Bosnian War*. London and New York: Routledge.

Hatzopoulos, Pavlos (2003) "All that is, is nationalist? Eastern Imaginings of the Balkans since the Yugoslav Wars", *Journal of Southern Europe and the Balkans*, Vol. 5, Nr. 1, fq. 28-35

Iser, Wolfgang (1974) *The Implied Reader*. Baltimore; London: Johns Hopkins University Press

Judt, Tony (2002) The Past is another country: Myth and Memory in post-war Europe", në *Memory and Poëer in Post-War Europe*, editor Jan-Verner Mueller. Cambridge: Cambridge University Press.

Kola, Paulin (2003) *The Search for Greater Albania*. Londër: Hurst Publishing.

Pamuk, Orhan (2006). *The Black Book*. Faber and Faber. Londër.

Wæver O. (2001) Identity, communities and foreign policy.-In: Hansen L. and O. Wæver (ed) *European Integration and National Identity: The challenge of the Nordic States*, London: Routledge. 20-50.

Wodak Ruth, (1996) *Disorders of Discourse*, Londër: Longman.

Media

"Fjalim i Fatos Nanos në Kongresin e Parë të Partisë Socialiste" *Zeri i Popullit*, 21.06.1992

Burime Arkivore

Punimet e Kuvendit Popullor, Legjislatura e 15-te. 1997, 1998 (Parliamentary Recordings, 15th Legislature 1997, 1998)

INTERNACIONALIZIMI I SË DREJTËS KUSHTETUESE: KLAUZOLAT KUSHTETUESE TË INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË

Prof. Dr. Aurela Anastasi

Abstrakt. Çështja e raportit të normave ndërkombëtare me të drejtën e brendshme është shndërruar sot në një raport të rregulluar nga ligji themelor i shtetit, Kushtetuta. Artikulli përqendrohet në disa aspekte të këtij raporti, në vështrim aktual e të krahasuar. Me hollësi analizohet përvoja shqiptare, sistemi i ndërtuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe risitë që ka sjellë jurisprudenca kushtetuese deri më sot. Kjo bëhet e mundur përmes analizës së sistemit shqiptar të burimeve dhe të raportit midis burimeve ndërkombëtare me ato të brendshme. Në këtë analizë një vëmendje e posaçme i kushtohet analizës së sistemit shqiptar nga pikëpamja e aftësisë së tij për të siguruar të gjitha proceset e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian; vendit të posaçëm që ka zënë Konventa Evropiane për të drejtat e Njeriut, në sistemin e burimeve të së drejtës, të sanksionuar nga Kushtetuta; si dhe qëndrimin të gjyqtarit kushtetues në çështje që kanë lidhje me këto raporte.

HYRJE

Kushtetutat bashkëkohore janë angazhuar të përcaktojnë raportet midis rendit juridik ndërkombëtar dhe rendit juridik të brendshëm, si dhe procedurat përmes të cilave do të sigurohet pajtueshmëria midis normave të të dyja vendeve. Këto raporte manifestohen në mënyrën, sipas të cilës Kushtetuta bën të mundur integrimin e normave ndërkombëtare në rendin juridik kombëtar. Ndërkohë, e drejta kushtetuese zgjidh çështjen e vendit që zënë normat e së drejtës ndërkombëtare në kuadrin e hierarkisë së normave të brendshme. Ajo përcakton sistemin përkatës rregullator, i cili në vështrimin e përgjithshëm juridik, i ndihmuar edhe nga doktrina juridike, paraqitet në dy modele kryesore: *sistemi monist* dhe ai *dualist*. I pari është ndërtuar mbi bazën e doktrinës së përparësisë të së drejtës ndërkombëtare, sipas të cilit kjo përfaqëson jo vetëm një sistem të pavarur normash e rregullash, por edhe një rend juridik, që ka epërsi mbi të drejtën e brendshme. Thelbi është shprehur qartë në nenin 47 të Konventës së Vjenës “Për të drejtën e traktateve” (1969): “Njëra palë nuk mund të përdorë dispozitat e së drejtës së saj të brendshme si justifikim për moszekutimin e një traktati”. I dyti, *sistemi dualist*, është themeluar mbi bazën e njohjes së bashkekzistencës në mënyrë të pavarur të të dyja vendeve. Doktrina dualiste përjashton të gjitha rreziqet e konfliktit midis normave. Sipas saj, duke qenë se të dyja fushat trajtohen të lidhura shumë ngushtë me njëra-tjetrën, nuk ka nevojë të afirmohet përparësia e të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtën e brendshme dhe as e anasjella. Është fjala për një paralelizëm midis të drejtës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme, ku asnjëra prej tyre nuk mund të ketë epërsi mbi tjetrën.

Duke vlerësuar këto sisteme, vëmë re se në dallim nga analiza dualiste, ajo moniste bazohet në unitetin e rendit juridik dhe presupozon që sistemi juridik epror të ndodhet në situatë përparësie në raport me tjetrin. Në këtë kuptim, vetë sistemi monist shfaqet qartë në dy opsione: sistemi *monist ndërkombëtarist* (njihet përparësia e të drejtës ndërkombëtare mbi të drejtën e brendshme) dhe sistemi *kushtetues nacionalist* (i jep përparësi të drejtës kombëtare kushtetuese mbi atë ndërkombëtare). Këto sisteme janë përqafuar nga pjesa më e madhe e shteteve evropiane, duke ofruar tipare të ndryshme. Për të arritur në përfundime të sakta në lidhje me ndërthurjen e të

* Prof. Dr. Aurela Anastasi është një pedagoge dhe eksperte e njohur në fushën e të drejtës kushtetuese në përgjithësi dhe atë të Shqipërisë në veçanti. Në këtë fushë Prof. Dr. Aurela Anastasi ka botuar një sërë artikujsh dhe studimesh.

drejtës ndërkombëtare me të drejtën e brendshme, është e nevojshme të njihemi me klauzolat dhe procedurat e parashikuara në kushtetutë. Në këtë kuadër, duhet të zgjidhet ende çështja e vendit që i njihet të drejtës ndërkombëtare në gjirin e hierarkisë së normave. Ndodh që formulat dhe modelet e adoptuara nga shtetet e bëjnë të paqartë klasifikimin e tyre sipas sistemeve. Sidoqoftë, kur një kushtetutë kombëtare kërkon nxjerrjen e një akti, përmes të cilit mund të receptohet (*merret*) ose transformohet akti i së drejtës ndërkombëtare, me qëllim që ky i fundit të fitojë vlerë juridike, atëherë pushteti kushtetues ka bërë zgjedhjen e dualizmit.

Sistemi dualist

Një zgjedhje e tillë vihet re në disa Kushtetuta Evropiane. P.sh. Kushtetuta suedeze ka sanksionuar një procedurë të posaçme për inkorporimin e akteve ndërkombëtare në të drejtën e brendshme. Në rastet e shteteve që cilësohen si adoptuese të një sistemi dualist (Gjermani, Danimarkë, Finlandë, Britani e Madhe, Itali, Irlandë, Austri), praktika dhe jurisprudenca kanë parashikuar nevojën e një ligji për receptimin e të drejtës ndërkombëtare në të drejtën e brendshme. Kurse Kushtetuta austriake flet vetëm për “miratim” të traktateve ndërkombëtare nga këshilli kombëtar¹. Megjithatë, në procedurën e miratimit është fjala për një receptim të vërtetë të akteve ndërkombëtare. “Nga këta shembuj shihet se Kushtetutat e disa shteteve konfirmojnë ekzistencën e padyshimtë dhe rëndësinë e të drejtës ndërkombëtare. ...Por, ato... kufizohen në një zgjedhje të pjesshme dhe jo të plotë... Ndonëse kanë pranuar zbatimin e së drejtës ndërkombëtare si pjesë e sistemeve të tyre normative, nuk është shprehur se ç’ndodh në rast se ka përplasje..., midis normës të së drejtës ndërkombëtare dhe asaj të së drejtës së brendshme”². Kjo është arsyeja që një vend i rëndësishëm i është lënë praktikës e jurisprudencës kushtetuese.

Në disa shtete norma ndërkombëtare ka vlerën juridike të normës së brendshme, përmes së cilës është operuar për receptimin e saj. Më shpesh bëhet fjalë për një ligj të zakonshëm, por ka edhe raste të veçanta që receptioni të kryhet përmes ligjeve kushtetuese. Prandaj, kur ngrihet opsioni i dallimit midis këtyre normave të brendshme, natyra dhe përmbajtja e traktatit shndërrohet në përputhje me normën me të cilën është operuar për marrjen e tij në të drejtën e brendshme. Kështu p.sh. në Austri akti ndërkombëtar mund të ketë vlerë legjislativ apo kushtetuese, sipas faktit nëse i qëllon të jetë në legjislacion ose në kushtetutë.

Sistemi monist

Zgjedhja e njërit prej opsioneve të këtij sistemi sjell pasojat të rëndësishme për natyrën e vetë shteteve, në mënyrë të veçantë për sovranitetin e tyre. Opsioni *monist ndërkombëtarist* e vendos përparësinë e të drejtës ndërkombëtare mbi rendin juridik të brendshëm, përfshirë edhe mbi vetë kushtetutën, gjë që në fakt, të shpie në një farë mohimi të së drejtës së brendshme. Prandaj, lidhja tradicionale e pjesës më të madhe të shteteve evropiane me parimin e sovranitetit, ka bërë që pothuajse të gjitha shtetet moniste të ruajnë përparësinë e Kushtetutave të tyre në të drejtën ndërkombëtare.

Janë mjaft të rralla rastet kur shtetet kanë vendosur që norma ndërkombëtare të ketë përparësi edhe mbi vetë kushtetutën. Ky opsion ka gjetur vend vetëm në vendet evropiane, në historinë kushtetuese të të cilave sovraniteti në kuptimin e tij klasik nuk ka luajtur ndonjë rol të veçantë³. P.sh. Vendet e Ulëta kanë gjetur këtë zgjedhje: “Çdo dispozitë e një traktati që vjen në kundërshtim me kushtetutën, ose që mund të çojë në një mospërputhje me të, mund të miratohet nga dhomat e shteteve të përgjithshme vetëm nëse miratohet

¹ Dhoma e Ulët e Parlamentit austriak, e zgjedhur me votim të përgjithshëm

² Ksenofon Krisafi, “Kushtetuta shqiptare dhe e drejta ndërkombëtare”, botuar në “5-vjet Kushtetutë”, Buletin e posaçëm i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Venecias, Tiranë, 2004

³ C. Greve dhe Ruiz Fabri, “La situation respective du droit international et du droit communautaire dans le droit constitutionnel des Etats”, cituar nga Anne Lavade et Bertrand Mathieu, “L’Internationalisation du Droit Constitutionnel” (Raport General), 2005.

me 2/3 e votave” (art. 91/3 i kushtetutës holandeze). Epërsia e traktateve ndërkombëtare në raport me të drejtën e brendshme riafirmohet qartë edhe më tej në kushtetutën holandeze, pikërisht kur theksohet se: “Rregullat ligjore që janë në fuqi brenda mbretërisë, nuk do të zbatohen nëse ky zbatim është në mospërputhje me dispozitat e traktateve që janë të detyrueshme për të gjithë, ose në mospërputhje me rezolutat e institucioneve ndërkombëtare” (art. 94 i kushtetutës holandeze). Pra, kjo përparësi është e sanksionuar shprehimisht në ligjin më të lartë të shtetit, për t’i dhënë siguri institucioneve kushtetuese.

Shembulli i Republikës Franceze me kushtetutën e vitit 1946 e më pas në Republikën V (1958), u shoqërua me përhapjen e sistemit monist në pjesën më të madhe të shteteve të Evropës. Artikulli 55 i kushtetutës franceze të vitit 1958 është interpretuar në mënyrë klasike si mishërim i adoptimit të sistemit juridik monist⁴. Belgjika, Spanja, Greqia, Luksemburgu dhe Portugalia kanë adoptuar gjithashtu sistemin monist. Ashtu sikurse edhe për shtetet që kanë bërë zgjedhjen e dualizmit monizmi rezulton jo vetëm nëpërmjet dispozitave të shprehura në Kushtetutat përkatëse, por edhe nëpërmjet praktikës e jurisprudencës. Kjo mund të shihet qartë në Spanjë (neni 96 i kushtetutës spanjolle).

Së fundmi, pothuajse të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, në Kushtetutat e hartuara pas rënies së sistemit komunist të tipit sovjetik, kanë bërë zgjedhjen e sistemit monist përmes sanksionimit të shprehur në dispozitat e Kushtetutave të tyre. Këto Kushtetuta përfituan nga përvoja e konstitucionalizmit të zhvilluar në veçanti, pas Luftës së Dytë Botërore, duke nxjerrë mësim jo vetëm nga shembujt e suksesshëm, por edhe nga problemet e Kushtetutave të mëparshme të vendeve evropiane. Kështu, ato parashikuan dispozita më të detajuara e më të qarta mbi vendin e të drejtës ndërkombëtare në rendin përkatës juridiko-kushtetues⁵.

Rasti i Shqipërisë

Çështja e raportit midis të dyja sistemeve, që në kohën e hartimit të kushtetutës përbënte një gur prove për Shqipërinë, për shkak të detyrave që kjo e fundit ka pasur dhe ka, në lidhje me integrimin euroatlantik. Në tërësi Kushtetuta e ka zgjidhur në mënyrë të detajuar (pjesa VII) problemin e raportit, duke përcaktuar hierarkinë midis normave, procedurat e ndërfutjes së normave ndërkombëtare në rendin juridik të brendshëm, si dhe kompetencat e organeve përkatëse në këtë fushë. Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara zënë vendin e dytë pas kushtetutës dhe marrin fuqi mbiligjore (neni 116 i Kushtetutës). Duket se Kushtetuta nuk e ka lëshuar vendin e parë dhe ruan superioritetin e vet mbi të gjitha aktet e tjera normative, pra edhe mbi marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj (neni 116). Në këtë mënyrë, ajo e ka renditur Shqipërinë krahas shumicës së shteteve që kanë përqaftuar opsionin kombëtar kushtetues të sistemit monist. Aktet ndërkombëtare që vijnë menjëherë pas saj ratifikohen me ligj, por ruajnë epërsinë vetëm mbi ligjet e tjera që dalin në vend (neni 116, 122/2).

Në tërësinë e neneve të kushtetutës që përcaktojnë vendin e së drejtës ndërkombëtare (nenet 5, 17, 116, 121, 122, 123), një interes të veçantë paraqet neni 5 i saj: “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”. Në fakt, duke gjykuar edhe nga vendi i tij në kushtetutë (është vendosur në pjesën e parë: “Parime Themelore”), duhet të pranojmë karakterin e tij si parim i përgjithshëm kushtetues. Në këtë mënyrë ai i paraprin gjithë rregullimit të mëtejshëm që Kushtetuta i ka bërë statusit të së drejtës ndërkombëtare dhe raportit të saj me të drejtën e brendshme.

Në literaturën tonë juridike ka mendime se ky nen nuk ekziston në mënyrë të pavarur, por mund të

⁴ Neni 55 i kushtetutës franceze (1958): “Traktatet ose marrëveshjet e ratifikuara ose të miratuara rregullisht, sapo të miratohen kanë një fuqi më të madhe nga ajo e ligjeve, me rezervën për çdo marrëveshje a traktat, të zbatimit të saj nga pala tjetër”.

⁵ Kështu mund të përmendim kushtetutën bullgare (art.5/4), kusht. kroate (artikulli 140), kusht. e Estonisë (art.3/1), kusht. hungareze (art. 7/1), kusht. lituaneze (art.138), kusht. polake (art.87/1), kusht. rumune (art 11), kusht. sllovene (art 8), kusht. çeke art 10, si dhe atë shqiptare (neni 122).

⁶ Xhezair Zaganjori, “Vendi i së drejtës ndërkombëtare në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”, botuar në “Jeta Juridike”, nr.2, shkurt 2004

zbatohet i lidhur ngushtë vetëm me nenet e tjera përkatëse. Ky këndvështrim do t'i jepte nenit një karakter të thjeshtë deklarativ. Përkundrazi, mendimi tjetër që shpreh se neni 5 duhet t'i nënshtrohet një interpretimi më të gjerë⁶ duket më i arsyeshëm. Sipas këtij, në nocionin e të "drejtës ndërkombëtare të detyrueshme" për një shtet, do të ishin jo vetëm normat e traktateve apo të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, por edhe normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare zakonore, si dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Ka një sërë normash të së drejtës ndërkombëtare zakonore, të cilat, edhe pse janë të pranuar përgjithësisht, nuk gjejnë pasqyrim në traktatet apo në aktet të tjera formale të së drejtës ndërkombëtare. P.sh. detyrime të tilla ndërkombëtare si ndalimi i agresionit, ndalimi i gjenocidit, mbrojtja nga skllavëria, etj., kanë karakter superior në të drejtën ndërkombëtare, duke qëndruar mbi normat e tjera të saj⁷. Kjo është arsyeja që na shtyn në konkluzionin se neni 5 i kushtetutës shqiptare duhet të shihet nga operatorët tanë kushtetues dhe gjykatat, jo vetëm si një nen i lidhur ngushtë me nenin 122 të kushtetutës, por edhe si një dispozitë që gjen zbatim në mënyrë të pavarur. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese kur ka gjykuar rastin e pajtueshmërisë me kushtetutën, të dispozitave të Statutit të Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare. Ajo shprehet se:

...përderisa në bazë të kushtetutës rregullat e gjithëpranuara të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë e të drejtës së brendshme, atëherë edhe mungesa e imunitetit në proceset penale ndërkombëtare për krime të caktuara me rrezikshmëri të lartë, bëhet pjesë e sistemit juridik shqiptar.⁸

Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare⁹.

Një prej krerëve të kushtetutës (*Pjesa e VII, Kreu II: Marrëveshjet Ndërkombëtare*), i është dedikuar procedurave përmes të cilave bëhet i mundur adoptimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare, si një akt me fuqi normative në territorin e RSH-së. Nga mënyra se si ndërthuren ato në të drejtën e brendshme, Kushtetuta i ka ndarë marrëveshjet ndërkombëtare në dy kategori kryesore. Së pari, janë marrëveshjet ndërkombëtare që ratifikohen me ligj nga Kuvendi, në kuptimin formal të fjalës. Së dyti, marrëveshjet ndërkombëtare qeveritare, të cilat nuk ratifikohen me ligj.

Kushtetuta ka përcaktuar rastet që e bëjnë të domosdoshme ratifikimin me ligj të një marrëveshjeje ndërkombëtare (neni 121)¹⁰. Megjithatë, kuvendi, mund të ratifikojë edhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare, kur këtë e vendos shumica e anëtarëve të tij. Edhe pse ato nuk përfshihen në rastet e listuara shprehimisht nga Kushtetuta, një ratifikim i tillë mund të vendoset për arsye të ndryshme, p.sh. kur është fjala për seriozitetin e detyrimeve të parashikuara në marrëveshje, për besueshmërinë, për respektimin e reciprocitetit, etj. Në këtë kuadër duhet theksuar edhe fakti se e drejta ndërkombëtare nuk mund të kuptohet vetëm si e drejtë konvencionale.

⁷ Po aty. Një qëndrim i ngjashëm është shprehur edhe nga Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë, e cila duke interpretuar neni 25 të Kushtetutës gjermane, që ka pika të përbashkëta me neni 5 të Kushtetutës sonë, ("Rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare janë pjesë përbërëse e së drejtës federale..."), ka theksuar ndër të tjera se "...rregullat e përgjithshme të kësaj natyre që ka parasysh neni 25 i ligjit themelor, janë norma të së drejtës ndërkombëtare zakonore që përmbajnë parime themelore të së drejtës ndërkombëtare me karakter të përgjithshëm dhe të pranuar përgjithësisht".

⁸ Shih Vendim Nr. 186, dt. 23.09.2002, i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së.

⁹ Ratifikimi, në kuptimin e përgjithshëm, është akti me anën e të cilit, organi kompetent i një shteti, miraton një traktat në mënyrë përfundimtare. Në bazë të kushtetutës 1998, organi i vetëm kompetent për ratifikimin është Kuvendi. (Më gjerë shih "E drejta e Traktateve" në: Arben Puto "E drejta Ndërkombëtare Publike II", Tiranë, 2000, fq. 101-144.

¹⁰ "Ratifikimi dhe denoncimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga Republika e Shqipërisë bëhet me ligj në rastet kur ato kanë të bëjnë me:

- a) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
- b) të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe detyrimet e shtetasve, siç parashikohen në Kushtetutë;
- c) anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare;
- ç) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë;
- d) miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve;

Është e domosdoshme që me termin marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar (referuar në nenin 116 të kushtetutës) të nënkuptohen të gjitha aktet ndërkombëtare, të cilat mund të formalizohen si konventa, traktate, statute, etj.

Në rastin e dytë, përfshihen marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat nënshkruhen nga Këshilli i Ministrave dhe nuk ratifikohen me ligj. Këto marrëveshje nuk kanë të bëjnë me ndonjë nga rastet e parashikuara në kushtetutë për ratifikimin dhe denoncimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në shumicën e rasteve janë marrëveshje të lidhura në nivel qeveritar. Megjithatë, kryeministri ka detyrimin kushtetues të njoftojë Kuvendin sa herë që Këshilli i Ministrave nënshkruan një marrëveshje ndërkombëtare që nuk ratifikohet me ligj. Njoftimi i Kuvendit ka një rol të rëndësishëm në kontrollin parlamentar të veprimtarisë së qeverisë në fushën ndërkombëtare. Nga ana tjetër, ndoshta, njoftimi i Kuvendit është konsideruar nga kushtetutëvënësi si një veprim formal i mjaftueshëm, për të garantuar palët e marrëveshjes dhe për të mos e lidhur vullnetin e palëve vetëm me ekzistencën e qeverisë nënshkruese. Në këtë mënyrë, ndërrimi i qeverisë nuk mund të shërbejë si shkas për ndërrimin e njëanshëm të marrëveshjes apo për të kërkuar pavlefshmërinë e saj. Gjithashtu, mendojmë se ky njoftim luan edhe një rol të rëndësishëm formal, duke iu dhënë epërsi vendimeve të Këshillit të Ministrave për të nënshkruar një marrëveshje ndërkombëtare mbi vendimet e tjera të zakonshme për rregullimin e marrëdhënieve të brendshme. Megjithatë, duhet theksuar se marrëveshje të këtij tipi nuk kanë status kushtetues të barabartë me marrëveshjet e ratifikuara nga Kuvendi.

Hyrja në fuqi e marrëveshjeve ndërkombëtare

Kushtetuta kërkon që marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, të shpallen dhe të botohen sipas procedurave që parashikohen për ligjet e tjera të vendit. (117/3). Ndërkohë, kërkesa e kushtetutës për botimin e tyre në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, përbën kusht që marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar të bëhet pjesë e sistemit tonë të brendshëm juridik. Aktualisht, ligji për ratifikimin e marrëveshjes përkatëse shoqërohet edhe me botimin e shqipëruar të saj. Në këtë mënyrë është bërë e mundur që të korrigjohet praktika e gabuar e botimit të ligjit për ratifikimin pa tekstin e marrëveshjes, e cila u ndoq deri përpara hyrjes në fuqi të kësaj kushtetute. Kërkesa e botimit të tekstit të plotë të tyre buron edhe nga parimi i zbatimit të drejtpërdrejtë.

Zbatimi i drejtpërdrejtë i akteve ndërkombëtare të ratifikuara dhe epërsia e tyre mbi ligjet e vendit në rast përplasjeje.

Marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar me ligj zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur ajo nuk është e vetëzbatueshme dhe kërkon nxjerrjen e një ligji (122/1). Kushtetuta është shprehur qartë lidhur me zbatimin e tyre. Megjithatë, në praktikë ka ende një ndrojtje të dukshme për t'i referuar veprimet dhe operacionet e brendshme në aktet ndërkombëtare. Sidoqoftë, gjyqtarët e kanë thyer tashmë mitin e interpretimit të vendimeve të tyre vetëm mbi bazën e ligjit, duke u referuar edhe në tekstin e konventave ndërkombëtare. Në këtë proces ata kanë rolin më të rëndësishëm.

Kushtetuta e RSH-së e ka përcaktuar qartë epërsinë që marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar me ligj nga Parlamenti, ka mbi ligjet e vendit. Në këtë mënyrë, ajo mban një qëndrim të hapur të epërsisë të së drejtës ndërkombëtare mbi ligjet e vendit dhe zgjidh automatikisht përplasjet midis tyre, në favor të zbatimit të normës ndërkombëtare. Ndërkohë, disa Kushtetuta të vendeve të tjera kufizohen vetëm në pohimin se legjislacioni i tyre i brendshëm i konformohet rregullave dhe normave të së drejtës ndërkombëtare, pa e zgjidhur drejtpërdrejt konfliktin që lind midis normës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme, në rast se ka përplasje (Italia, Spanja, Maqedonia, Sllovenia), etj. Në këtë kuptim Kushtetuta jonë është më afër formulimeve të kryera nga Kushtetuta e Polonisë, Kroacisë, etj., në të cilat shprehet qartë epërsia e normave ndërkombëtare të ratifikuara mbi ligjet e brendshme të vendit, në rast konflikti midis tyre.

Për sa më sipër, duhet theksuar fakti se çështja e pajtueshmërisë së ligjit të vendit me një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar, është çështje e kontrollit të ushtruar nga Gjykata Kushtetuese. Kjo gjykatë vendos për pajtueshmërinë e ligjit me marrëveshjen ndërkombëtare. Marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm të RSH-së, duhet të zbatohen nga gjykatat e vendit. Por lind pyetja nëse gjyqtarët e gjykatave të zakonshme ndeshin papajtueshmëri të ligjit të brendshëm me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, cili do të jetë qëndrimi i tyre? Të respektojnë ligjin apo të respektojnë nenin kushtetues 122/1, i cili i autorizon ato të zbatojnë drejtpërdrejt marrëveshjen ndërkombëtare të ratifikuar nga Parlamenti. Padyshim që ata janë të lirë të zbatojnë drejtpërdrejt nenet e marrëveshjes ndërkombëtare, e cila ka superioritet mbi ligjet e brendshme. Të mos harrojmë se gjykatat janë ato që kanë gjithmonë të drejtën e zgjedhjes midis ligjeve që ata i mendojnë si të përshtatshëm për t'i zbatuar. Çështja e zbatimit të marrëveshjes ndërkombëtare në vend të një ligji të brendshëm të vendit që nuk përputhet me të, nuk është çështje e gjykimit nga Gjykata Kushtetuese. Ajo mbetet një çështje e thjeshtë e interpretimit gjyqësor, pra një çështje e gjyqësorit të zakonshëm. Nëse ndeshet me një rast të tillë, gjyqtari nuk mund të zbatojë nenin 145 të Kushtetutës, por nenin 122/1.

Ndryshe ndodh në rastet kur është fjala për zbatimin e një ligji, i cili përmban kufizime të të drejtave të njeriut, që vijnë në kundërshtim me KEDNJ-në ose me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast, gjyqtari i zakonshëm nuk do të ndjekë zbatimin e nenit 122/1, por do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke referuar çështjen, në bazë të nenit 145 të Kushtetutës. Kjo buron nga vetë hierarkia e normave, për shkak se në këtë rast Konventa ka një status kushtetutor.

FORMULAT KUSHTETUESE SPECIFIKE PËR INTEGRIMIN EURO-ATLANTIK TË SHQIPËRISË

Duke analizuar me kujdes statusin kushtetues të akteve ndërkombëtare, krahas qëndrimit të përgjithshëm të përshkruar më sipër, konstatojmë edhe formula specifike të parashikuara nga Kushtetuta e Shqipërisë, të cilat lidhen me pjesëmarrjen e saj në organizata *supra* kombëtare. Formula e parë ka të bëjë me epërsinë e normave të kësaj organizate mbi të drejtën e vendit (neni 122/3 i Kushtetutës). E dyta parashikon transferimin e pushtetit tek një organizatë ndërkombëtare (neni 123 i Kushtetutës). Të dyja këto formula përbëjnë një bazë të rëndësishme kushtetuese për pjesëmarrjen e Shqipërisë në një organizatë ndërkombëtare, në vijim të vullnetit të saj të shprehur në marrëveshjet e arritura me këto organizata. Edhe pse nuk kemi pasur ende raste të zbatimit të këtyre dispozitave, mendojmë se ato janë të lidhura me njëra-tjetrën. Vetëm të marra së bashku ato i japin kuptimin e një organizate më të lartë, Bashkimit Evropian, gjë që heq shqetësimin e shprehur nga studiues për një status të papërcaktuar të BE-së¹¹. Këto dispozita ndihmojnë që sovraniteti i popullit, i cili që në artikullin e parë të Kushtetutës është afirmuar dukshëm si parim bazë i këtij shteti, të mos kuptohet si një sovranitet *summa potestas* i pandryshueshëm, por si një çështje fleksibël.

Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare që vendosin epërsinë akteve të një organizate ndërkombëtare, mbi të drejtën e vendit

Mbi bazën e nenit 122/3, Republika e Shqipërisë mund të ratifikojë marrëveshje me një organizatë ndërkombëtare, në të cilën të parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej saj. Në këtë lloj marrëveshjeje, në rast konflikti, normat e nxjerra prej kësaj organizate do të kenë epërsi mbi të drejtën e vendit. Deri më sot nuk është bërë e mundur të kemi ndonjë marrëveshje ndërkombëtare të këtij lloji, por nga interpretimi gjuhësor i dispozitës (neni 122/3) dhe nga krahasimi i saj me dispozitat e tjera, arrijmë në konkluzionin se këtu nuk

¹¹ Shih: Alfred Kellermann, "Impakti i anëtarësimit në BE në rendin e brendshëm ligjor të Republikës së Shqipërisë", botuar në revistën: "E drejta parlamentare dhe politikë ligjore", nr.1, viti 2007

është fjala vetëm për epërsinë mbiligjore të akteve të nxjerra nga kjo organizatë ndërkombëtare. Kjo dispozitë parashikon një epërsi të normave të organizatës ndërkombëtare mbi të gjithë korpusin e të drejtës së brendshme të vendit, pra edhe mbi vetë Kushtetutën. Sidoqoftë, ajo dispozitë mbetet disi e paqartë për sa kohë që nuk është zbatuar në praktikë dhe për sa kohë që nuk ka ndonjë interpretim të saj nga Gjykata Kushtetuese. I paqartë mbetet edhe interpretimi i saj në lidhje me nenin 123 të Kushtetutës (shih në vijim). Prandaj, unë bashkohem me mendimin e studiuesit Kellermann, sipas të cilit shihet e udhës që referencat për efektet dhe statusin e legjislacionit të BE-së në sistemin ligjor shqiptar duhet të shtohen në Kushtetutë së bashku me bazat ligjore për anëtarësimin në BE¹².

Transferimi i pushtetit normativ tek një organizatë ndërkombëtare

Në Kushtetutë është parashikuar mundësia e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat vendoset për çështje të caktuara, delegimi i kompetencave shtetërore tek një organizatë ndërkombëtare (neni 123). Konkretisht, në marrëveshje të tilla ndërkombëtare, sipas vullnetit të Kuvendit (ose me referendum), ndodh transferimi i një pjese të pushtetit për çështjen, përfshirë edhe pushtetin normativ. Gjithçka mund të vendoset me shumicën absolute të Kuvendit, përmes ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare që e parashikon shprehimisht sa më sipër. Kuvendi është sovran vetë në këtë transferim specifik kompetencash dhe madje është i lirë të vendosë nëse do ta bëjë ai vetë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje apo do të vendosë që ratifikimi të bëhet me referendum.

Edhe pse në praktikë ende nuk është bërë e mundur të kemi ndonjë marrëveshje ndërkombëtare të këtij tipi, mund të bëjmë disa përsiatje në kuadrin e integritetit të Shqipërisë. Duhet pranuar se në këtë kuadër kalimi i çështjes në referendum paraqet përparësitë ose disfavoret e tij. Paraqet përparësi, pasi një marrëveshjeje i forcon pozitat e saj kur ka marrë miratimin e përgjithshëm popullor përmes referendumit. Nga ana tjetër, një referendum mund të bëhet pengesë ose të ngadalësojë një marrëveshjeje të këtij tipi (kujo rastin e Francës në qëndrimin ndaj Kushtetutës së BE-së). Këtë e themi për faktin se neni 123 i Kushtetutës mund të përbëjë një bazë të mirë ligjore për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Edhe pse kemi mendimin që do të ishte më mirë që Kushtetuta të kishte parashikuar në mënyrë të posaçme një klauzolë specifike me të cilin të autorizonte anëtarësimin e Shqipërisë në BE, përmes nenit 123 si dhe 122/3, mund të realizohet qëllimi pa asnjë pengesë. Është më se i qartë vullneti popullor në Shqipëri për të shpejtuar procedurat për integrimin e saj në Bashkimin Evropian. Madje referendumi që qëndron si një mundësi në Kushtetutë nuk do të ishte ndonjë procedurë e domosdoshme në këtë rast.

Procedurat që garantojnë pajtueshmërinë midis normave të brendshme kushtetuese dhe normave ndërkombëtare

Parimi i kushtetutshmërisë dhe i sigurisë juridike dikton garantimin e pajtueshmërisë së normave ndërkombëtare që hyjnë në rendin juridik të brendshëm me normat kushtetuese të brendshme. Kontrolli kushtetues mbi to ekziston në të gjitha shtetet evropiane (me përjashtim të dy prej tyre, Belgjikës dhe Zvicrës). Në mjaft kushtetuta janë sanksionuar formula të ndryshme të këtij kontrolli. Në mënyrë të përgjithshme ai është mjaft i rëndësishëm për të krijuar uniformitetin e dëshiruar. Megjithatë, një vlerë të madhe paraqet qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese, i cili varet nga sistemi (nëse ky i fundit është monist apo dualist)¹³, si dhe nga fakti nëse kontrolli kushtetues është konkret apo abstrakt. Megjithatë, një ndryshim themelor në këtë kontroll

¹² Po aty.

¹³ Në këtë rast imponohet edhe një saktësim terminologjik: termi “pajtueshmëri”, duket më i përshtatshëm se sa termi “kushtetutshmëri”, për të dhënë raportin e përputhshmërisë së një norme me të ulët, në raport me normën më të lartë që është Kushtetuta.

¹⁴ Neni 54 i Kushtetutës franceze (1958): “Në qoftë se Këshilli Kushtetues, pas kërkesës së Presidentit të Republikës, të kryeministrit ose të kryetarit të njëres prej të dy dhomave, deklaron se një angazhim ndërkombëtar përmban një dispozitë në kundërshtim me Kushtetutën, autorizimi për ratifikim ose për miratim mund të jepet vetëm pas rishikimit të Kushtetutës”.

përbën edhe fakti nëse do të jemi përpara një kontrolli *a priori* apo *a posteriori*. Në rastin e parë, traktati ndërkombëtar i nënshtrohet gjykimit kushtetues përpara ratifikimit të tij. Neni 54 i Kushtetutës franceze¹⁴ parashikon një formulë të tillë. Kontrolli do të kryhet përpara ratifikimit, por hyrja në fuqi e traktatit (nëse Gjykata Kushtetuese vëren ndonjë papajtueshmëri) bëhet pas një rishikimi paraprak të Kushtetutës. Modelin *a priori* kanë zgjedhur edhe Bullgaria, Spanja, Hungaria, Portugalia si dhe Shqipëria.

Nuk ka dyshim që kontrolli paraprak i kushtetutshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare i përshtatet më mirë natyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe zbatimit më të mirë të parimit “*pacta sunt servanda*”. Në rastin e një kontrolli *apriori*, presupozohet se akti ndërkombëtar i paratifikuar nuk ka hyrë në fuqi, ndërkohë që mund të jetë vënë në lëvizje Gjykata Kushtetuese. Në këtë kuadër lind pyetja: çfarë pasoje do të ketë nëse gjyqtari kushtetues vëren papajtueshmëri të aktit ndërkombëtar objekt shqyrtimi dhe Kushtetutës? A mundet gjyqtari kushtetues të marrë vendime të tilla, që do ta bënin të paarrtshëm ratifikimin e një traktati ndërkombëtar? Ka disa opsione në lidhje me përgjigjen, të cilat janë përcaktuar shprehimisht nga kushtetutat ose praktika kushtetuese e shteteve të ndryshme.

Së pari, shteti mund të heqë dorë nga ratifikimi i traktatit. P.sh. këtë zgjidhje e ka bërë Franca, në lidhje me ratifikimin e kartës së gjuhëve rajonale ose minoritare, në përputhje me vendimin e Këshillit Kushtetues Francez (nr. 99-142 DC të 15 qershorit 1999).

Së dyti, shteti detyrohet të formulojë një rezervë mbi pikat e mosmarrëveshjeve në momentin e ratifikimit. Konventa e Vjenës (23 maj 1969), “Mbi të drejtën e traktateve”, parashikon mundësinë për të formuluar rezerva gjatë nënshkrimit, ratifikimit ose miratimit të një traktati (art. 19). Megjithatë, ky opcion nuk mund të zbatohet në rastet kur formulimi i rezervës ndalohet nga vetë traktati.

Së treti, shteti bën një rishikim të Kushtetutës, me qëllim që të eliminohen elementët e papajtueshmërisë. Kjo zgjidhje është parashikuar shprehimisht në kushtetutat e mjaft vendeve evropiane (Kushtetuta franceze neni 54, kusht. spanjolle neni 95/1, kusht. portugeze art. 279/4). Në këtë rast, rishikimi i Kushtetutës mund të marrë forma të ndryshme. Megjithatë, të rishikosh një dispozitë kombëtare me qëllim që të eliminosh rregullën që vjen në kundërshtim me traktatin ose të përfshih në Kushtetutë një klauzolë specifike që sjell një autorizim kushtetues për ratifikimin e këtij traktati, do të thotë që bashkë me të të vijë edhe detyrimi për të shfuqizuar normën kushtetuese të kundërt.

Duke u përsiatur në përvojat e vendeve të ndryshme, për të garantuar pajtueshmërinë midis normës ndërkombëtare dhe normës kushtetuese kombëtare, janë evidentuar dy rrugë kryesore: *së pari*, vendosja e kësaj pajtueshmërie midis të dyja normave, përmes interpretimit kushtetues; *së dyti*, në rast të pamundësisë për të parën (për shkak kundërshtie), vendoset rishikimi i Kushtetutës. “Kjo fushë është tipike për të ilustruar vetëpërmbytjen gjyqësore”.¹⁵ Gjyqtari kushtetues ndodhet përpara çështjes që duhet të mbrojë parimin e rëndësishëm kushtetues “*pacta sunt servanda*”, por në të njëjtën kohë ai duhet të mbetet garant i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kjo është arsyeja që ai përpiket paraprakisht për një interpretim konformues maksimal, për të shmangur rrjedhojat në planin ndërkombëtar¹⁶. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese Shqiptare, kur ka gjykuar rastin e pajtueshmërisë me Kushtetutën, të dispozitave të Statutit të Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare.

Në të kundërt, disa shtete të Evropës kanë zgjedhur modelin *a posteriori*, gjë që do të thotë se kërkesa mund të kryhet ndërkohë që traktati është në fuqi. Kjo mund të ndodhë si përkundër ligjit që ka ratifikuar traktatin (në shtetet ku nevojitet një ligj për të receiptuar traktatin, p.sh. në Austri), ashtu edhe përkundër traktatit vetë (p.sh. në Gjermani, Itali). Ky lloj kontrolli mund të jetë problematik sidomos në lidhje me faktin se deri në ç’masë traktati që ka hyrë në fuqi kufizohet nga një kontroll i kushtetutshmërisë *stricto sensu* të tij.

¹⁵ Kristaq Traja, Drejtësia Kushtetuese, Luarasi, Tiranë, 2000, fq. 170

¹⁶ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese shqiptare nr. 186, dt. 23.09.2002, me objekt: “Pajtueshmëria me Kushtetutën e RSH-së, i Statutit të Romës për Gjykatën Penale ndërkombëtare”

Situata bëhet më komplekse kur disa shtete e mbajnë këtë tip kontrolli edhe atëherë kur vetë Kushtetuta e tyre kombëtare parashikon kontrollin e pajtueshmërisë *a priori*. Është pikërisht rasti i Spanjës, në të cilën Kushtetuta parashikon shprehimisht në një dispozitë (art. 95/2) dy modele kontrolli, *a priori* dhe *a posteriori*¹⁷.

Tendenca e kohëve të fundit tregon se kontrolli *a priori* është më i preferuar, pasi të lejon të menaxhosh integritetin e rendit kushtetues në rastin kur ratifikimi nuk mund të ndërhyjë. P.sh. Kushtetuta franceze është rishikuar në dy raste për të lejuar ratifikimin e traktateve, papajtueshmëria e të cilave me Kushtetutën është ngritur nga Këshilli Kushtetues. Ky procedim është përdorur gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme edhe në kuadrin specifik të së drejtës së Bashkimit Evropian, gjë që të shpie në një evropianizim të vërtetë të kushtetutave kombëtare.

Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës

Kushtetuta e vitit 1998 e ka siguruar vazhdimësinë e *statusit* të akteve ndërkombëtare të miratuara përpara hyrjes së saj në fuqi. Ajo i ka konsideruar marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat janë ratifikuar përpara hyrjes në fuqi të saj, si të ratifikuara në bazë të kësaj kushtetute. Pavarësisht nga ndryshimet që njihte procedura e ratifikimit të akteve ndërkombëtare në bazë të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” (1991), ato do të konsiderohen si të ratifikuara në bazë të Kushtetutës në fuqi. Megjithatë, Kushtetuta ka ngarkuar Këshillin e Ministrave që të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, nëse konstaton se ndonjë prej marrëveshjeve ndërkombëtare të mëparshme, përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me këtë kushtetutë. Kushtetuta nuk ka përcaktuar ndonjë afat për këtë qëllim. Sidoqoftë, është fjala për një kontroll *a posteriori*, i cili zbatohet vetëm për këtë rast.

Veçoritë e statusit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Thirja e drejtpërdrejtë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga art. 17 i Kushtetutës, i cili thekson se ligji që kufizon një të drejtë, në asnjë rast nuk mund të tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 17/2) është një garanci karakteristike vetëm për Kushtetutën e Shqipërisë. Në botë ka përvoja të ndryshme të statusit që i është dhënë Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ka vende të cilat i kanë dhënë asaj një status kushtetues (Austria), ndërkohë që vende të tjera, siç është rasti i Holandës, i ka caktuar një pozicion mbi Kushtetutën e vendit. Megjithatë, grupi më i madh i shteteve e trajtojnë Konventën si një akt me fuqi ligjore ose mbiligjore.

Përvoja jonë karakterizohet nga disa veçori¹⁸. Prandaj lind nevoja e njohjes më të thellë të raportit që ekziston midis të drejtës së brendshme shqiptare dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Padyshim që Shqipëria bën pjesë në grupin e atyre vendeve që i kanë dhënë KEDNJ-së një fuqi mbiligjore (neni 122/2). Kjo do të thotë se nenet e Konventës janë vendosur mbi ligjet e brendshme por jo mbi Kushtetutën. E njëjta gjë është bërë e zakonshme edhe për një numër të madh kushtetutash evropiane. Por kjo merr një përmbajtje tjetër nëse lexojmë nenin 17/2 të Kushtetutës sonë, në të cilën konventa thirret drejtpërdrejt dhe merr një status të barabartë me vetë Kushtetutën.

Në këtë mënyrë arrijmë në mënyrë indirekte në përfundimin se të drejtave të parashikuara në KEDNJ nuk iu është garantuar një status kushtetutor për sa i përket përmbajtjes së tyre, por

¹⁷ Neni 95 i Kushtetutës spanjolle (1978): “1. Nënshkrimi i një traktati ndërkombëtar që përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, kërkon paraprakisht një rishikim të Kushtetutës. 2. Qeveria ose njëra nga të dy dhomat, mund t’i kërkojë Gjykatës Kushtetuese që të shprehet nëse ekziston ose jo një kundërshtim i tillë”.

¹⁸ Shih: Kristaq Traja, “Kushtetuta dhe sistemi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut”, botuar në “Kushtetuta e re shqiptare sfida e së ardhmes euroatlantike të Shqipërisë”, Luarasi, Tiranë, 2002

¹⁹ Po aty.

një status i tillë është parashikuar për kufizimet e këtyre të drejtave. Kjo doktrinë e identitetit të kufizimeve, siç do ta quaja, është veçoria më e dukshme e Kushtetutës sonë. Këtë gjë nuk mund ta gjeni në asnjë sistem tjetër juridik.¹⁹

Duket se qëllimi i hartuesve të Kushtetutës ka qenë vendosja e rezervës ligjore mjaft të përforcuar me qëllim që të sigurohej një garanci e fortë për të pasur një masë të përshtatshme të ndërhyrjes së shtetit në të drejtat e njeriut dhe për të mos lejuar arbitraritetet, të cilat mund të ndëshkoheshin nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për saktësi, duhet të theksojmë se vetëm kufizimet e Konventës janë ngritur në nivel Kushtetues. Kjo sjell si pasojë nevojën e referimit të gjyqtarëve drejtpërdrejt në të nevojën e përputhjes së ligjeve me kufizimet e parashikuara në të, nevojën e njohjes së vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, që kanë për objekt kufizimin e të drejtave të njeriut dhe referimin në to.

Edhe pse thirrja e drejtpërdrejtë që i bëhet Konventës Evropiane nga Kushtetuta i referohet vetëm kufizimeve të të drejtave të njeriut, jo pak vëmendje i duhet kushtuar përmbajtjes së neneve të saj. Kjo, sepse të drejtat themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutën shqiptare, janë ndërtuar në mënyrë identike me nenet përkatëse të Konventës Evropiane (me ndonjë përjashtim të vogël). Kjo e lehtëson punën e gjyqtarit, i cili, nëse gjykon një çështje të caktuar të lidhur me lirinë e individit, mund të referohet njëkohësisht në dy nenet përkatëse të Kushtetutës dhe të Konventës. Ato nuk sjellin ndryshime a kundërshti, gjë që lehtëson punën e gjyqtarit. P.sh. neni 27 i Kushtetutës mund të shihet i lidhur ngushtë me kufizimet e parashikuara në nenin 5 të Konventës Evropiane. Problem mund të shtrohet vetëm në rastet kur formulimet në Kushtetutën shqiptare kanë devijuar paksa nga formulimet në Konventë. Të tilla mund të përmendim të drejtën e organizimit, të tubimit, të mitingjeve paqësore etj. Në këto raste gjykatat dhe gjyqtarët janë të detyruar të respektojnë Kushtetutën dhe kufizimet përkatëse. Detyrimi kushtetues për të respektuar Konventën dhe kufizimet në të, lehtësojnë mjaft punën e gjyqtarit, i cili mund t'i referohet me lehtësi të dyja neneve (të Kushtetutës dhe Konventës) në mënyrë të barabartë kur është fjala për kufizimet e të drejtave të njeriut dhe detyrohet të ndjekë kështu parimet e gjykimit të Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut. Po në mënyrë të barabartë mund t'iu referohet neneve të Kushtetutës dhe të Konventës, kur ato janë formuluar në mënyrë simetrike. Konventës mund t'i referohet duke i dhënë fuqi mbilgjore por jo të barabartë me Kushtetutën, në rastet kur formulimet nuk janë të barabarta. Në të gjitha rastet e parashtruara më sipër do të ishte e vështirë të devijohesh nga praktika e Strasburgut. Përmbajtja e tyre thelbësore interpretohet dhe zbatohet në përputhje me praktikën e Strasburgut. Formulimi i ndryshëm, më shumë sesa për gjyqtarët, lë një hapësirë më të gjerë për organet shtetërore që prodhojnë norma juridike, të cilat vlerësojnë në përputhje me Kushtetutën hapësirën për të marrë masa mbrojtëse dhe për të ndërhyrë në fushën e të drejtave të njeriut.

Një garanci tjetër me karakter ndërkombëtar na jepet edhe përmes mbrojtjes që ofrojnë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat kanë fuqi mbilgjore. Në përgjithësi konventat ndërkombëtare përbëjnë një bazë të domosdoshme të të drejtave që nuk mund të shkelen, ndërkohë që nuk e pengojnë të drejtën e brendshme të ecë e të përparojë më tej për të afirmuar e mbrojtur të drejtat e njeriut²⁰. Qëndrim të njëjtë ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese shqiptare, e cila është shprehur qartë se:

E drejta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut sanksionon, si rregull, vetëm një minimum bazë të lirive dhe të të drejtave, ndërkohë që shtetet palë në konventat ndërkombëtare mund të ngrihem mbi këto minimume dhe të implementojnë ligje kombëtare që përmbajnë ose mund të përmbajnë dispozita të një karakteri më të gjerë.²¹

²⁰ Shih: Pierre Bon, "Les droit et libertès en Espagne. Èlèments pour une théorie générale", botuar në "Dix ans de democratie constitutionnelle en Espagne", Paris, 1991

²¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, Nr.3/04

DEMOKRATIZIM PA POLITIKË: BAZA KONCEPTUALE E QASJES NDERKOMBËTARE NË SHQIPËRI

Blendi Kajsiu*

Abstrakt. Qëllimi i këtij punimi është të nxjerrë në pah bazën konceptuale dhe presupozimet bazë, mbi të cilat bazohen përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për të ndihmuar demokratizimin e Shqipërisë. Për këtë qëllim, artikulli shqyrton disa nga qasjet kryesore në fushën e demokratizimit. Argumenti kryesor është që, pavarësisht specifikave, të gjitha këto qasje e anashkalojnë ose e neglizhojnë politikën si kategori analitike dhe empirike. Në shumicën e rasteve politika ose është e parëndësishme përballë kategorive më “esenciale” si kultura apo struktura shoqërore, ose përcaktohet thatë si ndërveprimi mes aktorëve të ndryshëm politikë. Në këtë punim kjo mangësi nxirret në pah dhe kritikohet. Në fund të esesë eksplorohet mundësia e rikonceptualizimit të politikës si akt themelues dhe jo reflektim i faktorëve më të “thellë” si kultura apo struktura shoqërore.

HYRJE

Faktori ndërkombëtar ka pasur dhe vazhdon të ketë një rol të veçantë dhe të rëndësishëm në procesin e demokratizimit të Shqipërisë. Ky rol shtrihet në pothuajse çdo qelizë të jetës politike dhe shoqërore shqiptare, aq sa është e vështirë ta veçosh atë nga faktori i brendshëm. Në fakt, koncepte të tilla si “faktori ndërkombëtar”, ndonëse të shumëpërdorua, përbëjnë para së gjithash kategori analitike më shumë sesa realitete faktike, për të paktën dy arsye. Së pari, është e vështirë të ndash qartazi rolin e faktorit lokal nga ai i atij ndërkombëtar në proceset e demokratizimit. Të dy këta faktorë janë aq të ndërthurur dhe të ndërvarur sa që do ishin të pakuptimtë në mungesë të njëri-tjetrit. Sjellja e faktorit ndërkombëtar mund të kuptohet vetëm në raport me veprimtarinë e faktorëve politikë lokalë dhe anasjelltas. Së dyti, “faktori ndërkombëtar” përbën një kategori jo gjithmonë të saktë përgjithësuese. Në të përmbledhen një sërë organizmash, shtetesh dhe faktorësh perëndimorë, që nuk ndajnë gjithmonë të njëjtën fushë veprimi apo axhendë politike. Kështu, nga njëra anë kemi organizma si OSBE-ja, që përqendrohet tek problematika e demokratizimit, që ka të bëjë me procese politike si zgjedhjet e lira, apo Delegacionin e Bashkimit Evropian, që përqendrohet në procesin e demokratizimit në funksion të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Nga ana tjetër, kemi faktorë të tillë të rëndësishëm si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që përtej demokratizimit dhe integritetit të Shqipërisë fokusohen edhe në rolin e saj gjeostrategjik dhe si partner në luftën kundër terrorizmit.

Megjithatë, përtej specifikave politike, ekzistojnë të paktën dy arsye se përse këto organizma mund të klasifikohen si një faktor i vetëm në raport me proceset e demokratizimit në Shqipëri. Së pari, të gjithë përtej specifikave të tyre institucionale dhe politike ndajnë një objekt të përbashkët veprimtarie; demokratizimin e

* Blendi Kajsiu është pedagog në Universitetin Europian të Tiranës (UET) si dhe student në programin e doktoraturës, *Ideology and Discourse Analysis (IDA)* të Universitetit të Esekstit. Ai është diplomuar në Ekonomi dhe në Shkencë Politike nga Universiteti Amerikan në Bullgari (AUBG). Më pas ka kryer një Master në Studimet Ndërkombëtare të Paqes dhe Konfliktit në Universitetin Notre Dame, SHBA, si dhe një Master në Analizën e Ideologjisë dhe Diskurit nga Universiteti i Esekstit, në Britaninë e Madhe.

Shqipërisë. Për pasojë, në raport me këtë objekt veprimi ata mund të analizohen si një faktor i vetëm. Kjo reflektohet edhe me faktin se veçanërisht vitet e fundit këta faktorë kanë mbajtur qëndrime pothuajse unike mbi problematikat e demokratizimit shqiptar, si zgjedhjet e lira dhe të ndershme, lufta kundër kimit dhe korrupsionit apo reforma institucionale. Në këto fusha në mos të njëjta, qëndrimet e SHBA-ve kanë përfuruar ato Evropiane dhe anasjelltas. Në këtë aspekt emërtimi i tyre i përbashkët si “faktor ndërkombëtar” është i justifikueshëm në raport me demokratizimin e Shqipërisë.

Së dyti, baza konceptuale mbi të cilat ndërtohen qasjet ndaj demokratizimit janë të njëjta, pavarësisht specifikave institucionale. Kështu, qoftë paradigma e kushtëzimit demokratik mbi të cilën bazohet Bashkimi Evropian, qoftë rrafshi teorik mbi të cilin bazohen organizma si USAID, ndajnë një strukturë konceptuale bazë, që ngrihet mbi një kuptim të procesit të demokratizimit, që ka të bëjë me forcimin e institucioneve demokratike, shoqërisë civile, mirëqeverisjen, luftën kundër korrupsionit apo rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Kështu, disa nga kushtet bazë që janë vendosur nga Bashkimi Evropian dhe që kanë të bëjnë me demokratizimin e Shqipërisë janë “parandalimi i kimit të organizuar... zbatimi i shtetit të së drejtës (*rule of law*); përpjekje më të mëdha për të luftuar korrupsionin; dialog mes forcave politike, zbatimi i rekomandimeve të OSBE-së në lidhje me procesin elektoral; zbatim i ligjit të Shërbimit Civil; zhvillimi i shoqërisë civile”¹.

Sikurse shikohet edhe nga objektivat e mësipërme, në thelb procesi i demokratizimit shikohet si zbatim i një modeli dhe reformave të caktuara më shumë sesa një proces dinamik politik. Ky është edhe një tipar i përbashkët i faktorit ndërkombëtar në proceset e demokratizimit shqiptar; neglizhimi apo reduktimi i procesit politik. Në rastin më të keq politika neglizhohet pasi procesi i demokratizimit nënkupton një rrugëtim drejtvizor nga më pak në më shumë demokraci apo nga institucionet e dobëta tek ato të konsoliduara. Në rastin më të mirë procesi politik reduktohet tek marrëdhënia mes institucioneve apo individëve, çka prodhon narrativa statistikore të zgjedhjeve apo aktive politike, por pa hedhur dritë mbi shkaqet e dinamikës politike. Në të dyja rastet politika shikohet si një faktor ekzogjen. Ajo është produkt i marrëdhënieve institucionale, kulturore apo individuale dhe jo procesi që në fakt i prodhon këta faktorë, ndërsa edhe formësohet prej tyre.

Për këtë arsye në qasjet ndaj demokratizimit të faktorit ndërkombëtar shpesh politika shikohet si një pengesë më shumë sesa çelësi i zgjidhjes së problematikës së demokratizimit. Kështu, klasa politike fajësohet për mungesën e reformave apo të konsolidimit të institucioneve që synohet të formësohen përtej dhe jo nëpërmjet procesit politik. Në këtë mënyrë ndërtohen institucione që synojnë ta neutralizojnë, në vend që ta kanalizojnë procesin politik, çka riprodhon kriza politike dhe deformime institucionale. Rasti më tipik në këtë aspekt janë të ashtuquajturat institucione të pavarura synimi parësor i të cilave është t’i rezistojnë politikës që shikohet si burimi dhe jo zgjidhja e problematikës demokratike shqiptare. Problemi themelor i këtyre institucioneve nuk është thjesht se nën ombrellën e pavarësisë ato janë përdorur politikisht, por fakti që në thelb ato ndërtohen për të mënjnuar më shumë sesa për ta kanalizuar procesin politik.

Për të nxjerrë në pah neglizhimin apo reduktimin e konceptit të politikës në qasjet ndaj demokratizimit, në këtë artikull do të shqyrtohen disa nga qasjet themelore teorike mbi të cilat ndërtohet asistencë demokratike për Shqipërinë nga faktori ndërkombëtar. Është e kuptueshme që duke pasur parasysh përmasat dhe rëndësinë e vogël të Shqipërisë në skenën ndërkombëtare qasjet ndaj demokratizimit nuk janë ndërtuar duke bazuar mbi specifikat e rastit shqiptar. Këto qasje janë ndërtuar duke u përqendruar në procesin e demokratizimit të Evropës Lindore në përgjithësi, dhe më pas janë zbatuar në rastin e Shqipërisë. Prandaj, për të nxjerrë në pah mangësitë e qasjeve ndaj demokratizimit në rastin e Shqipërisë, do përqendrohemi në literaturën e demokratizimit rreth Evropës Lindore në përgjithësi. Sikurse do të përpiqemi të argumentojmë më poshtë, ajo që kanë të përbashkët qasje të tilla është mungesa e një kuadri adekuat teorik, që i kushton vëmendjen e duhur politikës si procesi nëpërmjet të cilit shoqëria formësohet, dhe jo thjesht si nënprodukt i një rendi të caktuar shoqëror.

Duke pasur parasysh që literature në fushën e demokratizimit është tejet e gjerë, në këtë artikull do të fokusohemi tek qasjet që klasifikohen brenda kuadrit të politikës së krahasuar, sikurse është trajtuar kryesisht

në shkencat politike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo zgjedhje justifikohet me faktin se shumica e literaturës në lidhje me demokratizimin në Evropën Lindore është prodhuar në këtë fushë. Gjithashtu pjesa më e madhe e asistencës ndërkombëtare që ka të bëjë në mënyrë specifike me demokratizimin bazohet në koncepte që janë zhvilluar brenda fushës së demokratizimit të krahasuar (comparative democratization). Kështu që fokusi ynë do të jenë konceptet themelore dhe presupozimet bazë të qasjeve të ndryshme në këtë fushë. Rëndësi të veçantë do t'i kushtojmë qasjes së njohur me emrin “tranzitologji” jo vetëm për ndikimin e madh që ajo ka pasur në studimet e demokratizimit, por edhe sepse reflekton disa nga konceptet kyçe të fushës së demokratizimit të krahasuar në përgjithësi.

Për këtë qëllim artikulli është ndarë në pesë pjesë kryesore. Në pjesën e parë do të parashtrijmë origjinën e demokratizimit të krahasuar dhe të tranzitologjisë prej qasjeve më të hershme rreth demokratizimit. Në pjesën e dytë do të shtjellojmë me më hollësi paradigmen e tranzitologjisë, si një nga paradigmat që ka dominuar më gjatë fushën e demokratizimit. Në pjesën e tretë do ta shtjellojmë këtë paradigmë brenda kuadrit më të gjerë të studimeve krahasuese të demokratizimit mbi Evropën Lindore. Në pjesën e katërt do të ndërmarrim një vlerësim kritik të qasjeve ndaj demokratizimit. Së fundi, në pjesën e pestë dhe seksionin e konkluzionit do të ofrojmë një përmbledhje të mangësive, duke sugjeruar edhe alternativa teorike, nëpërmjet të cilave këto mangësi mund të tejkalohen.

NGA TEORIA E MODERNIZIMIT TEK DEMOKRATIZIMI I KRAHASUAR

Titulli i këtij seksioni mund të krijojë përshtypjen e gabuar se teoritë e modernizimit nuk trajtonin demokratizimin apo nuk bënin krahasime të demokracive mes vendeve të ndryshme. Në fakt, krahasimi i demokracive dhe demokratizimi ishin elementë thelbësorë të teorive të modernizimit. Elementi dallues i kësaj qasjeje ishte fakti që demokratizimi shikohej si produkti final i procesit të modernizimit. Sipas saj, moderniteti, që nënkuptonte një proces politik pluralist dhe kompetitiv si dhe një sistem ekonomik kapitalist, ishte faza përfundimtare drejt së cilës evoluonin shoqëritë tradicionale. “Këto procese analizoheshin brenda një kuadri konceptual, që ishte ndikuar nga strukturalizmi funksional i sociologjisë së Parson-it, dhe nga dikotomia midis tradicionales dhe modernes që këto teori synonin të specifikonin”.²

Kështu, teoritë e modernizimit e shikojnë lindjen e demokracisë në mënyrë evolucinare, duke theksuar një sërë faktorësh strukturorë dhe proceset afatgjata që përbëjnë parakushtet për shfaqjen e demokracisë. Disa autorë, si p.sh. Lipset, theksonin faktorë si pasurimi, industrializimi dhe edukimi.³ Autorë të tjerë e vendosën theksin tek “strukturat e socializimit” si variablat që prodhojnë “kulturën politike” dhe ndikojnë procesin e modernizimit, duke formësuar sistemin politik.⁴ Në të gjitha këto raste politika dhe shteti rezultojnë të jenë produkti i faktorëve të thellë strukturorë apo i proceseve afatgjata. Prandaj ekziston një “vonesë në zhvillimin e institucioneve politike, që pason ndryshimet sociale dhe ekonomike”.⁵ Ndonëse në teori procesi i modernizimit konsiderohej i hapur, në praktikë “zhvillimi politik identifikohet me atributet e konstitucionalizmit liberal demokratik anglez dhe amerikan”.⁶

Në praktikë paradigma e modernizimit prodhoi një tension në rritje midis konkluzionit teorik se demokracia është një proces i ngadalhtë evolucionar, dhe nevojës imediate për të stimuluar demokracinë në një numër vendesh që po linin pas regjime autoritare. Bëhet fjalë për momentin kur disa vende në Amerikën Latine dhe Evropën Jugore po linin pas sisteme politike autoritare. Pikërisht në këtë kuadër duhet kuptuar lindja e qasjes të mëvonshme të demokratizimit të krahasuar. Kjo qasje filloi nga një kritikë e brendshme e teorive të modernizimit nga Dankwart Rostow, sipas të cilit qasja funksionaliste e teorive të demokratizimit shpjegonte më shumë mënyrën se si funksiononin demokracitë ekzistuese sesa faktorët që i prodhonin këto demokraci. “Faktorët që garantojnë stabilitetin e një demokracie mund të mos jenë të njëjtë me ata që e kanë

prodhuar atë demokraci: shpjegimet e demokracisë duhet të dallojnë qartë midis funksionit dhe gjenezës (fillesës)". Veçanërisht pasi mënyra se si fillon një demokraci "praktikisht ka shumë më vlerë sesa panagjerizmi i virtyteve të demokracisë Anglo-Saksone".⁷ Kjo kritikë prodhoi një zhvendosje metodologjike, që theksonte autonominë e strukturave politike përballë strukturave shoqërore. Ndërsa më parë të parat përcaktoheshin dhe ishin një reflektim i të dytave.⁸

Në momentin që fokusi i analizës u përqendrua tek institucionet politike u bë e mundur që vëmendja të përqendrohej më shumë tek aktorët politikë sesa tek strukturat dhe proceset sociale. Kështu, në vitin 1978 Linz, përpara sesa të bëhej një nga baballarët e tranzitologjisë, deklaronte përkundër qasjes sociologjike se "dinamika e vërtetë e proceseve politike duhet të kërkohet tek zgjedhjet e bëra nga aktorët politikë dhe jo tek strukturat sociale".⁹ Kjo zhvendosje metodologjike drejt aktorit i përgjigjej nevojës për të shpjeguar transformimet që po ndodhnin në Amerikën Latine dhe Evropën Jugore. Transformime që mund të shpjegoheshin me vështirësi sipas teorive të modernizimit, pasi po ndodhnin më tepër në mënyrë revolucionare sesa evolucionare. Në këtë kontekst teorik dhe praktik botohet edhe vepra themelore në fushën e tranzitologjisë, një studim krahasues prej katër volumesh i tranzicionit nga autoritarizmi në Amerikën Latine dhe Evropën Jugore. Jo rastësisht ky volum titullohej *Tranzicione nga Autoritarizmi*, me bashkautor, Gulliermo O'Donnell, Philippe Schmitter dhe më vonë edhe Laurence Whitehead. U konsiderua "libri i parë në ndonjë gjuhë, që në mënyrë sistematike dhe krahasuese përqendrohet tek procesi i tranzicionit nga një regjim autoritar, duke e kthyer këtë proces në një tematikë qendrore të kërkimit shkencor".¹⁰ Ndonëse kjo vepër ishte një studim krahasues mbi Amerikën Latine dhe Evropën Jugore (Spanjë dhe Greqi) aparati konceptual që ajo prodhoi u aplikua pothuajse i paprekur në rastet e Evropës Lindore. Ai ishte shumë i volitshëm përballë ndryshimeve të menjëhershme që po ndodhnin në Evropën Lindore. Ndryshime që nuk mund të parashikoheshin apo kuptoheshin nëpërmjet teorive të modernizimit, që përqendroheshin në faktorë të thellë strukturorë dhe në procese sociale afatgjata. Në fakt, deri në vitin 1984, duke u bazuar në proceset afatgjata të qasjeve të modernizimit, Huntington do deklaronte se "shanset për zhvillime demokratike në Evropën Lindore janë praktikisht zero".¹¹

Deri tani kemi paraqitur një pikëpamje të thjeshtëzuar të zhvillimit të përqsasjeve ndaj demokratizimit që ngjason me një piramidë me kokëposhtë. Pra, nga qasjet e gjera të modernizimit, që fokusohen tek strukturat sociale, kemi lëvizur tek demokratizmi i krahasuar, që përqendrohet tek institucionet politike, dhe nga aty tek tranzitologjia, që ka një përqendrim edhe më specifik tek aktorët politikë. Kuptohet, trajektorja "e vërtetë" është shumë me komplekse sesa ky vështrim i thjeshtëzuar. Së pari, duhet të theksojmë se këto fusha nuk janë qartësisht të ndara nga njëra-tjetra. Disa autorë e konsiderojnë qasjen e demokratizimit të krahasuar si pjesë të një përqsasjeje më të përgjithshme që ka për objekt tranzicionin. Të tjerë e konsiderojnë tranzitologjinë si një fushë të veçantë brenda qasjes së përgjithshme të demokratizimit të krahasuar duke iu referuar në veçanti qasjes së zhvilluar nga O'Donnell, Schmitter dhe Linz.¹² Së dyti, ekzistojnë klasifikime të ndryshme nga ai që kemi ofruar deri tani në lidhje me qasjet mbi demokratizimin.

Një nga këto klasifikime alternative që ia vlen të përmendet është ajo e Reisinger, sipas të cilit qasjet në lidhje me demokratizimin e Evropës Lindore mund të ndahen në katër kategori; teoritë e modernizimit, studimet historike krahasuese, teoritë e kontestimit të elitave dhe teoritë e konfigurimit institucional.¹³ Teoritë e modernizimit konkludojnë se demokracia ka më shumë shanse të jetë e suksesshme në vendet e zhvilluara, në aspektin e ekonomisë, shoqërisë civile, edukimit, urbanizmit, etj. Ndërsa qasjet historike krahasuese përqendrohen tek "(1) shteti, (2) shoqëria civile, (3) shtresat socioekonomike dhe (4) natyra e situatës ndërkombëtare".¹⁴ Në këtë qasje disa autorë si Putnam theksojnë zhvillimin e "komuniteteve civike (civic community)"¹⁵, të tjerë si Barrington Moore arrijnë në përfundimin se "pa borgjezi nuk ka demokraci".¹⁶ Teoritë e kontestimit të elitave, nga ana tjetër përqendrohen tek negocimi midis elitave, duke i kushtuar vëmendje dinamikave afatshkurtra dhe vendimeve kyçe dhe duke ia mveshur "përgjegjësinë kryesore për suksesin apo dështimin e demokratizimit individëve kyç".¹⁷ Së fundi, teoritë e konfigurimit institucional

përqendrohen tek hartimi i institucioneve kushtetuese, që krijojnë kushtet për demokratizim dhe stabilitet. Një përfaqësues tipik i kësaj qasjeje, Lijphart, argumenton se “zgjedhja më e rëndësishme kushtetuese është ajo e sistemit elektorale... si dhe lloji i marrëdhënies midis legjislativit dhe ekzekutivit”.¹⁸

Ndonëse klasifikimi i Reisinger-it është mjaft i dobishëm, ai ka dy mangësi themelore. Së pari, vendosja e qasjeve të demokratizimit në katër kategori mjegullon ndarjen themelore midis strukturës dhe aktorit në fushën e demokratizimit. Përtej specifikave metodologjike qasjet ndaj demokratizimit mund të ndahen në dy grupe të mëdha: ato që theksojnë strukturën si element bazë të analizës dhe ato që theksojnë aktorin. Për këtë arsye, ne paraqitëm një përshkrim të thjeshtëzuar të zhvillimit të fushës së demokratizimit që lëviz nga theksimi i strukturës drejt theksimit të aktorit si elementë bazë të analizës. Së dyti, katër kategoritë e Reisinger-it fshehin një tjetër element të përbashkët të këtyre qasjeve: dimensionin e tyre teleologjik. Kështu, qasjet historike që theksojnë varësinë nga e kaluara dhe e tashmja (*path dependency*) në zhvillimet e shoqërive post-komuniste nënkuptojnë një zhvendosje të qartë drejt një modeli specifik të liberal demokracisë perëndimore. Ato “arsyetojnë nga një këndvështrim që e merr si të qenësishëm tranzicionin drejt një modeli specifik shoqëror”.¹⁹ Dimensioi teleologjik është akoma më i dallueshëm në qasjen tranzitologjike, e cila pothuajse e injoron trashëgiminë historike dhe sociale duke parashtruar fazat konkrete nëpër të cilat aktorët politikë duhet të kalojnë për ta zhvendosur një vend nga autoritarizmi drejt një modeli të caktuar të liberal demokracisë. Pikërisht këtë qasje do të shqyrtojmë në seksionin pasardhës.

TRANZITOLOGJIA

Modeli që propozojnë tranzitologjistët nuk fokusohet tek faktorët funksionalë apo strukturorë, përkundrazi ai “braktis kërkimin e “parakushteve funksionale” për demokracinë”.²⁰ Sidomos modeli i zhvilluar nga O’Donnell dhe Schmitter i kushton më tepër vëmendje rolit të aktorëve politikë dhe të elitave në procesin e demokratizimit.²¹ Në këtë aspekt tranzitologjia i përcakton rrënjët e veta filozofike tek Makiaveli, meqenëse ai ishte “teoricieni i parë i madh politik, që jo vetëm i trajtoi zhvillimet politike si produkte të sendëruara nga veprimtaria kolektive humane, por gjithashtu kuptoi problematikën konkrete të ndryshimit të një regjimi”.²² Rrjedhimisht, vëmendja e tranzitologjisë përqendrohet në konceptualizimin e mënyrave të ndryshme të tranzicionit, duke e vënë theksin tek roli i elitave në këtë proces. Duke u bazuar në eksperiencën e Amerikës Latine tranzitologjistët kanë përcaktuar katër forma të tranzicionit: 1) tranzicion nëpërmjet një pakti, 2) tranzicioni i imponuar, 3) tranzicion revolucionar dhe 4) reformator.²³ Këto kategori më pas u aplikuan në rastin e Evropës Lindore.²⁴ Prej këtyre katër modaliteteve tranzitologjistët eksplorojnë kryesisht tranzicionet që ndodhin nëpërmjet pakteve politike duke parashtruar fazat konkrete nëpër të cilat kalon një tranzicion i tillë, që nga momenti i çarjes në regjimin sundues deri tek zgjedhjet e para demokratike, që sipas kësaj qasjeje kanë një rol themelor në vendosjen e një sistemi demokratik. Me fjalë të tjera, theksi është tek proceset afatshkurtra.

Është e lehtë të identifikohen katër presupozime bazë në tranzitologji. I pari “që është edhe presupozimi më gjithëpërfshirës, nënkupton se çdo vend që *largohet nga një qeverisje diktatoriale* mund të konsiderohet një vend në tranzicion *drejt demokracisë*”.²⁵ Presupozimi i dytë është që tranzicioni kalon nëpër tre faza, *hapja*, gjatë të cilës shfaqen çarjet në regjimin sundues, *thyerja* që prodhon pluralizmin politik dhe *konsolidimi*, procesi gjatë të cilit demokracia bëhet “alternativa e vetme”.²⁶ Presupozimi i tretë është se zgjedhjet janë shumë të rëndësishme, sidomos zgjedhjet e para demokratike, të cilat “nëse janë të lira dhe të ndershme do të thotë se janë zhvilluar në kuadrin e një lirie politike, duke shënuar kështu një shkoputje nga sundimi arbitrar dhe autoritar”.²⁷ Presupozimi i katërt është se “kushtet bazë në vendet në tranzicion – niveli i tyre ekonomik, historia politike, trashëgimia institucionale, përbërja etnike, traditat socio-kulturale apo tipare të tjera “strukturorë” – nuk përbëjnë faktorë të rëndësishëm as në fillimin dhe as në produktin e procesit të tranzicionit”.²⁸

Duke u bazuar në paradigmat ekzistuese të demokratizimit, si p.sh. koncepti i valës së tretë të demokratizimit të Huntington, tranzitologjistët argumentonin se demokratizimi në Evropën Lindore “duhej trajtuar si pjesë e së njëjtës “valë demokratizimi”, që filloi në vitin 1974 në Portugali dhe që ende nuk e ka shteruar energjinë e vet tërësisht për t’i bërë vend kthimit drejt autokracisë”.²⁹ Rezultati i kësaj qasjeje janë një numër studimesh që përqendrohen tek momenti i rënies së regjimit komunist dhe shfaqja e sistemit demokratik.³⁰

Sikurse e tregojnë qartë edhe presupozimet bazë të tranzitologjisë në këtë qasje, ekziston një hapësirë dhe vëmendje më e madhe për procesin politik, sidomos krahasuar me qasjet e mëparshme moderniste ku ky proces ishte thjesht reflektim i faktorëve më të “thellë” shoqëror. Kjo do të thotë që politika si proces bëhet një objekt legjitim analize. Megjithatë, fokusi ekskluziv tek aktorët dhe neglizhenca e faktorëve shoqërorë që trajtohen si të dhënë e redukton politikën tek procesi i ndërveprimit mes aktorëve dhe institucioneve të ndryshe politike, të cilët duket se ekzistojnë pavarësisht dinamikës politike që prodhojnë. Kjo bën që tranzitologjia të prodhojë përshkrime të gjata dhe të detajuara të sjelljes politike individuale apo të statistikave politike, por pa hedhur dritë mbi burimin e kësaj sjelljeje apo se si ajo formëson vetë aktorët nga ku buron. Për më tepër, ndonëse lehtësisht i aplikueshëm në momentin e rrëzimit të regjimeve komuniste, aparati konceptual i tranzitologjisë nuk ishte i mjaftueshëm për trajtimin e procesit të konsolidimit demokratik.

Për këtë arsye disa “tranzitologjistë” filluan të eksploronin procesin e konsolidimit demokratik dhe për pasojë u emërtuan “konsidologë” (considologists). Vepra themelore në këtë fushë është *Probleme të Tranzicionit dhe Konsolidimit Demokratik (Problems of Democratic Transition and Consolidation)* me autorë Juan Linz dhe Alfred Stepan. Sipas Linz dhe Stepan, pesë janë fushat që ndërveprojnë për të garantuar konsolidimin demokratik: “Një shoqëri civile aktive, një shoqëri politike deri diku autonome, shteti ligjor (*rule of law*), një shtet dhe shoqëri ekonomike e dobishme (vini re, *jo thjesht* një ekonomi kapitaliste)”.³¹ Duke u bazuar mbi këto kategori, autorët ndërtuan një model që parashtron mënyrat se si këto fusha duhet të zhvillohen dhe ndërveprojnë për konsolidimin e një sistemi demokratik. Më pas ky model aplikohet në rastet e Amerikës Latine, Evropës Jugore dhe Lindore. Meqenëse këtu nuk kemi hapësirën e duhur për ta shtjelluar modelin e Linz-it dhe Stepan-it, mjafton të theksojmë se ai përbëhet nga një sërë klasifikimesh, tipologjish dhe kategorizimesh të kushteve fillestare dhe të regjimeve të ndryshme politike me synim gjetjen e kategorive që janë universalisht të aplikueshme në kohë dhe hapësirë.

Ajo që është e rëndësishme për qëllimin tonë është të vëmë në dukje faktin që në këtë punim vihet theksi tek disa faktorë që më parë i kemi cilësuar si faktorë strukturorë, si shoqëria apo besimet politike dhe sociale. Kështu kalohet përtej fokusit mbi aktorin individual apo veprimin politik. Sipas autorëve, synohet që demokracia të analizohet nëpërmjet një qasjeje të modifikuar të “varësisë historike (*path dependency*)”.³² Lexuesi mund të kujtojë se kjo qasje është tipike për analizat historike apo strukturore prej të cilave tranzitologjia u shkëput duke theksuar rëndësinë e aktorit më shumë sesa atë të strukturës apo kushteve historiko-sociale, të cilat theksoheshin në qasjet e modernizimit. Prandaj duke u fokusuar tek procesi i konsolidimit tranzitologjistët rimarrin koncepte të demokracisë, shtetit, shoqërisë, politikës dhe të kulturës politike të zhvilluara më parë nga qasja modernizuese apo ato të demokratizimit të krahasuar. Kështu, ata bazohen në disa vepra kyçe të këtyre traditave, siç janë *Njeriu Politik (Political Man)* nga Lipset, *Poliarkia (Poliarchy: Participation and Opposition)* nga Dahl apo *Vala e Tretë (The Third Wave)* nga Huntington. Kjo është mëse e qartë në një numër veprash të “konsidologjisë”, si p.sh. *Duke Zhvilluar Demokracinë: Drejt Konsolidimit (Developing Democracy: Toward Consolidation)* nga Larry Diamond.³³

Në këtë pikë nuk duhet të krijojmë idenë e gabuar se tranzitologjia përshkoi një rreth të mbyllur duke u larguar nga struktura drejt aktorit për t’u kthyer përsëri tek struktura. Tranzitologjia nuk është një qasje që u shkëput qartazi nga paradigmat e mëparshme nga ku u zhvillua, të cilat nuk u zhdukën me daljen e tranzitologjisë, por u zhvilluan përkrah saj. Sikurse është përmendur më sipër, për të justifikuar relevancën e kuadrit konceptual tranzitologjik në raport me demokratizimin në Evropën Lindore, tranzitologjistët iu referuan konceptit të valës së tretë të Huntington, një koncepti nga qasja modernizuese.

NGA TRANZITOLOGJIA TEK DEMOKRATIZIMI I KRAHASUAR

Tranzitologjistët pretendonin se kuadri konceptual i zhvilluar në Amerikën Latine dhe Evropën Jugore ishte i vlefshëm për Evropën Lindore, pasi “duke u mbështetur tek një grup konceptesh, presupozimesh dhe hipotezash universale, është e mundur të shpjegohen dhe madje edhe të drejtohen ndryshimet nga regjimet autokratike drejt atyre demokratike”.³⁴ Një pretendim i tillë u kritikua ashpër nga ish-Sovietologjistët³⁵, për të cilët vendet ish-komuniste jo vetëm kishin specifikat e tyre të ndryshme nga Amerika Latine dhe Evropa Jugore, por edhe sepse tranzitologjistët neglizhonin faktorët strukturorë dhe socialë që ndikojnë në proceset e demokratizimit.³⁶ Kritika themelore kish të bënte me faktin që sipas ish-Sovietologjistëve, tranzicionet në Evropën Lindore ishin të pakrahasueshëm me ato në Amerikën Latine dhe Evropën Jugore. Tranzicioni nga regjimi komunist drejt demokracisë është tejet më i thellë dhe shumëplanësh sesa transformimet që ndodhën në Amerikën Latine dhe Evropën Jugore.³⁷ Nëse tranzicionet në Amerikën Latine dhe Evropën Jugore (Greqi, Spanjë dhe Portugali) ishin thjesht të rendit politik, transformimet në vendet ish-komuniste preknin jo vetëm sistemin politik, por edhe atë ekonomik, shoqëror si dhe vetë konceptin e shtetit. Kështu që “çështja bazë mbetet nëse ndryshimet midis këtyre dy rasteve janë thjesht variacione të të njëjtit fenomen, pra të procesit të tranzicionit nga diktatura në demokraci – apo nëse kemi të bëjmë me dy fenomene të ndryshme – pra nga njëra anë kemi procesin e demokratizimit dhe, nga ana tjetër, diçka që mund të emërtohej postkomunizmi”.³⁸ Në këtë kuadër disa autorë konkludojnë se ndryshimi midis regjimeve autoritare në Amerikën Latine dhe Evropën Jugore dhe regjimeve totalitare në Evropën Lindore janë kaq të mëdha sa nuk ekziston baza e krahasimit.³⁹ Për këtë arsye, disa autorë të tjerë ngulmojnë se paradigma e tranzicionit duhet braktisur pasi “ishte produkt i një kohe të caktuar–kulmi i valës së tretë të demokratizimit–dhe tashmë kjo kohë ka kaluar”.⁴⁰

Në këtë pikë është e rëndësishme të theksojmë se kritikën e mësipërme ndaj tranzitologjisë nuk kanë të bëjnë me nevojën për të arritur tek përgjithësimet teorike duke u nisur nga një numër i kufizuar rastesh. Pra, nuk vihet aspak në pikëpyetje fakti se duhen kërkuar një grup konceptesh dhe presupozimesh, që janë universalisht të aplikueshme në procesin e demokratizimit. Debatimi ka të bëjë kryesisht me objektin e kërkimit dhe me fushën e aplikimit të këtyre koncepteve. Kështu, ish-Sovietologjistët, që përdorin qasjen e demokratizimit të krahasuar, si Bunce, e kritikojnë tranzitologjinë, pasi ata mendojnë që është më i vlefshëm krahasimi mes vendeve të një rajoni sesa krahasimi mes rajoneve të ndryshme. Autorë të tjerë e kritikojnë tranzitologjinë, sepse ka një fokus tejet të kufizuar duke injoruar kështu proceset afatgjata apo faktorët strukturorë. Megjithatë, ashtu si edhe tranzitologjia këto qasje synojnë të ndërtojnë modelin e një sistemi ideal, drejt të cilit vendi në tranzicion duhet të shkojë dhe në raport me të cilin sistemi politik i tij krahasohet. Kjo vlen jo vetëm për ato qasje që përqendrohen tek institucionet apo strukturat shoqërore, por edhe për ato që fokusohen tek kultura.

Qasjet kulturaliste janë në fakt një shembull i mirë në këtë rast. Këto qasje bazohen tek vepra e Almond dhe Verba, që kulturën politike e përcakton si “tendenca specifike e orientimit drejt objekteve politike e anëtarëve të një kombi”.⁴¹ Kultura politike trajtohet si një faktor më vete, që ndërvepron dhe përcakton faktorë të tjerë të demokratizimit. Në këtë mënyrë ajo gëzon një ekzistencë objektive përtej kontekstit ekonomik dhe institucional.⁴² Qëllimi i qasjeve kulturaliste është përkufizimi i kulturës demokratike në mënyrë që të zhvendoset drejt këtij modeli edhe kultura politike e një vendi në tranzicion. Theksi është tek “vlerat, konceptet e rrënjësura thellë dhe tek sensi i identitetit më shumë sesa tek sjellja e jashtme që mund të jetë shumë më e përkohshme dhe e ndryshueshme”.⁴³ Kjo lloj qasje në mënyrë implicite presupozon që ka kultura demokratike dhe jo demokratike. Kështu, “një kulturë thellësisht jodemokratike do të pengonte shpërndarjen e normave demokratike në shoqëri, do t’i mohonte legjitimitetin institucioneve demokratike dhe kështu do ta komplikonte së tepërmi dhe madje mund ta pengonte zhvillimin dhe efektivitetin e funksionimit

të këtyre institucioneve”.⁴⁴ Rrjedhimisht, pyetja që duhet bërë është “çfarë e përcakton zhvillimin e një kulture demokratike në përputhje me një regjim demokratik”.⁴⁵

Kjo është një pyetje mjaft e ngjashme me atë që shtrohet nga tranzitologjistët, të cilët gjithashtu synojnë përcaktimin e kushteve që favorizojnë procesin e demokratizimit, ndonëse ata nuk fokusohen tek kultura politike. Prandaj mund të themi se ndryshimi mes një qasjeje të pastër tranzitologjike dhe qasjeje të tjera në paradigmen e demokratizimit të krahasuar apo qasjeje modernizuese, është përqendrimi në aspekte të ndryshme të së njëjtës telelogji. Qëllimi është i njëjtë: zhvendosja e shoqërive që dalin nga një sistem autoritar në një drejtim të caktuar. Për këtë arsye, pavarësisht ndryshimeve, të gjitha këto qasje mbeten “brenda ‘kulturës së tranzicionit’, që kërkon rrugët nëpërmjet të cilave shoqëritë post-komuniste mund të arrijnë nivelet e modernizimit të Perëndimit”.⁴⁶ Në mënyrë implicite presupozohet se modernitei është një dhe i vetëm.

Këto qasje ndajnë një vizion të përbashkët të asaj që ndodhet në fund të *telos*-it të demokratizimit. Në shumicën e rasteve është një vizion i demokracisë që luhet mes procedurës dhe konsensusit. Përkufizimi i Schumpeter-it se demokracia është “konfigurimi institucional për të marrë vendime politike në të cilat individët e përftojnë pushtetin për të vendosur nëpërmjet një beteje konkurruese për votën e popullit”, është më i përdoruri nga studiuesit e shkencave politike amerikane.⁴⁷ Më praktikisht ky përkufizim është shtjelluar tek koncepti i poliarkisë së pasuesit të Schumpeter, Robert Dhal, një koncept që fokusohet “më shumë tek demokraci që ‘ekzistojnë realisht’ ... sesa rreth një apo më shumë varianteve të ideale të një demokracie ‘potenciale’”.⁴⁸ Mes studiuesve të demokratizimit, Dahl konsiderohet si formuluesi i “kriterëve më të gjithëpranara për të përcaktuar nëse një vend është demokratik”.⁴⁹ Dahl-i ka përcaktuar shtatë kushte, të emërtuara “kushtet minimale procedurale”, që kanë të bëjnë me të drejta themelore civile dhe politike dhe me zgjedhje të drejta, konkurruese dhe përfshirëse si parakushte për ekzistencën e poliarkisë.⁵⁰ Këto kushte pak a shumë reflektojnë demokracinë amerikane të kohës kur shkruante Dahl.

Për pasojë, në qasjet ndaj demokratizimit shumica e “autorëve kanë adoptuar një konceptim minimalist dhe procedural të demokracisë formale, që karakterizohet para së gjithash nga mbajtja e zgjedhjeve të rregullta me pak pengesa për pjesëmarrjen popullore”.⁵¹ Ndonëse jo të gjithë autorët dhe qasjet mbështeten tek përkufizimi minimalist dhe procedural i demokracisë, pothuajse të gjithë e pranojnë rëndësinë e procedurës si një *sine qua non* e demokracisë. Kështu, tranzitologjistë si Schmitter theksojnë se “vetëm procedura është e pamjaftueshme për të përkufizuar demokracinë, megjithatë prezenca e procedurave është e domsdoshme për vazhdimësinë e demokracisë”,⁵² Edhe autorët kritikë ndaj tranzitologjisë, si Bunce, e pranojnë rëndësinë e procedurave kur argumentojnë se “demokracia dhe kapitalizmi bazohen në të njëjtin parim që zbatohet në fusha të ndryshme të aktivitetit njerëzor: rezultate të paparashikueshme me procedura të parashikueshme”.⁵³

Natyrisht në fushën e demokratizimit janë bërë mjaft kritika ndaj përkufizimit minimalist të demokracisë, pasi në të “theksohen së tepërmi *procedurat* e vendimmarrjes publike, në kurriz të *produktit* dhe pothuajse duke përjashtuar *vlera më të gjera shoqërore*”.⁵⁴ Autorë të tillë kërkojnë për më shumë vëmendje tek përmbajtja sesa tek procedura. Duke kritikuar përkufizimet e mbyllura proceduraliste ata vënë në pah se “demokracia është e papërputhshme me mbylljen konceptuale rreth identitetit të saj [pra, me përkufizime që e përcaktojnë një herë e mirë se ç’është demokracia], prandaj demokratizimi duhet kuptuar si një proces i hapur”.⁵⁵ Praktikisht një qasje e tillë prodhon më shumë vëmendje ndaj proceseve deliberuese (diskutuese) dhe rezultateve që janë produkt i konsensusit. “Mes presupozimeve më të nevojshme gjatë analizimit të demokracisë dhe demokratizimit do ishte e arsyeshme të theksohej rëndësia e bindjes, diskutimit dhe arritja e konsensusit”.⁵⁶

Kjo nuk do të thotë që tek konceptimet e demokracisë në qasjet e demokratizimit mungon tërësisht theksi tek konflikti apo politika. Disa autorë e konsiderojnë konsensusin jo si diçka të dhënë *apriori*, por si produkt i

konfliktit dhe politikës. Rostow, në esenë e tij që themeloi qasjen e tranzitologjisë, u bazua tek botëkuptimi i Bernard Crick, sipas të cilit: “Konsensusi moral i një shteti të lirë nuk është diçka që ekziston në mënyrë misterioze përpara politikës apo mbi politikën; ai është aktiviteti (civilizues) i vetë politikës”.⁵⁷ Megjithatë, praktikisht në analizë konflikti dhe politika nuk theksohen për shkak të natyrës teleologjike të demokratizimit. Ndonëse demokratizimi “duhet kuptuar si një proces afatgjatë, kompleks, dinamik dhe i hapur. Ai do të thotë progres në drejtim të një lloji politike që bazohet më shumë tek rregullat, tek konsensusi dhe pjesëmarrja”.⁵⁸ Në rastin më të mirë një konceptim i tillë lë pak hapësirë për politikën, pasi ajo nuk shihet si burim i një sistemi të caktuar por si produkt i tij. Me fjalë të tjera, politika shikohet para së gjithash si procesi i implementimit të një sistemi të caktuar.

NJË VLERËSIM KRITIK I QASJEVE TË DEMOKRATIZIMIT

Një nga aspektet problematike të qasjeve krahasuese është theksi tek konceptim i dimensionit universal në kurriz të momenteve specifike. “Premisa më themelore, ndonëse jo eksplicite e tranzitologjisë, është se konstelacioni aktual i kapitalizmit dhe demokracisë... përfaqëson një model universal dhe përfundimtar që po fiton terren global”.⁵⁹ Përkundër kësaj universaleje, “trashëgimitë institucionale dhe kulturore të komunizmit janë mishërim i tradicionales”.⁶⁰ Kështu, universalja është modernia, perëndimorja, progresivja, pra ajo që duhet arritur, ndërsa specifika është tradicionalja, që do të thotë dimension post-komunist, që duhet tejkaluar si pengesë. E thënë më thjesht, universalja është e mirë dhe e pakorruptuar, specifika është e keqe dhe e korruptuar. E njëjta logjikë normative përcakton edhe qasjen metodologjike. Studiuesi kërkon të gjejë universalen përtej çdo rasti të veçantë në mënyrë që ai (dhe ndonjëherë ajo) të mund të prodhojë një model të përgjithshëm apo universal. Për pasojë, shpesh shpjegime të veçanta sakrifikohen për hir të përgjithësimeve të dyshimta.

Përgjithësimet në vetvete prodhohen duke gjetur emëruesin më minimal të përbashkët të faktorëve të ndryshëm që përcaktojnë dhe shkaktojnë tranzicionin. Kështu prodhohen përgjithësime tejet të cekëta dhe që pothuajse nuk na thonë asgjë të re ose thonë diçka që merret me mend. Pra, kërkimi për universalen thjesht prodhon banalen. Për këtë arsye, Bunce, një studiuese me përvojë në fushën e demokratizimit, arrin në konkluzionin se problemi i tranzitologjisë është se nuk ka ndriçuar aspak zhvillimet në vendet post-komuniste, përkundrazi konkluzionet e tranzitologjisë janë “pak më shumë se gjëra që dihen [bon sens]”.⁶¹ Megjithatë, as demokratizimi i krahasuar, qasja e vetë Bunce nuk është se ka qenë më e suksesshme si nga ana sasiore ashtu edhe nga ajo cilësore. Kjo qasje në tërësinë e saj ka prodhuar vetëm pesë përgjithësime që “duket se vlejnë të paktën për demokracitë e reja, në mos për demokracitë në përgjithësi, pavarësisht nga koha vendi apo pikënisja”.⁶² Megjithatë, disa nga këto pesë përgjithësime tingëllojnë thjesht si gjëra që merren me mend, për shembull: “udhëheqësit politikë kanë një rol kyç në themelimin dhe hartimin e demokracisë si dhe në mbijetesën apo dështimin e saj në momente krize”.⁶³ Edhe vetë teoricienët e demokratizimit e pranojnë se në raport me standardet shkencore që ata synojnë, fusha e demokratizimi “nuk ka prodhuar diçka që të mund të testohet shkencërisht”.⁶⁴ Gjithashtu, sikurse vërejnë disa autorë, qasjet e ndryshme të demokratizimit “kanë një potencial të ulët parashikues”.⁶⁵

Paaftësia e literaturës së demokratizimit për të hedhur dritë mbi zhvillimet komplekse të demokratizimit vjen minimalisht si pasojë e kombinimit të dy faktorëve metodologjikë. Së pari, kjo literaturë fokusohet tek shpjegimi i proceseve të demokratizimit në raport me një teori apo model të dhënë, më shumë sesa tek kuptimi i tyre brenda kontekstit ku këto zhvillime ndodhin. Me fjalë të tjera, metodologjikisht synohet të vendoset një zhvillim apo moment i dhënë brenda një kuadri të përgjithshëm historik. Në këtë mënyrë, konteksti specifik është diçka që duhet tejkaluar për ta vendosur dukurinë apo

zhvillimin në fjalë në një kuadër teorik të universal. Për pasojë, ky kontekst jo vetëm nuk merret parasysh por anashkalohet si një rrethanë që fsheh në fakt thelbin e problemit. Le të marrim një shembull: sjellja e një aktori politik që tregon shenja autoritarizmi, apo konfliktualitet të lartë në raport me kundërshtarët e tij politik. Në qasjen e shkencave politike një sjellje e tillë nuk shqyrtohet për t'u kuptuar brenda një konteksti të caktuar politik, pra cilët janë faktorët, arsyet apo rrethanat që e prodhojnë një fenomen të tillë. Këto do ishin thjesht momente dytësore, pikënisja nga ku do synohej të arrihej thelbi i problemit, pra ligjshmëria universale, që e shpjegon rastin në fjalë si një moment specifik të saj. Kështu, sjellja e aktorit politik në fjalë do të shpjegohej në kuadrin e trashëgimisë totalitare, ku kundërshtari trajtohej si armik, apo të kulturës jodemokratike që nuk pranon pluralizmin në mendim, e kështu me radhë. Në këtë mënyrë momenti specifik është thjesht shfaqje e një fenomeni të përgjithshëm, dhe si i tillë nuk është i rëndësishëm në vetvete, por thjesht si një tabelë që na drejton tek ligjësia universale nga ku buron edhe ky moment specifik. Kuptimi i kontekstit specifik nuk ka shumë vlerë përballë shpjegimit të ligjësive universale. Prandaj shumë pak nga ekspertët ndërkombëtarë të politikave të demokratizimit apo të tranzicionit "kanë arritur të bëhen njohës të gjuhëve të rajonit apo të përdorin literaturën e bollshme mbi historinë, politikën apo kulturën të prodhuar në rajon".⁶⁶ Këta ekspertë vijnë si njohës të ligjësive universale, të cilave duhet t'u binden me doemos edhe zhvillimet specifike të vendit ku ata japin ekspertizën e tyre universale.

Këtu fillon edhe faktori i dytë metodologjik, që i bën qasjet e demokratizimit shumë të varfra në ide apo "zbulime". Për sa kohë theksi është tek shpjegimi i universales dhe jo kuptimi i lokales, fokusi metodologjik do zhvendoset nga niveli mikro në atë makro. Në këtë mënyrë zhvillimet në nivelin mikro do shihen thjesht si refleksione të tendencave në nivelin makro, më shumë sesa anasjelltas. Kjo do të thotë që niveli makro do theksohet në kurriz të zhvillimeve në nivel mikro. Neglizhenca e nivelit mikro në disiplinën e demokratizimit është kritikuar veçanërisht nga qasjet etnografike dhe antropologjike, sidomos ato të zhvilluara nga Katherine Verdery. Në "përshkrimet konvencionale 'të tranzicionit' niveli mikro përcaktohet nga, ose është një shprehje e, strukturave, politikave dhe ideologjive të një niveli makro, duke neglizhuar teorizimin e pasojave të paqëllimshme në nivel lokal, si pasojë e kontestimeve kulturore dhe politike".⁶⁷

Theksimi i nivelit makro bën që në shumicën e rasteve të anashkalohen zhvillimet politike të ditës. Një proces i rëndësishëm ky, nëpërmjet të cilit individët e ripërkufizojnë vetveten çdo ditë dhe që nuk mund të shpjegohet nëpërmjet kategorive esenciale, siç janë "trashëgimitë historike" apo "kultura politike". Në fakt "fenomene që mund të duken lehtësisht të identifikueshme si trashëgimi e socializmit janë në fakt diçka krejt tjetër: reagime ndaj iniciativave të reja të tregut, produkt i tyre më shumë sesa mbetje të një mentaliteti të vjetër".⁶⁸ Natyrisht këto reagime shpesh tingëllojnë si shprehje nga e kaluara, por kjo ndodh pasi aktorët do përdorin koncepte nga një univers diskursiv që ata e njohin. Me fjalë të tjera, ata do të përdorin të njëjtën gjuhë dhe simbole që kanë trashëguar nga e kaluara, por për të negociuar realitete të reja.

Le të marrim një shembull konkret për të ilustruar argumentin e mësipërm që me të drejtë mund të duket paksa tejet teorik për lexuesin. Marrëdhënia historike midis Fatos Nanos dhe Sali Berishës është parë si burim i konfliktualitetit në Shqipëri. Në vetvete kjo marrëdhënie është shpjeguar nëpërmjet kategorive esenciale si "trashëgimia komuniste", "mungesa e kulturës demokratike" apo "psikologjia e konfliktit". Kështu, konflikti mes këtyre dy individëve është shpjeguar në nivel makro sipas ligjësive universale, të tipit "trashëgimia komuniste në të cilën kundërshtari politik trajtohet si armik, bën që lufta politike të jetë e ashpër dhe konfliktuale". Marrëdhënia Nano-Berisha është parë thjesht si një moment specifik i kësaj ligjësie. Meqenëse të dy aktorët janë produkte të trashëgimisë komuniste, atëherë edhe marrëdhënia mes tyre do të jetë tejet konfliktuale. Problemi është se në këtë mënyrë anashkalohen rrethanat specifike politike të ditës, që e prodhojnë këtë konfliktualitet. Për më tepër një qasje e tillë nuk shpjegon dot momentet kur një konfliktualitet i tillë "i natyrshëm" zhduket, siç ishte rasti i marrëveshjes Nano-Berisha

në vitin 2002. Nëse konflikti Nano–Berisha është një moment specifik i një ligjësie universale, atëherë është e pashpjegueshme se përse në momente të caktuara këta individë jo vetëm nuk janë në konflikt, por në bashkëpunim tejet dashamirës. Kjo do të thotë se përtej ligjesisë universale ekzistojnë dhe faktorë të tjerë politikë në nivel mikro apo makro, siç mund të jenë interesat apo strategjitë politike që përcaktojnë konfliktualitetin politik. Por faktorë të tillë nuk mund të analizohen apo kuptohen nëpërmjet një strukture teorike që dimensionin mikro e përcakton nga pikënisja makro dhe jo anasjelltas. Diçka e tillë do të kërkonte jo thjesht një fokus tek dimensionin mikro, por edhe një kuptim më të zgjeruar të rrethana politiko-shoqërore që sendërzojnë këtë dimension.

Për këtë arsye disiplinat etnografike dhe antropologjike kritikojnë kuptimin tejet të ngushtë të konceptit të politikës në qasjet krahasuese të demokratizimit në Evropën Lindore. Sipas tyre, “politika nuk kufizohet tek veprimet e udhëheqësve politikë, por është një aktivitet ku mund të angazhohet çdokush”.⁶⁹ Prandaj politika duhet të shikohet si “diçka më shumë sesa një proces thjesht teknik – si vendosja e procedurave demokratike dhe metodave zgjedhore, formimi i partive politike dhe i organizatave joqeveritare dhe kështu me radhë”.⁷⁰ Një kuptim i zgjeruar i konceptit të politikës nënkupton jo thjesht një fokus tek niveli mikro, por edhe një zhvendosje nga shpjegimet shkak-pasojë drejt kuptimit të procesit dhe aksionit politik, në mënyrë që “ta shikojmë politikën si një fushë të vazhdueshme beteje”, ku luftohet për t’i dhënë kuptim dhe për të përcaktuar shoqërinë.⁷¹ Nëpërmjet një qasjeje të tillë Verdery hedh shumë dritë në zhvillimet post-komuniste në vepra si *Çfarë ishte socializmi dhe çfarë vjen më pas? (What was socialism and what comes next?)*.⁷² Diçka e tillë është më se e qartë për këdo që ka një njohje minimale të vendeve ish-komuniste dhe që është minimalisht i/e predispozuar që t’i shikojë këto vende si diçka më shumë sesa një laborator për testimin e teorive të zhvilluar në një kohë dhe vend tjetër.

Fatkeqësisht, një predispozitë e tillë mungonte në qasjet kryesore të demokratizimit që ne kemi shtjelluar deri tani, ku vendet ish-komuniste shikoheshin më shumë si një hapësirë ku mund të testoheshin teoritë e tyre. Në këtë mënyrë, pa e kuptuar as vetë, këto qasje risollën në këtë rajon një koncept të tranzicionit që kish ekzistuar aty edhe më parë. Socializmi në vetvete ishte thjesht një tranzicion drejt komunizmit. Partia ishte grupi avangard që zotëronte projektin drejt një rendi të ri shoqëror. Për pasojë politika si proces u reduktua tek zbatimi i këtij projekti, nëpërmjet institucioneve politike, organizatave bazë apo fushatave të edukimit/ndërgjegjësimit që duhet të prodhonin “njeriun e ri” të çliruar nga trashëgimia e së kaluarës (borgjeze, feudale, konservatore, etj.) Në mënyrë të ngjashme teoritë e demokratizimit prodhuan një tjetër tranzicion, tashmë drejt demokracisë liberale. Partia tashmë zëvendësohet nga ekspertët që kanë në zotërim projektin e demokratizimit, apo të tranzicionit drejt rendit të ri shoqëror. Për pasojë, politika si proces reduktohet në funksion të *telos-it* të demokratizimit si zbatim i këtij projekti, qoftë nëpërmjet elitave, institucioneve apo fushatave politike që duhet të prodhojnë “qytetarin demokratik” të çliruar nga trashëgimitë e së kaluarës (komuniste, parakomuniste, antidemokratike, etj.)

Është ironik fakti që në të dyja rastet teorizimi i tranzicionit bëhet duke u bazuar tek struktura konceptuale e ndërtuar brenda Marksizmit, veçanërisht pas Revolucionit të Tetorit 1917, për të teorizuar kalimin nga një shoqëri kapitaliste në një shoqëri komuniste.⁷³ Në të dyja rastet synohet perfeksioni i asaj që quhet inxhinieria sociale (social engineering), procesi nëpërmjet të cilit partia apo eksperti i demokratizimit si njohës të ligjesisë universale zbërthejnë detajet teknike të procesit të tranzicionit të shoqërisë nga kapitalizmi në komunizëm apo anasjelltas. Rrjedhimisht në të dyja rastet procesi politik reduktohet tek veprimtaria e disa aktorëve politikë dhe është thjesht reflektim i faktorëve më të thellë shoqëror. Me fjalë të tjera, politika në rastin më të mirë bëhet një proces dytësor që buron nga “thellësitë” e realitetit shoqëror, ndërsa në rastin më të keq ajo është procesi që e pengon realizimin e projektit demokratizues. Për këtë arsye shpesh në Shqipëri dëgjojmë thirrje për ekspertë apo specialistë të pandikuar nga politika, që me ndërgjegje të lartë profesionale do zbatojnë projektin e demokratizimit pa e ndotur atë me politikë.

NË KËRKIM TË POLITIKES: NJË DIMENSION ALTERNATIV

Më sipër u përpoqëm që të parashtrojmë disa nga aspektet kyçe të qasjeve të ndryshmeve të demokratizimit, në të cilat pak a shumë bëjnë pjesë në atë që ne e kemi quajtur “qasjet tranzicionaliste”, që në mënyrë implicite apo eksplicite bazohen tek një *telos* drejt një modeli të demokracisë liberale, që luhet mes procedurës dhe konsensusit. Kuptohet, brenda një kategorie kaq të përgjithshme secila qasje ka specifikat e veta. Një nga pikat themelore ndarëse mes tyre është ajo midis theksimit të strukturës dhe theksimit të aktorit. Disa qasje si tranzitologjia theksojnë rëndësinë e veprimit të aktorit politik, qasje të tjera, si ajo e modernizmit theksojnë faktorë më të “thellë” si strukturat sociale apo kultura politike. Ndërkohë, një pjesë e mirë luhet midis këtyre dy ekstremeve. Kështu, disa qasje theksojnë institucionet politike apo sistemin politik dhe kushtetues që kombinon aktorin dhe strukturën.

Megjithatë, përtej ndryshimeve në theks apo fokus të gjitha këto qasje kanë një tjetër pikë të përbashkët. Ato e shpjegojnë procesin e demokratizimit nëpërmjet disa faktorëve esencialë dhe të pandryshueshëm, nga ku buron edhe dinamika politike. Kështu, tranzitologët theksojnë veprimin e aktorit politik ndërsa studiues të tjerë strukturën shoqërore apo kulturën politike. Në të dyja rastet variablet përkatëse përmbajnë një realitet objektiv që ekziston në vetvete dhe që mund nxisë apo pengojë demokratizimin. Ka institucione politike, sisteme elektorale dhe madje edhe kultura që “nxisin zhvillimin e demokracisë”.⁷⁴ Për pasojë procesi politik është thjesht reflektim i ndërveprimit të këtyre faktorëve dhe jo burim i sendërzimit të tyre. Ndonëse e ndikojnë dhe ndikohen nga procesi politik këta faktorë ruajnë diku thellë edhe një esencë të paprekshme që i bën ata të dobishëm ose jo për demokracinë. Prandaj shpesh qasje të tilla prodhojnë përshkrime të procesit politik që konsistojnë në një sërë statistikash mbi partitë politike, përqindjen e votuesve apo të vendeve në parlament.⁷⁵

Një alternativë: Analiza e ligjërimit

Për të tejkaluar një këndvështrim kaq të ngushtë të politikës ne duhet të kalojmë përtej dikotomisë strukturë – aktor duke theksuar dimensionin politik të demokratizimit. Kjo do të thotë që politika nuk duhet parë thjesht si reflektim i faktorëve “të thellë” shoqërorë, por përkundrazi si procesi që i sendërzon këta faktorë. Strukturat shoqërore, institucionet politike e kështu me radhë, janë produkt i një procesi politik dhe jo anasjelltas. Kështu ekzistenca ose jo e shtresave të caktuara shoqërore nuk është një realitet sociologjik, por mbi të gjitha një realitet politik. Mjafton të kujtojmë këtu se vende si Shqipëria apo edhe të tjerë në Evropën Lindore krijuan lëvizje të suksesshme komuniste në emër të një shtrese sociale si klasa punëtore, që pothuajse nuk ekzistonte, por u sendërzua politikisht më vonë. Po kështu sot në Shqipëri ekziston një konsensus i gjerë që shtresa e mesme pothuajse nuk ekziston. Megjithatë, ky nuk është thjesht një konstatim empirik, por politik. Në fund të fundit shtresa e mesme është një përkufizim. Por nëse kjo shtresë do të artikulohej politikisht, nëse do ekzistonin politika të caktuara që i drejtohen asaj, natyrisht që një shtresë e tillë do të sendërzohej dhe do të fitonte një ekzistencë “objektive”. Përtej të qenit një zhvillim sociologjik, ky do të ishte së pari një zhvillim politik. E thënë ndryshe, është politika ajo që prodhon një shoqëri apo rend të caktuar shoqëror. Nuk është një shoqëri apo rend i caktuar shoqëror që prodhon një politikë të caktuar. Natyrisht këtu jemi duke përdorur një konceptim të politikës, që shkon përtej veprimtarisë së ngushtë midis partive dhe politikanëve.

Një qasje e tillë që fokusohet tek analiza e ligjërimit është zhvilluar nga Ernesto Laclau dhe Chantal Mouffe. Laclau dhe Mouffe “mbrojnë prioritetin e politikës përballë të gjitha versioneve të ekonomizimit apo sociologjisë”.⁷⁶ Në këtë qasje politika shikohet si procesi themelues i identiteteve, strukturave dhe institucioneve dhe jo thjesht si një reflektim i ndërveprimit mes tyre. Për pasojë, “politika jo vetëm që nuk është e kufizuar tek një superstrukturë e caktuar, por zë vendin e asaj që ne mund ta quajmë *ontologjia e sociale*”.⁷⁷ E thënë

ndryshe, politika është pikënisja nga sendërzohet shoqëria dhe jo anasjelltas. Kjo do të thotë që sendërzimi i çdo rendi shoqëror është në vetvete një akt politik. Është procesi, nëpërmjet të cilit një ligjërim i caktuar synon të bëhet hegjemonik duke përcaktuar dhe përkufizuar shoqërinë dhe marrëdhëniet brenda saj. “Sfida e politikës (*the political*) është çështja e sendërzimit të dimensionit social, pra e përcaktimit dhe artikullimit të marrëdhënieve shoqërore”.⁷⁸ Kjo nuk do të thotë që kushtet kulturore, historike apo individuale nuk janë të rëndësishme. Por do të thotë që “politika e kuptuar si praktika e krijimit, riprodhimit dhe transformimit të marrëdhënieve sociale nuk mund lokalizohet në një nivel të caktuar shoqëror”.⁷⁹ Ç’ka është e natyrshme për sa kohë politika ka statusin e ontologjisë së dimensionit social dhe prandaj nuk mund të lokalizohet thjesht brenda një niveli të caktuar të fenomenit që ajo prodhon.

Kjo është një qasje anti-esencialiste, pasi nuk e gjen burimin e procesit politik tek esenca e strukturës, kulturës kolektive apo psikologjisë individuale, ndryshe nga qasjet e tjera në fushën e demokratizimit. Në fakt, arsyeja përse në qasjen e Laclau dhe Mouffe politika ka një rol kaq primar, është sepse për ta shoqëria nuk është një dukuri që përcaktohet apo sendërzohet rreth një realiteti objektiv. Pra, nuk ka asnjë element themelor, apo esencë objektive rreth së cilës konstituohet shoqëria. “*E vërteta e shoqërisë është se identiteti i saj nuk ekziston*”.⁸⁰ Për këtë arsye shoqëria si fenomen sendërzohet në mënyrë diskursive, pra nëpërmjet ligjërimit. Ajo është një fushë kuptimore, ku identitetet sociale nuk kanë një pozitivitet të brendshëm që ekziston *apriori*, por një identitet që krijohet në marrëdhënie me identitete të tjera. Për këtë arsye, që shoqëria të ekzistojë si një fenomen objektiv, ajo ka nevojë për disa simbole (që Laclau dhe Mouffe i quajnë shënjesat të zbratur–empty signifiers) si “liria”, “demokracia”, “barazia”, “kombi”, “zhvillimi”, “Evropa” etj., etj, në raport me të cilat shoqëria krijon një identitet të caktuar, që nuk e gëzon *apriori*. Procesi politik është në thelb një betejë për të artikuluar dhe përkufizuar këto simbole që në vetvete përkufizojnë dhe përcaktojnë shoqërinë. Ja përse politika është akti themelues i shoqërisë apo ontologjia e dimensionit social. Si e tillë, ajo jo vetëm nuk mund dhe duhet të anashkalohej, por as nuk mund të reduktohet në statistika, konsolidim institucionesh apo implementim të “reformave standarde” drejt NATO-s apo BE-së.

KONKLUZION

Qëllimi i këtij artikulli ishte të nxirrte në pah presupozimet bazë mbi të cilat janë bazuar qasje të ndryshme që kanë përcaktuar mënyrën se si është konceptuar procesi i demokratizimit në teori dhe praktikë. Natyrisht nuk mund të pretendojmë se në një artikull të tillë kemi ezauruar të gjitha qasjet ekzistuese në lidhje me demokratizimin. Ajo që jemi përpjekur të bëjmë është fokusimi tek ato qasje që kanë pasur një impakt imediat në lidhje me politikën që janë ngritur dhe vazhdojnë të ngrihen në kuadrin e procesit të demokratizimit. Qasjet e shqyrtuara më sipër përbëjnë kuadrin konceptual dhe teorik, mbi të cilin shumë organizma dhe organizata që nga USAID dhe deri tek Bashkimi Evropian formulojnë politikën e tyre në raport me Shqipërinë. Sikurse është lehtësisht e konstatueshme, këto politika kanë të bëjnë me forcimin e institucioneve, shoqërisë civile apo shtetin e së drejtës. Një tipar i tyre i përbashkët, që buron nga themelet konceptuale, është neglizhimi i procesit politik apo reduktimi i tij në një veprimtari mes partive politike. Në rastin më të mirë qasje të tilla e shohin politikën si një instrument për të zbatuar reformat e integritit në BE, të forcimit të administratës apo të luftës kundër korrupsionit, ndërsa në rastin më të keq politika shikohet si veprimtaria që pengon realizimin e reformave apo forcimin e institucioneve. Në të dyja rastet politika shikohet si një dukuri që, ose duhet disiplinuar ose duhet tejkaluar. Gjithsesi, në procesin e demokratizimit ajo është pjesë e problemit dhe jo e zgjidhjes.

Sikurse jemi përpjekur të theksojmë më sipër, kjo është një qasje problematike, pasi injoron dimensionin e gjerë të politikës si procesi i sendërzimit të realitetit shoqëror. Kjo do të thotë jo vetëm që politika nuk mund

të shmangët apo të reduktohet si proces, por edhe se çdo përpjekje në këtë drejtim do deformatë jo vetëm procesin politik, por edhe shoqërinë në përgjithësi, duke e bërë të pamundur demokratizimin. Forcimi i institucioneve apo i shtetit të drejtës janë procese thellësisht politike dhe si të tilla produkte dhe jo burim i procesit politik. Për sa kohë procese të tilla do reduktohen tek zbatimi teknik i një modeli të caktuar, ato do të prodhojnë institucione të brishta dhe të paafta për të kanalizuar dinamikën politike. Në kushte të tilla kjo dinamikë jo vetëm do të zhvillohet jashtë, por edhe kundër institucioneve, duke riprodhuar pikërisht ato fenomene që projektet demokratizuese përpiqen t'i eliminojnë. Fatkeqësisht diçka e tillë ka ndodhur, po ndodh dhe do të vazhdojë të ndodhë në Shqipëri, për sa kohë politika nuk shihet si pjesë e zgjidhjes, por e pjesë e problemit në procesin e demokratizimit.

¹ European Commission 2003. Albania: Stabilisation and Association Report. http://europa.eu.int/comm/external_relations/see/sap/rep2/com03_339_en.pdf.

² Guilhot, N. (2002) "The Transition to the Human World of Democracy": Notes for a History of the Concept of Transition, from the Early Marxism to 1989", *European Journal of Social Theory*, 5:2, pp 231.

³ Lipset, S. (1959) *Political Man*, (London: Heinemann).

⁴ Almond, G. and Powell, G.B. (1966) *Comparative Politics: A Developmental Approach*, (Boston: Little, Brown).

⁵ Huntington, S. (1968) *Political Order in Changing Societies*, (New Haven: Yale University Press), pp 4-5.

⁶ Packenham, R. (1973) *Liberal America and the Third World: Political Development Ideas in Foreign Aid and Social Science*, (Princeton: Princeton University Press), pp 198.

⁷ *Ibid.* pp 340.

⁸ Shiko Evans, Peter B. Rueschenmeyer, D. and Skocpol, T. (1985) *Bringing the State Back In*, (Cambridge: Cambridge University Press), or Skocpol, T. (1979) *States and Social Revolutions: A Comparative Analysis of France, Russia and China*, (Cambridge: Cambridge University Press).

⁹ Linz, J. (1978) *The Breakdown of Democratic Regimes: Crises, Breakdown and Re-equilibration*, (Baltimore: The John Hopkins University Press), cited in Guilhot, N. (2002) "The Transition to the Human World of Democracy": Notes for a History of the Concept of Transition, from the Early Marxism to 1989", *European Journal of Social Theory*, 5:2, pp 236.

¹⁰ Linz, J. (1978) *The Breakdown of Democratic Regimes: Crises, Breakdown and Re-equilibration*, (Baltimore: The John Hopkins University Press), cited in Guilhot, N. (2002) "The Transition to the Human World of Democracy": Notes for a History of the Concept of Transition, from the Early Marxism to 1989", *European Journal of Social Theory*, 5:2, pp 236.

¹¹ Lowenthal, A. (1986), "Foreword", in O'Donnell, G., Schmitter, P. and Whitehead, L. (eds.) *Transition from Authoritarian Rule: Comparative Perspectives*, (Baltimore and London: The John Hopkins University Press), pp. ix.

¹² Huntington, S. (1984) "Will More Countries Become Democratic?", *Political Science Quarterly*, 99:2, pp 217.

¹³ Shiko për shembull Valerie Bunce (1995) "Should Transitologists Be Grounded?", *Slavic Review*, 54:1, pp 111-27.

¹⁴ Reisinger, W. (1997), "Establishing and Strengthening Democracy", in Grey, R. (ed.) *Democratic Theory and Post-Communist Change*, (New Jersey: Prentice Hall), pp 54.

¹⁵ *Ibid.* pp 59.

¹⁶ Putnam, R. (1993) *Making Democracy Work*, (Princeton: Princeton University Press).

¹⁷ Moore, B. (1966) *Social Origins of Dictatorship and Democracy: Lord and Peasant in the Making of the Modern World*, (Boston: Beacon Press), pp 418.

¹⁸ Reisinger, W. (1997), "Establishing and Strengthening Democracy", in Grey, R. (ed.) *Democratic Theory and Post-Communist Change*, (New Jersey: Prentice Hall), pp 67.

¹⁹ Lijphart, A. (1992) "Democratization and Constitutional Choices in Czechoslovakia, Hungary and Poland, 1989-1991". *Journal of Theoretical Politics*, 4:2, pp 207.

²⁰ Blokter, P. (2005) "Post-Communist Modernization, Transition Studies, and Diversity in Europe", *European Journal of Social Theory*, 8:4, pp 512

²¹ Rustow, D. (1970), "Transition to Democracy: Toward a Dynamic Model", *Comparative Politics*, 2:2, pp 361.

²² Shiko O'Donnell, G. and Schmitter, P. (1986), *Transition from Authoritarian Rule: Tentative Conclusions About Uncertain Democracies*, (Baltimore: The John Hopkins University Press).

²³ Schmitter, P. and Terry, K. (1994) "The Conceptual Travels of Transitologists and Considologists: How Far to the East Should They Attempt to Go?" *Slavic Review*, 53:1, pp 174.

- ²⁴ Karl, T. (1990) "Dilemmas of Democratization in Latin America", *Comparative Politics*, 23:1, pp 1 – 23.
- ²⁵ Karl, T. and Schmitter, P. (1991), "Modes of Transition in Latin America and Southern and Eastern Europe", *International Social Science Journal*, 43:128, 269-284.
- ²⁶ Carothers, T. (2002), "The End of the Transition Paradigm", *Journal of Democracy*, 13:1, pp 6.
- ²⁷ *Ibid.* pp 7.
- ²⁸ O'Donnell, G. (2002) "In Partial Defence of an Evanescent Paradigm", *Journal of Democracy*, 13:3 pp 9
- ²⁹ Carothers, T. (2002), "The End of the Transition Paradigm", pp 8.
- ³⁰ Schmitter, P. and Terry, K. (1994) "The Konceptual Travels of Transitologists and Considologists: How Far to the East Should They Attempt to Go?" *Slavic Review*, 53:1, pp 178.
- ³¹ Shiko, Przeworsky, A. (1991) *Democracy and the Market* (Cambridge: Cambridge University Press), Susanne Lohman. "The Dynamics of Informational Cascades: The Monday Demonstrations in Leipzig, East Germany, 1989-1991". *World Politics* 47 (October 1994), 42-101, Daniel Sutter. "The Transition from Authoritarian Rule: A Game Theoretic Approach". *Journal of Theoretical Politics* 12 (2000-2001), 67-89 and Patrick O'Neil. "Revolution from Within: Institutional Analysis, Transitions from Authoritarianism, and the Case of Hungary". *World Politics* 48 (July 1996), 579-603.
- ³² Linz, J. and Stepan, A. (1996) *Problems of Democratic Transition and Consolidation*, (Baltimore and London: The John Hopkins University Press), pp xiv.
- ³³ *Ibid.* pp xiv.
- ³⁴ Diamond, L. (1999) *Developing Democracy: Towards Consolidation*, (Baltimore: Johns Hopkins University Press).
- ³⁵ Lynn, J. N.(1999) "Geography and Transition: Re-konceptualizing Systemic Change in the Former Soviet Union", *Slavic Studies*, 58:4, pp 827.
- ³⁶ *Sovietologjistë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës qheshin të gjithë ata autorë që merreshin me studimin e Bashkimit Sovietik.*
- ³⁷ Shiko Ken Jowitz, "Weber, Trotsky and Holmes on the Study of Leninist Regimes", *Journal of International Affairs* (Summer 1991): 31-50 and "The Leninist Extinction" in D. Chirot, ed., *The Crisis of Leninism and the Decline of the Left* (Seattle:University of Washington Press, 1991), 74-99.
- ³⁸ Bunce, V. (1995) "Should Transitologists Be Grounded?," *Slavic Review*, 54:1, pp 111-27.
- ³⁹ *Ibid.* pp 119.
- ⁴⁰ Wiarda, J. H. (2002), "Southern Europe, Eastern Europe, and Comparative Politics: "Transitology" and The Need for New Theory" *East European Politics and Society*, 15:3, pp 495.
- ⁴¹ Carothers, T. (2002), "The End of the Transition Paradigm", *Journal of Democracy*, 13:1, pp 20.
- ⁴² Almond, G. and Verba, S. (1989), *The Civic Culture – Political Attitudes and Democracy in Five Nations*, (Newbury Park:Sage), pp 13.
- ⁴³ Eckstein, H. (1988), "A Culturalist Theory of Political Change", *American Political Science Review*, vol 82, pp. 453-457.
- ⁴⁴ Brown, A. (2003), "Political Culture and Democratization: The Russian Case in Comparative Perspective", in Pollack, D., Jacobs, J, Muller, O., Pickel, G. (eds.) *Political Culture in Post-Communist Europe: Attitudes in new democracies*, (England: Ashgate), pp 18.
- ⁴⁵ Huntington, S. (1996) "Democracy's Third Wave" in Diamond, L. and Plattner, M. (eds.) *The Global Resurgence of Democracy: Second Edition*, (Baltimore and London: John Hopkins University Press), pp 13.
- ⁴⁶ Pollack, D., Jacobs, J, Muller, O., Pickel, G. (eds. 2003) *Political Culture in Post-Communist Europe: Attitudes in new democracies*, (England: Ashgate), pp. xiv.
- ⁴⁷ Blokker, P. (2005) "Post-Communist Modernization, Transition Studies, and Diversity in Europe", *European Journal of Social Theory*, 8:4, pp 511
- ⁴⁸ Schumpeter, A. J. (1976) *Capitalism, Socialism and Democracy*, (London: George Allen & Unwin Ltd), pp 269.
- ⁴⁹ Whitehead, W. (2002) *Democratization: Theory and Practice*, (Oxford: Oxford University Press), pp 9.
- ⁵⁰ Schedler, A. (1998) "What Is Democratic Consolidation?," *Journal of Democracy*, 9:2, pp 92.
- ⁵¹ Dahl, R. (1982) *Dilemmas of Pluralist Democracy*, (New Haven: Yale University Press), pp 11.
- ⁵² Sakwa, R. (1999) *Postcommunism*, (Buckingham, Philadelphia: Open University Press), pp 46.
- ⁵³ Schmitter, P. and Karl, T. (1996) "What Democracy Is...and Is Not", in Diamond, L. and Plattner, M. (eds.) *The Global Resurgence of Democracy: Second Edition*, (Baltimore and London: John Hopkins University Press), pp 55.
- ⁵⁴ Bunce, V. (1999) "The Political Economy of Postsocialism", *Slavic Review*, 58:4, pp 780.
- ⁵⁵ Whitehead, W. (2002) *Democratization: Theory and Practice*, (Oxford: Oxford University Press), pp 12.
- ⁵⁶ *Ibid.* pp 18.
- ⁵⁷ *Ibid.* pp 34.
- ⁵⁸ Bernard Crick (1964), *In Defence of Politics*, (Harmondsworth: Penguin Books), pp 24, cited in Rustow, D. (1970), "Transition to Democracy: Toward a Dynamic Model", *Comparative Politics*, 2:2, pp 363.
- ⁵⁹ Whitehead, W. (2002) *Democratization: Theory and Practice*, pp 27.
- ⁶⁰ Arnason, Johann, P. (2000) "Designs and Destinies: Making Sense of Post-Communism", *ese recence*, Thesis Eleven 63: 89-97, cited in Blokker, P. (2005) "Post-Communist Modernization, Transition Studies, and Diversity in Europe", *European Journal of Social Theory*, 8:4, pp 507.
- ⁶¹ Blokker, P. (2005) "Post-Communist Modernization, Transition Studies, and Diversity in Europe", *European Journal of Social Theory*, 8:4, pp 507.
- ⁶² Bunce, V. (1995) "Paper Curtains and Paper Tigers", *Slavic Review*, 54: 4, pp 979.
- ⁶³ Bunce, V. (2000) "Comparative Democratization: Big and Bounded Generalization", *Comparative Political Studies*, 33: 6/ 7, pp 715.
- ⁶⁴ *Ibid.* pp 715.
- ⁶⁵ Whitehead, W. (2002) *Democratization: Theory and Practice*, (Oxford: Oxford University Press), pp 237.
- ⁶⁶ *Ibid.* pp 237.

- ⁶⁷ Tokes, R. (2000) " 'Transitology': Global Dreams and Post-Communist Realities", *Central Europe Review*, 2:10, available at <http://www.ce-review.org/00/10/tokes10.html> last accessed, April 20, 2007.
- ⁶⁸ Burawoy, M. and Verdery, K. (eds. 1999) *Uncertain Transitions: Ethnographies of Change in the Postsocialist World*, (New York: Rowman & Littlefield Publishers, Inc.), pp 1.
- ⁶⁹ *Ibid.* pp 1-2.
- ⁷⁰ Verdery, K. (1999), *The Political Lives of Dead Bodies: Reburial and Postsocialist Change*, (New York: Columbia University Press), pp 23.
- ⁷¹ *Ibid.* pp 25.
- ⁷² *Ibid.* pp 24.
- ⁷³ Shiko Verdery, K. (1996), "What Was Socialism and What Comes Next?", (Princeton: Princeton University Press). *Kjo është një vepër impresionuese që përqendrohet tek Rumania ku Verdery jetoi si antropologe para, pas, dhe gjatë rënies së sistemit komunist. Aty ka shumë konkluzione mjaft të mprehta mbi të kaluarën socialiste dhe të tashmen post-socialiste.*
- ⁷⁴ Guilhot, N. (2002) " 'The Transition to the Human World of Democracy': Notes for a History of the Concept of Transition, from the Early Marxism to 1989", *European Journal of Social Theory*, 5:2, pp 238-39.
- ⁷⁵ Huntington, S. (1996) "Democracy's Third Wave" in Diamond, L. and Plattner, M. (eds.) *The Global Resurgence of Democracy: Second Edition*, (Baltimore and London: John Hopkins University Press), pp 13.
- ⁷⁶ Henderson, K. and Robinson, N. (1997), *Post-Communist Politics: An Introduction*, (London: Prentice Hall). pp 270-271.
- ⁷⁷ Yanarella, Ernest, J. (1993) "Whither Hegemony?: Between Gramsci and Derrida", in Jones, J.P. et al. (ed) *Postmodern Contentions. Epochs, Politics, Space* (New York: Guildford Press), pp 86.
- ⁷⁸ Laclau, E. (1996) *Emancipation(s)*, (London-New York: Verso), pp 103.
- ⁷⁹ Laclau and Mouffe (1996). *Hegemony and Socialist Strategy: Towards a Radical Democratic Politics*, (London-New York: Verso), pp 153.
- ⁸⁰ Laclau and Mouffe (1996). *Hegemony and Socialist Strategy: Towards a Radical Democratic Politics*, (London-New York: Verso), pp 153.
- ⁸¹ Brockelman, T. "The Failure of the Radical Democratic Imaginary: Zizek versus Laclau and Mouffe on Vestigial Utopia", in *Philosophy & Social Criticism*. 29:2, 2003, pp 189.

NDËRKOMBËTARËT SI PALA E TRETË : NJË UDHËTIM BASHKË ME NDËRKOMBËTARËT NËPËR TRANZICIONIN SHQIPTAR 1990 - 2002

Henri Çili*

Abstrakt. Në këtë ese shqyrtohet roli i komunitetit ndërkombëtar në procesin e demokratizimit të Shqipërisë nga fillimi i tranzicionit deri në ditët tona. Në fokus është procesi nëpërmjet të cilit komuniteti ndërkombëtar shndërrohet nga një faktor ndihmues në procesin e demokratizimit, sidomos në fillimet e tij, në një arbitër të këtij procesi. Në këtë mënyrë komuniteti ndërkombëtar kthehet në një ‘palë të tretë’ përbri aktorëve tradicional politikë në një demokraci, pozitë dhe opozitë. Kjo prodhon një hapësirë politike hibride ku standartet dhe procedurat demokratike nuk janë të vetmet elementë përcaktues në lojën politike. Madje sa më shumë çënohen këto standarte aq më shumë bëhet i domosdoshëm roli i komunitetit ndërkombëtar që shpesh është shfrytëzuar nga forca në pushtet për të bllokuar aksionin politik të opozitës. Në këtë hapësirë politike ‘hibride’ roli i komunitetit ndërkombëtar në procesin e demokratizimit duhet rishqyrtuar.

HYRJE

Në zhargonin politik dhe publicistik në Shqipëri, fjala *komuniteti ndërkombëtar* nuk ka ekzistuar deri në fillim të viteve 90-të. Ai është tanimë në media dhe ligjërimin politik një term mjaft i shpeshtë. Kurse në ortografinë e re të gjuhës shqiptare është gërmë e madhe. Veprimi apo mosveprimi i komunitetit ndërkombëtar në Shqipërinë e tranzicionit ka qenë i një rëndësie të madhe për zhvillimet demokratike në vend. Me termin “ndërkombëtarët”, edhe pse Shqipëria ka marrëdhënie me shumë shtete në të pesë kontinentet, në logjikën lokale kuptohet Perëndimi, pra Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Europian. Komuniteti Ndërkombëtar ka fituar edhe nga pikëpamja gjuhësore një status krejt të veçantë. Kjo sepse, në kushtet e rënies së vazhdueshme të besimit tek politika lokale krahas fragmentimit të interesave dhe artikulimit, kërkohet një tjetër pikë referimi, një tjetër që “flet drejt”, “jashtë interesave partiake” etj, dhe ky është Komuniteti Ndërkombëtar. Për faktin se është bërë burim legjitimiteti për pushtetin në Shqipëri, nga vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit, Xhejms Bejker, më 1991, e deri tek vizita e Presidentit Amerikan, Bush, më 2007, por dhe për faktin që në Shqipëri dominon ideja se nga Amerika dhe në përgjithësi nga Perëndimi varet fati i kombit shqiptar. Ndërkombëtarët janë zgjidhja, janë shpresa, janë gjykimi. Duke filluar që nga fillimet e transformimeve demokratike ku Perëndimi ishte ëndrra e shqiptarit të izoluar, si shprehje e lirisë, mirëqenies dhe lumturisë e deri më sot, ku integrimi euro-atlantik është shndërruar një një objektiv kombëtar, roli i komunitetit ndërkombëtar në Shqipëri ka qenë tepër i madh. Por në të njejtën kohë mjaft i diferencuar në kohë dhe faza të ndryshme të dinamikës sonë të brendshme politike dhe shoqërore.

Qëllimi i kësaj eseje është të analizojë pikërisht këtë nuancim të rolit të ndërkombëtarëve në Shqipëri që nga fillimi i transformimeve demokratike të Shqipërisë më 1990 e deri në vitin 2002, ku sipas kësaj eseje mbyllet një cikël i plotë: roli i tyre evoluon nga një rol ndihmues, asistues në fillim të viteve '90-të drejt një roli ndërmjetësues – moderues në mesin e viteve '90-të, për të përfunduar drejt një statusi të tillë si palë e tretë në fund të viteve '90-të e

* Henri Çili është pedagog në Universitetin Europian të Tiranës (UET). Ai ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare në filozofi politike në Universitetin Paris 8 në Francë. Kjo ese ka në bazë të saj temën diplomës për studime pauniversitare në filozofi politike, që autori ka mbrojtur në Universitetin Paris 8, France, në vitin 2004.

fillim të viteve 2000. Ndërsa pas vitit 2002, kur ndodh kompromisi pozitë-opozitë, apo ajo që quhet marrëveshja Nano – Berisha, futemi në një fazë të re të rolit të komunitetit ndërkombëtar, për të cilin ia vlen një analizë krejt tjetër.

Kjo ese përpiket të shtjellojë se si përkthehet veprimi i aktorëve ndërkombëtare në hapsirën politike lokale dhe si si kjo hapsirë politike *hibridizohet* duket fituar një status të ndërmjetëm: as një demokraci e vetqeverisur dhe me mekanizma vetmajftues ekulibri dhe vetregullimi; as një hapsirë e qeverisur plotësisht nga jashtë. Në pjesën e parë do të trajtohen ato pjesë të periudhës së tranzicionit, gjatë të cilave ka patur një përputhje mes legjitimitetit të jashtëm dhe legjitimitetit të brendshëm. Në pjesën e dytë do të trajtohen ato pjesë të periudhës së tranzicionit, gjatë të cilave ka patur kundërvënie mes legjitimitetit të jashtëm dhe atij të brendshëm. Në pjesën e tretë do të trajtohen transformimi i rolit të ndërkombëtarëve nga ndihmues- asistues në fillimet e tranzicionit për të përfunduar tek pala e tretë në fund të viteve '90-të e fillim të viteve 2000. Për këtë qëllim do të përdoren dy terma kyç për nevojat e këtij studimi: *legjitimitet i jashtëm* me të cilin do të kuptojmë mbështetjen ndërkombëtare për qeverinë apo partinë në fuqi; *legjitimitet i brendshëm* me të cilin do të kuptojmë mbështetjen e brendshme nga elektorati, e dalë dhe certifikuar kjo nga zgjedhje të pranuar gjerësisht si të lira dhe të ndershme.

NDRYSHIMET E SHPEJTA SI KOMBINIMIN I MBËSHTETJES SË BRENDSHME DHE TË JASHTME

Gjatë këtyre viteve të tranzicionit shqiptar, pushteti në Shqipëri ka qenë efektiv vetëm kur legjitimiteti i jashtëm dhe ai i brendshëm kanë shkuar drejt së njëjtës forcë politike. Mungesa e tensionit mes këtyre dy legjitimiteteve ka prodhuar një qetësi politike, një siguri për qeverisjen dhe një stabilitet të administratës publike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Kështu, në vitet 1992-1996, kur Partia Demokratike fitoi zgjedhjet me një shumicë të madhe dhe kur ajo ishte e mbështetur fort nga jashtë, kemi një periudhë mjaft efektive politike nga ana e qeverisë. Aksioni i saj është i gjallë, reformat janë të shpejta dhe për pasojë, ritmi i ndryshimit është i madh. Ja si e përshkruan këtë situatë presidenti i ri i Republikës, Sali Berisha, në korrik të vitit 1992, kur opozita kishte jo më shumë se 3 muaj në pushtet:

Në më pak se 100 ditë, Shqipëria priti, përcolli dhe u takua me presidentë, kryeministra e burra shteti më shumë se gjatë gjithë historisë sesa shumëshkullore të marra së bashku. Frytet më konkrete të kësaj politike të “dyerve të hapura” janë marrëveshjet e shumta që janë nënshkruar me botën, mesazhi i madh që solli mbledhja e 24 vendeve më të zhvilluara të botës.¹

E gjithë kjo mbështetje politike reflektohet natyrisht gjatë këtyre viteve edhe në planin ekonomik, në sigurimin e ndihmës së huaj për asistimin e reformave në vend. Qytetarët e zakonshëm, tek votat e të cilëve ndikoi shumë premtimi se forcat e reja demokratike në pushtet do të ndihmoheshin nga bota, kishin nevojë për ndihma më konkrete, (ushqime, rroba) në kushtet e mungesës për një kohë të gjatë të mallrave të konsumit. Presidenti Berisha e konkretizon në shifra këtë mbështetje:

Dua të them se komuniteti ndërkombëtar po i akordon Shqipërisë sasi ndihmesh të atilla, të cilat janë katër-pesë herë më të mëdha për frymë sesa çdo vend tjetër i Evropës Lindore. Mjafton t’u them se për një vit, të tri Republikave Ballklike së bashku u janë dhënë në formë kredie 630 milionë dollarë nga Komuniteti Evropian, ndërsa vetëm Shqipëria ka marrë ndihmë në formë dhurate rreth 500 milionë dollarë.²

¹ Berisha, Sali. “Mesazhi i madh i botës së zhvilluar. Berisha, Sali, “Rilindja demokratike”, 1992, nr.156, 25 korrik.

² Berisha, Sali, “Tribuna demokratike”, 1992, nr. 23, 23 nëntor.

Vitet 1992-1996 janë konkretisht dhe vitet me bilancin më të madh të transformimeve të të gjitha natyrave në vend; ekonomike, sociale, politike, institucionale. Kjo periudhë është një periudhë ndryshimesh rënësore, të cilat zor se do të bëheshin në një situatë tjetër të dytë, nëse mbështetja e qeverisë nuk do të ishte e fortë edhe brenda vendit, edhe jashtë, tek partnerët ndërkombëtarë.

E njëjta gjë mund të thuhet për periudhën e 1997 – 2001, për periudhën kur në pushtet erdhi Partia Socialiste. Ajo vinte me një legjitimitet të madh popullor për shkak të krizës së vitit 1997, dështimit të Partisë Demokratike me rastin e piramidave, ku shqiptarët humbën masivisht paratë e tyre. Po ashtu, ajo ishte mjaft e mbështetur nga jashtë, veçanërisht pasi partnerët ndërkombëtarë ishin tanimë mjaft skeptikë për ish-presidentin Berisha dhe partinë e tij në opozitë. Kjo vlente sidomos për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat patën një konflikt thuajse të hapur me administratën e Berishës, duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 1996, për shkak të problemeve me zgjedhjet. Në këtë periudhë kemi ndërmarrjen e shumë reformave të tjera, si çmontimi i skemave piramidale, një sërë reformash institucionale dhe liberalizim të medias elektronike. Po ashtu në këto vite u miratua dhe Kushtetuta e re e vendit, proces që mori një mbështetje të fortë ndërkombëtare. Edhe pse qeveritë dhe kryeministrat e shumicës socialiste u ndërruan shpesh, deri në fund të mandatit u shënuan disa suksese të dukshme edhe në raport me infrastrukturën e rrugëve kombëtare apo në menaxhimin e hapësirës urbane të vendit. Për kryeministrin Fatos Nano, i cili vetëm dy muaj pas fitores së zgjedhjeve bëri një vizitë në Uashington, sidomos mbështetja amerikane është e evidente:

Mbështetja amerikane është prioritare dhe do të vazhdojë të jetë mjaft motivuese për rritjen e përgjegjësive tona, që Shqipëria të jetë një pikë reference për evropianizimin e Ballkanit dhe jo me një vend që është pjesë e shqetësimeve të komunitetit ndërkombëtar, por një vend partner në zgjidhjen e problemeve globale.³

Diplomatët e huaj në Tiranë bëjnë çdo kujdes që qeveria të mbështetet, bile as të mos shqetësohet shumë nga ana e forcave opozitare në vend. Ambasadori i OSBE-së, hollandezi Dan Everts, në Tiranë nënvizon; “Jam pak i shqetësuar që kësaj qeverie nuk po i lihet kohë që në fillim. Nëse ka disa elemente të mira në politikën e saj, nuk ka asgjë të gabuar nëse opozita bashkëpunon.”⁴ Kur po i afrohem fundit të mandatit qeverisës së socialistëve në vitin 2001, Ambasadori amerikan, Jozef Limprecht, në Tiranë, jo vetëm shpreh mbështetjen për qeverinë dhe reformat e saj, por nuk ngurron t’i bëjë avokatinë bilancit të qeverisë socialiste:

Është e rëndësishme të theksohet se që nga viti 1997 ekonomia shqiptare është rritur me ritëm 7-8 për qind. Megjithëse u nis nga një pikë e ulët, ajo përsëri është një rritje e madhe. Të huajt që kanë punuar dhe jetuar në Shqipëri për një farë kohe, më kanë thënë shpesh se shqiptarët duan stabilitet dhe qëndrueshmëri. Ata po fillojnë të krijojnë klasën e mesme, një klasë që do stabilitet ekonomik dhe politik. Ky është një mesazh që u dërgohet partive politike.⁵

Nuk ka asgjë për të shënuar në kronikën e këtyre viteve në raportin mes pushtetit dhe ndërkombëtarëve, kur pushteti është i mbështetur dhe nga jashtë dhe nga brenda, hapësira politike është e qetë dhe funksionon. Mbështetja ndërkombëtare për pushtetin nuk ngurron të shfaqet jo vetëm në hapa konkretë, por dhe në nivelin deklarativ.

³ Nano, Fatos, “Zëri i popullit”; nr. 512, 28 shtator 1997, f. 3.

⁴ (Dan Everts: “Koha jonë”; nr. 294, 20 dhjetor 1998, f.5).

⁵ Limprecht, Joseph, Intervistë për VOA; ribotim, “Zëri i popullit”; nr. 813, 19 korrik 2001, f. 3.

Efektet anësore të legjitimitetit të dyfishtë: ndërkombëtarët në konflikt me opozitën

Komuniteti ndërkombëtar me përkrahjen e madhe që i ka dhënë palës në pushtet gjatë këtyre dy periudhave, pra në periudhën 1992–96 dhe 1997–2001, do të prodhonte në mënyrë të paevitueshme një konflikt me opozitën e kohës. Opozita socialiste nis pak nga pak dhe reagon duke u përpjekur, krahas denoncimit të qeverisë të diferencojë disa aktorë ndërkombëtarë, kryesisht persona, duke sulmuar mbështetjen që ata i japin regjimit të Berishës dhe efektet anësore që kjo ka në zhvillimin e demokracisë. Në fillim të viteve 90-të, socialistët shqiptarë nisin shpejt një konflikt me përfaqësuesit diplomatikë të SHBA-së në Tiranë, si reaksion i mbështetjes së hapur dhe totale që SHBA-ja dhe Ambasadori amerikan në Tiranë, Uilliam Rajerson, u japin demokratëve dhe liderit e tyre Sali Berisha. Rajerson jo vetëm që del në mitingjet elektorale të Partisë Demokratike të vitit 1992, por pothuajse e lë jashtë axhendës diplomatike Partinë Socialiste. Gazeta e Partisë Socialiste e sulmon shpesh në editorialet e saj ambasadorin amerikan, kurse në një intervistë nga burgu, kryetari i Partisë Socialiste, Fatos Nano, thotë:

Ballafaqimet me Rayersonin i kam pasur në shumë mjedise dhe ceremoni diplomatike, sepse ai nuk gjente kohë tjetër për t'iu përgjigjur ftesave tona për shkëmbim mendimesh dhe informacion; pra buzëqeshjet diplomatike nuk ia kemi kursyer njëri-tjetrit. Zoti Rayerson erdhi në Tiranë nga Beogradi, ku ishte specializuar për mbrojtjen e interesave globale amerikane në rajon, në periudhën dhe në klimën e “Luftës së Ftohtë”. Sa më takon mua, unë nuk paragjykova dhe as mund të mendoja për të ndërtuar raporte të këqija me të. Pra, mbetet që ai të ketë paragjykuar raportet me mua dhe PSSH-në, sipas koncepteve dhe skemave të vjetra makartiste dhe antikomuniste, të cilat për brezin e ri të intelektualëve e politikanëve shqiptarë janë krejt jashtë kohe dhe jashtë loje!⁶

Jo vetëm kaq, por për kryetarin e opozitës, edhe burgosja e tij, si një mënyrë për të dobësuar opozitën socialiste dhe për të mbështetur Partinë Demokratike në pushtet në vitet 1992-1996, duket se është një vepër e cila ka edhe mbështetjen apo shtysën e diplomatëve amerikanë në Tiranë. Por megjithatë opozita bën kujdes të ndajë veprimin e Amerikës nga aksioni i një ambasadori në Tiranë, jo thjesht sepse kjo është diplomatike, por sepse imagjinaria e Perëndimit apo Amerikës nuk duhen njollosur nga veprimi i individual, qoftë dhe i përfaqësuesit të SHBA-së në Tiranë. Sepse dhe për opozitën është jetik sot apo nesër mbështetja e SHBA-së, ndaj kllapat duhen lënë hapur. Ja si e shpjegon zoti Nano këtë anë të errët të kulisave të burgosjes së tij.

Megjithëse në shumë zyra të shtetit shqiptar e gjetkë, përreth shumë veprimeve të mia legale kam ndier hijen dhe ndikimin prapa krahëve të z. Rayerson, as unë, as shokët e mi nuk kemi mundur kurrë të ngatërrojmë veprimet e tij, shpesh jashtë statusit dhe të papëlqyera nga publiku, me politikën dhe interesat parimore të Shtëpisë së Bardhë për përparimin demokratik të Shqipërisë. Koha tregoi se nuk kishim gabuar!⁷

Opozita socialiste dhe lideri i saj, Fatos Nano, përdorin terma të ashpra kundër SHBA-së dhe politikës së saj në Tiranë, jo thjesht në nivelin e fatit personal të zotit Nano, por shumë më gjerë. Në një tjetër prononcim publik, kryetari i PS-së, Nano, bën një aludim të hapur ndaj SHBA-së, me togfjalëshin republikë bananesh.

⁶ Nano, Fatos, “Zëri i popullit”- nr. 9 shtator, 1994, f.3.

⁷ Nano, Fatos, “Zëri i popullit”, nr. 9 shtator, 1994, f.3.

E kuptoj fare mirë dhe nuk do të rresht deri në fund të karrierës sime diplomatike dhe të jetës sime fizike, të denoncoj, ashtu si dhe deri më sot, gjithçka që po zbatohet në Shqipëri në formë skemash të rekomanduara, të papërshtatshme për mentalitetin dhe realitetin e shqiptarëve nga shtabe politikanësh apo feudalësh të harbuar, të cilët i kam denoncuar prej kohësh si ideatorë të kthimit të Shqipërisë në një “republikë bananesh”.⁸

Ardhja e Partisë Demokratike në pushtet më 1992, por jo vetëm kaq, që nga krijimi i saj në dhjetor 1990, përkon me një periudhë ku SHBA-ja është angazhuar fort në përmbyshjen e komunizmit në vendet e Europës Lindore. Reganizmi në funksion të anti-komunizmit, i vënë tanimë në zbatim nga administrata republikane e Presidentit Bush është në kulmin e aplikimit si politikë. Opozita Demokratike e Shqipërisë dhe më pas qeveria demokratike e Presidentit Berisha priten në Uashington ngrohtë. Vetëm disa javë pas zgjedhjes si president në prill të vitit 1992, Sali Berisha pritet nga Presidenti amerikan, Xhorxh Bush, në Shtëpinë e Bardhë. Pritet sërish në 1995 edhe nga Presidenti Klinton në vizitë zyrtare. Hera e parë që një drejtues i shtetit shqiptar pritet në nivele kaq të larta. Sakaq, kjo mbështetje në planin e brendshëm manifestohet në një arrogancë në rritje të qeverisë, e cila ka si tregues të saj, ngushtimin e lirive politike të opozitës, arristimin dhe burgosjen e kryetarit të PS-së, Fatos Nano, ekseset me lirinë e shtypit, pengimin e hapjes së televizioneve private dhe shumë tregues të tjerë të dokumentuar në raportet ndërkombëtare për gjendjen e demokracisë në atë periudhë në Shqipëri.

ROLI I NDERKOMBËTARËVE PAS 1997: NDËRRIMI I VENDEVE MES SOCIALISTËVE DHE DEMOKRATËVE

Pas vitit 1997, kur në pushtet vijnë socialistët, është tanimë zoti Berisha dhe Partia Demokratike në opozitë që janë në konflikt të hapur me komunitetin ndërkombëtar dhe SHBA-në në veçanti. Aq më tepër që në ligjërimin e demokratëve rrëzimi i tyre me dhunë prej pushtetit në 1997-ën, është bërë dhe me ndihmën e shërbimeve të huaja sekrete, dhe me mbështetjen politike të SHBA-së. Në krye të Ambasadës Amerikane në Tiranë është një ambasadore, Mariza Lino. Kjo e fundit në shtypin e Partisë Demokratike shpesh kritikohet hapur, kurse në gazetatat afër demokratëve ajo është bërë personazh i rubrikave humoristike, duke e krahasuar me personazhe komike lokale. Në një analizë për krizën e vitit 1997 dhe raportet me SHBA-në, zoti Berisha, dikur miku i madh i amerikanëve dhe njeriu i mbështetur prej tij, në mënyrë absolute thotë:

Unë jam i vetëdijshëm se SHBA-ja është sot superfuqia e vetme në botë, janë gjithashtu një vend i madh, janë universi i lirisë në botë. Padyshim jam përpjekur për miqësi dhe bashkëpunim dhe do të përpiqem dhe më tej, të mos ketë kush iluzione. Por me këtë vend kemi pasur dallime serioze në interpretime, interesa dhe qëndrime. Jemi të hapur për dialog dhe zgjidhje në frymë bashkëpunimi, sikundër kemi mbrojtur të drejtat sovraane të vendit tonë.⁹

Të njëjtën kritikë ka kryetari i opozitës edhe ndaj ambasadorit pasardhës, në krye të misionit diplomatik amerikan në Tiranë, Jozeph Limpreht-it, të cilin së bashku me shefin e zyrës së OSBE-së në Tiranë, Gert Ahresn, shpesh e quan në fjalimet e tij publike, *gubernator të paemëruar*, natyrisht pa i përmendur emrin:

Vërtet kryeministri Meta mendon dhe u beson guvernatorëve që i fërkojnë shpatullat, por

⁸ Nano, Fatos “Heqja e imunitetit deputetit Fatos Nano, kryetar i PSSH. Bisedë e gazetarit Martin Leka me zotin F. Nano /Fatos Nano; Bised. Martin Leka “Koha jonë”-28 korrik, 1993, f.1.

⁹ Berisha, Sali, “Rilindja demokratike”, nr. 2700, 26 nëntor, 2000, f. 2 - 3.

harron se qytetarët nuk ia falin, Ilir Metës, vilën me qindra milionë lekë të taksapaguesve shqiptarë. Vërtet pra, këta qeveritarë mund të buzëqeshin dhe të trumbetojnë në mediat e tyre shtetërore ose joshetërore deklaratat e “gubernatorëve të paemëruar”. Këto media të kontrolluara deri në palcë janë angazhuar në një fushatë të turpshme dezinformimi të shqiptarëve me këto deklarata guvernatorësh. Por Evropa ka standarde tërësisht të tjera, dhe këto standarde dhe këto qëndrime ajo i ka shpallur në tempullin e demokracisë.”¹⁰

Duket një simetri gati karikaturale në këtë ndërrim rolesh. Ashtu si Kryetari i Opozitës dje, Fatos Nano, që kritikon Amerikën dhe përpiqet të afrohet me Europën, edhe Kryetari i opozitës, Sali Berisha, tani përpiqet të gjejë një *exit* tek Europa. Megjithatë jo më pak të kritikuar janë dhe shumë qeveri të vendeve të Bashkimit Evropian në vitin 2000, në prag të zgjedhjeve lokale, të cilat edhe këto duket se mbështesin hapur të majtën shqiptare në pushtet dhe bëjnë të mbyllet një sy për gjendjen në Shqipëri. Por edhe kritiqohet thjesht si qeveri ta majta. Ja çfarë thotë Berisha në këtë periudhë:

Ka një qëllim preciz në të gjithë këtë: e majta evropiane nuk dëshiron të bëjë të ditur gjendjen e tmerrshme në Shqipëri të shkaktuar nga kjo qeveri. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga shtatë persona, nga të cilët 6 janë të qeverisë dhe vetëm një është i opozitës.¹¹

Në periudhën kur legjitimiteti i jashtëm është i qartë ndaj qeverisë, komuniteti ndërkombëtar është armiku i opozitës shqiptare dhe ky është një cikël ku këmbehen vendet. Sa herë që një forcë politike është në pushtet, ajo është aleatja e komunitetit ndërkombëtar dhe anasjellas në opozitë ajo shikon tek ndërkombëtarët armikun e saj. Kjo dinamikë është aq e plotë sa të krijohet ideja se në pushtet mund të vihet vetëm nëse këtë e do dhe komuniteti ndërkombëtar. Kjo dinamikë vjen dhe prishet në fund të mandatit dhe kemi një lloj periudhe tranzitore derisa mbështetja ndërkombëtare kalon në krahun tjetër.

NDERKOMBËTARËT KALIMI NGA LOGJIKË E PAANËSISË TEK ANËSIA

Me praninë e tij ekseseve në të gjitha fushat dhe për të gjitha çështjet, komuniteti ndërkombëtar në Tiranë e ka braktisur me kohë diplomacinë dhe paanshmërinë kundrejt palëve politike. Logjika e këtij veprimi është e thjeshtë: përderisa ai është shndërruar në një lloj pale të tretë, prononcimi apo marrja e pozicionit për secilin problem ose konflikt të brendshëm, heq mundësinë për të qenë i paanshëm dhe i baraslarguar kundrejt palëve politike të implikuara në luftën e brendshme politike. Politika e ndërkombëtarëve kundrejt palëve politike, kapërcimi i statusit të tij diplomatik, devijimi nga principi i paanësisë, që teorikisht duhet të udhëheqë diplomatët në një vend sovran, perceptohet hapur dhe gjykohet shpesh hapur nga palët politike dhe media. Ambasadori i parë amerikan në Tiranë, Rajerson, i shënjuari i gazetës së Partisë Socialiste dhe opozitës së majtë, i përgjigjet kështu pyetjes se si i priste këto sulme të herëpashershme të opozitës: “Si një tregues tjetër se në vendin tuaj ka shtyp të lirë dhe demokratik falë Zotit.”¹²

Por jemi ende në embrionin e konceptimit nga ana a faktorit lokal dhe medias se çfarë do të thonë ndërkombëtarët pasi rasti i ambasadorit amerikan në fakt nuk ilustron tejkalimin e rolit të paanësisë që nënkupton statusi i një diplomati, pasi që jemi në fillim të viteve '90-të dhe axhenda e ndërkombëtarëve ishte inkurajimi i ndryshimeve demokratike në Shqipëri. Ndërkombëtarët tërhiqen në pozicionin e panësisë ose e

¹⁰ Berisha, Sali, “Rilindja demokratike”, nr. 2700, 26 nëntor, 2000, f. 2 - 3.

¹¹ Berisha, Sali, “Gazeta shqiptare”; nr. 1898, 17 qershor 2001, f. 3.

¹² Ryerson, W, Intervistë, gazeta “Lajmi i ditës”, nr. 32, 30 prill 1994, f. 1.

të paktën e pretendojnë publikisht ata diku nga mesi i viteve 90-të. Një pasardhëse e tij në krye të misionit amerikan në Tiranë, Mariza Lino, tanimë u përgjigjet akuzave të shtypit se për qeverinë socialiste të ardhur në pushtet pas ngjarjeve të vitit 1997, ka standarde të dyfishta vlerësimi në krahasim me paraardhësit.

Ne i masim të gjitha qeveritë me një standard të vetëm. Siç e dini, në çdo vit përgatisim një raport për të drejtat e njeriut, ku me sinjeritet parashtrajmë mendimin tonë për të drejtat e njeriut në një vend të caktuar. Nuk besojmë që standardi që po masim qeverinë e tanishme është i ndryshëm nga standardi i qeverisë së mëparshme.¹³

Kurse Ambasadori i radhës, Josef Limprecht, për kritikët që thonë se Perëndimi po i jep mbështetje pa rezerva qeverisë së Shqipërisë për qëndrimet e saj të moderuara ndaj krizës në Ballkan, por në të njëjtën kohë po mbyll njërën sy për problemet e brendshme që po kalon vend, ka këtë përgjigje:

Të gjitha palët në politikën shqiptare janë treguar të përgjegjshme për ato që po ndodhin në Maqedoni dhe në rajone të tjera të Ballkanit; Kjo është e rëndësishme dhe padysim si ne, dhe Bashkimi Evropian e kemi parasysh këtë. Por në të njëjtën kohë, ata që lexojnë me vëmendje raportet e Bashkimit Evropian për fillimin e bisedimeve për Marrëveshjen e Asociimit të Shqipërisë, do të shohin se ngrihen një numër problemesh.¹⁴

OSBE dhe drejtuesit e përfaqësimit të saj në Tiranë janë po ashtu në qendër të kritikave, sa dhe Ambasada Amerikane dhe SHBA-ja. Drejtuesi i zyrës në vitet 1997-1999, holandezi Dan Everts, thotë:

OSBE -ja është plotësisht transparente, nuk ka asnjë lloj axhende të fshehtë dhe është e gatshme të komunikojë me të gjithë opinionin shqiptar, pavarësisht se cilit spektri politik i takojnë. ...OSBE-ja dhe unë personalisht jemi fuqimisht në favor të krijimit të një klime të shëndetshme politike, që do të thotë sipas definicionit, mbështetje për një opozitë të fortë dhe kritike. Ne mendojmë që një opozitë e tillë duhet të luajë rolin e saj vendimtar brenda kornizave demokratike, me fjalë të tjera, në Parlament dhe nëpërmjet metodave bindëse në vend të konfrontimeve agresive.¹⁵

Por nuk është problem personash që drejtojnë zyrën e OSBE-së në Tiranë. Duket një konflikt më i thellë sesa kaq. OSBE-ja vazhdon të perceptohet nga opozita si palë me qeverinë, edhe pasi Ambasadori Everts u largua para afatit nga Tirana, për shkak të kritikave në rritje për afërsinë e tij me qeverinë. Ambasadori i ri, gjermani Gert Ahres, i gjendur përballë të njëjtave kritika të opozitës, shpjegon:

Duhet pasur parasysh se ne jemi një mision që kemi ardhur këtu me miratimin e Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë qeveriset nga një koalicion, i cili udhëhiqet nga Partia Socialiste. Ky është një vend sovran dhe ne duhet të respektojmë strukturat dhe qeverinë e tij. E kuptoj që është e lehtë t' u krijohet përshtypja se ne jemi më pranë qeverisë sesa forcave të tjera.¹⁶

Karakteristika e hapësirës politike në kushtet kur legjitimiteti i brendshëm dhe ai i jashtëm shkojnë tek

¹³ Lino, Mariza. Mariza Lino, "Diaspora shqiptare"; nr 1, shtator 1998, f.8-9.

¹⁴ Limprecht, Joseph, Intervistë për VOA, ribotim "Zëri i popullit"; nr. 813, 19 korrik 2001, f. 3.

¹⁵ Everts, Daan. Everts, "Albania"; nr. 244, 18 tetor 1998, f.1,4.

¹⁶ Ahrens, Geert, "Shekulli"; nr. 310, 11 nëntor 2000, f. 5.

e njëjta palë politike lokale, pra pushteti ka një mbështetje të dyfishtë, është një premisë për zbalancimi i saj në nivelin politik dhe po ashtu një premisë për një arrogancë në rritje të qeverisë kundrejt opozitës. Kemi një pushtet të fortë, të blinduar nga jashtë dhe nga brenda. Në këtë situatë nis dhe merr udhë një lloj arbitrariteti i pushtetit në Shqipëri, kundrejt minorancës, lirive politike të qytetarëve, lirisë së shtypit dhe përfundon tek vjedhja e zgjedhjeve. Arroganca e pushtetit dhe shkelja e të drejtave të njeriut bëhen gjithnjë e më të pranishme. E njëjta ndodh me rritjen e korrupsionit dhe degradimin e qeverisjes sa më shumë ajo i afrohet fundit. E gjithë kjo përfundon me vjedhjen e zgjedhjeve të radhës. Kjo është pak a shumë historia simetrike e demokratëve në periudhën 1992-1996 dhe socialistëve në periudhën 1997-2001.

Efekti i mbështetjes së komunitetit ndërkombëtar ndaj qeverisë në pushtet përfundon me prishjen e balancave politike në vend. Aq sa krizat dhe konfrontimet masive bëhen kërcënim tanimë për gjithë shoqërinë. Në këtë moment komuniteti ndërkombëtar, për shkak të degradimit të situatës dhe rritjes së tensionit, detyrohet të ndërrojë krejt logjikën e aksionit të tij. Atij i duhet me shpejtësi të shndërrohet nga mbështetës dhe *legjtimues* i pushtetit në fuqi, në një *ndërmjetësues* i konfliktit shoqëror, i cili ose shpërthen, ose është në prag dhe kërcënon për shpërthim. Kriza e zgjedhjeve të vitit 1996 dhe më pas trazirat e vitit 1997 e zhvendosin komunitetin ndërkombëtar, tanimë nga roli i tij ndihmues e asistues në një rol ndërmjetësues. Misioni i ish kancelarit austriak, Franc Vranicki, në marsin e vitit 1997, që pasohet me vendosjen e një misioni të përhershëm të OSBE-së në Tiranë nga ky vit, janë infrastruktura fillestare e këtij statusi të ri që do të tenonte të merrte komuniteti ndërkombëtar në një vend që kishte dështuar në kapacitetin e vet vet-regullues dhe kishte përfunduar në një trazirë civile.

KRIZA E PUSHTETIT PA MBËSHTETJE NDERKOMBËTARE: VITET 1991 DHE 1997.

Edhe pse fitoi zgjedhjet e para pluraliste më 31 mars 1991, Partia e Punës e Shqipërisë përmes një procesi të rregullt elektoral, pushteti i ri i dalë prej dy proceseve të vetme të lira elektorale në Shqipërinë e tranzicionit, ajo nuk mundi dot ta mbante pushtetin e fituar me një mbështetje të gjerë elektorale me gati 60 për qind të votave. Në zgjedhjet e para të lira, komunistët, që i ishin futur një procesi reformimi dhe rinovimi, siç shprehej shtypi i partisë dhe liderët e rinj të partisë së vjetër, mundën të ruanin ende besimin e fshatit dhe qyteteve periferike. Por duket se fitorja e tyre nuk u prit mirë në Perëndim dhe sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Departamenti amerikan i Shtetit bën një deklaratë të ftohtë për procesin elektoral, duke u shprehur jo tamam zgjedhje të lira dhe të ndershme, por për zgjedhjet e para me shumë parti. Mne anë të një deklaratë SHBA-ja inkurajon fort rritjen e opozitës dhe inkurajon thellimin e proceseve demokratike në vend.

Më 31 mars populli shqiptar votoi në zgjedhjet e para me shumë parti në disa dekada. Gjatë muajve të fundit ndryshimet politike në Shqipëri kanë qenë inkurajuese, po të kihet parasysh se vetëm katër muaj më parë partitë e opozitës as që ekzistonin. Sot, Partia Demokratike, partia më e madhe e opozitës, ka një të katërtat e vendeve në Parlament.¹⁷

Tre muaj më vonë, kur ishte zhvlerësuar praktikisht fitorja e 31 marsit 1991, dhe kur ishte ndërtuar një qeveri e përbashkët mes së djathtës dhe së majtës, me një mandat të përkohshëm në Tiranë, për të inkurajuar forcat demokratike, vjen për vizitë Sekretari Amerikan i Shtetit, Xhejms Bejker, pikërisht me “ftesë të kryetarit të Partisë Demokratike, Sali Berisha”. Një takim pa praninë e shtypit ai takoi një delegacion të zgjeruar të forcave anti-komuniste. Duke folur për këtë takim, kryetari i PD-së, Berisha, e përcjell kështu për

¹⁷ Deklaratë e qeverisë amerikane mbi zgjedhjet e 31 marsit 1991, gazeta “Rilindja demokratike”, nr. 28, 10 prill 1991, faqe 1.

publikun atmosferën e takimit. “Zoti Bejker ndër të tjera theksoi se është shumë i kënaqur me arritjet e opozitës në Shqipëri.... theksoi se është e domosdoshme që në të ardhmen opozita shqiptare të bashkojë radhët e saj dhe në zgjedhjet e ardhshme të shkojë e bashkuar.”¹⁸

Ngjarjet precipitojnë shpejt dhe në fund të vitit Partia Demokratike prish në mënyrë të njëanshme marrëveshjen me socialistët, e cila bëri të binte Qeveria e Stabilitetit dhe të afroreshin zgjedhjet e parakohshme edhe disa muaj. SHBA-ja është inkurajuese. Ambasadori amerikan në Tiranë, Rajerson, thekson nevojën e zgjedhjeve të parakohshme dhe mbi të gjitha bën kujdes që opozitës demokratike t’i garantohen kushtet e barabarta në garë:

Për mua personalisht, Shqipëria ka nevojë për zgjedhje të reja. Për ne, me rëndësi është që ato të jenë me të vërtetë të lira dhe jo vetëm gjatë ditës së votimeve, por gjatë gjithë fushatës elektorale. Të ketë hapësirë të plotë kohore opozita, si për shtypin, radion dhe transmetimet televizive.¹⁹

Zgjedhjet e 22 marsit 1997 sjellin në pushtet Partinë Demokratike dhe forcat opozitare, të mirëpritura në Perëndim, por sidomos në SHBA. Shumë i zhgënjyer, në një deklaratë të thatë, pak ditë pas zgjedhjeve, pasi pranon rezultatin e zgjedhjeve, kryetari i Partisë Socialiste, Fatos Nano, megjithatë vë në dukje se kjo që kishte ndodhur kishte si shkak ndërkombëtarët:

Nuk mund të heshtim për atë që ëndërruam e folëm shumë, që këto zgjedhje të ishin vërtet të lira dhe demokratike. Por ato nuk u shpëtuan presioneve psikologjike, as atyre fizike, as kërcënimeve dhe shantazheve se po fitoi PS-ja do të ketë luftë civile, ose se “bota ndihmon vetëm opozitën”.²⁰

Katër vjet më pas, pak a shumë të njëjtin fat do të kishte edhe pushteti i Partisë Demokratike. I dalë pas zgjedhjeve mjaft të diskreditura të 26 majit 1996, për shkak të parregullsive të dukshme në procesin elektorale, ai nuk mundi të rrijë në këmbë më shumë se 9 muaj. Zgjedhjet u mbajtën në një atmosferë kontestimi të opozitës socialiste, e cila në fund të ditës së votimeve i braktisi zgjedhjet dhe nuk njohu rezultatin. Sërish janë në qendër amerikanët, që duke mbajtur fort argumentin e parregullsive në zgjedhje, i kërkojnë presidentit Berisha t’i përsërisë ato. Këtë herë Departamenti i Shtetit reagoi fort ndaj parregullsive në zgjedhje dhe i kërkoi Presidentit të konsiderojë përsëritjen e zgjedhjeve në zonat problematike, shoqëruar kjo me një proces politik mes të gjitha forcave politike për të zgjidhur situatën e krijuar. Edhe pse siguron një mbështetje në Evropë, sërish kundërvënja amerikane ndaj administratës së Berishës, kombinuar kjo me krizën e piramidave, bëri që pushteti i Partisë Demokratike të merrte fund në mars 1997, në kulmin e trazirave popullore. Një kompromis politik mes partive politike solli tanimë një *Qeveri të Pajtimit Kombëtar* dhe zgjedhje të parakohshme. Kryetari i demokratëve, Sali Berisha, e shpjegon para forumeve të partisë së tij konfliktin me SHBA-në për problemin e zgjedhjeve dhe konflikte të tjera:

Marrim çështjen e zgjedhjeve të 26 majit. I vetmi vend që kërkoi përsëritjen e zgjedhjeve ishte SHBA-ja. Nuk e kam interpretuar si absurde kërkesën amerikane për përsëritjen e zgjedhjeve. Jo! E kam interpretuar si një dallim interpretimi ndërmjet një demokracie 200-vjeçare dhe të një demokracie në hapat e parë të saj. Ne nuk mund të jemi parti pro-evropiane dhe anti-amerikane.

¹⁸ Berisha, Sali, “Rilindja demokratike”, 1991, 26 qershor, f.1.

¹⁹ Ryerson, E., Intervistë: “Republika”, nr. 85, 9 janar 1992.

²⁰ Nano, Fatos «Bashkimi», 1992, nr.12, 26 mars.

²¹ Berisha, Sali, “Rilindja demokratike”; nr. 81, 15 prill 1997, f.1,3,4

Kjo nuk do të ndodhë kurrë. Ne jemi parti pro-evropiane, jashtë Evropës nuk mund ta shohim kurrë veten tonë, të hapur ndaj SHBA-së, të vendosur për miqësi me këtë vend.²¹

Demokratët nisën gjithnjë e më shumë të kërkojnë pika të tjera ankorimi në komunitetin ndërkombëtar dhe përpiqen të luajnë në hapësirën e rivalitetit SHBA - Evropë për gjeopolitikën e Ballkanit. Në pranverën tjetër, pa mbështetjen e amerikanëve dhe mbi të gjitha me kundërvënien e tyre energjike, Partia Demokratike u gjend në opozitë. Edhe pse nuk ishte e qartë mbështetja e brendshme e demokratëve në zgjedhjet e fundit, dukej sërish se qytetarët e zakonshëm, të gjendur në një farë *ëndrre piramidale*, nuk treguan ndjeshmëri ndaj problemeve të zgjedhjeve. Opozita Socialiste në muajt e parë nuk gjeti dot përkrahje masive kundër manipulimit të zgjedhjeve. Nga ana tjetër, në tetor të vitit 1996, pra vetëm pas tre muajsh pas zgjedhjeve të kontestuara parlamentare, u mbajtën zgjedhjet lokale. Partia e zotit Berisha i fitoi ato bindshëm dhe procesi elektoral u pranua nga palët. Në këtë mënyrë mund të themi se PD-ja kishte legjitimitet të brendshëm dhe ajo gëzonte ende besimin e shumicës së qytetarëve. Por ajo nuk kishte legjitimitet të jashtëm. Bashkuar kjo me demoralizimin e elektoratit të opozitës apo i pjesës gri apo të pavendosur të elektoratit, të cilët tanimë janë dy grupe që shndërrohen në të painteresuar për të dalë në zgjedhje pasi ato prezumohen si të vjedhura dhe të vjedhshme nga qeveria.

PLASARITJA DHE THËRMIMI I HAPËSIRËS POLITIKE: BLOKIMI I AKSIONIT POLITIK TË PUSHTETIT

Në kushtet kur mbështetja ndërkombëtare i mungon qeverisë në fuqi, kjo manifestohet shpejt në aksionin e saj politik dhe ekzekutiv, sado e madhe të jetë mbështetja e brendshme popullore, pra legjitimiteti i brendshëm. Varësia e gjerë dhe e gjithanshme nga ndihma e huaj, e bën jetike për qeverinë, përkrahjen dhe ndihmën ndërkombëtare. Sigurisht ky raport është dinamik, duke humbur njërën nga mbështetjet qeveria humbet pak nga pak dhe tjetrën. Ato ndikojnë tek njëra tjetra. Por e rëndësishme është të themi kur vjen dhe bie mbështetja ndërkombëtare kjo ndikon në rënien e mbështetjes së brendshme. Ashtu sikurse mbështetja ndërkombëtare fillon të bjerë në çastin kur komuniteti ndërkombëtar interpreton qoftë dhe shenjat e para të rënies së mbështetjes së brendshme.

Komunistët e reformuar pas fitores në zgjedhjet e para pluraliste, në 60 ditët e para të qeverisë së tyre u gjendën të bllokuar në planin e jashtëm. Përveç një farë ndihme humanitare nga Italia, qeveria e re u keqprit në skenën ndërkombëtare dhe aktorët politikë, financiarë, ndërkombëtarë. Dështimi në sigurimin e ndihmës së huaj për të mbështetur transformimin e sistemit në kolaps të plotë e bllokoi qeverinë edhe në planin e brendshëm. Në sytë e qytetarëve një “qeveri që nuk e ndihmon bota, një qeveri që nuk i hapen dyert në botë”, ajo nis dhe delegjitimohet dhe aksioni i saj politik nuk funksionon. Duke folur për këtë situatë të vitit 1991, kryetari i Partisë Socialiste, Fatos Nano, e gjykon kështu krizën:

Krizën qeveritare nuk e shkaktuam ne. Atë e shkaktuan ato forca të brendshme dhe të jashtme, të cilat i shqetësoi fakti se qeveria e stabilitetit dha mesazhin e parë të bashkëpunimit midis forcave të reja, politikanëve dhe ekspertëve të rinj shqiptarë për interesat kombëtare dhe po zhdukej polariteti i nevojshëm politik për të përfituar nga rrëmuja e tanishme institucionale.²²

Nga ana tjetër shumë e inkurajuar nga dështimi ndërkombëtar i pushtetit dhe kredencialet jashtëzakonisht të mira të opozitës, kryetari i Partisë Demokratike deklaroi:

²² Nano, Fatos, “Zëri i popullit”, 1992, nr.9, 9 shkurt.

Me luftën dhe përpjekjet e saj, brenda një kohe të shkurtër PD-ja shkatërroi PPSH-në, e cila në datën 31 mars vërtet fitoi zgjedhjet nën terror, por më 1 prill u gdhi një parti pa bazën e saj, pa punëtorë... Po të fitojë PD-ja, SHBA-ja do të ndihmojë. Të njëjtën gjë përmendi edhe Bejker në Parlamentin shqiptar, kur tha se ne do të mbështesim çdo hap të reformave tuaja. Por e vërteta është se në Shqipëri demokracia nuk ka fituar akoma.”²³

Mbështetja e jashtme për faktorë politikë brenda vendit që nuk janë në pushtet, e pësjtjellon aksionin politik të brendshëm të aktorëve lokalë. Pa mbështetje ndërkombëtare, qeveria nuk ndihet tamam qeveri, kurse opozita, duke pasur në krah ndërkombëtarët, nuk është minoranca në kuptimin që ka kjo zakonisht: kur një krah politik ka marrë më pak vota në zgjedhje se kundërshtarët që janë në pushtet. Me gjithë marrëdhëniet e shkëlqyera ndërkombëtare dhe mbështetjen e fortë që kishte pasur në vitet 1992-1996, pas zgjedhjeve të 26 majit dhe pas konfliktimit me SHBA-në, administrata e Partisë Demokratike u gjend brenda disa muajsh e bllokuar në skenën ndërkombëtare. Në vjeshtë Misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) u largua nga vendi për kohësisht, pas disa kontradiktave me qeverinë për probleme të treguesve makroekonomikë të politikës qeveritare dhe për problemin e piramidave. Kurse në fund të vjeshtës, Komisioni Evropian vendosi të shtyjë hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Asociimit me Shqipërinë, për shkak të gjendjes politike dhe problemit të marrëdhënieve të qeverisë me opozitën. Në përgjithësi projektet e ndihmave ekonomike dhe ato të investimeve të huaja nisën të anulohen dhe të shtyhen për më vonë, dhe në pak muaj qeveria u gjend e bllokuar në planin e jashtëm. Aksioni i saj i brendshëm ngeci po aq dhe u krijua një atmosferë që diçka do të ndodhë. Në fillim të vitit 1997 ndodhën vërtet shumë trazira. Institucionet politike ranë, u shpërbë shteti dhe hapësira politike u thërrmua plotësisht. Anarkia mbuloi vendin.

RISTRUKTURIMI I AKSIONIT POLITIK TË AKTORËVE LOKALE NË RAPORT ME FAKTORIN NDERKOMBËTAR

“Komuniteti ndërkombëtar” është një shpikje. Ai është heterogjen dhe gjendja e tij e zakonshme është të mos jetë *një zë*. Ky perceptim ekziston sigurisht për komunitetin ndërkombëtar edhe në Shqipëri. Në sytë e opinionit publik dhe aktorëve politikë lokalë komuniteti ndërkombëtar ka dy pjesë kryesore: SHBA dhe Evropa e Bashkuar. Aktorët politikë lokalë janë përpjekur të luajnë në këtë dualitet të komunitetit ndërkombëtar mes SHBA-së dhe Evropës së Bashkuar në raport me situatat e tyre të brendshme, por sidomos në raport me sjelljen e njëres prej këtyre *dy pjesëve* të aktorëve ndërkombëtarë ndaj tyre. Fenomeni është mjaft simetrik për të dyja palët politike në vend.

Në fillim të viteve 1990, kur Partia Demokratike e Sali Berishës ishte mjaft afër Shteteve të Bashkuara e Amerikës, socialistët shqiptarë ishin më të atashuar ndaj Evropës. Në një intervistë në fillim të vitit 1992, lidhur me pyetjen nëse do ta ndihmojë Evropa dhe SHBA-ja Shqipërinë nëse do të fitojë PSSH-ja në zgjedhjet e pritshme të 22 marsit, kryetari i Partisë Socialiste, Fatos Nano, i shmanget fare zënies në gojë të “SHBA”-së dhe shprehet me besim tek luajaliteti dhe paanësia e Evropës ndaj aktorëve lokalë:

Informacionet e ndryshme lidhur me këtë problem do t’i quaja desinformacione të tilla, që janë jashtë natyrës së politikës realiste evropiane. Do ta quaja sëmundje kalimtare të foshnjërisë sonë politike besimin e atyre parullave që gjoja Evropa nuk e ndihmon Shqipërinë nëse fiton

²³ Berisha, Sali, “Rilindja demokratike”, 1991, 24 korrik, f. 1.6.

²⁴ Nano, Fatos, “Zëri i popullit”, 1992, nr.9, 9 shkurt.

PSSH-ja. Evropa do të dijë se çfarë forcash politike, koalicion forcash respekton elektorati. Nuk është në frymën e saj të paragjykojë dhe të ndërhyjë në punët e brendshme të vendeve, duke instrumentalizuar nevojat e tij për ndihmë.²⁴

Socialistët shqiptarë në këtë periudhë janë shumë pro-evropianë dhe gjykojnë keq për të ardhmen e vendit afërsinë e madhe të administratës së Berishës ndaj SHBA-së. Në ditën e arrestimit të tij, zoti Nano deklaroi:

Më jepet mundësia të ripërsëris pozicionin tim, angazhimin tim, që edhe në të ardhmen, edhe sikur të gjendem në bankën e të akuzuarave..() për të realizuar integrimin e natyrshëm të Shqipërisë në kontinentin në të cilin ndodhet, pa humbje kohe dhe pa rrjedhje gjaku nëpër shkretëtira arabike apo në udhëtime transoqeanike.²⁵

Pas zgjedhjeve të vitit 1996, kur tanimë konflikti mes administratës amerikane dhe Partisë Demokratike u bë fakt, në ligjërimin e Partisë Socialiste dhe kryetarit të saj Fatos Nano, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dalin në radhën e parë të aleatëve: Në një mocion politik paraqitur partisë së tij, zoti Nano shtron strategjinë e re me partnerët ndërkombëtarë: "Adoptimi i qëndrimeve të PSSH-së ndaj rekomandimeve të Departamentit Amerikan të Shtetit, Parlamentit Evropian, institucioneve vëzhguese të OSBE-së, Këshillit të Evropës dhe organizmave të tjera ndërkombëtare."²⁶

Kurse në krizën e viteve 1996-1997 është rasti që Berisha dhe Partia Demokratike, pas mosmarrëveshjeve me SHBA-në të orientohen nga Evropa. Gjithnjë e me shumë në ligjërimin e zotit Berisha, Evropa bëhet parësore. Duke shpjeguar krizën e 1997-ës dhe angazhimin ndërkombëtar të mëtejshëm për zgjidhjen e saj, presidenti Berisha shpjegon:

Në rrethanat e krijuara, Partia Demokratike erdhi tek marrëveshja e 9 marsit, e cila synonte të shmangte një konflikt Veri-Jug, një ndarje të vendit, siç dëshironin rebelët dhe sponsorizuesit e tyre, synonte t' u jepte një shans të gjitha partive politike dhe për këtë u krijua Qeveria e Pajtitit Kombëtar. Zgjidhja është bërë në përputhje dhe në bashkëpunim të ngushtë me Bashkimin Evropian. Gjithashtu iu drejtua forcave të Bashkimit Evropiano-Perëndimor për zgjidhjen e krizës. Shqipëria i përket Evropës²⁷.

Pak më tej, në kuadrin e diplomacisë së re blu, ai e shpalli hapur se përparësia në marrëdhëniet e jashtme tanimë i takon Evropës:

Jam shumë i kënaqur për të gjithë kontributin që unë kam dhënë në marrëdhëniet shqiptaro-amerikane dhe jam i vendosur të mbetem i hapur për dialog dhe të punoj ditë e natë... Por unë mendoj se një vend i lirë duhet të jetë një vend sovran. S' mund të jetë ndryshe. Evropa është 100 për qind e interesuar për Stabilitetin e Shqipërisë. Kush më tepër se BE-ja, që i ka dhënë vendit 700-800 milionë dollarë ndihma, është i interesuar për zhvillimin dhe stabilitetin tonë.²⁸

Sigurisht, ky komportim rezultoi në dukje një sjellje partizane e aktorëve politikë ndaj interesave të pushtetit të tyre. Por e rëndësishme është se ky mobilitet në raport me mbështetjen ndërkombëtare, duket më së shumti një reaksion i aktorëve lokalë kundrejt aksionit të ndërkombëtarëve. Aksioni, zgjedhja fillestare

²⁵ Nano, Fatos, "Koha jonë", 28 korrik, 1993, f.1.

²⁶ Nano, Fatos, "Zëri i popullit", nr. 157, 6 korrik 1996, f.2.

²⁷ Berisha, Sali, "Rilindja demokratike"; nr. 81, 15 prill 1997, f.3.

²⁸ Berisha, Sali, "Rilindja demokratike"; nr. 81, 15 prill 1997, 4.

duket e ndërkombëtarëve, të cilët në raport me logjikën e aksionit të tyre, interesat gjeopolitike të tyre etj., bëjnë zgjedhjen e aktorit lokal që duhet mbështetur. Përballë kësaj, aktorët në terrenin lokal e ristrukturojnë marrëdhënien e tyre me ndërkombëtarët si pasojë e kësaj zgjedhjeje që ka bërë në fillim faktori ndërkombëtar.

HIBRIDIZIMI I HAPSIRËS POLITIKE SI PASOJË E VEPRIMIT TË AKTORËVE NDERKOMBËTARE

Duke nisur nga viti 1996-1997, në vend që të reduktohej prania e ndërkombëtarëve, në Shqipëri ndodhi e kundërta. Kriza e zgjedhjeve të vitit 1996 dhe më pas ajo e skemave piramidale, trazirat, kryengritja e armatosur dhe anarkia e vendit, e rivlerëson me një rëndësi edhe më të madhe faktorin ndërkombëtar në skenën e brendshme. Tanimë atij i duhej të ishte jo thjesht ndihmës dhe mbështetës i procesit të transformimit të vendit, por një ndërmjetës mes palëve për të qetësuar situatën dhe për të ruajtur kuadrin e përgjithshëm politik brenda një farë kuadri institucional. Kjo situatë sanksionohet dhe me rolin dhe vendosjen e një misioni të përhershëm të OSBE-së në Tiranë. Ndërkombëtarët në vend marrin një status krejt të ri dhe krejt të veçantë edhe nga pikëpamja institucionale. Pasi është qetësuar disi situata pas trazirave të vitit 1997 dhe është zhvilluar një farë procesi elektoral me zgjedhjet e 29 qershorit, në pushtet kanë ardhur socialistët dhe opozita ka pranuar zgjedhjet si një zgjidhje politike për momentin. Të njëjtën logjikë përdor edhe raporti i vëzhguesve të OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet e vitit 1997, duke i përcaktuar ato si “të pranueshme për momentin”.²⁹ Ky koncept i ri i përshtatjes së standardeve demokratike në përputhje me situatën lokale dhe axhendën e komunitetit ndërkombëtar, do të shndërrohet në filozofinë e aksionit të komunitetit ndërkombëtar në vazhdim të aksionit të tij në Shqipëri.

Elementë publikë që përvijojnë këtë strategji të re të komunitetit ndërkombëtar dhe SHBA-së në Tiranë gjejmë me shumicë. Zgjedhjet lokale të vitit 2000, ku komuniteti ndërkombëtar u angazhuan fort në përgatitjen e reformës elektorale, janë ilustrimi i parë i teknikës së relativizimit të standardeve. Ambasadori amerikan në Tiranë, Limpreht, thotë për zgjedhjet e vjeshtës se vëzhguesit ndërkombëtarë dhe vendas do të ndihmojnë për të vendosur nëse procesi është i lirë dhe i ndershëm. “Partitë apo udhëheqësit shqiptarë të mos vënë në rrezik punën e OSBE-së apo organizatave të tjera vëzhguese.”³⁰

Por opozita e Sali Berishës kundërshton reformën zgjedhore të ndërmarrë nga qeveria dhe mbi të gjitha kundërshton që zgjedhjet të administrohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili parashikohet në Kushtetutën e re si një institucion i pavarur kushtetues. Ajo argumenton se përbërja e tij nuk është aspak e tillë dhe se në krye të këtij organi është kushëriri i kryetarit të Partisë Socialiste, Fatos Nano, kurse në përbërje ka militantë socialistë. Shtypi boton skemën farefisnore të kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ka edhe ai mbiemrin “Nano” dhe fotografitë, ku një anëtare e këtij komisioni është filmuar në një prej mitingjeve elektorale të socialistëve. Opozita nuk e njeh rezultatit e zgjedhjeve lokale të 1 tetorit. Komuniteti ndërkombëtar, përkundrazi, e njeh vlefshmërinë e zgjedhjeve dhe ligjshmërinë e autoriteteve të reja lokale menjëherë. Ambasadori Gert Ahrens dhe prezenca e OSBE-së në Tiranë ishin ndërmjetës të negociatave mes qeverisë dhe opozitës, për të arritur një përbërje më të besueshme të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Qeveria e hodhi poshtë këtë kërkesë të opozitës dhe miratoi në mënyrë të njëanshme vetëm me votat e saj në Parlament Ligjin e Zgjedhjeve dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. “Nuk u bë i mundur balancimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Por dua të sqaroj se në Shqipëri nuk vendos unë personalisht ose OSBE-ja. Ne mund të ofrojmë ndihmën tonë në bashkëpunim me KE-në dhe me zyrat e ODIHR-it në Varshavë për të kaluar diferencat që vihen re.”³¹ Kështu pohoi ambasadori Ahrens disa muaj para se zgjedhjet të zhvilloheshin.

Ambasadori amerikan në Tiranë, Jozef Limpreht, dhe shefi i zyrës së OSBE-së në Shqipëri, Gert

²⁹ Raporti i OSBE-ODIHR për zgjedhjet e 29 qershorit 1997, ëëë.OSBE.org.al

³⁰ Limpreht, Joseph, “Demokracia”; nr. 37, 16 shtator 2000, f 12 - 13.

³¹ Ahrens, Geert. intervistë, «Shekulli»; nr. 60, 3 mars 2000, f.3.

Ahrens, flasin me një gjuhë kur vjen fjala për legjitimitetin e zgjedhjeve. Në përgjigje të pyetjes së gazetareve se ç' mendon për kritikën e opozitës se «SHBA-ja dhe OSBE-ja u nxituan duke vlerësuar zgjedhjet dhe se në rastin e Shqipërisë u përdorën standarde që nuk janë përdorur, ose që janë më të ulëta se në vendet e tjera anëtare të OSBE-së», Ambasadori amerikan, Limpreht, thotë:

Asgjë nuk është e përsosur dhe komuniteti ndërkombëtar tregoi me hollësi se pati disa parregullsi. Mbetet punë për t' u bërë që zgjedhjet e pranverës të zhvillohen më mirë se ato të vjeshtës. Me përpilimin e listave është e qartë se pati disa probleme. Megjithatë, në këto zgjedhje nuk pati prova që të tregonin se këto probleme ishin drejtuar nga ndonjë parti apo ndonjë tjetër.³²

Për ironi, në ndihmë të Ambasadorit amerikan në Tiranë, në ligjërimin e tij të standardeve të relativizuara vjen historia e parregullsive në zgjedhjet e vitit 2000 në SHBA mes Bush – Al Gore. «Siç mund të dëshmojë SHBA-ja, asnjë proces zgjedhor nuk është i imunizuar ndaj parregullsive teknike»,³³ – thotë Limpreht në një deklaram publik në Shkodër, një qytet i njohur si bastion i përhershëm i demokratëve. Edhe pse ka pohuar vetë publikisht se nuk u arrit kompromisi i duhur mes qeverisë dhe opozitës, ligjin dhe infrastrukturën zgjedhore, pra qeveria i ka organizuar në mënyrë të njëanshme zgjedhjet pa aksesin e opozitës në proces, kjo nuk e pengon zotin Ahrens të njohë legjitimitetin e fituesve të dalë nga një proces i tillë. Para Këshillit të Përhershëm të Ambasadorëve në Vjenë, Ambasadori Ahrens deklaroi lidhur me zgjedhjet e fundit lokale: “Zhvendosja e qartë në krah të socialistëve në nivelin vendor e risiguron qeverinë, ndërkohë që pas nëntë muajve shkojmë drejt zgjedhjeve kombëtare.”³⁴

Pak a shumë e njëjta situatë ndodh me zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, të cilat kishin një rëndësi edhe më të madhe për të përcaktuar kush do të *legjitimohej* në pushtet edhe për katër vjet të tjera. Qeveria miratoi në mënyrë të njëanshme Ligjin për Zgjedhjet, rindërtoi vetë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke u mbështetur tek neni përkatës në Kushtetutë. Kryetari dhe disa anëtarë të komisionit, të diskredituar në publik, ose si të afërm të kryetarit të Partisë Socialiste, Fatos Nano, ose si militantë të partisë në pushtet, dhanë dorëheqjen. Në krye të komisionit vjen një kryetar i ri, i cili dy vjet më parë kishte qenë zv.ministër i Punëve të Brendshme në kabinetin socialist. Opozita konteston fort, por vendos të marrë pjesë në proces “për të dëshmuar masakrën elektorale”. Opozita nuk e njeht procesin elektorale dhe e konsideron Kuvendin e dalë prej zgjedhjeve si jolegjitim, duke vendosur bojkotimin e tij. Të nesërmen e zgjedhjeve të 24 qershorit, misioni vëzhgues i OSBE – ODIHR-it për zgjedhjet bëri një deklaratë paraprake, duke i quajtur zgjedhjet, «si më të mirat e zhvilluara ndonjëherë në Shqipëri». Ambasadori amerikan në Tiranë, Limpreht, i bën jehonë dhe e mbështet plotësisht këtë deklaratë. “Për vlerësimin e tyre [zgjedhjeve] ne shikojmë Raportin e Vëzhguesve të OSBE-ODIHR-it. Dhe në përgjithësi vlerësimet pas këtyre dy raundeve kanë qenë pozitive. Kryetari i këtij misioni e tha hapur se këto ishin zgjedhjet më të mira të zhvilluara ndonjëherë në Shqipëri.”³⁵ Ai është mjaft i ashpër ndaj bojkotit të opozitës dhe përsëri e fton atë të njohë humbjen e zgjedhjeve:

Ka qenë e vështirë nga partitë e të gjithë spektrit në Shqipëri që të pranojnë zgjedhjet, siç është një gjë që ndodh në të gjitha vendet në tranzicion. Gjëja kryesore që theksuam për 24 qershorin është se ai që një proces më i mirë se gjithë të tjerët. Mendoj se çështja (e kontestimeve) mund të zgjidhet brenda sistemit dhe të mos zgjidhet rruga e zgjidhjes së tyre jashtë sistemit. Historia ka treguar në zgjedhjet në Evropën Lindore, Qendrore dhe Juglindore se ata që zgjedhin të zgjidhin çështjet jashtë sistemit, janë të humbur.³⁶

³² Limprecht, Joseph, «Koha jonë»; nr. 253, 27 tetor 2000, f. 7.

³³ Limprecht, Joseph, «Demokracia»; nr. 19, 12 maj 2001, f. 4 - 5

³⁴ Ahrens, Geert, «Albania»; nr. 256, 31 tetor 2000, f. 4.

³⁵ Ahrens, Geert, «Albania»; nr. 256, 31 tetor 2000, f. 4.

³⁶ Limprecht, Joseph, Korrieri; nr. 88, 8 korrik 2001.

Në të njëjtën frymë është dhe raporti përfundimtar i zgjedhjeve që doli në tetor. Ai ilustronte strategjinë e re të komunitetit ndërkombëtar për sa i përket standardeve të demokracisë në Shqipëri, relativizmin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë tek të gjitha palët. Raporti i konsideronte zgjedhjet se kishin bërë hapa përpara në krahasim me zgjedhjet e kaluara. Inkurajohen palët të ngrenë një komision dypalësh për të trajtuar rekomandimet e këtij raporti në funksion të përmirësimit të zgjedhjeve të ardhshme.³⁷ Komuniteti ndërkombëtar, që tanimë kishte marrë tagrin për të vlerësuar rregullsinë apo parregullsinë e tyre, pra shkurt, kishte fituar të drejtën të legjitimonte procesin elektorale dhe për pasojë fituesin e tij, përmes relativizimit të standardeve demokratike, i njohu të drejtën të majtës të qëndrojë në pushtet edhe një mandat tjetër.

Përpjekja e ndërkombëtarëve për të prodhuar skenën politike lokale: kundër klasës së vjetër politike.

Pas vitit 1997, SHBA-ja dhe në përgjithësi komuniteti ndërkombëtar mbështet fort socialistët në pushtet për rimëkëmbjen e vendit dhe ecurinë e reformave. Nga pikëpamja e interesave të komunitetit ndërkombëtar, stabiliteti i vendit dhe mospërsëritja e trazirave të 1997-ës janë objektivi kryesor së bashku me pasjen në Tiranë të një qeverie të dëgjueshme për axhendën që SHBA-ja dhe Perëndimi kanë për çështjen e shqiptarëve të Kosovës dhe Maqedonisë. Por ndjeshmëria e elektoratit shqiptar është e ndryshme nga ajo e korridoreve të diplomacisë ndërkombëtare dhe nga ekzgjencat gjeopolitike të momentit, dhe mund të prodhohen të papritura. Nga ky moment procesi politik i brendshëm mund të kontrollohet në dy mënyra, nga Perëndimi dhe SHBA-ja në mënyrë të veçantë: kontrolli i proceseve zgjedhore dhe përzgjedhja e figurave politike lokale që do të mbështeten prej Perëndimit. Ndërkohë, për sa i përket aksesit mbi procesin zgjedhor, komuniteti ndërkombëtar ka tanimë një rol vendimtar, që nga përgatitja e zgjedhjeve, deri tek monitorimi e vlerësimi i legjitimitetit të tyre.

Por kjo nuk mjafton më. Një strategji e mbështetjes së seleksionuar të liderëve politikë lokalë, pra përzgjedhja e individëve që duhen mbështetur brenda formacioneve kryesore politike, Partisë Socialiste në pushtet dhe Partisë Demokratike në opozitë, është mjaft e dallueshme edhe publikisht në aksionin e komuniteti ndërkombëtar në Tiranë, që në vitin 1998. Edhe më parë disidencat politike brenda dy partive të mëdha ndaj zotit Nano në Partinë Socialiste dhe ndaj zotit Berisha në Partinë Demokratike, kanë qenë inkuadruar fort nga ndërkombëtarët. Kështu, në vitin 1994 kryetari i Partisë Demokratike, Eduart Selami, i cili kishte qenë një lloj i emëruari i zotit Berisha në krye të partisë, përderisa statusi i presidentit të Republikës nuk ia lejonte të ishte kryetar i një partie politike, doli hapur kundër linjës politike të presidentit. U shkarkua nga funksionet. Disa muaj më pas ai shkoi në SHBA me një bursë të qeverisë amerikane. Kurse një dokument politik që paraqitën në shkurt të vitit 1997, brenda forumeve të partisë së tyre një grup deputetësh të Partisë Demokratike, u quajt nga shtypi i partisë si një ‘rezolutë e shkruar nga selia diplomatike në Rugën e Elbasanit’. Në këtë adresë ndodhet Ambasada Amerikane në Tiranë. Edhe zoti Nano kishte pasur të njëjtin problem në partinë e tij. Në korrik të vitit 1996, që nga burgu, ku ndodhej në vuajtje të dënimit, ai ndërmori një lëvizje radikale politike, duke shkarkuar udhëheqjen e lartë të partisë së tij katër nënkryetarët e partisë. Në një dokument politik të njohur në kronikën politike lokale si Mocioni për ndryshim,³⁸ ai aludonte se zëvendësit e tij ishin mikluar nga ambasadat dhe pushteti për t’i zënë vendin në krye të partisë dhe për ta harruar në burg.

Pas afro një viti në pushtet, në muajt gusht–shtator 1998, ndodhën krejt papritur një seri ngjarjesh që kulmuan me vrasjen e deputetit të opozitës, Azem Hajdari. Po ashtu, një revoltë disaorëshe e protestuesve të armatosur në momentin e funeralit të deputetit të vrarë, bënë që zoti Nano u detyrua të jepte dorëheqjen nga

³⁷ Raporti i OSBE-së për zgjedhjet parlamentare 24 qershor 2001, www.osce.org/al.

³⁸ Nano, Fatos, «Zëri i popullit», nr. 157, 6 korrik 1996, f.2.

postit të kryeministrit, kurse shumica në pushtet arriti të mbahej në këmbë me një mbështetje të fortë dhe të shpejtë ndërkombëtare, kryesisht amerikane, e cila tani po i jepej rivalit të zotit Nano, presidentit Rexhep Mejdani. Këto që ndodhën ishin të habitshme, jo vetëm për opinionin e gjerë, por dhe për vetë kryeministrin Nano. Disa muaj më vonë, duke analizuar ngjarjet që sollën rrezimin e tij, kryeministri Nano nënvizon rolin e ambasadave: “Mua më duket ende e pabesueshme që u hartua një skemë diskreditimi, që shëtiti ambasadat dhe botën, e cila duke dëmtuar solidaritetin tonë dhe klimën e bashkëpunimit, dobësoi strukturat e shtetit, për t’i çuar në paralizë të nesërmen e vrasjes së deputetit Azem Hajdari”³⁹.

Në një mesazh solidariteti drejtuar popullit shqiptar, zoti Nano ndalon në disa momente që sollën rrezimin e tij: “Tradhtia e shokëve socialistë” dhe “ngjarjet në Kosovë”. Deklarata e tij e tërheqjes së përkohshme nga politika hedh mjaft dritë mbi enigmën e ngjarjeve të 14 shtatorit:

Një pjesë jo e vogël, por e zhurmshme e atyre që zhvillojnë përgjegjësitë në kuadrin e marrëveshjes politike të 29 qershorit, kanë punuar si kuaj Troje për të organizuar funeralin tim politik. Këta bartës të pandreqshëm të traditës më të keqe të këtij vendi, i kanë filluar me kohë përgatitjet e gostisë së pasvdekjes sime politike. Nuk mund të pranoj më, qoftë edhe vetëm një pjesë shqiptarëve kudo që të jenë, në Shqipëri, Kosovë dhe gjetkë, të më identifikojnë me të keqen e këtij vendi, për të cilin kam dhënë dhe do të jap gjithë sa të mundem, deri në frymën e fundit! Nuk mund të pranoj që me përprjekjet e mija për një Shqipëri evropiane, për një Kosovë të lirë dhe demokratike, për një qytetari shqiptarë të njohur dhe të respektuar në mbarë botën demokratike, të nëpërkëmbem dita-ditës nga eksceset e papërgjegjshmërisë së kujtdo qoftë, brenda ose jashtë trojeve të vendit tonë të përbashkët.⁴⁰

Zoti Berisha ka të njëjtin problem në partinë e tij, ku nënkryetari i partisë së tij ka një miklim të fortë gjithandej për të rivalizuar me Berishën në kongresin e ardhshëm të partisë në 1999-ën. Një shizëm prodhohet në gjirin e partisë, gati gjysma e grupit parlamentar të opozitës përçarhet, dhe të “rinjtë” ose “reformatorët” krijojnë pas një viti një parti të re. Një debat publik për “rinovimin e klasës politike”, “për largimin e liderëve të vjetër të politikës shqiptare”, për “mungesën e demokracisë së brendshme brenda partive, shndërrohet në temën qendrore të debatit politik dhe mediatic. Nderkombëtarët ndërhyjnë gjithnjë e më shpesh mbi këtë temë: jetën e brendshme të partive politike shqiptare. Ambasadori amerikan në Tiranë, Limprecht, i pyetur nga gazetarët se cili është opinionin juaj për gjendjen e opozitës shqiptare, thotë:

Për partitë që kanë probleme të brendshme është e rëndësishme që të ekzistojnë brenda tyre struktura të brendshme demokratike, që t’u lejojnë të gjithëve të shpallin idetë e tyre. Më duket se është e rëndësishme që në parti, përpara se të marrin një vendim, të dëgjojnë pikëpamjet e të gjithë anëtarëve të tyre. Në sistemet demokratike politikanët duhet të kuptojnë se në zhvillimin politik demokratik asnjë individ nuk është i pazëvendësueshëm.⁴¹

Kurse ambasadori i OSBE-së në Tiranë, Ahrens, analizon hollësisht defektet e opozitës shqiptare pas zgjedhjeve të vitit 2000 dhe paralajmëron “shizmën” e re në Partinë Demokratike, e cila në fakt do të ndodhte 2 muaj më pas, me krijimin e Partisë Demokratike të Reformuar, e kryesuar nga rivali i zotit Berisha, Genc Pollo:

Por, nuk është dobishme për procesin demokratik në qoftë se partia kryesore opozitare është në pëshëllim dhe është e paaftë, qoftë për të pranuar refuzimin e zgjedhësve, qoftë për t’u

³⁹ Nano, Fatos, «Zëri i popullit»; nr. 237, 6 tetor 1999, f.3.

⁴⁰ Nano, Fatos, «Demokracia»; nr. 39, 4 tetor 1998, f.8-9.

⁴¹ Limprecht, Joseph, «Zëri i popullit»; nr. 16, 22 janar 2000, f. 16.

reformuar dhe modernizuar. Ekzistojnë elementë reformistë brenda PD-së, por deri më sot ato kanë qenë të marginalizuar. Megjithatë, është ende shumë herët për të parashikuar nëse do të ishte i mundshëm ndonjë rigrupim pas zgjedhjeve.⁴²

Në vitet 1999–2002, liderët e rinj, kryeministri Ilir Meta dhe ish-nënkryetari i Partisë Demokratike, Genc Pollo, u mbështetën unanimisht nga SHBA-ja dhe BE-ja për të marrë në dorë drejtimin e dy partive kryesore. Protokollit tepër i favorizuar diplomatik ndaj tyre ishte shenjë e hapur e mbështetjes ndërkombëtare për ta, përveç mbështetjes verbale nga nivelet e dyta politike ndërkombëtare, si puna e eurodeputetes Doris Pack, kryetare e Komisionit për Evropën Juglindore në Parlamentin Evropian, e cila përsëriste hapur se duhet një klasë e re politike, duhet të largohet Nano dhe Berisha, duhen mbështetur liderët e rinj në Shqipëri. Kurse kryetari i Komisionit Evropian, Prodi, kishte vizituar papritur Tiranën, më 28 nëntor 2001, ku takoi vetëm kryeministrin Meta. Ai e mbështeti fort ekipin qeveritar me në krye Metën, me shprehjen e tij emblematike tashmë në kronikën lokale “Stabilitet, stabilitet, stabilitet!”.

Duke reaguar në mbështetje të qeverisë ndaj ofensivës politike që kryetari i Partisë Socialiste ndërmoi ndaj kryeministrit Meta me moton “Do ta largojmë uzurpatorin Meta”, ambasadori amerikan në Tiranë, Limpreht, në kulmin e përpjekjes së Nanos për të rrëzuar kryeministrin, thotë:

Pas debateve të fundit brenda Partisë Socialiste, ministrat e rinj kanë nevojë për mbështetjen e partisë dhe të popullit, ndërkohë që merren me çështjet e ndërlikuara, të cilat janë kyçe në zhvillimin e vazhdueshëm të Shqipërisë. Tani është koha që qeveria të punojë dhe duhet të krijohet hapësirë që qeveria të lejohet të kryejë punën e saj.⁴³

Kjo prani ndërkombëtare tanimë e “shkallës së dytë” brenda jetës së partive politike, pas pranisë së «shkallës së parë» në jetën politike institucionale dhe ndërpartiake, përkrahja e seleksionuar e figurave politike brenda partive politike, e komplikoi edhe më shumë skenën politike, tanimë në nivelin e saj bazë, partitë politike. Duke u përpjekur të përzgjedhë apo në një farë mënyre duke u përpjekur të prodhojë nga jashtë lidërsipin e politikës shqiptare, komuniteti ndërkombëtar deshi të gjente në Tiranë interlokutorët e vet. Kjo ndoshta për të “ndëshkuar” liderët karizmatikë dhe me mbështetje të fortë në partitë e tyre, Nanon dhe Berishën, me të cilët bashkëpunimi i komunitetit ndërkombëtar kishte rezultuar mjaft i vështirë.

Sovranë sërish: komprimi Nano – Berisha dhe “dështimi i të rinjve”

Në fillim të vitit 2002, në Partinë Socialiste, Fatos Nano arrin ta mposhtë kundërshtarin e tij Ilir Meta, duke e detyruar të japë dorëheqjen. Kurse në krahun tjetër, Berisha arrin t’i mbijetojë shizmave dhe përkundrazi, në zgjedhjet e vitit 2001, koalicioni i djathtë udhëhequr prej tij, me gjithë problemet e zgjedhjeve, siguroi një rritje në elektorat prej gati 15 për qind nga zgjedhjet paraardhëse, duke siguruar gati 40 për qind të votave në proporcional. Liderët e mbështetur nga Perëndimi, Ilir Meta dhe Genc Pollo, kishin ngelur në periferi të vendimarrjes politike kryesore në dy krahët politikë, qendrën e majtë dhe qendrën e djathtë. Duke aluduar kundër përpjekjes së ndërkombëtarëve për t’i spostuar nga lidërsipi politik, kryetari i Partisë Socialiste, Fatos Nano, “kërcënon” me mbështetjen popullore që ka si figurë politike: “Unë jam një nga ata që votohem për të transformuar realitetin dhe për të forcuar institucionet. Natyrisht për të përmirësuar klimën politike dhe marrëdhëniet me opozitën.”⁴⁴ Nga

⁴² Ahrens, Geert, «Albania»; nr. 256, 31 tetor 2000, f. 4.

⁴³ Limprecht, Joseph, “Dita”; nr. 302, 6 dhjetor 2001, f. 6.

⁴⁴ Nano, Fatos, “Zëri i popullit”; nr. 229, 16 shtator 2000, f. 6 - 8.

⁴⁵ Berisha, Sali, “Klan”; nr. 207, 6 maj 2001, f. 12 - 15.

ana tjetër, kryetari i Partisë Demokratike, në të njëjtën logjikë, duke kundërshtuar ato përpjekje që synojnë të prodhojnë skenën politike, apo të “emërojnë” leadershipin politik të partive thotë: “Unë i përmbahem principit se nuk është kryetar i Partisë Demokratike ai që duhet të përcaktojë kryetarët e partive të tjera. Unë kam qenë gjithnjë i hapur për dialog, i gatshëm të takohem me këdo nga krahu tjetër.”⁴⁵

Në harkun e vjeshtës së vitit 2001–2002, një proces politik bashkëpunimi nis mes Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike, pasi ishin dhënë shenja të vullnetit politik të liderëve politikë të të dy palëve për një dialog mes palëve, pa pasur nevojën për ndërmjetësim të huaj. Ky proces konkretizohet në shumë hapa konkretë, ku bëjnë pjesë firmosja e një protokollit bashkëpunimi për reformën zgjedhore, zgjedhja e një presidenti konsensual me pëlqimin e të dy palëve si dhe nënshkrimi i një marrëveshjeje për reformën institucionale në vend. Por në fakt, pas këtyre gjesteve shquhet një fenomen dhe një qëllim i aktorëve kryesorë politikë, për ta risjellë procesin politik në duart e tyre.

Nga ana e tij, kryetari i opozitës, Berisha, është i gatshëm të angazhohet në një proces politik të gjerë kompromisi me palën tjetër.

Jemi të gatshëm që vendi të ketë një “president konsensual”, për këtë insistoj një zgjidhje, e cila nuk i zvogëlon rolin asnjë njeriu. Në një farë mënyre, pas këtij kompromisi mund të themi se e keqja që e ka zënë vendin do të mund të shndërrohet në diçka të mirë, në diçka pozitive, në një frymë të re në politikën shqiptare.⁴⁶

Nga ana e tij, kryetari i Partisë Socialiste ishte shprehur me kohë për institucionalizimin e dialogut me opozitën, pa ndihmën e tërthortë të së cilës, në fakt ai nuk do ta kishte mundur rivalin e tij të fuqishëm brenda partisë, Ilir Metën, i cili kishte jo vetëm mbështetjen e forumeve partiake, por dhe një mbështetje të fortë ndërkombëtare. Pas arritjes së kompromisit për presidentin dhe nënshkrimin të marrëveshjes pozitive–opozitive për reformën institucionale, në një intervistë të përbashkët televizive, në kanalin “Telearbëria”, dy liderët shprehen thuajse në një gojë se janë të kënaqur për marrëveshjen e arritur për presidentin konsensual. Sipas Nanos ky “është mekanizmi më i mirë, më i sigurt i shndërrimeve me kosto të vogël.”⁴⁷ Ndërsa për Berishën nuk “mund të vihen më njerëz të rastit në qeveri, aq më pak nuk mund të vihen njerëz të pavotuar, njerëz të paverifikuar nga elektorati në drejtim të institucioneve kushtetuese.”⁴⁸ Procesi politik në Shqipëri arrin në fazë të re ku hapësira politike është “risovranizuar” në favor të aktorëve politikë lokalë. Të nesërmen e këtij procesi duket se dy aktorët kryesorë politikë shfaqin vullnet për të qenë më luajalë ndaj lojës politike, në mënyrë që prania ndërkombëtare në procesin e brendshëm të jetë më pak e pranishme.

Ky moment është mbyllja e një cikli ku aktorët lokalë, përkatësisht qendra e majtë dhe qendra e djathtë, si dhe aktorët ndërkombëtarë kanë “konsumuar” të gjitha pozicionet teorike në raport me njëri-tjetrin: janë bashkërenduar, janë kundërvënë me secilin prej “tjetrit”. Ky trekëndësh “qendra e majtë”, “qendra e djathtë” dhe “komuniteti ndërkombëtar”, tani e tutje janë në parakushtet politike për vepruar rrethësisht ndryshe nga më parë. Hapësira politike shtendoset, për disa kohë krijohet përshtypja se jemi në një “normalitet politik”, ku secili ka punën e vet. Qeveria qeveris, opozita kritikon, kurse diplomatët punojnë në selitë e tyre. Për ironi të fatit, në verën e vitit 2002, ka dy përkime rastësore: ambasadori amerikan, Jozef Limpreht, fatkeqësisht ndërrohet papritur nga një atak kardiak gjatë një shëtitjeje në malet e Veriut të Shqipërisë, kurse ambasadori i OSBE-së në Tiranë është në muajt fundit të mandatit dhe në debatin politik nuk ka asnjë “temë për të ndërmjetësuar”.

⁴⁶ Berisha, Sali, “Rilindja demokratike”; nr. 3053, 22 janar 2002, f. 3.

⁴⁷ Berisha, Sali, “Korrieri”; nr. 145, 26 qershor 2002, f. 4.

⁴⁸ Nano, Fatos, “Korrieri”; nr. 145, 26 qershor 2002, f. 4.

PËRFUNDIME

Në funksion të legjitimitetit të pushtetit, një hapësirë politike e caktuar në një moment të caktuar aplikon një formë të caktuar legjitimiteti. Në rastin e Shqipërisë dhe në përgjithësi në rastin e demokracive të reja që bëjnë pjesë në “valën e tretë” të demokratizimit të vendeve në zhvillim, forma e re e legjitimitetit të pushtetit janë zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Pra “legjitimiteti racional” apo “juridik” i pushtetit shprehet nëpërmjet një procedure legale zgjedhore, e cila është neutrale kundrejt secilit aktor që hyn në garë, ose që plotëson kushtet për të hyrë në garën elektorale. Në një moment të supozuar “zero” të kësaj rruge, gjithçka është e qartë: aktorët politikë, që përfaqësojnë grupe të ndryshme të shoqërisë, do të konkurrojnë mes tyre me programe dhe ekipe, sipas një procedure të caktuar për të cilët palët që kanë hyrë në garë i kanë pranuar që në fillim rregullat e lojës. Shumica e zgjedhësve do të përcaktojë atë që fiton pushtetin për një mandat të caktuar.

Por shpejt ky model i pastër teorik nis dhe gjendet nën efektin e faktorëve të tjerë, të cilët e deformojnë principin e vendosur në këtë moment fillestar të dhënë të kontratës politike. Në skenë si një domosdoshmëri, për shumë arsye shfaqet “faktori ndërkombëtar” ose ndërkombëtarët. Në fillim është nevoja për ndihme ekonomike nga jashtë, për asistencë teknike, njerëzore dhe ekspertizë për sistemin e ri që po ndërtohet, ajo që bën që komuniteti ndërkombëtar të jetë i lutur të vijë për të marrë pjesë në hapësirën politike. Nga ana tjetër kjo prani është gjithashtu shumë legjitime dhe e preferuar në sytë e qytetarëve. Përderisa ne duam “ta bëjmë Shqipërinë si e gjithë Evropa”, përderisa duam të aplikojmë, të kopjojmë në vendin tonë modelin perëndimor, pra të “imitojmë” Perëndimin, ndërkombëtarët janë jo vetëm ata që po na ndihmojnë për të kaluar krizën humanitare, për të rindërtuar rrugët, shkollat, spitalet, por ata janë dhe modeli që duam të imitojmë. Ndërkombëtarët shfaqen në hapësirën politike jo thjesht si nevojë, por dhe si të mirëpritur, madje të “adhuruar” nga komuniteti politik.

Në këtë moment të parë roli i tyre vjen dhe bëhet i rëndësishëm në raport me aktorët lokalë dhe zgjedhësit. Në sytë e zgjedhësve, ai aktor politik lokal që ka marrëdhënie më të ngushta me komunitetin ndërkombëtar, që është i aftë të sigurojë më shumë ndihmë, më shumë asistencë për vendin, të përparojë më shpejt integrimin e vendit në strukturat euro-atlantike, ai është sigurisht dhe më “legjitim” në skenën e brendshme. Aksioni i tij është me efikas në skenën e brendshme jo thjesht për shkak të legjitimitetit të tij në skenën lokale, por dhe për shkak të ndihmës së huaj. Nga ana tjetër, komuniteti ndërkombëtar është i prirur të shtojë mbështetjen, ndihmën apo inkurajimin për aktorët lokalë, të cilët janë me mbështetje popullore të gjerë. Sipas parimit të efikasitetit, kjo duket diçka normale. Në këtë mënyrë, në këtë fazë të parë, komuniteti ndërkombëtar në sytë e bashkësisë politike dhe të qytetarëve të thjeshtë identifikohet me palën në pushtet, pra “është bërë njësh me ta”.

Ky “përforsim” prej dy legjitimitetesh që posedon aktori në pushtet, nuk ka se si të mos degradojë në një shkallë drejt arbitraritetit politik, arrogancës, prishjes së rregullave të lojës. Sidomos në një vend ku kultura politike është e mangët dhe aftësia vetërregulluese e sistemit politik është ende e brishtë. Në një kohë të dytë, në momentin kur konflikti politik ka mbërritur në një pikë kritike ose është në prag dhe ku ky konflikt rrezikon të hedhë në erë veç të tjerash edhe investimin e komunitetit ndërkombëtar, këtij të fundit i duhet tanimë të ndërrojë rolin me shpejtësi. Nga një mbështetës dhe asistues i faktorit të brendshëm, në një ndërmjetësues i konfliktit që kërcënon me shkatërrim gjithçka. Në këtë çast hapësira politike futet në një krizë të fortë dhe nuk është më e mundur të sigurohet një farë integriteti i kësaj hapësire politike pa praninë prej “ndërmjetësuesi” të komunitetit ndërkombëtar. Dhe më tej ajo nuk mund të funksionojë pa arbitrimin e ndërkombëtarëve. Ky model, pak a shumë i teorizuar në këtë mënyrë, është Shqipëria në ngjarjet politike dhe krizat e marsit 1997 dhe protestat e fuqishme të opozitës në shkurt të 2004-ës. Komuniteti ndërkombëtar është kthyer në ndërmjetësin politik mes aktorëve politikë të brendshëm por edhe në “vlerësuesin” apo “noterin” e procedurës demokratike.

Në këtë moment principet e legjitimitetit, të autoritetit apo sovranitetit nisin dhe transformohen për t'u shndërruar në forma hibride të modeleve të para. Për aktorët lokalë, loja e tyre politike nuk zhvillohet më si më parë. Krahas strukturimit të aksionit politik në funksion të elektoratit, i cili normalisht është legjitimuesi i vetëm i aksionit të tyre, ata duhet ta strukturjnë atë edhe në funksion të interesave, të axhendës dhe dinamikës e faktorit ndërkombëtar. Është mjaft e vështirë t'i takosh këto dy logjika, atë të interesave dhe axhendës së elektoratit dhe atë të interesave dhe axhendës së ndërkombëtarëve. Ato zhvillohen secila në drejtimin e tyre, duke iu nënshtruar principeve krejt të ndryshme. Hapësira politike nis dhe turbullohet dhe zgjedhësit kanë përshtypjen se ata nuk vendosin më, se vendimet merren në ambasada, në Bruksel apo Uashington, se sido që të votojnë ata në zgjedhje, e rëndësishme është se "kujt do t'ia japë fitoren OSBE-ja apo ndërkombëtarët".

Po ashtu, aktorët politikë lokalë në funksion të mbijetesës së tyre politike janë të detyruar të ndërtojnë një aksion politik krejt tjetër, që merr parasysh këtë princip të ri, sipas të cilit funksionon hapësira politike tani e tutje, me praninë përcaktuese të ndërkombëtarëve në të. Aktorët lokalë dhe mbi të gjitha elektorati, zgjedhin dhe zgjidhen, por ata praktikisht nuk vendosin më vetë. Ose nuk vendosin më vetëm ata. Kjo, duke filluar që nga momenti me kyc: kush është fituesi i zgjedhjeve dhe gjithë të tjerat që vijnë pas kësaj.

Për të gjitha këto arsye dhe për shkak të dinamikës që ka pësuar aksioni i komunitetit ndërkombëtar në terren, që nga viti 1991, nga një asistues i fushës politike, në një ndërmjetës apo lehtësues i lojës politike të brendshme deri tek shndërrimi në një arbitër dhe gjykatës të dinamikës së brendshme, ndërkombëtarët tani janë "pala e tretë" në hapësirën politike. Nëse hapësirën politike do ta ndajmë në mënyrë imagjinare në qeveria dhe opozita, me gjithëçfarë implikon kjo ndarje në elektorat, pra do të kishim dy palë, ndërkombëtarët do t'i quajmë për konvencion "pala e tretë". "Pala e tretë" në hapësirën e re politike hibride ka një status krejt origjinal. Ajo gjykon verifikon, certifikon apo noterizon procedurën demokratike në aspektet e saj themelore, siç janë ecuria e proceseve zgjedhore dhe reformat e rëndësishme në vend. Nga ana tjetër, "pala e tretë", pra komunitetit ndërkombëtar, për të plotësuar këtë funksion i duhet të shprehet periodikisht "çfarë është mirë apo çfarë është keq" në aksionin e dy palëve të para. Duke bërë këtë, ajo bëhet direkt bashkautore me dy palët e tjera në strukturimin e aksionit politik të brendshëm. Por në ndryshim nga dy palët e para, kjo e fundit ka një specifikë: ajo nuk votohet nga elektorati, nuk jep llogari për përmbajtjen dhe rezultatin e aksionit të vet. Është jashtë logjikës që ndërkombëtarët të mund të mendohej se do të votoheshin, duke qenë "aktorë politikë" të plotë në hapësirën politike. Në këtë mënyrë, pala e tretë ose ndërkombëtarët "vendosin, por nuk votohen".

Edhe kritikët më të mëdhenj të rolit të komunitetit ndërkombëtar në Tiranën politike as e shkojnë ndër mend të kthehemi në një situatë të tillë, ku hapësira politike do të zhdukte praninë dhe rolin e ndërkombëtarëve në zhvillimet e vendit. Efekti i parë i këtij operacioni do të ishte një rrezik i hapur për të rënë një tirani apo izolim të ri. Një hapësirë politike lokale pa praninë e ndërkombëtarëve do të "zhdukte" çdo kujdes të pushtetit për të qenë i kujdesshëm dhe luajal në skenën politike me opozitën apo me elektoratin. Prania e komunitetit ndërkombëtar është një presion mjaft pozitiv kundrejt aktorëve lokalë, në mënyrë që këta të sillen sa më konform procedurës demokratike. Ndërsa një hapësirë politike ku ndërkombëtarët "do të zhdukeshin", është jo vetëm e paimagjinueshme për kontekstin lokal dhe rajonal të sotëm, një gjë e tillë është po aq e padëshirueshme nga komuniteti politik lokal.

Por nga ana tjetër, mënyra se si e strukturon aksionin politik komuniteti ndërkombëtar në Shqipëri mbetet një problem i hapur. Një hapësirë politike e tillë, me praninë e kësaj forme, kësaj cilësie dhe këtyre përmasave të komunitetit ndërkombëtar në strukturimin e aksionit, shndërrohet vërtet në një "tjetër gjë". Prandaj kriteret e vlerësimit dhe gjykimit të një hapësire "politike hibride" në funksion të legjitimitetit të pushtetit dhe legjitimitetit të aksionit të tij politik, mbeten për t'u riparë. Ato nuk mund të jenë kurrsesi ato të parat, ku kjo hapësirë politike dhe sjellja e aktorëve lokalë do të bëhej në funksion të kritereve të "legjitimitetit racional", që thjesht respekton procedurën elektorale.

POLITIKAT E BASHKIMIT EVROPIAN NDAJ KËRCËNIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR SHQIPTAR: NJË SHQETËSIM REAL APO I HIPERBOLIZUAR?

Ilir Kalemaj*

Abstrakt. Krimi i organizuar dhe “kapja e shtetit” nga organizata mafioze prej kohësh është kthyer në shqetësimin kryesor të ndërkombëtarëve, kryesisht Bashkimit Evropian, për sa i përket rajonit që njihet si “dera e pasme” e tij, Ballkani Perëndimor. Shqipëria spikat për “treqshmerinë” që paraqet edhe ndërmjet këtyre vendeve dhe shpesh i është dashur të përballojë një retorikë të fortë kritikuese nga ana e ndërkombëtarëve, megjithëse provat empirike dëshmojnë se nuk ka rast të besohet se ky vend është sui generis dhe meriton këtë “trajtim” të veçantë. Ky punim synon të trajtojë si metamorfozën e retorikës së ndërkombëtarëve në lidhje me kërcënimin e krimit të organizuar shqiptar dhe perceptimet e institucioneve dhe aktorëve kryesorë politikë dhe shtresave shoqërore evropiane, ashtu edhe të anasjelltën: perceptimet publike të elitave shoqërore dhe politike shqiptare në lidhje me këtë retorikë evropiane. Teza kryesore që kjo ese artikulon është se ligjërimi mbi kërcënimin e krimit të organizuar shqiptar është sendërtuar mbi një stereotipizim të qëllimshëm të shqiptarëve, duke i dhënë krimit një veshje etnike, në mënyrë që të ruhet kohezioni i brendshëm i ndërkombëtarëve, pavarësisht largimit nga realiteti objektiv që ky ligjërim dominant ka prodhuar.

HYRJE

Kërcënimi i krimit të organizuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor prej kohësh është kthyer në një problem kërcënues për vendet e Bashkimit Evropian. Pikëpamja e BE-së për krimin e organizuar është se paraqet një “kërcënim të madh mbi sigurinë e brendshme dhe proceset demokratike [në përgjithësi]”.¹ Raporte të njëpasnjëshme, analiza vjetore të Këshillit të Evropës apo deklarata të zyrtarëve evropianë, të cilat kanë adresuar këto kërcënime, kanë qenë të shpeshta dhe në një rezonancë pothuajse lineare dhe të njëtrajtshme me njëra-tjetrën. Në një takim ministror të vitit 2003 për shembull, pjesëmarrësit theksuan *inter alia* që:

Krimi i organizuar dhe korrupsioni janë pengesa për stabilitetin demokratik, institucione të shëndosha dhe përgjegjëse, shtetin ligjor dhe zhvillimin ekonomik në Ballkanin Perëndimor. Theks i veçantë duhet të vihet mbi luftimin e të gjitha formave të trafikut, sidomos atij njerëzor, drogave dhe armëve si dhe trafikut të sendeve të tjera.²

Këto rekomandime të ministrave të Drejtësisë gjetën një pasqyrim më vonë në Strategjinë e Sigurimit Evropian (ESS), që merret me kërcënimet që Bashkimi Evropian po përballon dhe që do jenë sërish në fokus në të ardhmen. Disa nga këto kërcënime përfshijnë:

* Ilir Kalemaj është diplomuar për Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Empire State College. Më pas ka përfunduar Masterin për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane në Universitetin e Evropës Juglindore (CEU), Budapest, ku aktualisht është duke kryer edhe doktoraturën për Shkenca Politike. Fushat e tij të kërkimit janë: politikat dhe konfliktet etnike, irredentizmi në politikën e jashtme, multikulturalizmi dhe çështjet e identitetit (kombëtar, kulturor etj.)

¹ The EU's response to Organised Crime. Taken from: C:\Documents and Settings\neë user\Desktop\Org. crime_files\The EU's Response To Organised Crime.mht, 12/03/2007.

² “EU-Western Balkans Forum,” JHA Ministerial Meeting Brussels, 28 November 2003. Joint Conclusions. SN 3559/1/03, REV 1. Brussels, 28 November 2003. p.2.

Terrorizmin (i parë si një fenomen me shkaqe të thella dhe komplekse), proliferimin e armëve të shkatërrimit në masë, konfliktet rajonale, shtetet e dobëta dhe *krimin e organizuar*. Për të përballuar këto sfida dhe kërcënime, dokumenti thekson se objektivat evropiane duhet të jenë të trefishta: matja e kërcënimeve, ndërtimi i një mjedisi të sigurt dhe zhvillimi i një rregulli ndërkombëtar bazuar në multilaterizmin efektiv.³

Fokusi i këtij punimi do të përqendrohet në dialektikën dhe metamorfozën e pikëpamjes së BE-së ndaj kërcënimit të krimit të organizuar shqiptar,⁴ ku do analizohen kryesisht si retorika e disa prej zyrtarëve më të rëndësishëm evropianë në lidhje me këtë fenomen, ashtu edhe burime primare të Komisionit dhe Këshillit të Evropës në lidhje me trajtimin e krimit të organizuar nga shqiptarët. Analizat mbi kërcënimet nga krimi i organizuar si dhe deklaratat nga Këshilli i Bashkimit Evropian janë në të njëjtën linjë me qëllimet strategjike të paraqitura qartë në Strategjinë e Sigurimit Evropian që u përmend më lart.

Nga ana tjetër, kjo ese synon të diskutojë perceptimet publike të elitave shoqërore dhe politike shqiptare në lidhje me retorikën evropiane për kërcënimin e krimit të organizuar shqiptar. Pra, argumenti kryesor që ky punim synon të elaborojë është se ligjërimi mbi kërcënimin e krimit të organizuar shqiptar është sendërtuar mbi një stereotipizim të qëllimshëm të shqiptarëve, duke i dhënë krimit një veshje etnike, në mënyrë që të ruhet kohezioni i brendshëm i ndërkombëtarëve, pavarësisht largimit nga realiteti objektiv që ky ligjërim dominant ka prodhuar. Në këtë linjë, artikulli nxjerr në pah disa të meta esenciale, që shpesh raportet e institucioneve të BE-së mbartin në analizat e tyre vjetore, që matin empirikisht nivelet e krimit dhe korrupsionit në Shqipëri. Ky diskur “Western” ka riprodhuar nga ana tjetër një efekt bumerang, ku kryesisht elitat politike shqiptare artikulojnë të njëjtën retorikë kritike dhe mohuese të ndërkombëtarëve, duke trajtuar si ndër problemet më të mëdha që ka vendi, mafien dhe korrupsionin, megjithëse kjo nuk i përgjigjet atij realiteti që shumica e shqiptarëve perceptojnë.⁵ Metodologjia e përzgjedhur fokusohet në një analizë të diskursit analitik, si dhe trajtesë epistemologjike dhe ontologjike të burimeve primare dhe dytësore për të studiuar efektet e retorikës së “ndërkombëtarëve” në politikën e brendshme të vendit dhe ndryshimet [apo ndoshta stanjacionin], si dhe reflektimet që kjo retorikë ka prodhuar.

EUROPOLI DHE RAPORTET MBI KRIMIN E ORGANIZUAR SHQIPTAR

Europoli është “organi i ushtrimit të ligjit që merret me inteligjencën kriminale”.⁶ Ai ndihmon vendet anëtare që të kenë një efikasitet më të madh ndaj krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në mënyrë specifike. Ky i fundit ushtrohet nga organizata kriminale të sofistikuara, të cilat sipas një propozimi të Komisionit Evropian të Janarit 2005, përkufizohen si: “struktura shoqërore, të themeluara prej një periudhe kohe të caktuar, që përbëhen nga dy ose më shumë persona dhe që veprojnë për të ndërmarrë veprime të cilat janë

³ Lucarelli, Sonia and Roberto Menotti, 2006: ‘The Use of Force as Coercive Intervention’, in Sonia Lucarelli and Ian Manners, eds, Values and Principles in European Union Foreign Policy, London: Routledge, p.154.,

⁴ Në këtë punim, përdorimi i termit “shqiptar etnik” do përdoret në mënyrë të barazvlershme me termin shqiptar, duke anashkalur kufijtë zyrtarë që ndajnë shqiptarët e Shqipërisë me ato të trojeve të tjera etnike shqiptare, në përputhje me retorikën zyrtare të BE-së, siç vihet re nga burime zyrtare si Europoli. Por pikërisht në këtë pikë, ky punim tenton gjithashtu një qasje kritike ndaj ndërkombëtarëve, të cilët shpesh konfundojnë termat duke bllokuar kështu realisht procesin e integritimit në vend që ta stimulojnë atë.

⁵ Për shqetësimet kryesore të elektoratit shqiptar shih ndërmjet të tjerave Tabelën 2 te Blendi Kajsu, “Integrimi si pengesë për demokratizimin,” Polis 2, Tiranë, 2006. Të dhënat empirike flasin se shqetësimi kryesor i shqiptarëve sot është papunësia e ndjekur nga korrupsioni, infrastruktura, rrogat dhe pensionet. Siç shihet, krimi (i organizuar apo jo) apo fenomeni i shumëpërfolur i “kapjes së shtetit” nga mafia politike, nuk figurojnë ndër shqetësimet primare të shqiptarëve.

⁶ Fact Sheet on Europol 2006.

të dënueshme me privim lirie ose burgim me minimum të paktën katër vjet ose më shumë, si një mënyrë për të përfutur, direkt apo indirekt, të mira financiare apo materiale.⁷ Ndërsa për vetë krimin e organizuar nuk ka një përkufizim definitiv të tij, megjithëse artikullohet rëndom në raportet e ndërkombëtarëve. Ndër dy nga përkufizimet kryesore të tij mund të veçojmë atë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër kimit të organizuar të vitit 2000, i cili e shpreh me këto fjalë: “Një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personash që ka ekzistuar për një periudhë kohe dhe veprojnë në bashkëpunim, me qëllim kryerjen e një ose më shumë krimeve ose veprave penale serioze, në mënyrë që të përfitojnë, direkt ose indirekt, një përfitim financiar ose përfitim tjetër material”.⁸ Ndërsa, përkufizimi kryesisht i pranuar në SHBA është: “një aktivitet kriminal të dënueshëm, te vazhdueshëm e vetëveprues, duke pasur një strukturë të organizuar, të ushqyer nga frika dhe korrupsioni dhe të motivuar nga etja për fitim”.⁹

Europoli përgatit raporte vjetore, të cilat shërbejnë si matës të kërcënimit të kimit në BE dhe të cilat shërbejnë si udhërrëfyese për masat që komisioni implementon më vonë për t’u përgjigjur këtyre kërcënimeve. Europoli është i financuar nga kontributet e vendeve anëtare në baza proporcionale, sipas PPB-së së tyre vjetore.¹⁰ Qëllimi i tij kryesor është të krijojë një bashkëveprim ndërkufitar policor ndërmjet vendeve evropiane. Shpeshherë Europolit i referohen si një lloj “FBI-je evropiane”, i cili ka “një rol kyç që të asistojë agjencitë kombëtare policore për të luftuar krimin”.¹¹

Një raport i Europolit i vitit 2003 theksonte që grupet kriminale po bëhen më profesionale dhe heterogjene. Në referencë të veçantë për grupet shqiptare theksonte se “grupet etnike shqiptare të kimit të organizuar ishin ndër kërcënimet kryesore të Bashkimit Evropian, ashtu sikundër vendeve të asociuara dhe Norvegjisë”.¹² Më pas raporti përshkruan karakteristikat e këtyre grupeve, të cilat përfshijnë ndërmjet të tjerave, të njëjtin ekskluzivitet tradicional grupi, ku një etni mbizotëron mbi të tjerat, megjithë larminë gjithnjë e në rritje të këtyre grupeve. Aktivitetet e tyre kryesore fokusohen në trafikun e drogës dhe të qenieve njerëzore. Po ashtu është vënë re se “një element kyç i grupeve kriminale shqiptare është gradimi i tyre nga roli si ndërmjetës apo gjenerues shërbimesh, në organizata kriminale të mirëfillta, të cilat kanë marrë përsipër disa tregje kriminale kur ata kanë fituar njohuritë e duhura”.¹³ Disa prej shembujve që janë përmendur në raport përfshijnë “rëmbimin” e tregjeve ilegale nga trafikantët turq në Evropën Lindore apo dominimin e “tregut” të shtëpive publike në Britaninë e Madhe. Megjithatë, grupet kriminale të “shqiptarëve etnikë” vazhdojnë të qëndrojnë gjithashtu në rolet e tyre të hershme si transportues dhe “interlokutorë për drogën që vjen nga grupet e kimit të organizuar kolumbian, të cilët janë të përfshirë në trafikun ndërkombëtar të kokainës”.¹⁴

Kërcënimi nga krimi i organizuar është rritur edhe si pasojë e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Një raport mbi krimin e organizuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian në 2005, përqendrohet në faktin që zgjerimi vetëm e ka përforcuar kërcënimin e kimit të organizuar, megjithëse në forma më të sofistikuar tashmë. Ai thekson rritjen e heterogjenitetit të këtyre grupeve dhe aftësitë e reja që ato kanë fituar. Në mënyrë më specifike, theksi vendoset tek grupet kriminale të shqiptarëve etnikë dhe turqve si aktorët kryesorë problematikë i një numri gjithnjë e më të madh të shteteve anëtare.¹⁵ Shqiptarët etnikë u evidentuan si grupimet kriminale me rritjen më të shpejtë në këtë raport.

⁷ *Fight against Organised Crime. Freedom, Security and Justice: An Agenda for Europe.*

⁸ *Shih Xhavit Shala. Krimi i organizuar dhe sigurimi kombëtar. Marrë nga http://www.moi.gov.al/mpo/studime/krimi_i_organizuar.htm*

⁹ *Ibid*

¹⁰ *Për 2006-ën ky buxhet për shërbime ishte 63.4 milionë Euro.*

¹¹ *The EU's response to Organised Crime.*

¹² *Europol: 2003 European Union organized crime report. P.14*

¹³ *Ibid*

¹⁴ *Ibid*

¹⁵ *Council of the European Union: 2005 Organized Crime Report: Public Version. Brussels, 17 November 2005.*

¹⁶ *2005 Council report, p.5.*

Grupet e shqiptarëve etnikë kanë përparuar nga të qenit thjesht shërbyes të interesave të tjerëve në majat më të larta të krimit të organizuar ndërkombëtar. Ata kanë struktura hierarkike dhe homogjene, por bashkëpunojnë me bindje dhe në mënyrë përfutuese me grupet e tjera të krimit të organizuar. Ata janë kryesisht të përfshirë në trafik droge dhe trafik të qenieve njerëzore, eksploitim prostitucioni, favorizim të emigracionit të paligjshëm dhe gjithë llojet e krimit të pronës.¹⁶

Ky raport gjithashtu i referohet aspekteve të tjera të kërcënimit të krimit të organizuar shqiptar, të cilat kanë marrë vetëm vëmendje sipërfaqësore më parë. Një aspekt i tillë është edhe evidentimi i rolit të Shqipërisë, si një vend që shërben për të depozituar kokainën përpara se ajo të shpërndahet në BE.¹⁷ Më tej, “sipas informacionit të agjencive të ushtrimit të ligjit, çdo vit rreth 30 ton kokainë gjejnë rrugën për në Evropë nga Shqipëria”.¹⁸ Megjithatë raporti thekson se aktualisht vendet e Evropës Lindore nuk shërbejnë si tregje, nuk ka garanci që ky trend do vazhdojë në të ardhmen. Me fjalë të tjera, raporti i Këshillit jo vetëm informon, por gjithashtu ofron predikime që mund të përdoren për zbatim të politikave të ardhshme nga Komisioni ndërsa përpunon strategjinë e tij në lidhje me këtë çështje.

Në një dritë të ngjashme, ndërsa prezanton evoluimin e përgjithshëm të krimit të organizuar në Shqipëri, një vëzhguese maqedonase vëren se që nga 2003-shi policia ka observuar një fazë të tretë të avancimit të disa organizatave kriminale shqiptare. “Këto grupe kriminale janë në rrugën e tyre drejt majave të krimit të organizuar duke i bërë ndërkohë lojtarë kryesorë të rrjeteve komplekse kriminale”.¹⁹ Nga ana tjetër, duket se grupet etnike shqiptare po bëhen më profesionistë dhe të sofistikuar në biznesin e paligjshëm të krimit të organizuar në të cilin ata janë përfshirë. Duke iu referuar dhunës për shembull, “shqiptarët sot tentojnë të përdorin më pak dhunë në mënyrë që të reduktojnë impaktin social të krimeve të tyre”.²⁰ Nga evidenca e paraqitur deri tani, duket se kurba e krimit shqiptar është në rritje dhe po bëhet një kërcënim eksplicit për vendet e Bashkimit Evropian.

Megjithatë, raporti vjetor i Europolit i vitit 2005 përmban vetëm një referencë, e cila i drejtohet krimit të organizuar shqiptar. Kjo referencë përshkruan një operacion të përbashkët nga forcat e rendit të Italisë, Belgjikës dhe Holandës, që ka çuar në “arrestimin e menjëhershëm të 28 personave”.²¹ Ky ishte një operacion që konsistonte në një bashkëpunim të ngushtë të organeve të drejtësisë dhe të forcave policore në të trija këto vende, ndërsa mandati i arrestit ishte lëshuar nga zyra e Prokurorit në Breshia të Italisë.²² Por duke pasur parasysh referencat e shumta në raportin e mëparshëm dhe retorikën e përdorur në forumet e tjera të zyrave vendim-marrëse evropiane, duket se ose kërcënimin ose po reduktohet ose Europolit po kundërshton vetveten krahasuar me deklaratat zyrtare të mëparshme. Një hipotezë tjetër mund të jetë që vlerësimi i nivelit të kërcënimeve ka qenë i ekzagjeruar që në fillim.

POLITIKAT E BE-S NË LIDHJE ME KËRCËNIMIN E KRIMIT TË ORGANIZUAR SHQIPTAR

Duke qenë se nuk është qëllimi i këtij punimi t'i hyjë analizave të hollësishme të faktorëve që kanë influencuar raportet shpesh kontradiktore të organizmave evropiane, po e kthejmë vëmendjen tani drejt strategjisë dhe politikave më specifike të BE-së, duke u përpjekur të gjej të dhëna empirike nga deklaratat zyrtare dhe burimet mediatike.

¹⁷ 2005 Council report, p.10.

¹⁸ Ibid

¹⁹ Jana Arsovska. “The evolution of Albanian organized crime groups”. Law presentation for the Catholic University Leuven-Belgium.

²⁰ Ibid

Patrick Moore, një analist i pavarur evropian, në një artikull të tij të vitit 2005, argumenton se:

Për Brukselin, integrimi i Ballkanit Perëndimor do të thotë që nuk do të ketë një “vrimë të zezë” në mes të BE-së—sidomos mbasi Bullgaria dhe Rumania të bashkohen—në të cilën krimi i organizuar mund të lulëzojë. Duke ofruar perspektivën e anëtarësimit, BE-ja ka një mekanizëm të fuqishëm për të influencuar ekzaktësisht ato lloj ndryshimesh—të quajtura “reforma”—të cilat duan t’i shohin të implementuara.²³

Megjithatë, pa rritjen e mbështetjes financiare dhe institucionale retorika e BE-së, duke filluar me Samitin e Selanikut dhe në vazhdim, mund të kthehet në një “bllof të dyfishtë, në të cilin BE-ja pretendon të ofruarit e kartës së anëtarësimit, ndërsa vendet e rajonit pretendojnë të implementuarit e reformave”.²⁴ Meqenëse sipas një studimi, programi CARDS 2002-2004 ka dedikuar rreth 50% të shumës së përgjithshme të tij për çështje të sigurisë dhe drejtësisë, “qeveria shqiptare duhet të kërkojë dhe negociojë që të kanalizohen më tepër fonde në sektorin ekonomik,”²⁵ pasi ky mund ta luftojë më me efikasitet dinamikën e krimit dhe korrupsionit në vend, duke luftuar rrënjët që i prodhojnë ato. Siç thekson Bumçi, duke iu referuar vetëm ekzistencës së programit CARDS, si instrumenti kryesor i procesit të Asocim-Stabilizimit, “mungesa e një programi të mirëfilltë për bashkëpunim ndërkufitar të jep përshtypjen, të paktën deri në njëfarë shkalle, se fjalët nuk janë të mbështetura me vepra”.²⁶ Në këtë mënyrë do arrihen dhe rezultate më konkrete, duke bërë që Shqipëria të pësojë përmirësime të dukshme në imazhin e saj ndërkombëtar. Ndërsa retorika mohuese dhe kritikuese ndaj shqiptarëve nuk do të shërbejë për asgjë, duke qenë se në rastin më të mirë mund vetëm të ruajë *status quo*-në, ndërsa në rastin më të keq mund të provokojë dëshpërim dhe trazira. Po e theksoj këtë pikë, pasi nëse kushtet e rajonit nuk përmisohen, vende si Kosova dhe Shqipëria do të vazhdojnë të cilësohen vatra të lulëzimit të krimit të organizuar, megjithëse kjo nuk është një e vërtetë objektive, por e sendërtuar.

E parë në këtë optikë, është me interes të shihet roli që Politika e Sigurimit dhe Mbrojtjes Evropiane (ang-ESDP) ka në luftimin e krimit të organizuar, sidomos atij që gjeneron nga jashtë kufijve të BE-së, por gjithsesi brenda “derës së pasme” së saj, si në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo pikë ka rëndësi të diskutohet këtu, sepse rajoni është “shtëpia” e shqiptarëve, qofshin këta të Shqipërisë apo vendeve fqinjë dhe ka qenë gjithashtu i karakterizuar nga mungesa e stabilitetit dhe vatrës e konfliktit. Akoma më e rëndësishme për t’u theksuar është se nëse misioni i ri i BE-së në Kosovë, EUMIK-u dështon të vendosi rregullin dhe stabilitetin në vend, Kosova mund të shndërrohet në një shtet ku do mbizotërojë anarkia dhe më një nivel të lartë konflikti ndëretnik. Sikundër Alistair Shepherd sugjeron:

Kur ka konflikt dhe dështim shteti [state failure], krimi i organizuar lulëzon. Duke kufizuar rrezikun e konfliktit dhe të anarkisë që sjell dështimi i shtetit, BE-ja mund të ndihmojë të

²¹ Europol: Europol Annual Report 2005, The Hague, 22 March 2006, File nr: 1423-39r2 (#166073). Downloaded from: www.statwatc.org/news/2006/apr/europol-report-2005.pdf, p. 16.

²² Ibid

²³ Patrick Moore. “Western Balkans: Is there life outside the EU?” Sept. 16, 2005. Downloaded from: <http://www.rferl.org/featuresarticle/2005/09/0189a1b5-e9a4-469d-8ad6-1e876b5b572f.html>

²⁴ Stefan Lehne. “Has the ‘Hour of Europe’ come at last? The EU’s strategy for the Balkans,” in the Franz Lothar Altmann et al. “The Western Balkans: moving on”. Judy Batt ed. Chaillot paper, n.70. Oct.2004. pp.121-122. Këtu i referohem gjithashtu faktit se megjithëse BE-ja ka dhënë ndihmesë në disa sektorë të veçantë, si p.sh. në sigurimin e kufijve, po të marrim një vështrim krahasues me ndihmat e BE-së për vende ekstrakomunitare që as nuk e kanë perspektivën e anëtarësimit, si Moldavia, e cila do përfitojë vetëm gjatë tre viteve të ardhshëm, 1.2 miliardë euro, apo Palestina që përfiton akoma më tepër, është e qartë se vendet e Ballkanit Perëndimor po përfitojnë shumë më pak. Për një trajtim më të zgjeruar të këtij argumenti shih Ilir Kalemaj, “Politika Largpamëse,” gazeta Standard, 13 Janar, 2007.

²⁵ Aldo Bumçi. “Çështje të sigurisë kombëtare,” Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, 2004. p.43.

²⁶ Ibid, f.54.

kufizuarit e krimit të organizuar. ESDP-ja është vetëm një nga instrumentet për luftimin e krimit të organizuar dhe veprimet e BE-së jashtë kufijve të saj në stabilizimin e shteteve dhe rajoneve duhet të plotësohet më veprimet brenda kufijve të saj.²⁷

Në një linjë me argumentin e Shepherdit, ne mund të argumentojmë që vetëm nëse Bashkimi Evropian është plotësisht i përgatitur për t'u marrë seriozisht me rajonin dhe sidomos me Kosovën, mund të shpresohet se do gjenden instrumentet e nevojshme për të luftuar krimin e organizuar në vend dhe rrezikun e eksportimit të tij. Pra, nëse ESDP-ja nuk krijon mekanizmat e caktuara institucionale brenda kontekstit të misionit të ri të EUMIK-ut, mision që do të bëhet së shpejti operacional, atëherë ai rrezikon të kthehet në një mision të dështuar pa filluar mirë dhe ku retorika sërish nuk do barabitet me veprimet konkrete. Disa prej këtyre mekanizmave duhet të synojnë planifikimin e politikave afatgjatë, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me logjistikën e nevojshme, me fokus të veçantë stimulimin e rritjes ekonomike dhe prosperitetin si qëllimin kryesor. Kjo vetëm do shtonte besueshmërinë e retorikës evropiane dhe ndërkohë do të reduktonte kërcënimin e krimit të organizuar, i cili vjen nga rajoni dhe sidomos nga Kosova. Ndërkohë, disa aktorë influencialë vendimmarrës evropianë duket se kanë ndërruar kahun e retorikës, duke e lënë "topin" në fushën e shqiptarëve. Solana e bëri të qartë këtë, kur ai theksoi se:

Ne po bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë për të luftuar krimin e organizuar. Por ky krim i organizuar nuk është evropian, është kosovar. Prandaj, u takon kosovarëve të luftojnë krimin e organizuar, sepse është një krim kosovar dhe kjo duhet mbajtur në mend.²⁸

Është pra e qartë se ndryshimi në retorikë në nivelet më të larta të politikëbërjes në BE duket se synon të drejtojë vëmendjen te vendet nga të cilat ky krim "buron" dhe e bën këtë duke epitemizuar vetë krimin, duke i specifikuar origjinën dhe për rrjedhojë marrjen e përgjegjësive nga vendi përkatës. Por në rastin e Kosovës, kjo duket irrealë, pasi Kosova është aktualisht nën një menaxhim ndërkombëtar dhe rrjedhimisht e paafte për të përmbyshur kushtet e BE-së, sidomos nëse mungon një ndihmë konkrete në këtë drejtim. Nga ana tjetër, vendimmarrja në nivelin evropian është ndonjëherë e influencuar nga një mediatizim shpeshherë i deformuar, që synon të pikturojë një realitet krejt imagjinar. Sikundër një analist kosovar shkruan: "Politikanët kosovarë nuk reagojnë edhe kur disa të përditshme influenciale, si "Der Spiegel," shkruajnë se të ardhurat nga biznesi i drogës shkojnë deri në gjysmën e buxhetit; rreth 350 milionë euro".²⁹ Megjithatë Robelli e hedh pjesën më të madhe të fajit mbi politikanët kosovarë për mos përgjigjen ndaj akuzave të tilla, të cilat nuk mund të provohen, prapë fakti qëndron se autoritetet kosovare kanë pak apo aspak fuqi për t'u marrë me persistencën në rritje të krimit të organizuar. Kjo ndodh kryesisht për shkak të faktit se pjesa më e madhe e autoritetit legjitim në Kosovë aktualisht u është dhënë trupave të UNMIK-ut dhe NATO-s.

Ndërsa për një pikëpamje të Shteteve të Bashkuara mbi Kosovën dhe rrezikun e krimit të organizuar që vjen prej aty, ne mund t'i referohemi dëshmisë së Janet Bogue, zëvendësasistent i sekretares së shtetit për Evropën Juglindore. Ndërsa përmendte sfidën e krimit të organizuar si kërcënimin më të madh që Kosovës vetë i duhej të merrej me dhe që gjithashtu rrezikonte ta eksportonte në vendet fqinjë, Bogue bën thirrje për një zbatim të formulës tashmë të njohur "standartet përpara statusit," duke shmangur kërkesën për pavarësi.³⁰

²⁷ A. J. K. Shepherd, "Irrelevant or Indispensable? ESDP, the 'War on Terror' and the fallout from Iraq," *International Politics* 43: 82, 2006.

²⁸ Cituar në "EU- Western Balkans Forum," JHA Ministerial Meeting Brussels, 28 November 2003. Joint Conclusions. SN 3559/1/03, REV 1. Brussels, 28 November 2003.

²⁹ Enver Robelli. "Një shpatë mbi lirinë e Kosovës", gazeta Shekulli

³⁰ Janet Bogue. FDCH Congressional Testimony; 05/21/2003

Por kjo pikëpamje dështon së marri në fuqi opinionin e disa prej politikanëve më influencialë kosovarë, të cilët ankohen se i kanë duart shpesh të “lidhura” nga prezenca ndërkombëtare kur merren me një pjesë të mirë të problemeve të brendshme. Sipas ish-kryeministrit kosovar, Bajram Rexhepi: “...pa një plan të programuar qartë apo afate të përcaktuara politike, ose sensin për të zgjidhur statusin ndërkombëtar të paqartë të këtij entiteti, kosovarët janë duke humbur shpresën shpejt... Njerëzit më votuan mua si kryeministër, por unë e gjej veten me duar të lidhura mbrapa shpine. Është një kontradiktë e plotë”.³¹ Siç mund të shihet qartë nga këto deklaratat, ka një kontradiktë themeltare ndërmjet presionit ndërkombëtar mbi Kosovën për të plotësuar standardet, të cilat përfshijnë *inter alia*, reduktimin e krimit të organizuar në territorin e saj dhe kërcënimin që i shfaq shteteve të tjera, - duke rrezikuar ta eksportojnë atë, - dhe përgjegjësinë e autoriteteve kosovare për të luftuar seriozisht krimin dhe përmbushur standardet, kur shumë nga kompetencat akoma janë nën administrimin ndërkombëtar.

Përsa i përket shtetit shqiptar, shenjat janë që qeveria e re po lufton krimin e organizuar me një fuqi të rigjeneruar. Një nga tre prioritetet e qeverisë aktuale shqiptare, sipas ish-ministrit të Jashtëm të saj, z. Besnik Mustafaj, është të luftuarit e krimit të organizuar. “Krimi i organizuar nuk mund të ekzistojë pa mbështetjen politike. Lidhja mes tyre [krimit dhe politikës] duhet prerë”.³² Me të vërtetë, qeveria e re që erdhi pas zgjedhjeve të përgjithshme të korrikut të 2005-ës ka qenë e ashpër me krimin në përgjithësi dhe krimin e organizuar në veçanti. Për shembull, “një paketë anti-mafia përmban instrumente të rinj legalë për të lehtësuar sekuestrimin e të ardhurave kriminale dhe të fokusoj prioritetet e krimit të organizuar, vetëm në krimin e organizuar”.³³ Akoma më tej, një ligj mbi riatdhesimin e emigrantëve të paligjshëm nga shtetet anëtare evropiane, u propozua nga qeveria në prill të 2006-ës dhe u kalua vetëm një muaj më vonë nga Parlamenti Shqiptar. Shqipëria ishte i pari vend në Ballkanin Perëndimor, i cili kaloi një ligj të tillë dhe për rrjedhojë premtimet për një liberalizim të shpejtë të regjimit të vizave pasuan. Gjithsesi, këto përpjekje kanë filluar që nga viti 2003, kur qeveria socialiste e atëhershme ka nënshkruar një marrëveshje bilaterale me Britaninë e Madhe, e cila i hapi rrugën edhe firmosjes së marrëveshjeve të tilla me shtete të tjera. Për më tepër, qeveria e mëparshme reduktoi trafikun e qenieve njerëzore pothuajse në nivele zero, kur ndërmori operacionin “Puna” në vitin 2002, një sukses i madh për kohën.³⁴ Ky operacion u mundësua nga një bashkëpunim i ngushtë me “Guardia di Financia-n” italiane, e cila mbështeti financiarisht dhe me baza logjistike këtë operacion të parë të suksesshëm dhe të koordinuar të Policisë Shqiptare kundër trafikut, qoftë ky i drogës apo i emigrantëve të paligjshëm.³⁵ Në fakt është shqetësues fakti që të dyja llojet e trafikëve vendosen në të njëjtën paralele, pavarësisht rrezikut që ato pozojnë ndaj vendeve pritëse.³⁶

Ndërsa administrata aktuale i ka marrë gjërat akoma më tej, kur vendosi të propozonte një moratorium 3-vjeçar mbi mjetet lundruese motorike, i cili hyri në fuqi në prill të 2006-ës.³⁷ Kjo masë e tepërt dhe ekstreme - që në fakt u dënua si nga juristë të njohur në vend, ashtu dhe nga shoqatat dhe organizatat e të

³¹ Quoted in Helena Smith, “Angry Kosovars Call on ‘Colonial’ UN Occupying Force To Leave,” The Observer, 19 October 2003, 21.

³² Stability and prosperity: key steps in Albania’s European Union vocation. Downloaded from: C:\Documents and Settings\new user\Desktop\Org. crime_files\European Policy Centre Website.mht. Last accessed: 20 Feb. 2007.

³³ Eno Trimcev. “Nations in Transit 2006,” Freedom House. Budapest: AQUINCUM Publishing, 2006.p.72.

³⁴ Jana Arsovska. “The evolution of Albanian organized crime groups”. Law presentation for the Catholic University Leuven-Belgium.

³⁵ Kjo gjithashtu demonstron që kur ka një vendosmëri politike për të luftuar fenomene të rrezikshme tranzicionale (si rrjedhojë e kondicionalitetit evropian në këtë rast), lidhjet e krimit të organizuar, mund të priten.

³⁶ Bumçi thekson se qëndrimi liberal ndaj imigrimit në vendet perëndimore ku shqiptarët kanë emigruar, “gradualisht u shndërrua në një politikë të dyerve të mbyllura dhe më në fund në vlerësimin e imigrimit ilegal në të njëjtën shkallë me kriminalitetin”. Shih për më gjerë Aldo Bumçi, Çështje të sigurisë kombëtare: Rasti i Shqipërisë. Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, 2004. p.20

³⁷ Official Bulletin of the Republic of Albania: A Publication of the Centre for Official Publications. Downloaded from: www.legjisllacionishqiptar.gov.al, March 10, 2007.

drejtave të njeriut- u konsiderua si shenjë e një vullneti pozitiv nga partnerët ndërkombëtarë, të cilët e përshëndetën këtë hap. Megjithëse në retorikën për konsumim të brendshëm kjo masë u mbrojt me arsyetimin e dogmës tashmë të përsëritur të plotësisht të kushteve për integrimin në BE dhe si parakusht për firmosjen e MSA-së që pasoi shpejt, logjika të çon se ky moratorium ishte ndoshta i nxituar dhe emotiv.³⁸ Moratoriumi nxori gjithashtu në pah faktin që shqetësimi kryesor nuk është thjesht te krimi i organizuar- pasi trafikantët e drogës apo “mishit të bardhë” kanë gjetur dhe gjejnë forma më të stërholluara trafiku, ku të dhënat flasin për një trend konstant të zhvillimit të këtyre trafikeve- por mbi të gjitha te emigracioni ilegal, që shihet edhe si burim i krimit të organizuar dhe që për pasojë njehsohet me të.³⁹

Një raport i Departamentit të Shtetit i vitit 2007, njohu hapat pozitivë të ndërmarë nga shteti shqiptar “ku vetëm në vitet 2001 deri në 2005-ën qeveritë shqiptare të njëpasnjëshme kishin konfiskuar 4.72 milionë dollarë në asete të krimit të organizuar dhe terrorizmit dhe një tjetër 1.58 milionë dollarë nga pastrimi i parave”.⁴⁰ Me gjithë retorikën dhe vullnetin e mirë të qeverisë së re, gjurmë të dështimeve mund të vihen re pa shumë mundim. Në të njëjtin raport të

Departamentit të Shtetit për shembull, mund të vihet re gjithashtu se Shqipëria konsiderohej ndër vendet ku pastrimi i parave lulëzon. Një nga pengesat kryesore që kishte nevojë të luftohej, sipas raportit, ishte qarkullimi i parave *cash* në ekonomi (pra jashtë sistemit bankar), i cili mendoj të përbënte rreth 25% të ekonomisë së përgjithshme të vendit, duke u krahasuar me vetëm rreth 10% që vërtitet në vendet e rajonit.⁴¹ Raporti gjithashtu thotë se grupet e krimit të organizuar dhe trafikantët e drogës e kanë përdorur territorin shqiptar si një pikë tranzite për trafikun e heroinës nga Azia Qendrore.⁴² Por raporti konkludon se: “dëshira shqiptare për t’u bashkuar NATO-s dhe BE-së ka qenë një motivacion kryesor për përbushjen e reformave,” megjithëse theksohet se procesi ka qenë i ngadalshëm edhe për shkak të ndarjeve të brendshme politike që kërcënonin stabilitetin e vendit.⁴³

NJË QASJE KRITIKE E RETORIKËS SË NDERKOMBËTARËVE DHE EFEKTI BUMERANG QË PRODHON KJO RETORIKË

Një element i veçantë që vlen për t’u evidentuar në kuadër të kësaj eseje është edhe optika e ndryshme që shqiptarët e Shqipërisë dhe ata të trojeve kanë përsa i përket pozicionimeve të tyre analitike në raport me evidentimin e krimit të organizuar shqiptar nga ana e ndërkombëtarëve. Një pjesë e mirë e analistëve kosovarë, si p.sh. Enver Robelli, kanë qenë mjaft kritikë ndaj qeverisë kosovare për heshtjen e tyre përballë akuzave (fallse) të mediave perëndimore apo zyrtarëve evropianë, ndërsa në Shqipëri një trajektore e ndryshme është vënë re. Sipas një observuesi, Parlamenti Shqiptar, i nxitur nga “palë” të interesuara, “në

³⁸ Në fillim të muajit korrik të 2007-ës, ambasadori i OSBE-se në Tiranë, z.Pavel Vacek, u filmua ndërsa përdorte një mjet të tillë motorik në brigjet shqiptare. Me të drejtë, një prej analistëve, një drejtues emisioni televiziv ngrinte pyetjen retorike: A nuk vlen ky ligj për të gjithë..., apo disa janë më të barabartë se të tjerët? Emisioni Déjà Vu i gazetarit Mustafa Nano.

³⁹ Më poshtë do ta trajtoj më hollësisht konceptin e “shpikjes” së shqetësimit (fiktiv) që sjell krimi i organizuar shqiptar, duke e parë nga pikëpamja e sendërzimit të vetë identitetit evropian, i cili ka të nevojshëm praninë e “Tjetrit” në shoqëri për të rikonfirmuar ekzistencën e vet.

⁴⁰ U.S.A. report for the money laundering in Albania. Shekulli 03/03/2007

⁴¹ Ibid

⁴² E parë nga një qasje kritike, do thoshim se përdorimi i territorit të Shqipërisë nga grupe të huaja të mirorganizuara trafiku, ka ndodhur edhe për shkak të pafuqisë relative dhe mungesës së mekanizmave të shtetit shqiptar për ta luftuar me forcë këtë fenomen. Gjithsesi, vullneti i mirë nuk ka munguar po të kujtojmë që Shqipëria ka bashkëpunuar me të gjitha mundësitë për “ngrirjen” e aseteve financiare dhe arrestimin apo dëbimin e personave të huaj të dyshuar për lidhje me Al Kaedën. Nga ana tjetër, edhe territori i SHBA-së, ashtu si dhe i vendeve evropiane, shpesh bëhet vend tranziti apo destinancioni përfundimtar i trafikantëve të drogës apo grupeve të tjera kriminale. Gjithsesi askush nuk i fajëson apo kritikon këto shtete, pasi një gjë e tillë do konsiderohej absurde. (I jam mirënjohës B. Kajsit për sjelljen në vëmendjen time të kësaj pike të fundit).

⁴³ Ibid

janar të 2001-shit, amendoi nenin 283 të Kodit Penal dhe depenalizoi përdorimin personal të drogave”.⁴⁴ Ndryshe nga vendet e tjera, që kanë ndjekur praktika të ndryshme për mospenalizimin e disa kategorive të drogave për përdorim vetjak, të cilat iu janë referuar kryesisht vetëm drogave të lehta, parlamentarët shqiptarë, për shkak të mungesës së njohurive apo informacionit, e kanë kaluar këtë ligj në bllok.⁴⁵ Siç vihet re, autori atakon politikanët shqiptarë për lejim me apo pa dashje të ligjeve që favorizojnë qoftë edhe indirekt klanet kriminale. Nga ana tjetër, një ish-funksionar i lartë i Policisë së Shtetit për vite me radhë, Pjerin Ndreu shprehet se “Klanet kriminale në vendin tonë, janë të mbështetura nga politika dhe për t’i luftuar kërkohet vullnet politik”.⁴⁶ Ai vijon më tej, duke thënë se ky vullnet mungon dhe “ata [kriminelët] punojnë të qetë, ndërtojnë pa asnjë preokupim, hanë e pinë çdo ditë me funksionarë të lartë, financojnë fushata me para të fituara në mënyrë jo ligjore”.⁴⁷ Gjithsesi, duhet mbajtur parasysh fakti që këto kritika të Ndreut erdhën pasi ai ishte shkarkuar (ndoshta dhe pa të drejtë) nga posti i tij dhe mund të jenë dhe rrjedhojë e një dimensionit diskursiv të krimit, ku sendërtohet një tablo bardhë e zi, nga njëra anë politika e lidhur me krimin dhe nga tjetra, individë të ndershëm dhe të përkushtuar si Ndreu, të cilët sakrifikohen si “koka turku” nga politika “e inkriminuar”, sa herë që kjo e fundit mbaron punë me ta. Megjithatë, në këto raste është vështirë të heqësh një vijë ndarëse se ku mbaron realiteti objektiv dhe ku fillon ai subjektiv në ligjërimin dominant të kapjes së shtetit nga mafia dhe krimi i organizuar.

Siç mund pra të shihet qartë, megjithëse reagimet janë në të njëjtën paralele kritike, ato ndryshojnë në premisat e tyre dhe mënyrën si gjykojnë palën fajtoare që ka sjellë dhe mediatizimin e “tejfryrë” të krimit të organizuar. Ndërsa kosovarët e drejtojnë kryesisht gishtin te mediumet e huaja, të cilat influencojnë vendimmarrjen evropiane dhe fajësojnë politikën kosovare për mefshtësi, shqiptarët janë kryesisht më të prirur drejt gjetjes së një rezonance me raportet e evropianëve, të cilat i marrin si të vërteta absolute dhe ua mvëshin fajin klasës politike shqiptare për dështimet e mundshme. Megjithë disa përpjekje të vakëta për të çmitizuar raportet e ndërkombëtarëve, të cilat shpesh bazohen në biseda private me politikanë të caktuar,⁴⁸ shumëkush është i bindur për vërtetësinë e tyre të pakorruptueshme, duke i kthyer në dogma, të cilat më vonë përdoren si instrumente politike. Një përjashtim që gjithsesi nuk prish rregullin, bën ish-kreu i Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH-it), z.Fatos Klosi, i cili e hedh poshtë mundësinë e një mafieje të strukturuar që ngjason me krimin e organizuar. Klosi deklaroi se: “Nuk mund të flitet për mafie në Shqipëri. Ka grupe kriminale që imitojnë mafien, por që s’kanë kodet, strukturën dhe forcën e saj në Itali apo Amerikë. Mendoj se nuk është duhet që vendi të bëhet epiqendër e këtyre sulmeve [të ndërkombëtarëve], sepse ka vetëm grupe që veprojnë në fushën e trafiqeve”.⁴⁹

Një argument tjetër i rëndësishëm që e ceka më parë, por pa e zhvilluar, ka të bëjë me konfondimin që sjell etiketimi i krimit të organizuar shqiptar si “etnik”, duke mos dalluar ata që vijnë nga Shqipëria me krimin e eksportuar nga vendet fqinjë ku banojnë shqiptarë etnikë nga Maqedonia, Mali i Zi apo Kosova. Kjo vlen të theksohet së paku për tri arsye kryesore. Së pari, shqiptarët etnikë nga ish-Jugosllavia, kanë pasur mundësinë për të emigruar në Evropën Perëndimore, shumë më parë sesa “vëllezërit” e tyre nga shteti shqiptar, të cilët kanë qenë të izoluar nga një prej regjimeve më stalinistë në Evropën Lindore. Kjo do të thotë se një pjesë e tyre, të cilët gjetën më të përshtatshme të punonin për bosët e rrjeteve të nëndheshëm në vendet ku ata emigruan, ishin më të aftë mbas pak kohe për të vendosur sferat e tyre të influencës, të cilat ata mund

⁴⁴ Lekë Sokoli. “The freezing of the Albanian lawgiver,” Tirana Observer, Monday, February 26, 2007.

⁴⁵ Ibid

⁴⁶ Artan Cena. “Në Shqipëri mafia mbështetet nga politika,” gazeta Koha Jonë, 31 Maj 2007. <http://www.kohajone.com/artikull.php?idm=5844> Aksesuar së fundmi nga 01/07/2007.

⁴⁷ Ibid

⁴⁸ Deklaratë e Neritan Cekës në emisionin e Blendi Fevziut, “Opinion”.

⁴⁹ Artur Qoraj. “Në Shqipëri nuk ka mafie, por grupe që e imitojnë,” Koha Jonë, 15 Maj 2007. http://kohajone.com/artikull_print.php?idm=5960 Aksesuar më 02/07/2007.

të kontrollonin. Me shembjen e regjimit komunist dhe hapjen e kufijve në Shqipëri, bosët e rinj kosovarë⁵⁰ filluan të përdornin “punën e krahut” të të sapoardhurve shqiptarë, të cilët u punësuan menjëherë për të bërë shpesh punët më të zeza për llogari të *nouveau riche*-ve kosovarë. Megjithëse një pjesë e mirë e shqiptarëve me kohë arritën të krijojnë rrjetet e tyre dhe madje të nxirrnin “jashtë loje” një pjesë të mirë të mafies vendase,⁵¹ prapëseprapë nuk mund të arrihet në konkluzionin empirik se shqiptarët kanë arritur të krijojnë struktura të mirëfillta të krimit të organizuar, të afta për një menaxhim ndërkombëtar të trafikut dhe me lidhje të fuqishme me strukturat shtetërore (state capture), megjithëse shpeshherë ndërkombëtarët kanë përdorur këtë gjuhë kur u janë referuar organizatave kriminale shqiptare. Kjo për arsyeën e thjeshtë se organizatat kriminale shqiptare janë akoma në një stad infantil, sidomos nëse krahasohen me organizata të mirorganizuara mafioze si ato që njihen me emrin “shoqëria e nderuar” në Itali dhe që përfaqësojnë botën e mirëfilltë të krimit, që u përmbahet njëkohësisht edhe rregullave shoqërore.⁵² Statistikat e shtetit italian në fakt flasin vetë, ku sipas të dhënave që disponohen, vetëm 20% e numrit të përgjithshëm të krimeve kryhen nga të huajt që vijnë nga zonat e Ballkanit Perëndimor. Siç shprehet Della Rocca: “në ato 20% ka shqiptarë por edhe ciganë, serbë, kroatë, myslimanë, boshnjakë, maqedonas, sllovenë”. Ndërsa nga ana tjetër, surprizues është edhe fakti që autori e sjell në vëmendjen e lexuesit kur shprehet se “nëpër statistikat e krimit të moshave të mitura të emigrantëve jashtëkomunitarë nuk gjen shqiptarë”.⁵³ Kjo me fjalë të tjera do të thotë që krimi i kryer nga shqiptarë të moshave të mitura është kaq i papërfillshëm sa vetë italianët kanë menduar se nuk ia vlen “barra qiranë” që ta përfshijnë në statistikat zyrtare. Duke qenë se sipas këtyre fakteve del se përqindja e krimit të shqiptarëve në raport edhe me numrin e madh të emigrantëve shqiptarë në Itali është aspak shqetësuese, atëherë kalohet në kufijtë e absurdit nëse konkludohet apo përflitet rreziku i një krimi të organizuar apo mafie shqiptare.

Arsyeja e dytë rrjedh prej konfuzionit që krijon termi “shqiptar etnik,” i cili anashkalon faktin që këta shqiptarë u përkasin formalisht shteteve të ndryshëm. Parë në këtë prizëm, kritikata e forta të ndërkombëtarëve ndaj shtetit shqiptar për mangësitë që shfaq ky i fundit në luftën ndaj krimit të organizuar, janë të ndërtuara mbi premisa aspak realiste, duke qenë se shteti shqiptar nuk ka juridiksion mbi shqiptarët e vendeve fqinjë. Nga ana tjetër, shteti shqiptar duket se po i përdor mekanizmat e nevojshëm dhe ka nënshkruar marrëveshje të rëndësishme me partnerët evropianë, që synojnë një monitorim më të mirë të kufijve, sistem doganor, që po kompjuterizohet gradualisht, dhe bashkëpunim rajonal ndërkufitar për të goditur grupet mafioze me pjesëtarë heterogjenë në këtë pjesë të Ballkanit.

Së treti, një aspekt tjetër interesant është fakti që krimi marginalizohet në vija etnike, duke i veshur identitete që sendërtojnë një ligjërim të deformuar dhe aspak realist. Duke specifikuar krimin shqiptar, partnerët evropianë ndërtojnë një tablo subjektive dhe nuk i përgjigjen realitetit, që shpesh i sheh organizatat kriminale si heterogjene, me përbërje të ndryshme etnike dhe pse jo racore. Krimi nuk ka nënshtetësi apo etni të caktuar dhe nëse do përdornim terma ekonomikë, është një treg që përbëhet nga dy komponentët kryesorë të ekonomisë së tregut: kërkesa dhe oferta. Edhe nëse kemi të bëjmë me organizata të mirëfillta homogjene kriminale shqiptare, përsëri krimi që ato eksportojnë (drogë, prostitucion, trafik të qenieve njerëzore me qëllim marrjen e organeve vitale etj.), gjen një pritshmëri në vendet nga vjen kërkesa, pra kryesisht nga

⁵⁰ Këta ishin kryesisht të vendosur në vende perëndimore si Zvicra apo Gjermania dhe kanë qenë dhe janë kryesisht të përfshirë në trafikun e drogave. Nga bashkëbisedimi që kam pasur me një pjesë të mirë emigrantësh shqiptarë në këto vende, një pjesë e tyre pohonte në mënyrë konfidenciale që shpesh u është dashur të përfshiheshin si korrierë të drogave të ndryshme dhe ishin kryesisht bosët e pozicionuar mirë kosovarë, ata të cilët u ofronin shpesh punë të tilla.

⁵¹ Një shembull i tillë është rajoni i Puljes në Italinë e Jugut, ku sipas informacioneve nga Ministria e Brendshme Italiane, të cituara dhe në shtypin shqiptar, organizata kriminale shqiptare për shkak të brutalitetit dhe konsolidimit të mëvonshëm të tyre, arritën të zëvendësonin degë të veçanta të rrjeteve të fuqishme mafioze, si *Sacra Corona Unita*.

⁵² Për një elaborim më të hollësishëm të këtij koncepti shih: Roberto Morozzo della Rocca, Shqipëria: rrënjët e krizës, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2000. p.110

⁵³ Ibid

vendet e Evropës Perëndimore.⁵⁴ Parë në këtë dritë, a është e drejtë (ang.- fair), që të fajësohet krimi “etnik” shqiptar për gjithçka, qoftë edhe kur eksportohet kryesisht nga Shqipëria dhe çfarë e shtyn në të vërtetë konstruktin e ligjërimit evropian në këtë drejtim?

Ndërsa pjesa e parë e pyetjes së mësipërme është retorike, pasi kritikizmi duhet të jetë gjithnjë në proporcion me shkallën e përfshirjes dhe përgjegjësisë që dikush mbart,- dhe identitetet është mirë t’i shmangen asocimit me fenomenin për mos të rënë në grackën e subjektivizmit, pjesa e dytë e pyetjes meriton një vëmendje më të madhe, pasi prek thelbin e një problematike të rëndësishme. Nuk ka se si të jetë rastësi që ritja e fuqisë politike të së djathtës evropiane që bazohet në diskursin ksenofob ndaj emigrantëve, përkon me një asociim të termave “emigrant i paligjshëm” dhe “krimi i organizuar,” duke hequr një paralele të trashë ndërmjet dy fenomeneve krejt të ndryshëm dhe të papërputhshëm objektivisht. Siç thekson dhe raporti i Europolit i vitit 2003:

Megjithëse ndikimi negativ i trafikut të drogës nuk duhet minimizuar, duket se ndikimi që ka mbi BE-në migracioni ilegal vjetor i qindra mijëra njerëzve është më i gjerë dhe më i prekshëm në kuptimin politik, social dhe ekonomik. Ky lloj krimi në forumet politike të BE-së tashmë është klasifikuar si një fushë parësore për shtetet anëtare, si dëshmohet nga operacionet me ndikim të madh që janë ndërmarrë nga katër presidencat e fundit të BE-së, duke vënë në objektiv migracionin ilegal dhe, kohët më të fundit, trafikun e qenieve njerëzore.⁵⁵

Paragrafi i mësipërm ekuivalenton njëfarësoj, duke ju dhënë të njëjtën peshë dhe rëndësi, emigrimit ilegal dhe trafikut të drogës, madje duket sikur prioritizon të parin.⁵⁶ Kjo si rrjedhojë ka nxitur një ligjërimit ksenofob ndaj emigrantëve të paligjshëm, të cilëve shpesh u vihen në pah trajtat etnike, duke epitetizuar krimin. Italianët p.sh., siç vë në pah della Rocca, kanë formuluar ekuacionin “shqiptar baras me kriminel”, i cili “vlen për të fashitur ndërjegjet e italianëve të lemerisur e viktimistë, të cilët shohin të shqiptarët një rrezik për mirëqenien e tyre dhe për këtë arsye do të dëshironin t’i flaknin në det”.⁵⁷ Dhe këtu bëhet fjalë veç për emigrantë, ndër të cilët edhe ata të paligjshmit, në masën dërrmuese punojnë “në të zezë”, pra pa kontrata sigurimesh dhe në punët më të rëndomta, por që gjithsesi nuk kanë asnjë lidhje me krimin, i organizuar apo jo qoftë ky. Siç përmend Della Rocca, “në një raport të Ministrisë së Brendshme Italiane të datës 20 nëntor 1996 shkruhet: “shqiptarët përdoren kryesisht në punë ndërtimi dhe në punë krahu, që kërkojnë sidoqoftë përdorimin e forcës fizike”. Pra, punë që italianët priren të mos i bëjnë vetë”.⁵⁸ Akoma më arbitrare paraqitet situata në Britaninë e Madhe, ku për median Britanike,

Shqipëria ka qenë dhe vazhdon të jetë një vend “i prapambetur”, “i varfër”, “enigmatik”, ashtu sikundër dhe Ballkani vazhdon të jetë një “fuçi baruti”, ekonomitë lokale “jofunksionale”, liderët rajonalë “infantilë politikisht dhe të korruptuar” dhe i gjithë gadishulli një kuti e Pandorës nga ku gjithë të këqijat vijnë në Perëndim, sidomos në Britani: drogat, trafiku njerëzor, pastrimi i parave, prostitucioni, vrasësit me pagesë e kështu me radhë.⁵⁹

Duke qenë se vlerat dhe identitetet kombëtare, fetare, kulturore dhe kështu me radhë, kanë nevojën

⁵⁴ I jam mirënjohës Blendi Kajsit për sugjerimin për ta parë edhe nga ky këndvështrim “veshjen” etnike të krimin.

⁵⁵ Raporti i Europolit: European Union organized crime report, 2003, <http://www.europol.eu.int>, cituar te Bumçi, 15.

⁵⁶ Shih për një argumentim më të shtjelluar lidhur me këtë pikë, Bumçi, 15.

⁵⁷ della Rocca, 107.

⁵⁸ Ibid, 109

⁵⁹ Alpiom, Gëzim. 2005. *Western Media and the European “Other”: Images of Albania in the British Press in the New Millennium*. Albanian Journal of Politics. I (1): 4-25. p.17

e projeksonit ndaj një “Tjetri” në shoqëri që të mund të njësohen dhe riafirmohen në shoqëritë përkatëse, diskursi anti-emigrant mbush një boshllëk të natyrshëm dhe të domosdoshëm, në pritje për t’u kapitalizuar politikisht. Kjo ndodh pasi në epokën e anktheve dhe pasigurisë së globalizimit dhe pasojave të një ere pas-ideologjike, shoqëria e përcakton veten në raport me një kërcënim, të tillë si terrorizmi, krimi, anarkia, mafia, etj. Një rol të qenësishëm në projeksonin e këtij tjetri në shoqëritë evropiane kanë luajtur pa dyshim dhe mediat, të cilat kanë shërbyer si katalizatorë të një fuzioni të krijuar në sferën e hapësirës publike, duke i dhënë trajtën nga njëra anë formësimit të opinionit publik dhe duke nxitur në njëfarë mënyre politikanët radikalë (të së djathtës kryesisht), për të kapitalizuar politikisht. Nga ana tjetër, ndërkohë që më parë një pjesë e mirë e politikanëve alla-Lw Pen e kanë përdorur diskursin antiemigrantë si “gurin” e tyre kryesor elektoral, kohët e fundit politikanë më “qendrorë” dhe popullorë, si Presidenti i ri i Francës, Sarkozy, e kanë bërë të tyrin këtë ligjërim, duke iu marrë njëfarësoj “kalin e betejës” ekstremistëve dhe duke legjitimuar njëkohësisht procesin.

Por për ta rikthyer vëmendjen te roli i medias apo i nukleuseve të tjera shoqërore, si letërsia, feja, shtypi, televizioni etj., duhet thënë se ato ushtrojnë pushtet, “një pushtet të ngushtë,” sipas Fukosë, i cili “lidh pushtetin dhe dijen”.⁶⁰ Ky pushtet më pas “ushtrohet mbi individin, duke synuar disiplinimin, vetëkontrollin dhe rritjen e aftësisë prodhuese të tij”.⁶¹ Në këtë shoqëri poliarkike, ku pushteti buron nga qendra të veçanta, roli i medias është veçanërisht crucial, për shkak se media informon sjellje të caktuara të aktorëve politikë dhe shoqëror. Media pra, shërben si katalizator i dyfishtë: nga njëra anë për të ndikuar opinionin publik nëpërmjet krijimit të stereotipeve të caktuar shoqërore (si diskursi kriminalizues për emigrantët e paligjshëm), ndërsa nga ana tjetër, e përdor këtë ligjërim dominant për të influencuar sferat më të larta të politik-bërjes (si ndërhyrjet diskrimuese në legjislacion).

Disa autorë kanë vënë re transformimin e shoqërive evropiane nën efektet presuese të globalizimit dhe kanë vënë re:

Se një fluks i ri refugjatësh dhe azilantësh politikë, Gastarbeiter-ësh⁶² dhe ish-kolonësh ka tronditur vlerat tradicionale dhe besimet në një identitet homogjen kombëtar, duke sfiduar ideologjitë kombëtare të vjetra dhe narracionet pedagogjike të një kombi të bashkuar dhe në disa versione, duke zëvendësuar një seri komunitetesh kulturore të veçuara të mbajtura bashkë në një ombrellë të përbashkët të quajtur “komunitet kombëtar”. Në këtë “komb multikulturor,” gjithkush përcaktohet në lidhje me “Tjetrin” ...⁶³

Ndryshime të tilla, të cilat zakonisht kanë një prapavijë ekonomike, krijojnë një “tokë pjellore” për shoqëri plurale, polietnike që krijojnë paradigma të reja dhe i japin formë ligjërimit të vjetër mbi identitetet e kombeve-shtete. Kjo nga ana tjetër, ndihmon në luftimin e stereotipeve të vjetër, që theksojnë se anëtarët e të njëjtit komb “ndejnë për njëri-tjetrin simpati të përbashkëta që nuk ekzistojnë ndërmjet tyre dhe ndonjë tjetri,”⁶⁴ dhe se “institucionet e lira janë pothuajse të pamundura në një vend që përbëhet nga kombësi të ndryshme”.⁶⁵ Por zakonisht të dhënat empirike flasin për një nevojshmëri të madhe për krahun e lirë të punës të prezencës së “Tjetrit” në shoqëritë “në plakje” evropiane për të kryer punët e rëndomta. Bumçi, duke

⁶⁰ Cituar te Enis Sulstarova. Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja. *Tiranë: Dudaj, 2006. fq.24.*

⁶¹ Ibid

⁶² Punëtorësh sezonale (ang. guest workers). Shën. i autorit.

⁶³ Anthony D. Smith. “Nations and Nationalism in a Global Era,” *Oxford: Polity Press, 1998. fq. 127.* Shih gjithashtu kapitullin 16 at Homi Bhabha (ed.): *Nations and Narration. London and New York: Routledge, 1990.*

⁶⁴ John Stuart Mill. “Considerations on Representative Government”, in *Utilitarianism, Liberty, Representative Government, ed. H. Acton. London: J.M. Dent, 1972. p.391.*

⁶⁵ Ibid

përmendur një studim të huaj, në punimin e tij theksonte ndërmjet të tjerash se:

prirjet demografike në Evropë, nga rënia e nivelit të lindjeve dhe nga moshimi i popullsisë, pritet që nga viti 2050 popullsia e 25 vendeve të BE-së të bjerë me rreth 40-50 milionë banorë. Kështu, për të mbajtur një forcë pune të qëndrueshme hyrja vjetore e emigrantëve duhet të jetë rreth 1.6 milionë.⁶⁶

Është disi paradoksale që një nga kushtet e forta që i vihet Shqipërisë është luftimi i mafies dhe krimin të organizuar, ndërsa në raporte të ndryshme vihet theksi sidomos te korrupsioni shtetëror dhe fenomeni i kapjes së shtetit (state capture). E parë nën një këndvështrim kritik kjo qasje ka së paku dy të meta kryesore. Së pari, megjithëse Shqipëria ka vuajtur dhe vazhdon të vuajë prej një kohe relativisht të gjatë atë që Ethan Nadelmani e quan “korrupsion i institucionalizuar,” fenomeni i *state capture* është hiperbolizuar tej kufijve të së arsyeshmes në një kohë që empirikisht kjo gjë është pothuajse e pamundur të matet. Ndërkohë që edhe të dhënat statistikore për nivelet e korrupsionit si raportet vjetore të korrupsionit nga Transparency International bazohen në perceptimet e njerëzve për nivelin dhe shkallën e korrupsionit në institucione të ndryshme shtetërore, sesa në matje reale, të testuara empirikisht nga organe të specializuara. Dhe perceptimi në fakt është diçka shumë subjektive, megjithëse gjerësisht pranohet se korrupsioni në Shqipëri është tejet i përhapur.

Ndërsa përsa i përket prezencës së Mafies dhe krimin të organizuar, këtu kemi të bëjmë me një qerthull vicioz, ku retorika e ndërkombëtarëve ka gjetur një rezonancë të plotë nga klasa politike në Shqipëri, e cila është munduar të kapitalizojë politikisht me “gogolin” e mafies në vend. Për qeverinë aktuale, mitizimi i rolit të mafies dhe krimin të organizuar në shoqërinë shqiptare dhe lidhjet e tyre me politikanë të caktuar (kuptohet të majtë), kanë filluar që kur Partia Demokratike, e cila sot qeveris vendin, ka qenë në opozitë. Atëherë, lideri i kësaj partie dhe kryeministri i vendit akuzonte shefin e Partisë Socialiste dhe kryeministrin e vendit, Fatos Nanon, se ishte i lidhur me “klanin e Zemunit,” apo “Dukën e krimin”, duke iu referuar lidhjeve personale që z.Nano kishte me biznesmenë, që shpesh financonin fushatat e tij. Edhe pas ardhjes në pushtet, Berisha nuk ka hequr dorë nga mitizimi i mafies dhe krimin të organizuar, duke iu atribuar shpesh fuqi, që për një vend të vogël si Shqipëria, me një prezencë të fuqishme ndërkombëtare duken tepër irrealë. Sipas analistit politik, Blendi Kajsio, prodhimi i konceptit të një Mafie të fuqishme në vend bëhet për të unifikuar radhët brenda llojit dhe për të krijuar një front të përbashkët ndaj një armiku të tmerrshëm dhe imagjinar.⁶⁷ Kjo në fakt është karakteristikë pak a shumë e të gjitha vendeve pas-komuniste, siç ka vënë në pah Katherine Verderi. Shpjegimi që autorja në fjalë jep është se njerëzit në këto shoqëri në tranzicion, me probleme të shumta ekonomike dhe infrastrukturore, ju duhet t’u japin një shpjegim logjik gjendjes së tyre të rënduar dhe koncepti i një mafie të gjithpushtetshme që dominon tregun duke e monopolizuar atë, duket si diçka racionale.⁶⁸ Në mënyrë paradoksale, siç ka vënë në dukje studiuesja Shannon Woodcock, në Rumani kjo “mafie” surreale iu mvesh komunitetit Roma, i cili në fakt ishte ‘Tjetri’ për shoqërinë rumune,⁶⁹ sado paradoksale mund të duket kjo, po të marrim parasysh se termat “mafie” apo “krim i organizuar” janë agjenci të specializuara që funksionojnë në baza hierarkike dhe kanë mbi të gjitha kanë një pushtet të fshehur (jo publik). Se si mund të arrijë një komunitet i tërë, për më tepër i disavantazhuar si ai Roma, të krijojë struktura të tilla të sofistikuara, është tërësisht e paimagjinuar, siç Woodcock kritikon me të drejtë. Autorja vazhdon duke theksuar se në këto

⁶⁶ Bunçi, 20. Shih për më gjerë Christina Boswell, “The ‘External Dimension’ of EU Immigration and Asylum Policy”, *International affairs*, Vol.79, No.3, May 2003, p.624.

⁶⁷ Blendi Kajsio. “Në emër të mafies,” gazeta Panorama, 2 prill, 2007.

⁶⁸ Shannon Woodcock, “The Pigan is not a man”: *The Pigan Other as catalyst for Romanian ethnonational identity*. University of Sydney, Department of History, Dissertation for PhD June 2005. p.113

⁶⁹ Ibid

shoqëri: “mafia është një simbol që njerëzit përdorin për të adresuar dhe shprehur ambiguitetin që ata ndjejnë rreth ndryshimeve politike, ekonomike dhe sociale që ata eksperimentojnë në jetën e përditshme”.⁷⁰ Ndërsa Kajsiu, duke iu referuar specifikisht opinionit publik shqiptar shprehet se:

...edhe për qytetarin e thjeshtë mafia është e domosdoshme. Ajo thjeshton kompleksitetin e situatës, eliminon përgjegjësitë individuale, zgjedhjet e gabuara në jetë, vështirësinë për të gjetur punë ose dështimin apo humbjen në biznes, madje edhe në dashuri.⁷¹

Siç shihet, kemi të bëjmë jo vetëm me një retorikë të ndërkombëtarëve, të cilët shpesh kanë njohje sipërfaqësore të realitetit, por edhe me një prodhim për konsum të brendshëm, me një armik imagjinar, që si dikur në komunizëm unifikon radhët e shoqërisë sonë, duke na hequr njëkohësisht edhe peshën e ndjenjës së fajit për këtë tranzicion të pambarimtë që po kalojmë dhe problemet e panumërta që e shoqërojnë. Kjo atmosferë në këmbim bën të mundur krijimin e një klime, ku lideri i qeverisë më pas mundohet që të arrijë të grumbullojë sa më shumë pushtet nën dogmën e luftimit të “gogolit” mafie apo krimi i organizuar dhe korrupsion. Për këtë ai nuk heziton aspak të etiketojë si “hanxharë të mafies” mediat e pavarura, prokurorin e përgjithshëm ta quajë si kryemafiozin e vendit, ndërsa organet e tjera të shtetit si të kapura prej krimit. Në këtë mënyrë, kryeministri luan në lojë me rregullat e ndërkombëtarëve, të cilët shpesh gjejnë të pasqyruara në këtë retorikë një pjesë të mirë të fjalorit politik që përdoret nga ata në raporte të ndryshme. Siç ka vënë në pah Kajsiu në një punim kritik mbi qasjen e ndërkombëtarëve, këtyre të fundit u intereson më tepër stabiliteti se demokratizimi, ndërkohë që elitat politike në Shqipëri i kthejnë në prioritet të vendit tonë shqetësimet apo prioritetet e BE-së, ndërkohë që jo domosdoshmërisht këto përrputhen.⁷² Përsa i takon ligjërimin anti-krimi apo mafie, që është në fokusin e këtij punimi, raportet e BE-së të ne lexohen me lupë, ndërsa më pas BE-ja i referohet diskurrit lokal, që është bazuar mbi raportet e saj për të vërtetuar se krimi dhe mafia janë vërtetë një problem i madh.

Se sa të ekzagjeruar janë raportet që flasin për kapjen e shtetit në Shqipëri, kjo mund të vihet re pa shumë mundim, po të ndërmerret një vështrim krahasues me vendin fqinj të Malit të Zi. Gjatë luftërave në ish-Jugosllavi, por edhe më pas, siç u pranua fillimisht nga ish-Presidenti malazez Bullatovic,⁷³ ky shtet i vogël shkëmbor me vetëm 600 mijë banorë, organizonte një prej trafikeve më të mirëorganizuar nga strukturat shtetërore që qe parë deri atëherë. Thyerja e rregullt e embargos me bekimin e organeve më të larta shtetërore, përfshi presidentin Bullatovic, u bë e mundur me anë të një bashkëpunimi të ngushtë me rrjetet e fuqishme kriminale të vendit, duke i dhënë shtysë formësimit dhe konsolidimit të krimit të organizuar të mirëfilltë, në nivele që Shqipëria nuk ka arritur kurrë t’i emulojë. Kjo ka ndodhur pjesërisht edhe për shkak të një ekspozimi dhe vulnerabiliteti më të madh nga kushtëzimeve që rrjedhin nga partneriteti me partnerët evropianë, sidomos fqinjët italianë dhe grekë, në rastin e Shqipërisë.

Është për t’u theksuar fakti që mediat perëndimore kanë luajtur një rol kritik në përshkrimin e një panorame të ekzagjeruar të kërcënimit të krimit të organizuar shqiptar dhe kanë shërbyer në formësimin dhe ravijëzimin e tendencave raciste në opinionin publik evropian, gjë që më pas ka mundësuar kristalizimin e politikave shpesh diskriminuese dhe aspak realiste të BE-së. Duke hiperbolizuar rrezikun e krimit të organizuar shqiptar dhe duke fajësuar pafuqishmërinë e shqiptarëve për ta luftuar me efikasitet atë, mediat evropiane kanë ndikuar jo pak në perceptimin e elitave që ndërtojnë strategjinë evropianë për këtë pjesë të gadishullit ballkanik.

⁷⁰ Ibid

⁷¹ Kajsiu, ibid

⁷² Shih për një argument të ngjashëm, që i referohet rolit të ndërkombëtarëve (specifikisht BE-së) në proceset e demokratizimit në Shqipëri: Kajsiu, “Integrimi si pengesë për demokratizimin,” Polis 2, Tiranë, 2006.

⁷³ Shih për shembull, “Roli grek në takimin Berisha-Bullatovic,” revista Mapo, nr.32. 22 May 2007.

Rastet janë me qindra, por mjafton të përmendet një artikull i gjatë i shkruar në një revistë gjeopolitike italiane, pak kohë para paraqitjes së planit Ahtisari, e cila e përshkruante Kosovën si një vatër të krimit të organizuar dhe trafikeve dhe bënte thirrje për rrezikshmërinë që do paraqiste ky shtet, nëse i jepej pavarësia.⁷⁴ Influenca e këtij artikulli apo atyre të ngjashëm me artikullin e cituar më lart të Der Spiegel, kanë krijuar një frikë dhe pasiguri ndërmjet evropianëve për një Kosovë të pavarur dhe të keqmenaxhuar, që rrezikon të eksportojë krimin e organizuar jashtë kufijve të saj. Kjo dhe fakti që krimit shqiptar, siç e theksova dhe më sipër, i vishen trajta etnike, bëjnë që opinioni publik evropian të jetë i “tmerruar” nga kërcënimi aspak real i mafies shqiptare. Si mund të mendohet ndryshe kur artikuj të të përditshmeve më prestigjioze angleze si “The Times”, “The Independent”, “The Guardian” apo “The Observer” hapen ndërmjet të tjerash me tituj të tillë si: “Gangsterët shqiptarë marrin kontrollin e rrugëve britanike,” apo “kriminelët ballkanas më të organizuar se ne [anglezët]”.⁷⁵ Siç thekson reporteri Andrew Mueller, një nga të paktët që është treguar deri diku objektiv në paraqitjen e një tabloje reale të Shqipërisë dhe shqiptarëve, situata ka precipituar deri aty sa në shkollat angleze, emërtimi “Albanian” është ekuivalentuar me diçka të papëlqyer apo kriminale.⁷⁶ Një rast të ngjashëm në vëmendjen tonë sjell dhe studiuesja Schwander-Sievers, kur përmend episodin e një studenteje të shkëlqyer shqiptare në Angli, së cilës iu desh të pretendonte fillimisht se qe një italiane, në mënyrë që të arrinte të siguronte një shtëpi me qira. Pronarja e shtëpisë, pasi e mori vesh të vërtetën kur vajza kishte hyrë ndërkohë në apartamentin e ri dhe ishin miqësuar bashkë, i tregoi vajzës se dokumentarët e BBC-së dhe mediumet e tjera mediatikë e kishin “bombarduar: trurin e saj me stigmatizime të tilla si “shqiptarët janë të gjithë kriminelë dhe prostituta”.⁷⁷ Siç tregonte vetë studentja në fjalë, pronarja e shtëpisë ishte habitur më pas se si kishte mundësi që kjo vajzë shqiptare të ishte normale.

Nga ana tjetër, politikanët shqiptarë (kryesisht pala që ka qenë në opozitë) shpesh kanë cituar me mburrje këta artikuj dashakeqës që nxijnë realitetin shqiptar apo raporte të ndryshëm të ndërkombëtarëve, që shpesh na krahasojnë me vende të botës së tretë. Sipas një politikani shqiptar, këto të fundit shpesh bazohen në intervista individuale që përfaqësues të këtyre “ndërkombëtarëve” në Tiranë i kryejnë me pjesëtarë rivalë të klasës politike të vendit.⁷⁸ Duke shfrytëzuar gatishmërinë e politikanëve shqiptarë për të hedhur sa më shumë baltë mbi njëri-tjetrin, këto raporte arrijnë në konkluzione të tilla që shpesh na barasvlerësojnë me Guinenë e Re apo Burkina Fason. Më pas, këto deklarata apo raporte citohen pafundësisht nga politikanët tanë dhe merren si etalone nga ku eskalojnë sulme banale ndaj njëri-tjetrit. Nuk është aspak habi dhe është përsëritur disa herë në arenën e brendshme politike të Shqipërisë në këto 17 vite të pluralizmit që i njëjti raport të përdoret si nga mazhoranca, ashtu edhe nga opozita për të filluar sulme mediatike që jo rrallë përfundojnë (çuditërisht) pa fitues. Duke qenë se lufta politike kryesisht bëhet jo mbi bazë të parimeve normale që funksionojnë në një demokraci të konsoliduar, por mbi bazën e shpifjes ndaj kundërshtarit dhe arritjes të mbështetjes të “ndërkombëtarëve” si kut suksesi, është legjitimuar një sistem i deformuar ku retorika politike rrallë herë u përgjigjet nevojave konkrete të vendit. Në këtë kuadër, siç shprehet një vëzhgues:

Ajo që e kërcënon më së shumti demokracinë shqiptare sot është eliminimi i debatit politik dhe jo institucionet e dobëta. Përqendrimi i tepruar tek retorika luftarake anti-korrupsion, që mjegullon debatin mbi politikat reformuese, është veçse njëri nga shembujt e këtij kërcënimi.⁷⁹

⁷⁴ Shih “Kosova, shteti i mafieve: Mbi shpatullat e Evropës, Një ndarje model, Efekt domino gjer në Kaukaz,” revista Limes, shkurt, 2007. Per referencë aktuale shih gjithashtu Ylli Polovina, “Kosova, përleshja mediatike mes gënjeshtërs dhe te vërtetës,” 16 korrik 2007.

⁷⁵ *Alpion*, 13

⁷⁶ *Ibid*, 21

⁷⁷ Stephanie, Schwander-Sievers, “Albanians, Albanianism and the Strategic Subversion of Stereotypes,” in Andreë Hammond ed. *The Balkans and the West: Constructing the European Other, 1945-2003*. London: Ashgate, 2004. p.112

⁷⁸ Deklaratë e Neritan Cekës, kryetarit e partisë Aleanca Demokratike në emisionin *Opinion* të gazetarit Blendi Fevziu. 26/12/2006.

⁷⁹ Shih Kajsii, *ibid*.

KONKLUZION

Në përfundim të kësaj eseje, që vetëm sa ka cekur një temë që është përmendur gjerësisht, por trajtuar pak apo aspak nga një qasje kritike, dua të theksoj edhe njëherë rrezikun që vjen nga mitizimi i krimit të organizuar shqiptar dhe pamundësinë e klasës politike shqiptare në të dy anët e kufirit për të reaguar ndaj retorikës së “ndërkombëtarëve” në lidhje me të. Siç u shpreh së fundmi një zyrtar i lartë i policisë britanike, kërcënimi i krimit të organizuar shqiptar në Britaninë e Madhe është hiperbolizuar tej kufijve të së arsyeshmes dhe shpesh i janë atribuar padrejtësisht krime të grupeve të tjera mafioze që operojnë në vend.⁸⁰ Për të evidentuar më tepër arritjet ndaj krimit të organizuar në vend dhe parandalimin e eksportimit të tij në vendet e BE-së, qeveria shqiptare duhet të lërë mënjanë retorikën vetasgjësuese dhe dogmatike, të ngrejë bazat e një bashkëpunimi bipartizan për të ndërtuar një kuadër më të plotë ligjor në këtë aspekt dhe të punojë ngushtësisht me institucionet e pavarura (në vend që t’i atakojë ato), për të arritur rezultate konkrete, qoftë në drejtimin e reduktimit të kriminalitetit, qoftë në përmirësimin e imazhit publik të saj. Po ashtu, klasa politike duhet të kuptojë se thjesht plotësimi i kuadrit institucional apo përafrimi i tij me standardet e BE-së (implementimi i *acqui communautaire*) nuk mjafton, por është e nevojshme të zhvillohen edhe politika dhe strategji afatgjata që luftojnë rrënjët nga buron vetë krimi. Këto rrënjë janë varfëria, papunësia apo mungesa e zhvillimit real (investimeve të huaja etj), të cilat në njëfarë mënyrë fermentojnë kriminalitetin.

Përsa i takon palës komunitare, nga të dhënat empirike të paraqitura në këtë punim, del se ndërsa Bashkimi Evropian ka amplifikuar ndjeshëm retorikën kritike ndaj pafuqishmërisë së politikës shqiptare për të luftuar me efikasitet krimin e organizuar, ndërkohë që ka hiperbolizuar këtë të fundit, shumë pak është bërë për krijimin e mekanizmave realë për luftimin me efikasitet të këtij kërcënimi. Gjithashtu, konfuzioni që sjell termi “shqiptarë etnikë” në etiketimin e autorësisë së kriminalitetit, që vjen nga kjo pjesë e Ballkanit, nuk shërben për asgjë, përveçse një perceptimi të gabuar të ngritur mbi premisa irrealë.

Për të përballuar në mënyrë adekuate kërcënimin e krimit të organizuar shqiptar, mendoj se BE-ja duhet të zhvillojë politika afatgjata konkrete që të sigurohet se asnjë “vrimë e zezë” nuk do vazhdojë të ekzistojë në “derën e pasme” të saj, prej nga ku krimi i organizuar mund të lulëzojë. Akoma më tej, BE-ja duhet të nxisë dhe motivojë reforma konkrete nga vende si Shqipëria, ashtu sikundër duhet të njohë përpjekjet reale të qeverive shqiptare për të luftuar trajektoren e krimit kur këto evidentohen. Për ta bërë këtë, BE-së i duhet të përdorë edhe “karotat” e saj, pasi vetëm “shkopinjte” nuk mund të arrijnë rezultate të qenësishme dhe të qëndrueshme. Vetëm nëpërmjet bashkëpunimit, ndarjes së informacionit dhe vullnetit të fortë multilateral mundet që BE-ja të asistojë konkretisht luftën ndaj krimit të organizuar dhe mafies në vend dhe mundësinë e një integrimi sa më të shpejtë të Shqipërisë në strukturat euro-atlantike.

⁸⁰ Shih “Deklaratë e shefit të policisë angleze në lidhje me kriminalitetin shqiptar,” *Balkanweb*, 30/05/2007.

BIBLIOGRAFIA

Europol: Europol Annual Report 2005, The Hague, 22 March 2006,

File nr: 1423-39r2 (#166073). Doënloaded from:

www.statewatch.org/news/2006/apr/europol-report-2005.pdf

Europol: 2003 European Union organized crime report. Doënloaded from:

www.statewatch.org/news/2006/apr/europol-report-2005.pdf

Council of the European Union. 2005 EU Organised Crime Report: Public Version. Brussels, 17 November 2005.

The EU's response to Organised Crime. Taken from: C:\Documents and Settings\new user\Desktop\Org. crime_files\The EU's Response To Organised Crime.mht, 12/03/2007.

“EU-Western Balkans Forum, *JHA Ministerial Meeting Brussels*, 28 November 2003. *Joint Conclusions*. SN 3559/1/03, REV 1. Brussels, 28 November 2003.

Official Bulletin of the Republic of Albania: A Publication of the Centre for Official Publications. Doënloaded from: www.legjislacionishqiptar.gov.al, March 10, 2007.

The Status Issue Looms. Transitions Online, 5/19/2003. Downloaded from: C:\Documents and Settings\neë user\Desktop\Org. crime_files\KOS 1.mht

Stability and prosperity: key steps in Albania's European Union vocation. Downloaded from: C:\Documents and Settings\neë user\Desktop\Org. crime_files\European Policy Centre Website.mht. Last accessed: 20 Feb. 2007.

Shannon Woodcock, “The Bigan is not a man”: The Bigan Other as catalyst for Romanian ethnonational identity. University of Sydney, Department of History, Dissertation for PhD June 2005.

Stephanie, Schwander-Sievers, “Albanians, Albanianism and the Strategic Subversion of Stereotypes,” in Andreë Hammond ed. *The Balkans and the West: Constructing the European Other, 1945-2003*. London: Ashgate, 2004.

Official Bulletin of the Republic of Albania: A Publication of the Centre for Official Publications. Doënloaded from: www.legjislacionishqiptar.gov.al, March 10, 2007.

U.S.A. report for the money laundering in Albania. *Shekulli* 03/03/2007. Taken from: C:\Documents and Settings\new user\Desktop\Raporti i SHBA-se.mht

Bumci, Aldo. “Çështje të Sigurisë Kombëtare,” *Instituti i Studimeve Ndërkombëtare*, Tirane, 2004.

Trimceç, Eno. “Nations in Transit 2006,” Freedom House. Budapest: AQUINCUM Publishing, 2006.p.72.

Sulstarova, Enis. Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja. Tirane: Dudaj, 2006.

Kajsiu, Blendi. “Në emër të mafies,” *gazeta Panorama*, 2 prill, 2007.

Kalemaj, Ilir. “Politika Largpamese,” *gazeta Standard*, prill 2007.

Cena, Artan. “Në Shqipëri mafia mbështetet nga politika,” *gazeta Koha Jonë*, 31 Maj 2007. <http://www.kohajone.com/artikull.php?idm=5844>
Aksesuar së fundmi nga 01/07/2007.

Qoraj, Artan. “Ne Shqipëri nuk ka mafia, por grupe që e imitojnë,” *Koha Jone*, 15 Maj 2007. http://kohajone.com/artikull_print.php?idm=5960
Aksesuar me 02/07/2007.

Lucarelli, Sonia and Roberto Menotti, 2006: ‘The Use of Force as Coercive Intervention’, in Sonia Lucarelli and Ian Manners, eds, *Values and Principles in European Union Foreign Policy*, London: Routledge, pp.147-63.

Roberto Morozzo della Rocca, *Shqipëria: rrënjët e krizës*, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2000.

Mill, John Stuart. "Considerations on Representative Government", in Utilitarianism, *Liberty, Representative Government*, ed. H. Acton. London: J.M. Dent, 1972.

Smith, Anthony D. "Nations and Nationalism in a Global Era," Oxford: Polity Press, 1998.

Bhabha, Homi (ed.): *Nations and Narration*. London and New York: Routledge, 1990.

Robelli, Enver. A sëord over Kosovo's freedom. Taken from "Shekulli", the Albanian biggest daily newspaper. Q & A EU Enlargement. Downloaded from: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/2266385.stm> Last accessed: 03/02/2007.

Sokoli, Leke. "The freezing of the Albanian laëgiver," *Tirana Observer*, Monday, February 26, 2007.

"Kosova, shteti i mafieve: Mbi shpatullat e Evropës, një ndarje model, efekt domino gjer në Kaukaz," revista *Limes*, shkurt, 2007.

Arsovska, Jana. "The evolution of Albanian organized crime groups". Law presentation for the Catholic University Leuven-Belgium.

Smith, Helena. "Angry Kosovars Call on 'Colonial' UN Occupying Force To Leave," *The Observer*, 19 October 2003, 21.

Bogue, Janet. FDCH Congressional Testimony; 05/21/2003. Downloaded from: C:\Documents and Settings\new user\Desktop\Org. crime_files\KOC.mht, last accessed on 18/03/2007.

Lehne, Stefan. "Has the 'Hour of Europe' come at last? The EU's strategy for the Balkans," in the Franz Lothar Altmann et al. "The Western Balkans: moving on". Judy Batt ed. *Chaillot paper*, n.70. Oct.2004. pp.121-122.

Moore, Patrick. "Western Balkans: Is there life outside the EU?" Sept. 16, 2005. Downloaded from: <http://www.rferl.org/featuresarticle/2005/09/0189a1b5-e9a4-469d-8ad6-1e876b5b572f.html>

Peshkopia, Ridvan. "The Limits of Conditionality". *Southeast European Politics*, July 2005, Vol. VI, No.1, 46.

"Roli grek ne takimin Berisha-Bullatovic," revista *Mapo*, nr.32. 22 May 2007.

A. J. K. Shepherd, "Irrelevant or Indispensable? ESDP, the 'War on Terror' and the fallout from Iraq," *International Politics* 43: 71-92, 2006.

NDIKIMI I NDËRKOMBËTARËVE NËPËRMJET ORGANIZATAVE JOQEVERITARE NË PROCESIN E ZHVILLIMIT

Blerta Picari*

Abstrakt. Qëllimi i kësaj eseje është të shqyrtojë ndikimin që kanë pasur organizatat joqeveritare/jofitimprurëse (OJQ/OJF) në procesin e demokratizimit të vendit, sikurse dhe burimet e tyre të vetme të financimit, donatorët e huaj dhe politikat e tyre në lidhje me sektorin e OJF-ve në Shqipëri. Për të paraqitur një panoramë sa më të plotë është analizuar dhe mjedisi i brendshëm i vetë këtyre organizatave sikurse dhe marrëdhëniet e tyre me njëra-tjetrën, me qeverinë dhe me publikun. Analiza e kryer nxjerr në pah tezën se OJF-të në Shqipëri nuk janë krijuar dhe nuk funksionojnë në një mjedis të jashtëm dhe të brendshëm demokratik dhe si rrjedhojë nuk kanë ndikuar pozitivisht në procesin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendit. Ndryshimet e bëra kanë qenë sporadike, pasi ka munguar një bashkërendim i veprimtarive të tyre për të arritur një zhvillim në rritje dhe uniform.

Tranzicioni është gjithashtu një biznes dhe me gjithë shpërdorimin, mungesën e efikasitetit dhe mistifikimin që e shoqëron, është e qartë që ka një sasi të bollshme përfitimi.
(Sampson, 1996:128)

Tranzicioni si mënyrë e të jetuarit është brendësuar nga popullsia shqiptare si pjesë e pandashme e ekzistencës që nga rënia e diktaturës komuniste. Vetë ky term nënkupton procesin e zhvillimit që ndodh për t'u "integruar" në botën perëndimore dhe ekonominë botërore, për t'u pranuar më në fund si pjesë e saj. Pritja e vazhdueshme për t'u "integruar" ka pasur karakteristikat e saj, por qëllimi i kësaj eseje është të shqyrtojë ndikimin që kanë pasur organizatat joqeveritare/jofitimprurëse (OJQ/OJF) të shoqërisë civile në procesin e demokratizimit të vendit sikurse dhe burimet e tyre të vetme të financimit, donatorët e huaj dhe politikat e tyre në lidhje me sektorin e OJF-ve në Shqipëri. Shoqëria civile përbëhet nga dy nivele. I pari përbën mundësinë e njerëzve për t'u bashkuar me vullnet të lirë në shoqata për qëllime të veçanta, ndërsa i dyti mbështetet në gatishmërinë e njerëzve (individë apo grupe) për të kritikuar në mënyrë të pavarur ushtrimin e pushtetit të qeverisë, partive, biznesit, institucioneve fetare si dhe të shprehin opinionet e tyre të pavarura mbi politikat e ndërmarra. Shoqëria civile është e rëndësishme, pasi është e domosdoshme në funksionimin e një shoqërie të lirë e demokratike (Clunies-Ross&Sudar ed., 1998:140). Ekzistenca e një shoqërie civile funksionale mundëson që zërat e grupeve të caktuara, të nënpërfaqësuar, si p.sh. pakicat, gratë, fëmijët, etj., të kenë mundësi të dëgjohen dhe të organizohen vetë në shoqata biznesi apo në interes të të rinjve, fëmijëve, grave, etj., në OJF, të cilat do të kryenin rolin e ndërmjetësuesit në përfaqësim. Duhet theksuar se shoqëria civile është teorizim dhe praktikë perëndimore duke iu referuar një sistemi të veçantë njohurish, praktikash dhe konstruktesh shoqërore që mishërojnë modelin liberal-individualist dhe përvetësimi

* Blerta Picari ka mbaruar studimet universitare në Shtetet e Bashkuara për Shkenca Politike dhe Menaxhim Biznesi. Ajo ka përfunduar gjithashtu një Master për Zhvillim Ndërkombëtar pranë Universitetit të Bolonjës në Itali. Blerta ka punuar në organizata jofitimprurëse në Shtetet e Bashkuara dhe në Shqipëri. Që prej dy vjetësh ajo është pedagoge e brendshme në Seksionin e Shkencave Politike pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës.

kulturor i këtij koncepti në vendet joperëndimore ka mundësi të kthehet në një qëllim për të “importuar një model të politizuar, të stabilizuar, hegjemon të një shoqërie (më) të qytetëruar ku askush nuk vlerësohet si i tillë” (Mai, 1999:207).

Metodologjia bazë e përdorur ka qenë hulumtimi në literaturë duke u bazuar në artikuj, raporte dhe intervista të kryera më parë mbi këtë çështje gjatë eksperiencës personale si pjesëtare e shoqërisë civile. Është e rëndësishme të theksohet se për sa i përket vlerësimit të ecurisë së OJF-ve në Shqipëri ekziston një literaturë tepër e ngushtë dhe përveç disa vlerësimeve individuale, nuk ka pasur raporte të thelluara mbi punën e kryer prej tyre gjatë këtyre viteve. Ky ka qenë problemi kryesor në shkrimin e kësaj eseje. Kriteret me të cilat analizohet ndikimi i OJF-ve në Shqipëri bazohet në disa tregues kyç të tyre, siç janë: mjedisi ku operojnë, kapaciteti i organizatës, qëndrueshmëria financiare, funksionimi në rrjete dhe grupe presioni, shërbimet e ofruara sikurse dhe imazhi që i përcillet publikut (The 2005 NGO Sustainability Index, 2006: 40). Analiza e kryer më poshtë nxjerr në pah tezën se OJF-të në Shqipëri nuk janë krijuar dhe nuk funksionojnë në një mjedis të jashtëm dhe të brendshëm demokratik dhe si rrjedhojë nuk kanë ndikuar pozitivisht në procesin e zhvillimit dhe demokratizimit të vendit. Ndryshimet e bëra kanë qenë sporadike, pasi ka munguar një bashkërendim i veprimtarive të tyre për të arritur një zhvillim në rritje dhe uniform.

Në mënyrë që të bëhet një analizë sa më objektive, është parë e rëndësishme që të trajtohen të gjithë faktorët ndikues dhe të mos shihet problemi vetëm nga mangësitë e modeleve të zhvillimit të sjella nga donatorët e huaj. Përgjatë esesë, trajtohet çështja duke i parë OJF-të të ndikuara nga mjedisi i jashtëm që ndahet në disa fusha: OJF-të si njësi të ndikuara dhe të ndjeshme ndaj politikave të donatorëve sikurse dhe si njësi ndikuese ku përfituesi është publiku; së dyti, ndikimi në procesin e demokratizimit vjen dhe nëpërmjet shembullit personal të vetë OJF-ve, nëpërmjet nivelit të demokratizimit të brendshëm të organizatave, nga i cili duhet të fillojë ndryshimi dhe që tregohet nëpërmjet transparencës financiare, përfshirjes së anëtarëve në procesin e vendimmarrjes dhe të përfaqësimit në publik. Për më tej ato janë analizuar dhe në marrëdhënie me njëra-tjetrën dhe me qeverinë. Këto nivele ndikimi janë ndërthurur ngushtë me njëri-tjetrin duke i dhënë formë situatës së sotme.

OJF-TË DHE DONATORËT E HUAJ

Procesi i zhvillimit (me këtë term i referohem periudhës së tranzicionit) në Shqipëri ashtu si dhe në çdo vend tjetër të Evropës Lindore dhe Qendrore është shoqëruar me hapjen e ekonomisë dhe “demokratizimin” e institucioneve dhe shoqërisë me ndihmën e shprehur nëpërmjet huave dhe fondeve të organizatave ndërkombëtare si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Fondacioni Soros, Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian, etj.

Qëllimi i fondeve të dhëna nga organizatat ndërkombëtare ka qenë zhvillimi i OJF-ve dhe i qëndrueshmërisë së tyre në Shqipëri, pavarësisht nëse kanë mundur ta përmbushin atë apo jo. Po të mos kishin qenë donatorët e huaj, në Shqipëri do të kishte një numër shumë të kufizuar OJF-sh, pasi kanë qenë donatorët që kanë mbështetur financiarisht pjesën më të madhe të tyre. Shuma të konsiderueshme parash janë derdhur në vend me idenë se vendet në zhvillim kanë nevojë për ndihmë financiare sikurse dhe për modelet dhe ekspertizën e organizatës që i transmeton ato (Stiglitz, 2003: 22-35). Kjo ndodh për shkak se vetë organizatat ndërkombëtare përfitojnë nga nevoja për zhvillim dhe procesi i tejzgjatur i tranzicionit pasi në to punësohet një numër i tepërt burokratësh të niveleve të ndryshme, blihen teknologjitë më të fundit dhe udhëtohet nëpër vendet më ekzotike të planetit (Sampson, 1996: 141). Zhvillimi, si proces, si për vendet e pazhvilluara edhe për ato të zhvilluara, është një cikël ndërveprimesh bankare me qëllimin për të qenë fitimprurës për të dyja palët. Por që një gjë e tillë të funksionojë duhet që të dyja palët të investojnë sipas

kushteve të tyre për të vjelë përfitimet (Stiglitz, 2003:34). Mirëpo përfitimi i ndërsjellë nuk është arritur në Shqipëri, ku është krijuar një varësi ndaj donatorëve të huaj (The 2005 NGO Sustainability Index, 2006: 41) në mungesë të mbështetjes financiare të qeverisë qendrore dhe vendore për shërbimet që ofrojnë OJF-të. Donatorët kanë vazhduar të japin para dhe të huazojnë vazhdimisht ekspertët e tyre, dhe jo të përqendrohen në përmirësimin e kapitalit njerëzor të vendit, duke transferuar njohuritë dhe teknologjitë në komunitetin që ka nevojë për to (Klosi, 1997:61).

Vetë koncepti i “integritit”, siç u përmend më parë, është bazuar në idenë se tranzicioni është periudha që duhet për t’u bërë pjesë e Evropës Perëndimore dhe se procesi i zhvillimit me projektet e tij duhet ndjekur rigorozisht bazuar në programet e donatorëve të huaj dhe organizatave ndërkombëtare për të përfutur eksperiencën perëndimore. Problemi fillestar qëndron në mundësimin e krijimit të një shoqërie civile pa futur më parë në të mënyrat e të menduarit demokratik, për ta kuptuar atë pasi shoqëria civile nuk mund të ekzistojë e izoluar nga konteksti ku vepron. Pra, “modelet” e marra për t’u përmbushur gjatë procesit të zhvillimit kopjohen nga vendet e zhvilluara dhe importohen në vendet në zhvillim duke anashkaluar kontekstin apo nevojat më thelbësore të vendit në të cilin zbatohen (Sampson, 1996:123). Për shembull, pretendohet nga donatorët, sidomos Bashkimi Evropian, Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, se për një vend si Shqipëria është e mjaftueshme që të merret një ligj nga vendet e zhvilluara dhe të përkthehet për t’u vendosur në fletoren zyrtare. Rast konkret është ligji për barazi gjinore, pjesë të mëdha të së cilit janë “huazuar” nga Konventa të Kombeve të Bashkuara për t’u zbatuar në Shqipëri. Për të mundësuar zbatimin e këtij ligji duhen vlerësuar pikësëpari konteksti ku aplikohet dhe të konsolidohen institucionet dhe mekanizmat e zbatimit të tij, përndryshe ai bëhet tërësisht i pavlerë, siç edhe ka ndodhur që prej vitit 2004 kur ky ligj u miratua.

Transferimi i modeleve nga perëndimi në lindje përbën një mori lëvizjesh njerëzish që trajnohen dhe trajnojnë duke përqendruar kështu njohuritë në një grup të veçantë individësh të privilegjuar. Thuhet të privilegjuar, pasi të bësh pjesë në OJF-të dhe shoqërinë civile në Shqipëri, duhet medoemos të flasësh minimalisht shumë mirë gjuhën angleze, të kesh arsimin e lartë dhe kontakte të shumta (Sampson, 1996: 136). Duke i pasur këto, automatikisht individit nuk është më pjesë e njerëzve të thjeshtë. Si pasojë, njohuritë mbi menaxhimin e projekteve, fondeve, zhvillimit organizativ mbeten brenda për brenda OJF-ve dhe nuk “derdhen” në pjesën tjetër të shoqërisë, duke izoluar kështu organizatat nga vetë përfituesit e tyre. Duke mos pasur një marrëdhënie shkëmbimi të drejtpërdrejtë me publikun, njohuritë e marra nuk transmetohen tek individët që në fund të fundit duhet t’i përdorin ato. Si pasojë, në vend që të kemi një shpërndarje uniforme të njohurive dhe praktikave, kemi disa “oaze” që funksionojnë të izoluar. Një gjë e tillë ndodh dhe për faktin që burimet financiare në dispozicion janë të kufizuara dhe OJF-të e përfshira përpiqen të mbijetojnë në botën konkurruese të projekteve.

Një pjesë e mirë e modeleve që transmetohen nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht problematikën e brendshme dhe nevojat vendase dhe për vetë faktin që shumica e OJQ-ve, të cilat janë të detyruara të mbijetojnë financiarisht, predispozohen të ndjekin dëshirat dhe projektet e gatshme të donatorëve, pasi mungon mbështetja financiare nga pushteti vendor (Mai, 1999:218). Me demokracinë dhe strukturat demokratike është eksperimentuar në Shqipëri, pasi mungon mjedisi i përshtatshëm shoqëror dhe ekonomik për t’i krijuar ato, duke bërë që shpesh teoritë dhe praktikatat demokratike të brendësohen si “një modë për t’u kopjuar”, kur në të vërtetë duhet të kuptohet rëndësia e tyre në mjedisin politik dhe kulturor ku aplikohen (Mai, 1999:213). Si rrjedhojë, pak projekte janë të qëndrueshme në terma afatgjatë në momentin kur largohen donatorët, sepse me ta largohen fondet dhe aksesit ndaj shumë burimeve. Gjithashtu, mungesa e mbështetjes të OJF-ve nga ana e pushtetit vendor krijon hendeqe të jashtëzakonshme në mundësinë për të konkurruar për fonde dhe për të ofruar shërbime që mungojnë në qytete dhe fshatra. Si pasojë, projektet ekzistojnë sa ekzistojnë donatorët dhe e gjithë puna e kryer venitet në pak kohë kur largohet donatori. Ka pasur pak raste të shembujve konkretë

pozitivë që pasqyrojnë politikat e donatorëve, ndër të cilët mund të përmendim buxhetimin me pjesëmarrje që është zbatuar deri më sot vetëm nga Bashkia e Kuçovës dhe e Elbasanit. Ky model ka mundësuar marrjen në konsideratë të problematikës vendore dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në proces. Normalisht rezultatet kërkojnë kohë, por ky model u mundëson aktorëve të përfshirë në proces (përfshirë edhe OJF-të që ofrojnë shërbime) të pasqyrojnë interesat e tyre në terma të prekshëm dhe afatgjatë.

Nuk mund të mohojmë se ekspertiza e huaj për çështje ku ne nuk kemi përvojë është më se e domosdoshme dhe e mirëpritur, pasi vendet e zhvilluara kanë eksperiencë më të gjerë në hartimin dhe zbatimin e ligjeve, konsolidimin e institucioneve dhe përmirësimin e praktikave ekzistuese. Problemi që duhet shmangur është pikërisht kur fondet e dhëna u rikthehen sërish në mënyrë indirekte po atyre organizatave dhe donatorëve që kanë kontribuar në projektet e zhvillimit. Me parimin e “transferimit të njohurive dhe ekspertizës” apo të shumëqajturat “trajnime” janë kontraktuar me qindra “ekspertë” të huaj, që dëgjojnë për herë të parë mbi Shqipërinë vetëm një javë para se të fillojë trajnimi, dhe paguhen me shuma marramendëse për t’u folur për të dhjetën herë, p.sh. grave avokate që mbrojnë në gjyq gratë e dhunuara, se çfarë është dhuna në familje.

Për më tepër, pjesëmarrësit në trajnimet për ngritjen e kapaciteteve janë shpesh të njëjtët njerëz që përfitojnë vazhdimisht prej tyre. Si rrjedhojë, trajnimet e zhvilluara në kushtet e mungesës së njohjes së kontekstit ku veprohet dhe përsëritjes së veprimtarive të njëjta me po të njëjtët njerëz, bëjnë që të zhvlerësohet qëllimi i tyre parësor i përgatitjes së profesionistëve dhe kthehen thjesht në qëllim në vetvete si në një procedurë formale, gjë që është konstatuar nga vlerësimet e bëra nga pjesëmarrësit në fund të shumë aktiviteve të kësaj natyre. Si përfundim, pas tri ditësh trajnimi, trajnuesi/ja merr zarfin me para dhe largohet i/e kënaqur nga Shqipëria se “ndërgjegjësoi” gratë në vendet në zhvillim, ndërsa OJF-ja që zbatoi projektin dhe donatorët që e mbështetën financiarisht atë, ndihen gjithashtu të kënaqur se kështu mund ta deklarojnë projektin të realizuar me sukses dhe për këtë të mburren para të tjerëve për efektshmërinë e projekteve të tyre. Si rezultat, shuma të mëdha parash janë shpenzuar për trajnimet e dhëna ndaj OJF-ve, duke përfshirë trajnime mbi ndërtimin e koalicioneve, lobimin, luftën kundër korrupsionit dhe qëndrueshmërisë afatgjatë, por aplikimet e tyre në procesin e zhvillimit kanë qenë të pakta (Për më shumë informacion mbi trajnimet shih: Partners Albania, 2005). Pavarësisht nga zbatueshmëria dhe efektshmëria e tyre, trajnimet vazhdojnë dhe paratë shpenzohen për të trajnuar të njëjtët njerëz, gjë që tregon se zhvillimi i qëndrueshëm i OJQ-ve deri më sot nuk është një çështje e prekshme në Shqipëri (The 2005 NGO Sustainability Index, 2006: 40-41). Rrjedhimisht, kjo bën që strukturat që duhet të demokratizohen dhe të konsolidohen për të funksionuar në një shoqëri demokratike të dështojnë në praktikën e tyre.

Në mënyrë të justifikuar, çdo donator i huaj, qoftë organizatë ndërkombëtare apo agjenci që përfaqëson ndihmën e një shteti të caktuar, kërkon të “mburret” me projektet dhe ndihmën e dhënë gjatë procesit të zhvillimit në Shqipëri apo gjetkë. Për këtë arsye ato ruajnë me fanatizëm projektet dhe ekspertët e tyre, duke i bërë ato publike vetëm kur janë në fazë të përparuar kohore dhe kur rezultatet mund të tregohen me shifra. Si rezultat, me qindra projekte të njëjta janë mbështetur nga donatorë të ndryshëm, duke mos pasur informacion mbi njëri-tjetrin apo thjesht duke konkurruar për të qenë sa më të suksesshëm. Një nga rastet më konkrete që mund të përmendet këtu janë projektet e shumta për studime, trajnime ndërgjegjësuese dhe vlerësimet nevojash mbi varfërinë, papunësinë, dhunën ndaj grave apo në familje, mbi procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, mbi perceptimin e popullatës mbi korrupsionin, etj., që në fund të fundit ofrojnë shumë pak të dhëna statistikore reale. Normalisht që studimet janë të domosdoshme, por duhet krijuar një drejtpeshim ndërmjet punës në terren dhe asaj studimore pasi mbingarkesa e të dytës nuk sjell ndryshime të prekshme për publikun e gjerë.

Për më tepër, procedurat e përzgjedhjes së OJF-ve, të cilat zbatojnë projektet e donatorëve, janë gjithashtu të diskutueshme. Në ditët e sotme, 17 vjet më pas, ashtu sikurse në fillimet e tranzicionit, ende shihet

qartë se lidhjet dhe marrëdhëniet personale dhe përputhja e karakterit ndërmjet donatorëve dhe pjesëtarëve të OJF-ve janë të fuqishme (Sampson, 1996: 138) dhe shpesh arrijnë deri aty sa të hedhin poshtë procedurën zyrtare të aplikimit për projekte. Ka pasur jo pak raste kur donatorët e kanë vetë të qartë se me cilën OJF duan të bashkëpunojnë dhe anashkalojnë rrugën institucionale për të shpërndarë informacionin mbi kriteret e përzgjedhjes së OJF-ve të tjera kur duan të ndërmarrin zbatimin e një projekti të ri. Nuk synohet të ketë një menaxhim demokratik të kundërshtimeve dhe dallimeve në këndvështrim, strategji dhe praktika mbi hartimin dhe zbatimin e projekteve, por një imponim të tyre me forcë duke shpërfillur aspektet e tjera (Mai, 1999: 214). Në çastin kur donatorët përpiqen të konsolidojnë institucionet dhe të vënë në veprim shtetin ligjor, kjo qasje informale hedh poshtë të gjitha parimet e shkruara kaq pastër në letër.

Diskutimi i mësipërm parashtroi se si donatorët kanë ndikuar gjatë procesit të zhvillimit në krijimin e një mjedisi “demokratik” ku mund të operojnë OJF-të shqiptare. Struktura të tilla të pakonsoliduara është e vështirë të ndihmojnë në procesin e demokratizimit të vendit, pasi varësia financiare e krijuar nga donatorët e huaj dhe mungesa e fondeve të pushtetit vendor të ndërthurura me problemet e hasura në transmetimin e modeleve dhe menaxhimin e fondeve, krijojnë struktura dhe praktika të paqëndrueshme. Për pasojë, “... ky model zhvillimi i shoqërisë civile sjell me vete rrezikun e rforcimit të një dinamike tashmë ekzistuese, të thjeshtëzimit dhe të idealizimit jokritik të koncepteve dhe sistemeve të mendimit, të cilët nuk mund të përvetësohen në krejt pasurinë dhe aspektet fuqizuese të tyre, nëse nuk kundërbalancohen nga një autonomi financiare dhe kulturore” (Mai, 1999:218). Vetëm OJF-të e konsoliduara mirë në strukturën dhe qëllimet e tyre dhe që mbartin interesat vendore e kanë më të lehtë të llobojnë në politikë dhe pranë institucioneve përkatëse, pasi i kanë mundësitë, mekanizmat dhe pushtetin për ta bërë një gjë të tillë, analizë të cilën e kemi shtjelluar më poshtë.

ORGANIZIMI I OJF-VE SHQIPTARE, VENDIMMARRJA DHE BURIMET NJERËZORE BRENDIA TYRE

Për të kuptuar nivelin e suksesit të OJF-ve në procesin e zhvillimit, është e domosdoshme të trajtohen problemet që ekzistojnë gjithashtu në menaxhimin e brendshëm të tyre. Së pari, duhet theksuar se nëse një organizatë nuk ka demokratizim të brendshëm, atëherë është e vështirë të marrë pjesë në një proces demokratizimi në tërësi, pasi mungojnë kriteret bazë të zhvillimit: bashkëpunimi reciprok dhe i qëndrueshëm, pjesëmarrja në procesin e zhvillimit dhe vendimmarrje sikurse dhe shumë e rëndësishmja, transparencë financiare ndaj palëve të përfshira.

Për ta hapur analizën e brendshme të menaxhimit të OJF-ve, duhet filluar patjetër me transparencën financiare, çështje kjo shumë e debatueshme dhe ku nuk pa pasur shumë zhvillim vitet e fundit. Deri tani janë konstatuar interpretime të ndryshme të ligjit, sidomos aty ku vihen re mangësi në specifikimet financiare (The 2005 NGO Sustainability Index, 2006: 40-41). Sipas Ligjit Nr. 8788 datë 7.5.2001 “Për Organizatat Jo-Fitimprurëse” të legjislacionit shqiptar, OJF-ve nuk u është kërkuar të raportojnë në mënyrë të detajuar qarkullimin e parave në bazë vjetore, siç ndodh në shumë vende të botës. Pra, mungon një nga parimet kryesore demokratike, transparenca. Madje edhe procesi i auditimit bëhet vetëm nëse donatori/ët e kërkojnë një gjë të tillë. Vetëm këtë vit (2007), ka dalë për herë të parë një urdhëresë nga qeveria shqiptare, që u kërkon OJF-ve të dorëzojnë në fund të vitit një raport financiar, zbatimin e të cilës i mbetet kohës.

Ndërmjet OJF-ve gjithashtu nuk ekziston madje asnjë kod etik për të siguruar pritshmëri të njëjta në mbarëvajtjen dhe praktikën e tyre të përditshme. Në mungesë të një raportimi rigoroz krijohet gjithmonë hapësirë për abuzime financiare. Spekulumet të shumta bëhen nga publiku teksa shohin që një pjesë e drejtuesve të OJF-ve kanë disa shtëpi dhe jetojnë një jetë shumë më të shtrenjtë sesa mund t’u lejohet nga pagat e deklaruara donatorëve dhe publikut. Mungesa e transparencës nuk ndodh vetëm përkundrejt donatorëve,

por edhe ndaj publikut dhe stafit. Numri i OJF-ve që botojnë raporte vjetore dhe i bëjnë të disponueshme të dhënat ndaj kujt do nuk shkon përtej gishtave të një dore. Arrihet deri aty sa projektet e shkruara fitohen dhe zbatohen dhe vetë personeli që i kryen ato nuk ka akses ndaj buxhetit të projektit. OJF-të ndryshojnë nga strukturat e tjera politike apo të biznesit, ku kontrolli është më i rreptë dhe më i drejtpërdrejtë nga ana e elektoratit apo aksionerëve. Dhe është pikërisht mungesa e kësaj llogaridhënieje që lë hapësirë për interpretime të ndryshme. Nuk ka pasur deri tani ndonjë sondazh të perceptimit publik ndaj OJF-ve për të vërtetuar nivelin e tyre të besueshmërisë, ndoshta për vetë faktin se OJF-të kanë frikë nga rezultatet e mundshme të këtij lloji sondazhi. Përgjegjësia në llogaridhënie dhe transparencë financiare mundësojnë përmirësimin e statusit të një organizate në publik, pasi në bashkëpunim me objektivitetin në përfaqësimin e interesave të publikut legjitimojnë veprimtarinë e vetë OJF-së.

Së dyti, duhet folur për vendimmarrjen brenda për brenda OJF-ve, e cila është e ngurtë dhe jo përfshirëse (La Cava&Nanetti, 2000:39-40), pasi në shumicën e rasteve OJF-ja njihet nga figura kryesore e saj, drejtori/esha, pasi ky/kjo i/e fundit është edhe personi që në shumicën e rasteve është më aktiv në publik dhe ngre fondet, gjë me të cilën mund të abuzohet duke përfutur nëpërmjet përfshirjes në projekte personale (Sampson, 1996:135). Vetë ky fakt nuk përbën një organizim demokratik brenda për brenda strukturës, pasi përfaqësimi në publik nëpërmjet fytyrës së një personi është tërësisht diktatorial dhe reflekton mungesën e përfshirjes së pjesës tjetër të stafit. Madje dhe detyrat dhe aktivitetet u përcaktohen secilit anëtar të stafit me të cilin drejtori/esha ka marrëdhënie të drejtpërdrejtë, të pandërmjetësuar. Kjo mënyrë veprimi e centralizuar ecën paralel me mbledhjet e rregullta të stafit, ku “çështjet e projektuara dhe të vendosura diku tjetër, më në fund publikohen dhe u komunikohen një grupi njerëzish që punojnë së bashku” (Mai, 1999:214). Bordet e OJF-ve që në letër operojnë në baza vullnetare nuk janë realisht aktivë në marrjen e vendimeve (Mai, 1999: 213). Në këtë aspekt, OJF-të shihen nga publiku si biznese private dhe për nga mënyra e udhëheqjes ngajnë shumë me partitë politike shqiptare.

Mund të thuhet se mënyra diktatoriale e vendimmarrjes është trashëgimi e periudhës komuniste dhe këto janë modelet e trashëguara. Përpos të gjitha problemeve të tjera të diskutuara më sipër, ky është një nga më thelbësorët (Qirjako&Dhimitri, 2000:155). Tranzicioni po vazhdon dhe të njëjtat kopje të shëmtuara udhëheqjeje transmetohen nga njëri brez tek tjetri, pavarësisht trajnimeve të shumta në plot vende të botës, brenda vetë shoqërisë civile që pretendohet se duhet të jetë pioniere në demokratizimin e shoqërisë. Për shembull, kur kërkon një takim pune apo fton në një të tillë një nga punonjësit e OJF-së duhet lajmëruar më parë drejtori dhe të japë miratimin e tij. Ose ku në momentin që haset mosaprovim nga anëtarët e stafit për një vendim të marrë ose aktivitet të projekteve, që zakonisht është i marrë nga drejtuesi i OJF-së, interpretohet sikur të ishte një teori e ndërlikuar konspiracioni për të kundërshtuar politikën e OJF-së. E njëjta gjë ndodh dhe në rastin kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet OJF-ve. Strukturat demokratike krijohen dhe funksionojnë në bazë të pranimit dhe vlerësimit të tjetrit, duke përfshirë dhe diskutuar mbi ndryshimet dhe jo thjesht duke i zhvlerësuar ato kur bien ndesh me këndvështrimet e individit vendimmarrës brenda organizatës. Është e vështirë kësaj që një organizatë të mund të kërkojë zbatimin e projekteve dhe të ndihmojë në procesin e demokratizimit, nëse vetë nuk është e tillë.

Për të vazhduar më tutje, mund të përqendrohemi dhe në një aspekt teknik dhe ligjor të kontraktimit të punonjësve. Ka plot OJF, të cilat raportojnë një numër më të ulët të stafit ekzistues, për të mos paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, para që janë të paguara në buxhetin e projektit, por që “arkëtohen” dhe humbasin diku në një llogari bankare. Si mund të motivohet stafi për të investuar dhe kryer punën, nëse paguhet me para të thata në dorë pa asnjë kontratë pune dhe përfitimet e domosdoshme që kërkohen me ligj nga kodi i punës? Por duke qenë se është e vështirë të gjendet një vend pune, marrja në punë shihet si një nder i madh, ndërsa shmangia e detyrimeve ligjore, si strategji më vete për t’iu shmangur kostove dhe përfituar më shumë nga projektet. Fatkeqësisht, edhe institucionet zyrtare shtetërore, që duhet të sigurojnë zbatimin e

kontratave të punës dhe pagesën e sigurimeve shoqërore, nuk ushtrojnë pushtetin e tyre dhe si pasojë nuk ekzistojnë të dhëna treguese mbi përhapjen e këtij fenomeni.

Pjesa më e madhe e OJF-ve kanë një staf mjaft të vogël dhe një bazë relativisht të konsiderueshme vullnetarësh. Kjo do të thotë që në strukturën organizative të OJF-së pjesa më e madhe e stafit është në nivel koordinatori apo asistenti dhe më pas është financieri dhe drejtori. Është pothuajse e pamundur të lëvizësh në rendin hierarkik (përveçse kur lëviz nga vullnetar në asistent dhe koordinatori) për të ecur përpara në karrierë, pasi nuk ofrohen shumë mundësi. Si rrjedhojë, stafi i nivelit të ulët qarkullon shpesh ndërsa njerëzit e pozicionit më të lartë hierarkik qëndrojnë në OJF për vite e vite me radhë, duke gëzuar privilegjet që ofrohen nga vendet e tilla të punës. Normalisht, specializimi që këta njerëz mbartin në shkrimin e projekt-propozimeve, raporteve dhe krijimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit, kërkon kohë për t'u përfituar, por lëvizja e tyre gjithashtu mund të mundësojë transferimin e njohurive në sektorë të tjerë të tregut. Si pasojë, është e vështirë të qarkullojnë ide dhe mënyra të reja të të bërit të gjërave, pasi marrja e vendimeve mbetet sërish tek të njëjtët njerëz.

Në shumicën e OJF-ve, sidomos ato të grave, mungojnë drejtuesi/et e reja dhe kjo gjë është analizuar si pasojë e dëshirës për t'u aktivizuar dhe mungesë promovimi nga ana e drejtuesve aktuale të OJF-ve të grave për të përfshirë më shumë të reja (Qirjako & Dhimitri, 2000: 155). Apatia shoqërore zë përqindjen e saj, por në anën tjetër përfshirja në shoqërinë civile është mjaft e vështirë për vajzat dhe djemtë e rinj që janë të interesuar. Plot studentë trokasin në dyert e OJF-ve për të kërkuar punë vullnetare vetëm e vetëm për t'u kthyer mbrapsht nga erdhën. Bashkëndimi i vullnetarëve kërkon një person më vete dhe me numrin e kufizuar të stafit të OJF-ve kjo gjë bëhet e vështirë. Nga ana tjetër, edhe ata të rinj e të reja të interesuar për t'u aktivizuar e humbasin motivimin dhe largohen. Si pasojë, mungesa e promovimit nëpërmjet aktivizimit si vullnetarë/e apo shtytjes për të ngjitur shkallët e karrierës shpie në mungesën e dëshirës për t'u aktivizuar. Pra, rrethi i mbyllur fillon sërish aty ku u la më sipër.

BASHKËPUNIMI NDËRMJET OJF-VE

Mungesa e një rrjeti të konsoliduar të OJF-ve është gjëja e parë që bie në sy, pavarësisht se procesi i zhvillimit dhe demokratizimit në një shoqëri të hapur duhet të mbështetet në lirinë, shkëmbimin e informacionit dhe debatit ndërmjet palëve të përfshira. Bashkëpunime afatshkurtra dhe sporadike shihen shpesh në OJF-të e grave, të fëmijëve, të drejtave të njeriut apo ato që merren me migracionin, sidomos kur kjo është kërkesë e donatorëve. Ka pasur disa bashkëpunime të OJF-ve, sidomos në vitet e fundit, si në vitin 2005, për të luftuar korrupsionin e vënë re gjatë monitorimit të zgjedhjeve parlamentare (The 2005 NGO Sustainability Index, 2006: 42-43). Megjithatë, problemi që ekziston është se bashkëpunimet ndërmjet OJF-ve bëhen në bazë të kontakteve personale, ndërsa me donatorët si nevojë e shkëmbimit të informacionit (Regional Environmental Center, 3 gusht 2007). Një pjesë e mirë e stafit të OJF-ve kanë stabilizuar njëfarë monopoli në treg dhe është krijuar një rreth i mbyllur, tek i cili mund të futesh dhe të ecësh më tutje në shumicën e rasteve nëpërmjet kontakteve personale, të cilat përcaktohen në bazë të miratimeve dhe rrahjes së shpatullave të njëri-tjetrit.

Nuk kanë munguar rastet kur vetë përfaqësuesit e OJF-ve kanë akuzuar njëri-tjetrin për abuzim fondesh dhe mashtrime si një mënyrë për të tërhequr donatorët drejt vetes dhe për të fituar projektet (Sampson, 1996: 137), sidomos vitet e fundit, duke qenë se fondet janë kufizuar, pasi një pjesë e mirë e donatorëve janë duke u larguar nga Shqipëria. Për rrjedhojë, OJF-të janë gjithmonë e më të ndjeshme ndaj bërillave që i vënë njëra-tjetrës, për të përfituar projektet që do t'u sigurojnë "qëndrueshmërinë" edhe për 2-3 vjet të tjerë. Shembull konkret është pikërisht Lëvizja e Gruas, ku ka munguar vizioni dhe aftësia për t'u përqendruar në gjatjen e një qasjeje efikase për të lobuar në strukturat përkatëse për përmirësimin e gjendjes së grave

shqiptare. OJF-të e grave nuk kanë ditur të organizohen në mënyrë strategjike dhe mungesa e bashkërendimit dhe dëshirës për të bashkëpunuar ka çuar dëm përpjekjet dhe rezultatet e arritura në krahasim me energjitë dhe paratë e harxhuara (Ekonomi et al, 2006: 39).

Në pjesën më të madhe të kohës mungon shpërndarja e informacionit që qarkullon ndërmjet tyre lidhur me projektet që zbatohen apo me problemet që hasen, mungon bashkëpunimi dhe korrektesa e vënë re qartë që në ardhjen me vonësë apo thjesht mungesën në takime konsultimi dhe grupe pune. Një marrëdhënie e tillë izoluese dhe përjashtuese nuk ka se si të çojë në krijimin e një atmosfere bashkëpunimi frytdhënëse dhe, si rrjedhojë, nuk ndikon pozitivisht në procesin e zhvillimit. Strukturat ekzistuese përveç se duhet të konsolidohen në mënyrë që të jenë efikase, duhet gjithashtu që të shkëmbejnë informacion dhe praktika me njëra-tjetrën, për të shërbyer si mekanizma mbështetëse në procesin e demokratizimit.

OJF-TË DHE QEVERIA

Shumë pak mund të thuhet mbi bashkëpunimin ndërmjet OJF-ve dhe qeverive të periudhës së tranzicionit në Shqipëri. Deri më sot ka pasur raste tepër të pakta që qeveria të ketë mbështetur financiarisht veprimtaritë e OJF-ve. Por tani ka disa raste kur anëtarë dhe udhëheqës të shoqërisë civile janë bërë pjesë e institucioneve politike zyrtare dhe kanë vazhduar të aplikojnë për fonde nga donatorët e huaj për OJF-të që vazhdojnë të drejtohen prej tyre. Nuk ekziston një marrëdhënie e mirëfilltë bashkëpunimi ndërmjet palëve dhe OJF-të nuk shihen seriozisht nga pjesa më e madhe e administratës shqiptare. Çuditërisht kjo, pasi OJF-të në Shqipëri kanë ofruar dhe vazhdojnë të ofrojnë shërbime shumë herë më cilësore sesa institucionet shtetërore që ofrojnë shërbime shoqërore të amortizuara (La Cava&Nanetti, 2000:39). Madje në konferenca dhe grupe pune shihet njëfarë marrëdhënieje e prerë ndërmjet përfaqësuesve të qeverisë dhe stafit të OJF-ve, e cila shkon deri aty sa përfaqësuesit e qeverisë të diktojnë termat e tyre dhe të punësojnë njerëzit që duan për zbatimin e projekteve të OJF-së (Sampson, 1996: 135).

Shumë pak OJF janë shprehur haptas publikisht mbi qëndrimin e tyre ndaj zbatimit të planeve të qeverisë. Rrallëherë gjërat kanë shkuar përtej artikujve në gazetë dhe protestave me numër të kufizuar njerëzish. Kjo, pasi lidhja apo asociimi me njërin apo tjetrin kah politik zhvlerëson diskutimin dhe çështjen në fjalë (Mai, 1999:216). Nuk ka qenë e rrallë kur në momentin që një OJF e caktuar ka vënë në pah mangësitë e planit të zbatimit të qeverisë, ajo është etiketuar si përkrahëse e opozitës apo anasjelltas. Madje, OJF-të e grave kanë vite që duan të bashkëpunojnë për të lobuar për të rritur numrin e grave kandidatë gjatë zgjedhjeve, por mbështetja e tyre mund të interpretohet si mbështetje ndaj partive përkatëse ku kandidatet bëjnë pjesë dhe asnjë iniciativë nuk është ndërmarrë. Ose kur 2-3 OJF-të e vetme që organizojnë protesta modeste dalin për të kritikuar cilësinë e deputetëve në Parlament, etiketohen menjëherë si mbështetës të partisë në pushtet apo të opozitës, pavarësisht se objektiviteti i tyre politik është kriter, qoftë edhe formal, përzgjedhës për donatorët e huaj. Si rrjedhim, kjo është kthyer në një nga mënyrat më efikase se si politika zyrtare mban nën kontroll shoqërinë civile, duke i paraprirë presionit që ajo mund të ushtrojë ndaj qeverisë.

Pra, OJF-të në Shqipëri nuk kanë pasur ndonjë ndikim të madh (madje nuk kanë formuar asnjë grup domethënës për të ushtruar presion) në procesin e politikëbërjes (The 2005 NGO Sustainability Index, 2006: 42) dhe si rrjedhojë nuk janë vështruar si pengesë për axhendën e qeverisë. Nuk duhet lënë pa përmendur se vitet e fundit qeveria ka bërë disa tentativa të hartojë strategji dhe plane veprimi duke përfshirë përfaqësues të shoqërisë civile. Shembuj konkretë janë strategjitë e shumta individuale që përfshihen tek Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Dhjetëra takime janë bërë me aktorë të shoqërisë civile për t'i "përfshirë" ato në procesin e hartimit të këtyre strategjive dhe planeve veprimi. Megjithatë, procesi i takimeve është kthyer thjesht në një formalitet që duhet kryer, pasi duhen justifikuar fondet e marra, ndërsa zbatimi i

strategjive mbetet akoma për t' u parë.

Mënyra më e qartë e përfshirjes së anëtarëve të OJF-ve në politikë ka qenë në vitin 2005, para dhe pas zgjedhjeve elektorale, ku parti të ndryshme, sikurse dhe qeveria, tërhoqën brenda vetes individë nga shoqëria civile. Këta individë u përdorën jo vetëm për aftësitë e tyre, por dhe për faktin se imazhi i tyre ishte i papërlyer në krahasim me figurat ekzistuese politike. Meqë partia opozitare në atë kohë kishte humbur 2 raunde zgjedhjesh qendrore dhe lokale, kishte nevojë për një imazh të ri dhe strategji të reja për platformën e saj elektorale. Përfshirja e anëtarëve të shoqërisë civile nënkuptoi krijimin e një imazhi të ri, pozitiv, në sy të elektoratit për të kundërshtuar kësaj imazhin e mbyllur dhe autoritativ të krijuar për Partinë Demokratike, por edhe partitë e tjera që u përfshinë në garën politike. E njëjta strategji po ndiqet tani nga Partia Socialiste, ndërsa përgatitet për garën elektorale të radhës. Kjo gjë mundësoi në atë kohë dhe vazhdon të mundësojë përveç joshjes së elektoratit edhe mbështetjen e donatorëve dhe përfaqësive diplomatike, të cilat nxisin dhe mbështesin demokratizimin e vendit.

Për më tepër, këto dy vitet e fundit, të përballur me dukurinë e përsëritjes nga fillimi të së njëjtës iniciativë, organizata dhe institucione të huaja kanë parë të përshtatshme të kanalizojnë fondet e tyre nëpërmjet qeverisë shqiptare për të mirëmenaxhuar dhe zhvilluar konceptin e qëndrueshmërisë së shoqërisë civile. Me fjalë të tjera, më në fund u pa e arsyeshme që, nëse fondet do të menaxhoheshin nga një agjent i përbashkët që ka nën kontroll mekanizmat e vendimmarrjes, zbatimit dhe kontrollit të zbatueshmërisë, fondet e dhuruara do të shfrytëzoheshin më mirë dhe rezultatet do të ishin më të kënaqshme për zyrat qendrore të donatorëve. Ky veprim tingëllon në plan të parë i arsyeshëm, duke qenë se synon shmangien e përsëritjes së projekteve nga aktorë të ndryshëm. Mirëpo bazuar në funksionimin aktual të administratës shqiptare, kjo strategji ka vështirësitë e saj për t' u zbatuar, për të mos përmendur faktin se kjo i jep qeverisë një pushtet të madh në shpërndarjen e fondeve për shoqërinë civile dhe reflekton rrezikun e monopolizimit të këtyre fondeve nga organizata e shoqata që kënaqin qeverinë dhe interesat e saj, përkundrajt atyre që e kritikojnë apo i bëjnë asaj presion. Gjithsesi, këto argumente krijojnë një hapësirë të re diskutimi, që nuk është qëllimi i kësaj eseje, por që pasqyrojnë marrëdhënien OJF-Qeveri, e cila mund të thuhet se nuk ka rezultuar të jetë pozitive dhe frytdhënëse në procesin e zhvillimit.

OJF-TË DHE PUBLIKU

Vendet e Evropës Lindore gjatë sistemit komunist nuk kanë pasur kurrë një shoqëri civile, brenda të cilës individë dhe grupe do të mund të organizoheshin pavarësisht nga shteti për të arritur qëllime të caktuara. Si rrjedhojë, krijimi i shoqërisë civile dhe veçanërisht OJF-ve është konceptuar nga donatorët e huaj si një hallkë lidhëse me kulturën politike demokratike (Wedel në Mai, 1999: 208). Është e domosdoshme të analizojmë dhe raportin ndërmjet OJF-ve dhe përfituesve të shërbimeve të tyre, që është publiku, pasi këtu shihet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe suksesi i tyre dhe i procesit të “demokratizimit” dhe zhvillimit. Shumica e OJF-ve nuk kanë stabilizuar një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me publikun (La Cava&Nanetti, 2000:39), pasi janë në konkurrencë të vazhdueshme për fonde me njëra-tjetrën dhe zakonisht ndjekin dëshirat dhe planet e donatorëve që nuk përkrijnë domosdoshmërisht me nevojat aktuale. Normalisht, pavarësia që kanë OJF-të nga bota e biznesit dhe politika i kategorizon ato në një nivel tjetër autoriteti profesional dhe moral, duke krijuar në mendjen e njerëzve imazhe të papërlyera që monitorojnë dhe përfaqësojnë interesat e publikut ose grupeve të caktuara shoqërore. Shoqëria civile e organizuar në OJF, duhet të bashkëpunojë me publikun për të nxitur pjesëmarrjen në diskutim të interesave të qytetarëve, pasi kjo legjitimon edhe veprimtarinë e vetë OJF-ve dhe të procesit të demokratizimit, synim për të cilin ato janë krijuar. Si rrjedhojë, prej tyre pritët më tepër pavarësi mbi çështje të rëndësishme të interesit publik.

Teksa demokratizimi i shoqërisë civile në Shqipëri nënkuptoi se duheshin krijuar një numër i pafund OJF-sh, u la mënjane në fillim të procesit të zhvillimit fakti që përveç sasisë duhet folur edhe për cilësinë. Tashmë një pjesë e mirë e OJF-ve të krijuara pas vitit 1990 janë zhdukur dhe nuk janë funksionale përveçse në ndonjë bazë të dhënash të paaksesueshme nga publiku. Gjatë kësaj periudhe OJF-të kanë krijuar diskursin e tyre të veçantë (Sampson, 1996: 124) dhe operojnë në një sferë tjetër influence që nuk është e lidhur domosdoshmërisht me qeverinë apo publikun në rastin shqiptar.

Izolimi i përfituesve ka çuar në mungesën e suksesit të projekteve të zbatuara. Shumica e trajnimeve dhe veprimeve të ndërmarra janë kryer në Tiranë apo qytetet e mëdha, duke lënë mënjane periferinë, në veçanti zonat fshatare dhe OJF-të e ngritura aty, stafi i të cilave, duke qenë larg qendrës, nuk zotëron të njëjtat kualifikime dhe nuk ka të njëjtin nivel aksesi ndaj burimeve dhe donatorëve. Mungojnë projektet me bazë të gjerë të zbatuara në terren sikurse dhe pjesëmarrja e përfituesve në hartimin e tyre (La Cava&Nanetti, 2000:39-40), ndërsa nuk numërohen projektet që kanë si qëllim studime apo “vlerësime nevojash” pa ndonjë të dhënë statistikore dhe që përsërisin ato që tashmë ekzistojnë dhe janë kryer nga OJF të tjera. Shpërbërja e strukturave bazë të organizimit në zonat fshatare ka çuar në një boshllëk organizativ dhe në një mungesë hapësire për të diskutuar problemet e njerëzve në këto zona dhe si rrjedhojë janë të pakta organizatat me bazë të gjerë (grassroot), të cilave u rrihet larg pasi shihen si “trashëgimi komuniste”, që për kontekstin shqiptar ka konotacion negativ.

Për më tepër, terminologjia e përdorur në këto trajnime bazohet në pretendimin se të gjithë e dinë se çfarë është x apo y term në anglisht mbi fushën dhe se teknologjia e përdorur në trajnime në Tiranë dhe p.sh. në një fshat të Kukësit është po e njëjta. P.sh. në shumë zona fshatare ku janë zhvilluar më pak trajnime (në krahasim me zonat urbane) për të ndërgjegjësuar popullsinë mbi problemet gjinore, është e pamundur që gratë dhe vajzat që janë analfabete të kuptojnë termin “gender” të shqiptuar “xhender”, që në shqip përkthehet në përkatësi gjinore (Çuli, 2000:11). Mungesa e përshtatjes së moduleve të trajnimeve ka sjellë një mungesë të interesit të përfituesve. Një gjë e tillë sjell mangësi në informimin mbi qëllimet e projekteve të OJF-ve, mungesë kontributi financiar nga pushteti vendor, mungesë të mbështetjes së komunitetit për arritjen e synimeve, sikurse dhe mungesë përfshirjeje dhe pjesëmarrjeje. Të gjitha këto çojnë në mangësi të thella në rezultate dhe në indiferencën e njerëzve, duke sjellë kështu dështimin në misionin e tyre të përbashkët, që është demokratizimi i vendit dhe brumosja i vlerave dhe sjelljeve demokratike.

Si rrjedhim, publiku është i pranishëm në punën e OJF-ve në formën e një target-grupi dhe ashtu si çdo shënjestër mbahet në distancë, duke u pasqyruar më shumë si shifër dhe prani në fotografitë që dëshmojnë realizimin konkret dhe jo në letër të aktiviteteve, sesa pjesëmarrës aktivë në procesin e zhvillimit. Ky qëndrim garanton vazhdueshmërinë e projekteve për hir të nevojës së vazhdueshme për “ndërtimin e kapaciteteve” dhe “qëndrueshmërisë” për grupe të ndryshme të shoqërisë shqiptare.

PËRFUNDIME

Ndikimi i ndërkombëtarëve nëpërmjet OJF-ve në Shqipëri ka pasur karakteristika dhe është ndikuar nga faktorë të shumtë. Mangësitë e ndeshura në politikat e zhvillimit dhe të modeleve të transmetuara janë problemet e para që hasen në zbatimin e projekteve. Për më tepër, menaxhimi i fondeve të projekteve ka pasur mjaft probleme teksa donatorë të shumtë nuk i kanë bashkërenduar veprimtaritë dhe paratë e tyre për të arritur objektiva të caktuara që përkojnë me nevojat e vendit. Projektet që kopjohen dhe importohen në vendet në zhvillim nuk kanë qenë të suksesshme në kontekstin shqiptar, ku nuk ekziston një kulturë politike dhe shoqërore demokratike dhe ku shoqëria civile nuk ka struktura të konsoliduara që janë produkt i vlerave dhe sjelljes demokratike. “Këto përfaqësime të thjeshtëzuara, nëpërmjet të cilave shumë popuj të botës janë

ndeshur dhe po ndeshen me Perëndimin, në kuadrin e superioritetit ekonomik, teknologjik dhe kulturor, u korrespondojnë disa programeve të politizuara, të parapërgatitura dhe të gatshme për të zbatuar “zhvillimin”, implementimi i të cilave nuk ka përfunduar gjithmonë me futjen e një rendi të vërtetë demokratik në të gjithë botën (Mai, 1999:219).

Gjithsesi, nuk është e justifikueshme të “fajësohen” vetëm donatorët dhe organizatat e huaja për mangësitë në politikat e zhvillimit dhe mungesën e vizionit të qartë gjatë procesit të krijimit dhe funksionimit të OJF-ve në Shqipëri, pasi ato janë influencuar dhe nga faktorë të tjerë. Pavarësisht se ka pasur mjaft probleme në menaxhimin e fondeve dhe përputhshmërinë e modeleve të transmetuara me realitetin ekzistues, nuk duhen mënjanuar përgjegjësitë e vetë OJF-ve për gjendjen e sotme të shoqërisë civile. Transparenca financiare dhe vendimmarrja brenda OJF-ve mbeten probleme thelbësore të demokratizimit të brendshëm të tyre. Mungesa e strukturimit demokratik brenda organizatës ka çuar në zhvillimin e një sistemi autokratik të marrjes së vendimeve dhe të komunikimit, duke mos lënë hapësirë për diskutime dhe ide të reja. Gjithashtu, nuk duhen anashkuar marrëdhëniet e varfra të krijuara ndërmjet vetë OJF-ve, me qeverinë, sikurse dhe me përfituesit e tyre, marrëdhënie që nuk lënë hapësira për diskutime ku palët të shihen dhe trajtohen si të barabartë apo të pasqyrojnë bashkëpunim dhe përfitim të ndërsjellë. OJF-të shqiptare kanë funksionuar në një sferë veprimi të distancuar nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe institucioneve, duke shërbyer si mekanizma të disa grupeve të privileguara, duke përjashtuar raste të veçanta, për të përfituar individualisht nëpërmjet projekteve të donatorëve perëndimorë. Të gjithë këta faktorë kanë sjellë si pasojë mangësi të thella në rezultatet e projekteve të zhvillimit dhe në procesin e demokratizimit të vendit.

BIBLIOGRAFIA

Clunies-Ross, A. & Sudar, P. ed. 1998. *Albania's Economy in Transition and Turmoil 1990-1997*, U.K.: The Book Company.

Çuli, D. 2000. *Ese për Gruan Shqiptare*, Tiranë: ILAR.

Democracy and Governance in Albania Program, Training Outcome Report October 2004-September 2005. 2005. *Partners Albania*, <http://www.partners-intl.org/centers/DGA%20Training%20Outcome%20Report%2012-05.pdf> [Parë për herë të fundit më 3 gusht 2007].

Does the New draft Legislation Means an End for NGO Independence in Albania?. 9 January 2007, *One World South East Europe*, <http://see.oneworld.net/article/view/144704/1/> [Parë për herë të fundit më 3 gusht 2007].

Ekonomi, M. et al. 2006. *Përfaqësimi dhe Demokracia në Shqipëri, një perspektivë gjinore*, Aleanca Gjimore për Zhvillim, Tiranë: Pegi. Introduction to Albania. *Regional Environmental Center in Albania*, <http://www.rec.org/REC/Publications/NGODirIntros/Albania.html> [Parë për herë të fundit më 3 gusht 2007].

Klosi, A. 1997. *Shqipëria ç'mund të jetë*, Botimet Përpjekja, Munih: Tachidromos.

La Cava, G. & Nanetti, R. 2000. *Albania: Filling the Vulnerability Gap*, World Bank Technical Paper no. 460: Washington D.C. http://books.google.com/books?pg=PA39&lpg=PA39&dq=ngos+in+albania&sig=rgk8Du5Z0dD_xhCJs9v5Vn-TWpA&id=5k09CsJh8XAC&ots=7teVShVv28#PPA9,M1 [Parë për herë të fundit më 3 gusht 2007].

Mai, N. 1999. “OJQ-të e Rinisë në Shqipëri...”, *Përpjekja*, Tiranë, nr. 15-16, fq. 206-219.

Marschall, M. 29 tetor – 1 nëntor 2002. *Legjitimiteti dhe Efektiviteti: Organizatat e Shoqërisë Civile në Qeverisjen e Mirë*, Forumi për

Strategjitë e Varfërisë.

Qirjaku, S. & Dhimitri, R. 2000. *Shoqëria Civile dhe Lëvizja Asociative e Lirë e Grave*, në përmbledhjen “Studim mbi Kontributin e Shkruar të Lëvizjes së Gruas në Shqipëri”, Qendra e Gruas, Tiranë: D.I.J.A., 132-161.

Sampson, S. (Hann, C. & Dunn, E. ed.) 1996. *Civil Society: Challenging Western Models*, London: Routledge, 121-142.

Stiglitz, J. 2003. “Premtimi i Institucioneve Globale”, *Përpyekja*, verë 2003, nr. 17, Tiranë.

Survey of Tax Laws Affecting NGOs in Central and Eastern Europe. *International Center for Not-for-Profit Law*, http://www.icnl.org/journal/vol3iss3/cr_cee.htm [Parë për herë të fundit më 3 gusht 2007].

The 2006 NGO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Eurasia. 2007. *United States Agency for International Development*. http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/2006/albania.pdf [parë për herë të fundit më 3 gusht 2007].

The 2005 NGO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Eurasia. 2006. *United States Agency for International Development*.

The 2000 NGO Sustainability Index for Central and Eastern Europe and Eurasia. 2000. *United States Agency for International Development*, http://www.usaid.gov/locations/europe_eurasia/dem_gov/ngoindex/2002/albania.pdf [Parë për herë të fundit më 3 gusht 2007].

SHQIPËRIA OSE EVROPIANIZIMI I VËSHTIRË

Sokol Lleshi*

Abstrakt. Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian kalon më së pari përmes plotësimit të kriterëve të Kopenhagenit. Me synim promovimin e demokracisë dhe qëndrueshmërisë të institucioneve në vendet candidate, Bashkimi Evropian ushtron ndikimin e tij përmes mekanizmit të Kushtëzimit Demokratik. Ndërkaq, procesi i integritimit nënkupton njëherësh dhe një proces të evropianizimit të përhapjes dhe institucionalizimit të normave evropiane. Eseja synon të analizojë shkaqet e pamundësise së efikasitetit të mekanizmit të kushtëzimit demokratik përballë qeverisjeve problematike, duke u përqendruar në rastin e Shqipërisë. Vërehet se mekanizmi i kushtëzimit demokratik apo përpjekja për demokratizim e vendeve candidate nga ana e BE-së mund të ketë sukses vetëm kur kushtëzimi demokratik të shihet i lidhur me procesin e evropianizimit dhe kur të ekzistojë një identifikim me normat dhe praktikatat demokratike të qeverisjes nga qeveritë e vendeve candidate.

HYRJE

Fill pas rënies së sistemeve totalitare komuniste në Evropën Qendrore dhe Lindore, në këto shtete nis përpjekja për (ri)themelimin e sistemeve demokratike, ndërtimin e institucioneve sikurse dhe vendosjen e ekonomisë së lirë të tregut. Në këto shtete ekzistonte njëherësh dhe angazhimi për të qenë pjesë e strukturave euro-atlantike, të anëtarësimit në Bashkimin Evropian krahas kalimit në një sistem demokratik. Ndërkaq, ndërhyrja e organizmave ndërkombëtare apo institucioneve ndërkombëtare, në fillim të viteve 90' nuk kishte marrë ende trajtat e një procesi të paracaktuar negociatash, mbikëqyrje dhe promovim të institucioneve demokratike, shtetit ligjor, respektim të të drejtave të njeriut, kushte të cilat u vendosën në Këshillin e Kopenhagenit dhe që njihen si kriteret e Kopenhagenit. Tashmë Bashkimi Evropian do të ndërmarrë atë çka mund të quhet një proces i "promovimit të demokracisë" kryesisht përmes mekanizmit të kushtëzimit demokratik me synim integrim të vendeve candidate, proces që lidhet pikësisht me përmbushjen e kriterëve të Kopenhagenit. Megjithatë, procesi dhe kushti për demokratizim është pjesë e një procesi të fundëm më të gjerë sikurse evropianizimi i vendeve që aspirojnë në BE, çka nënkupton njehsimin dhe përvetësimin e vlerave, normave dhe praktikave të BE-së, që nisin me respektimin e shtetit ligjor, institucione të konsoliduara demokratike, respektimin e të drejtave të minoritetit e deri tek përafrimi i legjisllacionit apo praktikave vendimmarrëse.

Në këtë punim fokusi nuk është mbi dallimin apo kontradiktën mes procesit të integritimit dhe zhvillimit të demokracisë e institucioneve të pavarura në vendet candidate, apo vënia në pah e logjikave të ndryshme që ndjekin procesi i integritimit dhe ai i forcimit të demokracisë në vendet aspirante sikurse është qëmtuar mjaft dhe në mënyre bindëse nga (Mair, Peter: 2004), (Raik, Kristi: 2004) apo në rastin e Shqipërisë nga (Kajsiu, Blendi: 2006). Eseja nis nga premisa e konsiderimit të Bashkimit Evropian si një komunitet shtetesh bazuar në vlerat e demokracisë parlamentare, respektin ndaj të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor. Tashmë

* Blerta Picari ka mbaruar studimet universitare në Shtetet e Bashkuara për Shkenca Politike dhe Menaxhim Biznesi. Ajo ka përfunduar gjithashtu një Master për Zhvillim Ndërkombëtar pranë Universitetit të Bolonjës në Itali. Blerta ka punuar në organizata jofitimprurëse në Shtetet e Bashkuara dhe në Shqipëri. Që prej dy vjetësh ajo është pedagoge e brendshme në Seksionin e Shkencave Politike pranë Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin e Tiranës.

është gjithkund e pranuar se ky organizëm synon përmes strategjive të tij të ndikojë në ngritjen e shtetit ligjor, stabilizimin e demokracisë dhe institucioneve, si dhe respektim të lirive dhe të drejtave të njeriut në shtetet aspirante si kushte parësore të integritimit në Bashkimin Evropian.

Eseja synon të provojë se mekanizmi i Kushtëzimit Demokratik, termi i cilësuar nga Schimmelfennig për të karakterizuar mekanizmin apo strategjinë e ndikimit të BE-së në përmbushjen e kushteve politike nga vendet candidate (Schimmelfennig & Sedelmeier, 2004) nuk ka funksionuar në vende “problematike” sikurse Shqipëria. Shkak për këtë pamundësi të ndikimit të këtij mekanizmi është mospërputhja me normat dhe praktikat demokratike e praktikave qeverisëse dhe vendimmarrëse të vendeve candidate. Për pasojë, mekanizmi i kushtëzimit demokratik është provuar i pafuqishëm për të shuar arbitraritetin apo sjelljet jodemokratike të qeverive apo institucioneve të vendeve candidate. Në të njëjtën kohë, mënyra se si është strukturuar mekanizmi i kushtëzimit demokratik, i cili nuk është i ndërthurur me një proces evropianizimi të përhapjes dhe institucionalizimit të normave dhe praktikave demokratike përmes angazhimit të faktorëve të tjerë socialë, sikurse shoqëria civile e kufizon ndikimin e kushtëzimit demokratik në varësi të vullnetit të qeverisë së radhës. Së fundi, Bashkimi Evropian duke përcaktuar kushte afatshkurtra apo afatmesme që duhen plotësuar, duke këmbëngulur më tepër në arritjen e rezulttit sesa procesit që sjell në këtë rezultat, nuk vëren ato praktika jodemokratike që çojnë në plotësim të këtyre kushteve.

Pra, procesi i kushtëzimit demokratik, që synon të nxisë përmbushjen e kriterëve të Kopenhagenit si një kusht për anëtarësimin e plotë në Bashkimin Evropian, si një mekanizëm presioni ndaj qeverive të shteteve aspirante për t’u demokratizuar dhe integruar, përmes mekanizmave të mbikëqyrjes si raportet vjetore apo opinionet e Komisionit Evropian dhe planeve të partneriteti, nuk përbën një strategji apo praktikë unksionale nëse shihet i veçuar dhe i pavarur nga procesi i evropianizimit, i cili përmes përhapjes dhe institucionalizimit të normave dhe praktikave të pranura qeverisëse apo të politikëbërjes në strukturat dhe diskursin vendas, do të konsolidonte dhe mbronte vijueshmërinë e institucioneve të qëndrueshme demokratike, mosdeformim apo bishtnim të rregullave dhe normave demokratike.

Ndërkaq, në një analizë më konkrete, ngritja krye në mënyrë të herëpashershme e sjelljeve abuzive me pushtetin dhe shpërfillja e normave dhe praktikave demokratike që vërehet në qeverisjet e vendeve candidate apo potencialisht candidate, që janë dhe negociatorët kryesorë të BE-së, mbi të cilët BE-ja ushtron mekanizmin e kushtëzimit demokratik, është tregues i mosidentifikimit të elitave qeverisëse me praktikat dhe normat demokratike të BE-së dhe i ngërçit të mekanizmit të kushtëzimit demokratik. Nga ana tjetër, struktura e mekanizmit të ndikimit të BE-së mbi vende “problematike” i jep më tepër rëndësi rezultatit, pra pasjes së institucioneve demokratike të qëndrueshme, ngritjes së shtetit ligjor, respektim të drejtave të njeriut dhe jo detyrimisht procesit përmes të cilit të mund të arrihet një përvetësim dhe institucionalizim i normave demokratike në sistemin politik dhe praktikat vendimmarrëse të vendeve aspirante. Për pasojë, vështirësohet mundësia e ndikimit të mekanizmit të kushtëzimit demokratik, pasi nëse do të kishte një përhapje, institucionalizim dhe përvetësim të normave dhe praktikave demokratike përmes ndërthurjes së mekanizmit të kushtëzimit demokratik dhe procesit të evropianizimit, nuk do të mund të dyshohej zbatimi i ligjit, cenimi i lirisë së medias apo deformimi i pavarësisë së institucioneve.

Struktura teorike apo qasja teorike e përdorur dhe mbrojtur në këtë ese i përket teorisë së Institucionalizimit Sociologjik përpunuar nga Frank Schimmelfennig dhe Sedelmeier, në lidhje me procesin dhe mekanizmat e kushtëzimit demokratik, që ushtron BE-ja kundrejt vendeve aspirante, sikurse dhe përfshirja e konceptit apo termit të evropianizimit, si një proces i përshtatjes së vendeve që duan të integrohen ideuar nga Claudio Radaelli. Kjo qasje teorike e prezantuar nga Schimmelfennig do të mundësojë të kuptojmë përmes mekanizmi i kushtëzimit demokratik, ashtu sikurse është konceptuar dhe strukturuar nga BE-ja ndeshet me pamundësinë për të nxitur përshtatjen me rregullat dhe normat demokratike, formale ose jo, të përcaktuara nga BE-ja si pjesë e kriterëve themelore të Kopenhagenit. Duke u përqendruar kryesisht në rastin e Shqipërisë dhe duke e ilustruar me raste të vendeve tashmë anëtare të BE-se, si Sllovakia gjatë qeverisjes së Meciar-it,

apo Rumania do të verehet mospërputhja e sjelljeve dhe veprimeve të qeverive të vendeve aspirante me normat dhe praktikat demokratike të gjithëndara këto në hapësirën e Bashkimit Evropian gjatë kohës së ushtrimit të mekanizmit të kushtëzimit demokratik nga BE-ja.

Nga ana tjetër, duke paraqitur një qasje kritike ndaj mënyrës se si është strukturuar funksionimi i mekanizmit të kushtëzimit demokratik, i cili përqendrohet tek disa prioritete afatshkurtra dhe afatgjata që duhet të plotësojë vendi kandidat dhe duke i vënë rëndësi më tepër rezultatit sesa procesit përmes të arrihen këto rezultate, vërehet se kjo është një nga arsytet e mosfunksionimit të kushtëzimit demokratik në vende “problematike”. Për rrjedhojë, koncepti i evropianizimit i Radaellit, i bashkangjitur modelit teorik të Schimmelfennig, që shpjegon pamundësinë e “përshtatjes me rregullat” nga qeveria apo institucionet e vendit aspirant, ndihmon për një argumentim më të plotë të mosfunksionimit të kushtëzimit demokratik si dhe një mënyre të caktuar zgjidhjeje. Në të njëjtën kohë, mosreflektimi në raportet dhe planet e veprimit, si mjete të ushtrimit të mekanizmit të kushtëzimit demokratik, i debateve publike dhe shqetësimeve që lidhen në një mënyre ose një tjetër me pavarësinë e institucioneve, me shtetin ligjor, me nivelin e demokracisë në vendet potencialisht kandidatë është një tregues i mangësisë së këtij mekanizmi. Sikurse vërehet në rastin e Shqipërisë, diskursi që bart e që shoqëron kushtëzimin demokratik të BE-së shprehur në raporte të Komisionit Evropian apo në plan veprimit në lidhje me demokratizimin e pavarësimin e institucioneve, respektimin e shtetit ligjor apo lirisë së medias nuk reflekton ato shqetësime të shprehura në hapësirën publike të brendshme. Në të kundërt, këto mekanizma përmes të cilave ushtrohet kushtëzimi demokratik, sikurse janë raportet dhe Planet e Veprimit, në rastin më të mirë ripërsërisin dhe përmendin përsëri ato abuzime ndaj normave dhe praktikave demokratike dhe në rastin më të keq i anashkalojnë apo i minimizojnë ato.

Punimi është ndarë në një pjesë teorike ilustruar me shembuj dhe në një pjesë ku trajtohet rasti i Shqipërisë pas zgjedhjeve të 3 korrikut 2005. Eseja në nëndarjen e parë të pjesës teorike të saj trajton kufizimet e modeleve teorike, të cilët mëtojnë të shpjegojnë ndikimin e kushtëzimit demokratik në vendin kandidat. Në nëndarjen, e dytë duke u mbështetur në modelin teorik të Socializimit (*Social Learning Model*) të Schimmelfennig dhe konceptin e evropianizimit të Radaelli-t, shpjegohet (pa)mundësia e suksesit të kushtëzimit demokratik si dhe zgjidhja e mundshme, duke u shoqëruar me shembuj të dështimit të tij nga eksperiencia të vendeve të tjera kandidatë sikurse Sllovakia gjatë qeverisjes së Meciar-it dhe Shqipëria e qeverisjes “Nano” fill pas hapjes së negociatave të MSA-së. Pjesa e dytë e esesë zbaton modelin teorik në rastin e Shqipërisë pas nënshkrimit të MSA-së gjatë qeverisjes së djathtë të pas 3 korrikut 2005. Fokusi në këtë pjesë është vënia në pah e mosidentifikimit me normat dhe praktikat demokratike të qeverisjes aktuale, mosnxitja nga ana e BE-së të një procesi evropianizimi, duke përfshirë në dialog shoqërorinë civile si dhe pasojat që sjell këmbëngulja e arritjes të rezultatit e kushteve të vëna, duke mos konsideruar si parësor procesin përmes të cilit arrihet ky rezultat.

KUSHTËZIMI DEMOKRATIK DHE EVROPIANIZIMI SI PROCES I FUNDËM

Rrugëtimi drejt integritimit në Bashkimin Evropian nënkupton pikë së pari, përveç përafrimit të legjislationit dhe përshtatjes së *acquis communautaire* në legjislationin kombëtar, ekzistencën e institucioneve të qëndrueshme demokratike, shtet ligjor dhe ekonomi të tregut të lirë. Tek e fundit kërkon ndarjen e vlerave të përbashkëta që përbëjnë thelbin e Bashkimit Evropian, demokracia liberale parlamentare dhe respektim të të drejtave të njeriut. Nuk mund të ketë asnjë ndërnyshje se integrimi në BE nuk do të ishte i mjaftueshem, tërësor dhe i sigurt, nëse nuk do të plotësoheshin kushtet politike të përcaktuara në Kriteret e Kopenhagenit. Sikurse shprehet Schimmelfennig: “Të drejtat e njeriut, demokracia liberale dhe shteti i së drejtës përbëjnë normat themelore të një shteti e qeverisjeje legjitime në Bashkimin Evropian” (2005, p. 29). Këto kritere përbëjnë thelbin në të cilin mbështetet ajo çka Schimmelfennig e cilëson me termin kushtëzimi demokratik

ose anasjelltas kushtëzimi politik, që BE-ja ushtron mbi vendet candidate. Në thelb kushtëzimi demokratik, sipas Schimmelfennig, është strategjia bazë përmes të cilës BE-ja synon të arrijë përmbushjen e këtyre kriterëve politike nga vendet aspirante. Pra, është më tepër një strategji apo mekanizëm ndikues me synim plotësimin e kriterëve të Kopenhagenit, që ndihmon dhe kushtëzon procesin e integritit.

Njëherësh procesi i integritit ka si synim të fundëm dhe rezultat përfundimtar evropianizimin e vendeve aspirante për në BE. Për pasojë, mekanizmi dhe praktika e kushtëzimit demokratik, duke u përqendur në forcimin e pavarësisë së institucioneve, vendosjen e shtetit ligjor është e duhet të jetë pjesë e një procesi më të gjerë të evropianizimit, sikurse përcakton Radaelli. Ky autor e përcakton konceptin evropianizim si më poshtë:

“Evropianizimi ka të bëjë me një proces të a) ndërtimit, b) difuzimit, c) dhe institucionalizimit të rregullave formale ose jo, procedurave, modeleve të politikave, stileve, mënyrën e bërjes së gjërave dhe normave apo besimeve të përbashkëta që janë themeluar dhe konsoliduar në nivel të politikave në BE, që më pas përfshihen në logjikën e diskutit vendor, të identitetit, strukturave politike dhe politikave publike” (Radaelli: 2003, f.30)

Pra, ajo çka duhet kërkuar dhe provuar është nëse procesi i monitorimit dhe kushtëzimit politik e demokratik i ushtruar nga BE-ja mbi vendet candidate në funksion të integritit të tyre në këtë organizëm ka mundur ose jo përhapjen, insitucionalizimin e rregullave, normave dhe vlerave të mirëpranuara dhe themelore të BE-së në diskursin dhe praktikën vendase që reflektohet në ndërtimin dhe vijimin e institucioneve demokratike, në zbatim të shtetit ligjor, respektim të të drejtave të njeriut dhe të lirive të medias. Nëse mekanizmi i kushtëzimit demokratik nuk ka nxitur një identifikim me normat dhe praktikën demokratike të qeverisjes dhe nëse nuk ka nxitur një proces të institucionalizimit të tyre, atëherë ai mund të konsiderohet joefikas, për të mos thënë i dështuar. Identifikimi me normat dhe praktikën qeverisëse demokratike vërehet nëse ekziston ajo çka Schimmelfennig e cilëson si “sjellje sipas rregullave” pra praktika qeverisëse dhe vendimmarrje në përputhje me normat dhe praktikën demokratike. Nëse, megjithë ushtrimin e këtij mekanizmi ndikues qeverisjet e vendeve candidate, apo institucionet përkatëse vazhdojnë të shfaqin herë pas here praktika që bien ndesh me praktikën parësore demokratike atëherë kuptojmë se ky identifikim nuk është prezent. Nga ana tjetër, nuk duhet ngatërruar zotimi i qeverisjeve për anëtarësim në BE dhe plotësim të kushteve të vëna si një trajtë e identifikimit me normat e komunitetit ku kërkon të bëjnë pjesë, pasi këto norma nuk reflektohen në veprimet dhe praktikën qeverisëse, që janë në të shumtën e herës jo demokratike.

Për më tepër, ky mekanizmi i Kushtëzimit demokratik, që duhet të përbënte pikënisjen e një procesi evropianizimi nga mënyra se si është strukturuar funksionimi i tij, nuk ndihmon në këtë proces të evropianizimit të vendeve aspirante “problematike”. Sferat që përfshihen në këtë proces evropianizimi sipas Radaellit përbëhen nga: “Strukturat politike që përmbajnë institucionet dhe administratën publike mes të tjerash, strukturat e përfaqësimit, grupe të interesit dhe parti politike sikurse dhe struktura kognitive e normative, që nënkuptojnë vlera dhe norma” (Radaelli: 2003, f.3). Për pasojë, ndikimi që ushtron BE-ja për promovimin e institucioneve demokratike, të qëndrueshme dhe të shtetit ligjor përmes kushtëzimit demokratik në analizë të fundit duhet të nxisë pikërisht këtë proces evropianizimi.

Kufizimet e modeleve teorike mbi kushtëzimin demokratik

Në këtë nëndarje shtjellohen modele të ndryshme teorike të konceptimit të kushtëzimit demokratik si dhe mënyra e ndikimit të tij mbi proceset demokratizuese në vendet candidate. Njëkohësisht, vërehen kufizimet e këtyre modeleve për të shpjeguar pamundësinë e efektivitetit të mekanizmit të kushtëzimit demokratik përballë qeverisjeve “problematike”.

Ndikimi i BE-së në proceset integruese të vendeve aspirante në përgjithësi dhe kushtëzimi demokratik në veçanti, është konceptuar si një marrëdhënie asimetrike mes BE-së dhe vendeve candidate sikurse shprehet Grabbe: “i jep BE-së rrugë të ndikimit me të fuqishëm në proceset e politikëbërjes kombëtare” (2003, f. 303) dhe nëpërmjet mekanizmave të tilla, sikurse raportet vjetore apo plan-programeve, vazhdon Grabbe: Këto dokumente sigurojnë një lidhje direkte me politikën e brendshme... sepse BE-ja vendos një listë prioritesh që duhet të përmbushen brenda një viti ose në një periudhë më afatgjatë” (2003, f. 315). Për pasojë, sipas këtij modeli teorik të konceptimit të marrëdhënieve mes BE-së dhe vendeve candidate, është me e lehtë për Bashkimin Evropian të nxisë plotësimin dhe arrijtjen e kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në prioritetet afatshkurtra dhe afatgjata. Duke u përqendruar në vendet e Evropës Qendrore, kur ishin ende në statusin e vendit kandidat, Grabbe pohon se këto vende janë më të prirur për të përmbushur kërkesat dhe kushtet e vëna nga BE-ja, pasi synim i tyre është integrimi në këtë organizëm (2003, f.315). Madje shton më tej se “Kjo ndërvarësi asimetrike i lejon Bashkimit Evropian të vendosë rregullat e lojës në kushtëzimin e hyrjes në BE” (2003, f.318).

Sipas këtij modeli, do të prisnim që kriteret politike do të mund të plotësoheshin pa u ndeshur në vështirësi. Në rast se do të kishte një pamundësi plotësimi të këtyre kushteve, kjo sipas Grabbe-s, i dedikohet “paqartësisë” që vjen prej mënyrës së përcaktimit të prioriteteve apo axhendës nga Bashkimi Evropian, pasi nuk ekziston një hierarki e qartë kushtesh. Çdo kriter apo kusht, sikurse dhe tërësia e legjislacionit të BE-së, duhet përshtatur dhe zbatuar. Kjo marrëdhënie asimetrike dhe vendosja në mënyrë paraprake i prioriteteve afatshkurtra dhe afatmesme apo përkthimi i kushteve politike në prioritet që duhet të përmbushen, çon në njehsimin e këtyre prioriteteve me planet e veprimit të qeverive të vendeve candidate. Sikurse vëren Kajsiu: “...prioritetet e përcaktuara në raportet e BE-së përbëjnë pak a shumë programin qeverisës të forcës politike në pushtet” (2006). Për pasojë, struktura teorike e mbështetur nga Grabbe e cilëson mekanizmin e kushtëzimit demokratik, ose kushtet që rrjedhin prej tij si pjesë e tërësise së prioriteteve afatshkurtra apo afatmesme të përcaktuara nga marrëdhënia asimetrike mes BE-se dhe vendit kandidat.

Duke vijuar me modelin teorik të Grabbe-s prezantuar më lart, mund të thuhet se kushtëzimi demokratik duhet të kishte qenë i efektshëm në rastin e Sllovakisë apo të Shqipërisë. Kjo sepse edhe me këto vende marrëdhënia mes BE-së dhe këtyre vendeve candidate vazhdon të mbetet asimetrike, duke lejuar që BE-ja të kushtëzojë proceset integruese dhe të këmbëngulë për plotësimin e kushteve dhe kriterëve ku përfshihen dhe kushtet politike që mekanizmi i kushtëzimit demokratik synon të arrijë. Pra, vendet candidate shihen më tepër si të pafuqishëm për të ndikuar apo ndryshuar vendosjen e këtyre kriterëve dhe kushteve. Nga ana tjetër, zotimi dhe interesimi i këtyre vendeve candidate, përfshirë dhe Shqipërinë për t’u anëtarësuar në BE duhet të nënkuptojë plotësimin lehtësisht të këtyre kushteve të vëna. Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur. Ajo çka e bën të pamundur shpjegimin sipas këtij modeli teorik të mosefektivitetit të mekanizmit të kushtëzimit demokratik lidhet me prirjen për të reflektuar në teori mekanizmin e procesit standard të negociatave mes BE-së dhe vendeve candidate. Duke e cilësuar raportin BE-vend kandidat si një marrëdhënie vertikale të përcaktuar, nuk analizohen dinamikat e brendshme dhe praktikën qeverisëse në sistemet politike të vendeve candidate. Për pasojë, modeli teorik mbetet i njëanshëm. Njëherazi, Grabbe nuk e koncepton Bashkimin Evropian si një komunitet shtetesh që ndajnë vlera dhe norma themelore të përbashkëta, kështu që nuk synon të bëjë krahasimin mes praktikave qeverisëse të vendit kandidat me normat dhe praktikën demokratike të BE-së. Si rrjedhojë ngatërrohet zotimi dhe interesi për t’u integruar në BE me identifikimin me normat demokratike dhe qeverisjes sipas tyre. Kur në fakt kjo nuk gjendet në rastin e Shqipërisë apo të Sllovakisë gjatë Meciar-it. Duke i njehsuar apo barasvlerësuar kushtet dhe kriteret që promovohen përmes kushtëzimit demokratik me kushte dhe kriterë të tjera, qoftë edhe teknike si pjesë e legjislacionit të BE-së, atëherë ky model nuk ndihmon shumë për të shpjeguar përse promovimi i demokracisë përmes kushtëzimit demokratik nuk funksionon në Sllovakinë e Meciar-it dhe në Shqipëri.

Një qasje dhe pamje më optimiste mbi ndikimin e BE-së në promovimin e demokracisë në vendet kandidate, në kushtëzimin demokratik si parakusht për anëtarësimin jep Vachudova, duke u mbështetur në konceptimin e influences së BE-së në bazë të mekanizmit të ndërhyrjes apo influencës pasive ose aktive (Vachudova: 2001). Mekanizmi nëpërmjet të cilit BE-ja ushtron ndikimin e vet aktiv për të realizuar plotësimin e kushteve politike të integritimit në vendet kandidate sipas Vachudova-s, dhe në mënyrë të suksesshme përfshin: “ndërvarësinë asimetrike [mes vendeve kandidate dhe BE-së], diktimin dhe vlerësimin sipas meritave” (Vachudova: 2001, f.137). Shembujt që sjell Vachudova për të ilustruar suksesin e ndikimit të ushtruar nga BE-ja, për të mbështetur dhe konsoliduar demokratizimin në vendet kandidate, tashmë vende anëtare si Sllovakia e Rumania tregojnë për pamundësinë e mekanizmit të ndërhyrjes e influencës aktive në promovimin e demokracisë dhe më konkretisht në respektimin e të drejtave të minoriteteve: “Këshilli i Evropës gjithashtu vendosi shtyrjen e hyrjes së Rumanisë. Pikërisht një javë pasi Rumania u pranua, sulmet anti-hungareze u bënë nga Iliescu, partitë në qeverisje dhe mediat” (2001, f.153). Ndërsa Sllovakia gjatë qeverisjes së koalicionit të drejtuar nga Meciar sikurse shprehet Vachudova: “Nuk e ndryshoi sjelljen e tij për të shmangur rrjedhën e kritikave të Perëndimit” (2001, f. 159). Për pasojë, pavarësisht nga ndikimi aktiv i BE-së për të detyruar këto vende në zbatimin e kushteve politike të Kopenhagenit dhe shmangien e abuzimit dhe shkeljen e rregullave demokratike, dështimi i të cilit vërehet më tepër në autoritarizmin e qeverisjes së Meciar-it, sikurse vetë Vachudova e pranon: “Madje dhe kur kërcënimi për përjashtimin i bënte mëse të qarta kostot e moszbatimit të kriterëve të Kopenhagenit, presioni i Perëndimit për të ndryshuar politika të caktuara kishte çuditërisht pak efekt në shtetet iliberale” (2001, f. 144).

Sipas modelit teorik të Vachudova-s, kushtëzimi demokratik përmes kësaj fuqie apo ndikimi aktiv të BE-së në politikën vendase të shteteve potencialisht kandidate, është i suksesshëm vetëm pas rrëzimit nga pushteti të një qeverisjeje jodemokratike dhe jo gjatë një qeverisjeje të tillë. Ndërkaq ndikimi aktiv i BE-së, që Vachudova e cilëson “*active leverage*”, duhet të mundësonte pikërisht ndryshimin e praktikave qeverisëse jodemokratike dhe përputhje me këto norma gjatë këtyre qeverisjeve problematike. Pra, modeli teorik i Vachudova-s është më tepër një konfirmim empirik i pamundësisë së mekanizmit të kushtëzimit demokratik në stepjen dhe kufizimin e praktikave jodemokratike të vendimmarrjes sesa një model i plotë teorik që të shpjegojë përse dhe si mund të dështojë ose të ketë sukses kushtëzimi demokratik i ushtruar nga BE-ja përpos cilësimit të vendeve ku ky mekanizëm ka qenë joefektiv si vende joliberalë. Njëherazi, ndarja që i bëhet shteteve potencialisht kandidate si liberale apo joliberalë nuk merr parasysh nuancat apo dritëhijet e praktikave jodemokratike të vendimmarrjes apo të qeverisjes, që jo detyrimisht mund t’i cilësojë këto vende si joliberalë apo autoritare. Shqipëria është një rast i tillë, ku megjithë ndikimin e BE-së për të pasur një administratë të pavarur, zgjedhje të lira dhe të drejta, ende vazhdon të mos ketë një përmirësim të dukshëm dhe një ngritje krye të praktikave qeverisëse jodemokratike.

Modeli teorik i konceptuar nga Frank Schimmelfennig, që conceptualizon faktorët që kushtëzojnë efikasitetin e kushtëzimit demokratik të ushtruar nga BE-ja ndaj vendeve kandidate, merr si njësi të analizës atë çka ai e quan mundësinë e “përshtatjes ndaj rregullave”, të cilët përfshijnë: “një gamë të gjerë çështjesh e strukturash dhe janë njëherësh formale dhe jo formale” (Schimmelfennig & Sedelmeier: 2004, f.7). Pra, përshtatja ndaj rregullave ndaj normave përbën një test për të vlerësuar evropianizimin e atyre strukturave të përmendura më lart nga Radaelli: strukturat politike, institucionet, mënyrat e të vepruarit dhe struktura normative. Përshtatje e suksesshme ndaj rregullave, normave të diktuar nga BE-ja përfshin sipas Schimmelfennig jo vetëm një përshtatje formale sikurse është transpozimi i *acquis communautaire*, po adoptimi i cili reflektohet në veprime që konformohen me rregullat e përshtatura dhe akoma më tej me përvetësimin e këtyre rregullave që bëhen referuese brenda një diskursi të caktuar (2004, f. 8).

Ky autor ofron dy modele teorike të analizimit të shkaqeve që çojnë në përshtatje ose jo ndaj rregullave atë që e quan Modeli i Nxitjes së Jashtme (*External Incentive Model*) dhe modeli i Socializimit (*Social Learning*

Model). Modeli i parë bazohet tek shpërblimet/sanksionet të vendosura nga BE-ja në rast të përmbushjes ose jo të kushteve dhe kriterëve për integrim përkundrejt analizës së kosto/përfitimeve të shtetit që synon të integrohet. Shtetet apo aktorët, sipas këtij modeli të paraqitur nga Schimmelfennig, nënkupton: “aktorë që ndjekin strategjinë e maksimizimit të përfitimeve dhe pushtetit të tyre”. Ndërkohë, Schimmelfennig vëren se kushtëzimi demokratik i BE-së vepron sipas asaj që ai e cilëson si *reactive reinforcement* (përforcimit reagues) në raste të mosplotësisimit të kushteve dhe *reinforcement by reward* (përforcimit përmes shpërblimit) në rast të përmbushjes së kriterëve dhe përshtatjes ndaj rregullit. Nisur nga ky konstatim, dhe duke u bazuar në Modelin e Nxitjes së Jashtme, (pa)mundësia e mekanizmit të kushtëzimit demokratik në ushtrimin e ndikimit për të realizuar përmbushjen e kushteve dhe të “përshtatjes me rregullin” nga vendet candidate shpjegohet përmes: vendosmërisë dhe qartësisë së rregullave dhe kriterëve që duhet të zbatohen, besueshmëria e kërcënimit nga ana e BE-së për ndërprerje të negociatave në rast mospërmbushjeje apo të shpërblimit në rast të kundërt, si dhe nga prezenca e kostove të brendshme të aktorëve që negociojnë sikurse qeveria apo faktorë të tjerë bllokues (2004). Duke marrë të mirëqenë vendosmërinë e rregullave, besueshmërinë për të ndërprerë apo avancuar negociatat në raport me kushtet e vëna dhe përshtatshmërinë ndaj rregullave, Schimmelfennig nënvizon se ajo çka përcakton përfundimisht, sipas këtij modeli teorik të mësipërm, (pa)mundësinë e përshtatjes ndaj rregullit janë kostot e brendshme të aktorëve qeverisës apo të aktorëve të tjerë ndikues (2004, p.16).

Konceptualizimi i (pa)mundësisë së suksesit të kushtëzimit demokratik

Në këtë nënndarje parashtrahet korniza teorike, që shpjegon në mënyrë më të plotë dështimin e kushtëzimit demokratik nisur nga modeli teorik i Socializimit (*Social Learning Model*) të Schimmelfennig së bashku me konceptin e evropianizimit të Radaelli-t. Ndërkaq, duke e konceptuar mekanizmin e kushtëzimit demokratik si të pandarë nga procesi i evropianizimit, nisur nga kjo premisë, paraqitet kritika ndaj strukturës së funksionimit të mekanizmit të kushtëzimit demokratik. Strukturë që nuk nxit dialogun me aktorë dhe faktorë të tjerë të shoqërisë, çka në të kundërt do të mundësonte institucionalizmin dhe përhapjen e normave dhe praktikave demokratike. Krahas mënyrës së funksionimit të këtij mekanizmi, dhënia e përparësisë arritjes së rezultatit, të plotësisimit të kushteve për një kohë relativisht të shkurtër, në vend të vëzhgimit dhe monitorimit të procesit përmes të cilit mbërrihet në përmbushjen e këtyre rezultateve është një e metë e këtij mekanizmi që shtjellohet në këtë nënndarje. Proces i cili megjithëse rezultativ nuk është në të shumtën e herës demokratik dhe nuk reflekton norma dhe praktika demokratike. Për të ilustruar aftësinë shpjeguese të kësaj kornize teorike të parashtruar, i referohem Sllovakisë gjatë qeverisjes së Meciar-it sikurse dhe qeverisjes “Nano” para dhe pas hapjes së negociatave me BE-në për MSA-në. Kjo, pasi fokusi i analizës më të plotë në rastin e Shqipërisë përbën qeverisja e djathtë e pas 3 korrikut nisur dhe nga fakti i gjendjes në një stad të ri në procesin e integritimit pas nënshkrimit të MSA-së.

Sikurse u vërejt më sipër, modeli teorik i nxitjes së jashtme (*External Incentive Model*) nënkupton se nëse kostoja e aktorit të brendshëm është më e lartë sesa përfitimi nga kushtëzimi i jashtëm, atëherë mekanizmi i kushtëzimit demokratik nuk do të funksiononte. Nisur nga kjo kornizë teorike, ky autor vlerëson se pamundësia e përshtatjes me rregullat e diktuar nga BE-ja dhe plotësisimit të kushteve parësore të Kopenhagenit në rastin e Sllovakisë lidhet kryesisht me faktin se: “Për qeverinë e Meciar-it kostot e përshtatjes ishin të larta. Motivimi kryesor për politikën autoritariste të Meciar-it ishte mbajtja e pushtetit...” (2004, p.38). Ndërkohë që Bashkimi Evropian i kishte bërë të qartë Sllovakisë për domosdoshmërinë e ndryshimit të kursit apo mundësinë e përjashtimit nga procesi i anëtarësisimit. Ndërsa Meciar-i, megjithë ushtrimin e kushtëzimit demokratik nga BE-ja vazhdonte kursin e tij jodemokratik e autoritar: “Zvogëloi të drejtat e opozitës në Parlament, ...solli administratën publike nën kontrollin e ndjekësve të tij. Për më tepër zgjeroi kontrollin e qeverisë mbi mediat audiovizuale, aplikoi presione financiare mbi mediat private dhe kufizoi lirinë e saj” (2004, f.35). Për pasojë,

nëse do të ndjekim këtë shpjegim të mospërputhjes së veprimeve të qeverisjes së Meciar-it me kriteret e vendosura nga BE-ja, atëherë rezulton se zbatimi i këtyre kriterëve nuk do të bënte gjë tjetër vetëm se do të rrezikonte pushtetin e Meciar-it, pra do të kishte kosto të lartë për këtë qeveri. Sikurse e pranon vetë Schimmelfennig: “Kushtëzimi demokratik i BE-së nuk kishte asnjë ndikim të rëndësishëm apo afatgjatë në qeverisjen e Meciar-it” (p.39). Vetëm me ndryshimin në qeverisje, me ardhjen e opozitës në 1998-ën në pushtet, një koalicion opozitar, që do të zhbënte praktikën qeverisëse jodemokratike dhe do të rivendoste zotimin për të ndjekur dhe zbatuar kushtet e vëna nga BE-ja Sllovakia, kushtëzimi demokratik do të funksiononte.

Modeli i socializimit (*Social Learning Model*), i cili buron prej institucionalizimit sociologjik, shpjegon sjelljen e veprimet e aktorëve nëpërmjet brendësimit dhe ndarjes së normave dhe vlerave të caktuara dhe jo mbi bazën e interesit vetjak për të maksimizuar pushtet. Sikurse e konsideron Bashkimin Evropian, si një komunitet vlerash themelore të përbashkëta. Ky model e shpjegon më qartë (pa)mundësinë e veprimit të kushtëzimit demokratik për dy arsye. Së pari, sepse, nëse nisemi nga premisa që një aktor vendas apo një qeveri e një vendi kandidat synon të maksimizojë pushtetin e tij, siç është premisa bazë e modelit të nxitjes së jashtme (*External Incentive Model*), atëherë kushtet e vëna përmes mekanizmit të kushtëzimit demokratik konsiderohen si pengesë apo kërcënim për rritjen e pushtetit të qeverisë së vendit joanëtar. Mirëpo, nëse e pranojmë këtë arsyetim, atëherë nuk na mbetet të shqyrtojmë më tej dhe të analizojmë dimensionin normativ dhe vleror të këtyre veprimeve dhe praktikave qeverisëse arbitrare dhe jo demokratike si në rastin e Meciar-it. Veprime të tilla jodemokratike, që kanë si synim përqendrimin e pushtetit, burojnë më së pari prej mospranimit dhe mosndarjes së normave demokratike si referuese për veprime dhe praktika qeverisëse. Së dyti, kriteret apo kushtet që kërkohen të përmbushen përmes ndikimit të mekanizmit të kushtëzimit demokratik nuk janë kriteret apo kushte mirëfilli teknike apo pjesë e *acquis communautaire*. Kushte si stabiliteti dhe pavarësia e institucioneve, respektimi i të drejtave të njeriut, lirisë së medias, pasja e një administrate publike të pavarur, sundimi i shtetit ligjor, reflektojnë norma dhe praktika të caktuara demokratike. Për pasojë, nëpërmjet modelit të socializimit kuptojmë më qartë mosefikasitetin e kushtëzimit demokratik përballë qeverisjeve “problematike”. Sikurse, nga ana tjetër, zgjidhja që parashtrohet në këtë punim për të rritur mundësinë e kushtëzimit demokratik në promovimin e demokracisë përmes ndërthyrjes së këtij mekanizmi me një proces evropianizimi të institucionalizimit dhe përhapjes së normave dhe praktikave demokratike merr më tepër vlerë.

Sipas këtij modeli, faktorët që mundësojnë zbatimin e kriterëve janë: legjitimiteti i kriterëve të përcaktuara nga BE-ja për t’u përmbushur, duke reflektuar normat dhe vlerat themelore të këtij organizmi, identifikimi i vendit kandidat, i qeverisë me vlerat dhe normat e këtij komuniteti ku kërkon të bëjë pjesë, si dhe rezonanca që kanë këto rregulla, norma, këto praktika që duhet të përshtaten me praktikën dhe normat vendase (2004, p.19-20). Kështu që, në bazë të kësaj kornize teorike dhe duke përfshirë dhe konceptin e “sjelljes konform-rregullit” të cilësuar nga Schimmelfennig, vërehet se gjatë tërë ushtrimit të kushtëzimit demokratik ndaj qeverisjes së Meciar-it, si aktori kryesor i procesit të negociatave, praktikën, sjelljet dhe veprimet e këtij koalicioni kanë qenë në kundërshtim me normat e një demokracie liberale, të shtetit ligjor, të respektimit të të drejtave të minoritetit si dhe të lirisë së medias.

Fill pas ardhjes në pushtet të Meciar-it në 1994 e më tej, kur mekanizmi i kushtëzimit demokratik filloi të ushtrohej mbi këtë qeverisje, mosshfaqja e një sjelljeje konform rregullave legjitime që duhet të përshateshin në lidhje me pavarësinë e administratës publike, liritë politike dhe mosdeformim të sistemit demokratik dhe vazhdimi i këtyre praktikave jodemokratike të qeverisjes, janë tregues i mungesës së identifikimit të kësaj qeverie me normat dhe vlerat demokratike të gjithëndara në hapësirën e BE-së. Sikurse shprehet Pridham: “Meciar nuk ndante atë motivim të njëjtë ideologjik apo historik për t’u angazhuar në bashkimin me Evropën me liderë të tjerë politikë të Evropës Qendrore” (2003, p.10). Për rrjedhojë, arsyeja e pamundësisë së kushtëzimit demokratik për të vepruar në mënyrë efikase kundërt qeverisjeve që shprehin forma dhe praktika jodemokratike

qeverimi nuk duhet kërkuar në kostot e larta që ndesh qeveria kundrejt zbatimit të rregullave dhe kritereve që do të çonin në humbjen e pushtetit, sipas idesë se synimi është maksimizimi i pushtetit, por në mungesën apo mosndarjen e normave dhe vlerave demokratike si referuese themelore për veprime dhe praktika legjitime demokratike nga qeveritë e vendeve kandidatë. Tek e fundit, nuk mund të kërkohej dhe pritjet një identifikim me normat dhe vlerat e komunitetit ku kërkon të integrohet vendi kandidat, kur qeveria e këtij vendi vepron sot e gjithë ditën në kundërshtim me këto norma.

Një shembull i mungesës së identifikimit me normat dhe praktikën qeverisëse demokratike është dhe qeverisja “Nano” e viteve 2002-2005, gjatë kohës së hapjes së negociatave të MSA-së. Megjithatë qeverisja “Nano” nuk mund të njehsohet me një qeverisje kryekëput autoritare të Meciar-it përsëri, vërehet se pavarësisht zotimit të shprehur për anëtarësim në BE, praktikën qeverisëse të ndjekur nga qeveria “Nano” nuk reflektonin normat demokratike. Raporte vjetore të BE-së gjatë kësaj qeverisjeje vërejnë një sërë problematikash që lidhen me vështirësinë për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, politizimin e administratës publike, lirisë së medias dhe shtetin ligjor: “Ka pasur ca progres në lidhje me administratën publike, por që është përmbysur për shkak të emërimeve politike dhe nepotike në një numër rastesh të rëndësishme” (Raporti i BE-së, 2003). Më tej në raport thuhet: “Respekti dhe zbatimi i ligjit në Shqipëri mbetet i pamjaftueshëm” (2003, f.2). Sikurse vëren qartë Raporti i Marsit 2003, ka një mospërputhje mes retorikës për integrim dhe kryerje të reformave dhe veprimeve të qeverisë “Nano”: “Integrimi Evropian ka mbetur një prioritet parësor i deklaruar i qeverive, por veprimet e tyre nuk kanë mbështetur këto deklaratat” (2003, f. 3). Mund të argumentohet se qeverisë “Nano” nuk i interesonte plotësisht i kushteve që lidhej me mbajtjen e zgjedhjeve të lira, e një administratë të pavarur apo sundimin e shtetit ligjor, pasi kjo do të thoshte më pak kontroll e pushtet të përqendruar në duart e qeverisë. Megjithatë, cilës qeverisjeje nuk do t’i pëlqente kontrolli apo përqendrimi i pushtetit në duart e saj, apo maksimizimi i pushtetit? Pra, në fund të fundit, vështirësia për të shkëputur administratën publike nga kontrolli politik, presioni financiar ndaj medias, pamundësia për të nisur vendosjen e shtetit ligjor dhe respektimin e ligjit, si dhe vështirësia për mbajtjen e zgjedhjeve të lira janë tregues të një praktike qeverisëse jodemokratike për të qëndruar në pushtet.

Madje, fill pas çeljes së negociatave në krye të vitit 2003 e deri pas raportit të vitit 2004 pas zgjedhjeve lokale të tetorit 2003, situata nuk pati shenja ndryshimi në lidhje me përmirësimin e treguesve të pavarësise së institucioneve, të mbajtjes së zgjedhjeve të lira dhe të drejta apo zbatimit të shtetit ligjor. Duke iu referuar zgjedhjeve lokale të tetorit 2003, raporti i BE-së shprehet: “...Zgjedhje thelbësisht të përmirësuara nuk u konkretizuan” (2004, f.4). Raporti vijon më tej: “Ka pasur raporte se është ushtruar presion ndaj nëpunësve të administratës publike nga autoritete politike qendrore ose lokale në muajt para dhe gjatë zgjedhjeve të tetorit 2003” (2004, f.4). Për rrjedhojë, faktet tregojnë për një vijueshmëri të praktikave qeverisëse jodemokratike, abuzive me pushtetin. Pra, gjatë qeverisjes “Nano”, përkundër retorikës për reforma evropianizuese dhe integruese, nuk ekzistonte një identifikim me normat dhe praktikën demokratike qeverisëse.

Në të njëjtën kohë, mekanizmi i kushtëzimit demokratik nga mënyra se si është strukturuar përmes caktimit të kushteve dhe kërkesave afatshkurtra dhe afatmesme që duhet të arrihen nuk nxit procesin e evropianizimit, të difuzionit dhe përvetësimit të normave dhe praktikave vendimmarrëse. Pra, në rastin e vendeve le t’i cilësojmë si problematike, sikurse rasti i Sllovakisë gjatë Meciar-it dhe siç vërehet në rastin e Shqipërisë, mosefikasiteti i kushtëzimit demokratik nuk i atribuohet vetëm mungesës së identifikimit me vlerat dhe normat demokratike, që duhet të përktheheshin në stepjen dhe mosvazhdimin e praktikave jodemokratike të qeverisjes, por edhe strukturës funksionale të këtij mekanizmi. Sikurse vëren Schimmelfennig, mekanizmi i kushtëzimit demokratik bazohet në *përforsim përmes shpërblimit* apo *përforsim reagues* në rastet kur shteti kandidat, pra qeveria e radhës, i plotëson ose jo kushtet e kërkuara, i përshtat ose jo rregullat e përcaktuara. Për pasojë, duke u përqendruar në negociatën kryesive dhe vetëm me qeverinë e radhës, duke parashtruar një numër kushtesh afatshkurtra apo afatmesme, dallimi mes këtyre cilësimeve kohore nuk është

i dukshëm, Bashkimi Evropian pret dhe këmbëngul në arritjen e rezultatit, ndërkohë që nuk nxit një proces të përhapjes dhe të institucionalizimit të normave, vlerave dhe praktikave që përshkojnë këto kushte të caktuara dhe që sigurojnë në mënyrë me të qëndrueshme zbatimin e tyre.

Ndërkohë, raporti mes BE-së dhe shoqërisë civile të vendit kandidat është i vagullt ku shoqëria civile shfaqet më tepër si një sektor më shumë që duhet përmirësuar sesa si një aktor i angazhuar në dialog me BE-në. Sikurse vëren Pridham, një e metë e mekanizmit të kushtëzimit demokratik është marrëdhënia e BE-së me shoqërinë civile të vendit kandidat: Megjithëse termi [shoqëri civile] shfaqet në disa dokumente zyrtare të BE-së si Programi PHARE për Demokracinë... nuk ka një kuptim të qartë në lidhje me të... Për pasojë vënia në zbatim e kushtëzimit demokratik priret të jetë e shpërbërë jo e plotë...” (2002, f.7). Nëse do të lidhte mekanizmin e kushtëzimit demokratik me një proces të tërë dialogu me grupe të interesit apo aktorë të shoqërisë civile, që janë faktorë në hapësirën publike të vendit kandidat, nëse do të ndërmernte një dialog paralel me këto faktorë përveç dialogut me qeverinë e radhës do t’i jepte jo thjesht më tepër legjitimitet procesit, por do të ndihmonte në pasjen e një pamje më të qartë të dinamikës së brendshme në lidhje me (pa)mundësinë e demokratizimit. Shqetësimet apo problematikat që shfaqeshin në hapësirën publike, në lidhje me proceset demokratizuese, me pavarësinë e institucioneve, me vendosjen e shtetit ligjor apo me deformime të demokracisë do të mund të përçoheshin dhe në raportet vjetore. Kështu që nxitet jo më një proces vertikal evropianizimi që mbështetet më tepër në vullnetin e qeverisë së radhës, por një proces horizontal ku këta faktorë shoqërorë e grupe të interesit, nga legjitimiteti që marrin nga përfshirja në proceset e integritit për shkak të faktorizimit nga BE-ja, luajnë njëherësh rolin e *epistemic communities* në difuzimin e vlerave, normave dhe praktikave si dhe të këmbënguljes për institucionalizimin e këtyre praktikave dhe normave nga qeverisja apo administrata e radhës.

Megjithatë, shembulli i Sllovakisë është tregues i një modeli të nxitjes së një procesi paralel të difuzimit dhe institucionalizimit të normave dhe praktikave demokratike në rastin kur shoqëria e vendit kandidat, duke përdorur një koncept të shpjeguar më lart të Schimmelfennig, shfaq një rezonancë kundrejt praktikave, modeleve të veprimit dhe normave të Bashkimit Evropian, të komunitetit ku kërkon të bëhet pjesë. Megjithëse angazhimi i faktorëve socialë nuk ishte pjesë e mekanizmit të kushtëzimit demokratik të BE-së, ky organizëm i gjendur përballë qeverisjes jodemokratike të Meciar-it legjitimon dhe faktorizon aktorë të shoqërisë civile që ndihmojnë në difuzimin e normave demokratike. Sikurse shprehet Vachudova: “Përfaqesuesit e institucioneve qeverisëse dhe joqeverisëse perëndimore ofruan informacion liderëve të opozitës dhe të organizatave të shoqërisë civile mbi thelbin e një axhende të demokracisë liberale, duke i vënë theksin llogaridhënies politike dhe forcimit të një hapësire politike të hapur plurale...” (f.163). Ndërkohë, ky proces i difuzimit të normave demokratike dhe praktikave legjitime të qeverisjes që duheshin ndjekur u krye në një kohë kur, sikurse thotë Pridham: “Mbështetja publike ndaj demokracisë si sistem ishte në rritje, ndjekur me një mobilizim të organizatave joqeveritare” (2002: f. 11). Pra, megjithëse jo në një formë të strukturuar dhe jo si pjesë integrale e strategjisë së kushtëzimit demokratik, rasti i angazhimit në dialog, direkt ose jo, i aktorëve të shoqërisë civile që ndanin të njëjtat norma dhe vlera demokratike me BE-në ndihmoi nisjen e procesit të difuzimit dhe pranimit të këtyre normave në këtë vend kandidat duke sjellë në pushtet pas 1998-ës një qeverisje që identifikohet me normat demokratike dhe i kishte ato referenca thelbësore të diskursit dhe veprimit politik.

Nëse i kthehemi rastit të qeverisjes “Nano” pas hapjes së negociatave të MSA-së, ndërsa Bashkimi Evropian vazhdonte të ushtronte mekanizmin e kushtëzimit demokratik në mënyrë jorezultative ndaj kësaj qeverisjeje për të bërë të mundur plotësimin e kriterëve për pavarësinë e administratës, respektimin e ligjit, luftën ndaj korrupsionit dhe vendosjen e shtetit ligjor në hapësirën publike shqiptare organizata të shoqërisë civile ushtronin presionin e tyre ndaj qeverisë “Nano” kundër praktikave të abuzimit me pushtetin dhe metodave jodemokratike qeverisëse. Kështu, mund të përmenden fushata të organizatës “Mjajt”, duke u

pasuar me protesta së bashku me opozitën më 21 shkurt të 2004 kundër qeverisë “Nano”, apo fushata të Zyrës për Mbrojtjen e Qytetarëve. Mund të argumentohet se ekzistonte një rezonancë mes aktoreve të shoqërisë civile shqiptare me kërkesat dhe kushtet e BE-së. Megjithatë, për shkak të strukturimit të tillë të mekanizmit të kushtëzimit demokratik që konsideron si parësor dialogun me qeverinë e radhës, BE nuk u angazhua në një proces dialogu me aktorë të shoqërisë civile, por u mjaftua me ushtrimin e presionit ndaj qeverisë. Për pasojë, nuk u ndërmor një proces i difuzimit dhe institucionalizimit të normave dhe praktikave demokratike nëpërmjet shoqërisë civile. Megjithëse duhet pranuar se mekanizmi i kushtëzimit demokratik ia mbërriti të detyrojë qeverinë “Nano” të mbajë zgjedhje të pakontestuarra parlamentare të korrikut 2005, por jo pa probleme. Por ajo çka nuk u arrit, për shkak të strukturës së tillë të mekanizmit të kushtëzimit demokratik dhe mosnxitjes së një procesi evropianizimi, ishte pamundësia për të pasur rezultate të qëndrueshme. Pasi sikurse do vihet re në pjesën e dytë të punimit, edhe pas ardhjes në pushtet të opozitës së djathtë pas 3 korrikut 2005, e cila premtoi të zhbënte çka qeverisja “Nano” kishte bërë keq në lidhje me procesin e integritetit dhe përbushjen e kushteve të BE-së, situata mbetet gati po e njëjta.

SHQIPËRIA PAS NËNSHKRIMIT TË MSA-SË

Duke u mbështetur në kornizën teorike të Schimmelfennig-it dhe Radaelli-t të shtjelluar më lart, do të analizohet në këtë pjesë të esesë (pa)mundësia e mekanizmit të kushtëzimit demokratik kundrejt përbushjes së kushteve dhe kriterëve politike, që lidhen me mbajtjen e zgjedhjeve të lira, pavarësinë e administratës publike, respektimin e lirisë së medias nga Shqipëria. Më saktë, do të jetë në analizë qeverisja e pas 3 korrikut lidhur dhe me faktin se nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit është kryer gjatë kësaj qeverie, çka mund të merret si një shenjë e vlerësimit nga ana e BE-së të progresit të deritashëm. Nënshkrimi më 12 qershor 2006 i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit pas tre vjetësh nga hapja e negociatave, duhet të përbënte një mundësi më tepër dhe më serioze për të provuar zotimin Evropian të Shqipërisë, dhe për më tepër të qeverisjes, duke mos u mjaftuar me konformimin apo përshtatjen formale ndaj legjislacionit të BE-së, por duke mos vënë më në dyshim pamundësinë për të mbajtur zgjedhje të lira dhe të ndershme, mospolitizimin e administratës publike, përkundër ngutjes për të centralizuar pushtet, apo për të bërë presion mbi median e lirë. Në raport me vlerat dhe normat demokratike të qeverisjes dhe pavarësisë të institucioneve, gjendja nuk është më mirë sesa ishte para nënshkrimit të MSA-së.

Ndryshe nga ç’ka ndodhur në një pjesë të vendeve të tjera kandidate për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, ku ekzistonin grupe apo parti politike euroskeptike, në Shqipëri zotimi për t’u anëtarësuar në BE është mëse i përsëritur dhe i gjithëpranuar. Sikurse shprehet Arolda Elbasani : “Përveç konsensusit të gjerë shoqëror, orientimi evropian reflekton një qëllim të përbashkët mes elitave shqiptare për të formësuar ndryshim të regjimit brenda modelit evropian” (Elbasani: 2004, f. 37). Në këtë linjë mendimi një raport mbi BE-në i AHS thekson dëshirën dhe identifikimin së paku diskursiv të elitës së re politike të pas ‘90-ës dhe qytetarëve me modelin e demokracisë liberale, me modelin e BE-së: “Rruga e vetme për t’u ndarë me izolimin tragjik dhe prapambetjen e thellë ekonomike u njehsua me integrimin evropian, përmes ndërtimit të demokracisë dhe ekonomisë së tregut të lirë” (f. 7). Për pasojë, ky identifikim me Evropën, me modelin evropian të shtetit, përmes artikullimit të shprehur për t’u bërë pjesë e saj duhet të reflektohej dhe në sjellje dhe praktika qeverisëse konform normave dhe rregullave demokratike sikurse mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, krijimi i një administrate publike të pavarur politikisht, respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirisë së medias. Tashmë dihet pamundësia e kahershme e mbajtjes së zgjedhjeve të lira duke nisur prej 1996-ës, apo raportet problematike të qeverive me mediat apo politizimi i administratës publike. Sikurse shprehet Hoffman, fill pas 1997-ës Bashkimi Evropian kërkonte përmes strategjisë së tij mbi Shqipërinë të arrinte në një proces ku: “...është në

interes të Shqipërisë dhe BE-së të nxisë zhvillimin e një shoqërie që përvetëson “rregullat e lojës” dhe parimet bazë të shoqërive evropiane” (2005: f. 62). Pikërisht “rregullat e lojës” janë deformuar, janë bishtnuar ga qeverisjet e radhës.

Mes zotimit dhe praktikave qeverisëse jodemokratike

Në raportet vjetore të publikuara nga Bashkimi Evropian mbi proceset integruese dhe reformat në Shqipëri, duke u fokusuar dhe në kriteret politike që duhet të ndiqen e zbatohen si dhe në Vendimin e Këshillit të 30 qershorit 2006 mbi Partneritetin Evropian të Shqipërisë me BE-në, i cili është një nga instrumentet e ndikimit dhe ndihmës mbi proceset integruese theksohet, se: “Prioritetet kryesore caktuar për Shqipërinë lidhen me kapacitetin e vendit për të përmbushur Kriteret e Kopenhagenit...”. Një kusht bazë i kriterëve të Kopenhagenit është qëndrueshmëria e institucioneve demokratike që nis me legjitimitimin e këtyre institucioneve përmes zgjedhjeve të lira dhe të drejta demokratike. Vërehet se një nga zotimet e qeverisë së pas 3 korrikut shpallur në programin e saj është dhe mbajtja e zgjedhjeve jo më problematike: “Zgjedhjet e lira dhe të ndershme do të jenë burim i vërtetë i legjitimitetit të institucioneve demokratike. Kthimi i besimit të publikut tek zgjedhjet është një prioritet absolut i mazhorancës së re qeverisëse” (Programi i Qeverisë: 2005). Nisur nga ky zotim i mazhorancës së re dhe duke parë një analizë të saktë për problematikën e vazhdimin të zgjedhjeve të kontestueshme shkruar në program: “Ndërkaq, vendosja e sistemit të korrupsionit, dhunimi i zgjedhjeve të lira, moszbatimi, zbatimi i dobët, i shtrembëruar ose vonesat në kryerjen e reformave, kanë shkaktuar humbjen në shkallë të gjerë dhe në nivele tepër të larta të besimit të shqiptarëve në institucionet shtetërore...” (Programi i Qeverisë) të bën të besosh se ajo çka Schimmelfenning quan identifikim të vendeve kandidatë me komunitetin në të cilin kërkojnë të integrohen duke ndarë të njëjtat vlera dhe norma (2004), është tashmë prezente në diskursin e koalicionit qeverisëse. Pra, është shpallur se nuk mund të këtë legjitimitet të institucioneve pa zgjedhje të lira.

Ndërkaq, raportet e OSBE-së, duke u konsideruar më tepër si analizë të proceseve zgjedhore të ndodhura sesa si aktorë në pamundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të drejta dhe të lira, vërejnë se zgjedhjet lokale të shkurtit 2007 nuk kishin një përmirësim rrënjësor nga zgjedhjet e fundit parlamentare të korrikut 2005. “Përgjithësisht, vëzhguesit e vlerësuan procesin e votimit keq ose shumë keq në 10 për qind të QV-ve të vizituara” (Raporti i OSBE-së: 2007, p.2). Kurse në raportin e zgjedhjeve parlamentare 2005 thuhet: “Në tërësi, vëzhguesit e vlerësuan pozitivisht votimin në 67 për qind të QV-ve të vizituara dhe vërejtën probleme domethënëse në 11 për qind të QV-ve të vizituara” (Raporti: 2005, p.25). Vërejtjet për zgjedhjet lokale vijojnë: “Në disa NJQV gjatë pasdites së ditës së zgjedhjeve. Vëzhguesit raportuan tension apo trazirë në 7 për qind të QV-ve të vizituara...” (Raporti: 2007, p.18). Për rrjedhojë, zgjedhjet lokale 2007 nuk vërtetuan atë zotim të ndërmarrë nga qeverisja, sikurse dhe nuk provuan një identifikim real me normat demokratike, duke shfaqur një mungesë të përvetësimit të rregullave demokratike kur reforma zgjedhore i mbetet një marrëveshje e minutave të fundit, kur situata parazgjedhore vijoi e tensionuar dhe mosbesuese mes kampeve kundërshtare, duke mos kryer një proces që në hapësirën evropiane ku kërkojmë të integrohemi është tashmë një proces sa vendimtar për legjitimitetin e institucioneve të dala nga zgjedhjet, aq sa dhe rutinor për shkak të mosdeformimit të rregullave të lojës demokratike.

Një tjetër kusht i shumëpërmendur në Raportet e BE-së për sa i takon kriterëve politike është dhe ndërtimi i një administrate publike të pavarur dhe efikase. Në Vendimin e Këshillit, më 9 nëntor 2005, kërkohet: “Të sigurohet zbatimi i Ligjit të Shërbimit Civil për emërimet dhe punën e administratës publike. Rekrutimi, transferimi dhe shkarkimi i nëpunësve civile të kryhet sipas rregullave të përcaktuara” (Vendimi i Këshillit: 2005, f. 7). Lidhur me këtë kërkesë të kahershme të BE-së, e cila ende nuk është zbatuar, çka do të mundësonte qëndrueshmërinë e institucioneve dhe vijueshmërinë e shtetit, mazhoranca e pas 3 korrikut

konfirmon zotimin e saj: “Qeveria do të kryejë një reformë të thellë e të vërtetë të administratës publike për krijimin e një rrjeti insitucional efektiv dhe eficient, si dhe të një administrate të qëndrueshme, të përkushtuar ndaj zbatimit të ligjit” (Programi Qeverisës). Përkundër këtij premtimi dhe shprehje e vullnetit për t’i dhënë fund praktikave abuzive jodemokratike dhe jo evropiane të rekrutimit të nënpunësve civilë mbi baza të preferencave partiake, miqësore apo klanore, sjellja dhe praktika qeverisëse e deritanishme, si dhe e kësaj qeverisjeje nuk shkon përtej “përshtatjes formale ndaj rregullit”, duke mos realizuar sjellje dhe praktika në përputhje me rregullin, sikurse vëren Schimmelfennig mbi mënyrën më të suksesshme të adoptimit të rregullave të diktuar nga BE-ja.

Sikurse raportohet në media në lidhje me reformën administrative, dobësimin e kompetencave të Departamentit të Administratës Publike dhe shkurtime të administratës: “...Departamenti i Administratës Publike ose, siç quhet ndryshe, DAP, është zhveshur nga kompetencat e veta dhe funksionon vetëm formalisht. Në fakt, shkurtime në administratën shqiptare pas vendimit të Këshillit të Ministrave kanë qenë tejet të përhapura...” (Gazeta Albania: Korrik 2007). Për të vazhduar më pas me shkurtime në Policinë e Shtetit, ku ndodhin dhe situata qesharake, ku të sapodiplomuar nga PAMECA u kërkohet shkarkim nga detyra: “Pala ndërkombëtare ka mbetur e befasuar tri ditë më parë kur dy oficerët u lajmëruan për shkarkim vetëm pak orë pasi kishin marrë diplomat nga ministri Nishani” (Gazeta Panorama: Korrik 2007). Emërimet abuzive në administratën publike përmenden dhe në Raportin e Komisionit Evropian të vitit 2006: “...Rekrutimi dhe shkarkimi i stafit ka ndodhur në disa raste pa respektuar Ligjin e Shërbimit Civil. Akte administrative janë firmosur nga zëvendësime të përkohshme që nuk kanë qenë caktuar në mënyrë zyrtare” (Raporti i BE-së: 2006). Për pasojë, kriteret apo standartet që duhen plotësuar për pasjen e një administrate publike të pavarur nuk janë përmbushur për shkak të vijueshmërisë së praktikave qeverisëse jodemokratike që mbeten tregues i mosdarjes së normave demokratike si referenca themelore dhe për rrjedhojë i mungesës së një procesi të institucionalizimit të këtyre praktikave, “mënyrës së kryerjes së gjërave” dhe normave.

Mospërputhje vlerash mes normave dhe rregullave të BE-së dhe praktikave të qeverisjes vërehet dhe në raportet e qeverisë me lirinë e medias. Në një vështrim dhe analizë të parë, do të dukej absurde që të vazhdohet me praktikën e presionit ndaj medias e krijimit të raporteve klienteliste me median. Një arsytim i mundshëm mbi këmbënguljen e qeverive të deritanishme për të kontrolluar mediat apo për të ngushtuar liritë dhe veprimin e institucioneve të pavarura, mund të jetë dëshira për të përqendruar pushtet apo frika e humbjes së pushtetit. Sidoqoftë, kalkulime të tilla politike që cenojnë lirinë e shprehjes, ku përfshihet dhe liria e medias shfaqin mungesën e theksuar të normave demokratike, tek e fundit këto vlera nuk merren si vlera të pakundërshtueshme dhe të patjetërsueshme. Po të lexohet programi qeverisës i mazhorancës nuk mbetet pa përmendur dhe zotimi për respektim të lirisë së medias: “Mediat në asnjë rast nuk do trajtohen në mënyrë diskriminuese, qoftë për interesa politike apo për interesa të tjera” (Programi i Qeverisë).

Përse duhet të përmendëj me ngulm premtimi për të mos diskriminuar asnjë media apo për të mos cenuar lirinë e medias, në rast se kjo do të ishte një praktikë rutinë qeverisëse? Rasti më i fundit i cenimit të lirisë dhe pavarësisë së medias, shtuar praktikave diskriminuese të ndëshkimit të mediave nga KKRT-ja, është kontrolli financiar dhe gjoba e vendosur ndaj televizionit “Top-Channel”, që çoi dhe në reagimin e gazetarëve, duke e cilësuar si: “Një kërcënim i lirisë së shprehjes për të gjithë komunitetin e gazetarëve... të cilët janë direkt të ekspozuar ndaj presionit ekonomik të qeverisë” (Balkanweb: Korrik 2007). Kështu që kërkesa e vazhdueshme e institucioneve të BE-së për të rritur lirinë e medias, sikurse vërehet në Planin e Partneritetit si një nga kushtet afatshkurtra: “Të përmirësohet liria e medias, veçanërisht duke miratuar legjislacionin e duhur për median e shkruar...” (Partneriteti Evropian: 2005), i cili është një kusht deri diku dhe teknik apo profesional, nuk mund t’i paraprijë një qëndrimi abuziv dhe diskriminues ndaj medias. Por deformime të tilla të lirisë së medias nuk mund të mohohet që kanë ndodhur.

Ndërsa kushtet e përmendura më sipër që i janë vënë Shqipërisë përbëjnë një specifikë tipike për të,

sikurse kërkese për mbajtjen e zgjedhjeve të lira apo depolitizimi i administratës, reforma e institucioneve dhe demokratizimi i tyre, e cila i përfshin dhe kushtet e analizuara më sipër, në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë dhe pavarësisë të tyre është një sferë e qenësishme që BE-ja mëton të realizojë përmes mekanizmit dhe praktikës së kushtëzimit demokratik në vendet kandidatë. Në Strategjinë e Zgjerimit 2006-2007 të BE-së theksohet: “Forcimi i institucioneve të këtyre vendeve është i rëndësishëm dhe reformat duhet të përqendrohen në reforma politike, juridike dhe ekonomike dhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar” (Strategjia e Zgjerimit). Pra, ajo çka kërkohet është institucione më të pavarura, më efikase dhe të qëndrueshme. Duket se ky qëllim i forcimit të institucioneve është kuptuar dhe nga pala qeverisëse shqiptare: “Të gjitha reformat dhe programet qeveritare do të hartohen dhe zbatohen me synimin e përshtatjes me modelet dhe arritjes së standardeve evropiane të demokracisë, shtetit ligjor...” Për më tej mbi respektimin e forcimit të pavarësisë të institucioneve shprehet: “Respektimi dhe garantimi i pavarësisë të pushteteve do të sigurojë funksionimin e institucioneve bazuar në Kushtetutë... ndërsa nisja dhe/ose vazhdimi i zbatimit të reformave do të rrisë efektivitetin e institucioneve themelore të shtetit demokratik” (Programi i Qeverisë). Ndërkaq, ky qëndrim apo zotim nuk është gjë tjetër veçse referim ndaj një diskursi të gjithëpranuar shprehur nga BE-ja për forcim të institucioneve. Sikurse u vu re më sipër, ato reforma që ndihmojnë në legjitimimin e institucioneve dhe përbëjnë pastaj premisën për pavarësimin dhe qëndrueshmërinë e tyre sikurse zgjedhjet e lira apo reforma për një administratë të pavarur dhe efikase nuk janë kryer. Nisur nga ajo analizë kryer në programin qeverisës dhe nga zotimi për garantimin e pavarësisë së institucioneve apo ndjekjen e modeleve evropiane të demokracisë apo shtetit ligjor, duhej të nënkuptohej se kjo qeverisje ndan normat themelore demokratike dhe vepron sipas tyre. Por praktikat qeverisëse vazhdojnë të mbeten jodemokratike në raport me pavarësinë e institucioneve apo me mënyrën se si kërkohet të kryet reforma e institucioneve.

Pa shkuar më tej mbi raportin që qeverisja tashmë ka krijuar me institucionet e pavarura dhe respektim të shtetit ligjor dhe Kushtetutës, mjafton të përmendet raporti i vështirë apo problematik i qeverisë me presidentin e mëparshëm në detyrë z. Moisiu apo institucione të tjera si Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe institucioni i prokurorit të Përgjithshëm. Nisur nga qëllimi për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, si një prioritet parësor i qeverisë, deformohet shteti ligjor dhe pavarësia e institucioneve, duke kërkuar më tepër përqendrim të pushtetit apo ndikim të ekzekutivit në këto institucione. Megjithatë mundësia e përdorimit për arsye politike të institucionit të akuzës mund të ndodhë dhe në shtete demokratike si në SHBA apo në disa vende të BE-së, procesi i përbaltjes apo linçimit të prokurorit të Përgjithshëm përmes një komisioni hetimor që tejkalonte caqet e kompetencave të tij, si dhe presioni dhe këmbëngulja për të kërkuar nga Presidenti i atëherëshëm i Republikës, shkarkimin e tij, dëshmon për përpjekje të cenimit të pavarësisë së institucioneve kushtetuese. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese mbi këtë çështje i dhjetorit të 2006-ës vëren se: “...veprimtaria e komisionit hetimor në këtë rast përbën një tejkalim të funksioneve të Kuvendit, mosrespektim të parimeve kushtetuese, si dhe ndërhyrje në kompetencat e organit të prokurorisë”. Gjykata Kushtetuese e cilësoi anti-kushtetuese procesin e hetimit dhe raportin përkatës për shkarkim të prokurorit të Përgjithshëm. Për rrjedhojë, zotimi i qeverisë për të bashkëpunuar me institucionet e pavarura kushtetuese, për të “garantuar pavarësinë e pushteteve”, si një kusht i stabilitetit të institucioneve dhe të demokracisë, për shkak të nismave anti-kushtetuese të përpjekjes për kontroll ndaj këtyre institucioneve, reflekton mungesën e identifikimit me normat demokratike, sikurse respektimi i pavarësisë së institucioneve e të shtetit ligjor është një ndër këto norma. Lufta ndaj korrupsionit mund të legjitimojë kritikën ndaj institucionit të prokurorit për mosefikasitet në luftën ndaj krimit apo korrupsionit, madje mund të legjitimojë dhe largimin e tij, por nuk mund të legjitimohen praktikat anti-kushtetuese si dhe praktikat jodemokratike të këtij procesi. Kufiri mes luftës së korrupsionit dhe moscenimit të pavarësisë së institucioneve kushtetuese bëhet i paqenë dhe tejkalohet kur procedurat dhe praktikat e ndjekura për të luftuar korrupsionin vijnë kundër shtetit ligjor dhe normave demokratike.

Në raportin e BE-së të vitit 2006, raport i cili së bashku me Planin e Partneriteti përbën një mekanizëm

të ushtrimit të Kushtëzimit Demokratik të BE-së për të nxitur demokratizimin e mëtejshëm në Shqipëri dhe që do të jetë pjesë e analizës në vijim për pamundësinë e këtyre mekanizmave në demokratizimin e vendit, përshkruhet përpjekja për përqendrim pushteti nga qeverisja aktuale: “Një rritje në numrin e institucioneve në varësi direkte nga Këshilli i Ministrave ka ndodhur, si dhe një tendence për mbikëqyrje direkte nga kryeministri” (Raport i BE-së: 2006, f.6). Shkeljet ndaj Kushtetutës dhe shtetit ligjor vijnë më tej: “Disa masa legjislative përcaktuar për të luftuar korrupsionin janë hedhur poshtë nga Gjykata Kushtetuese, për shkak të shqetësimeve mbi të drejtat e njeriut (si rasti i ligjit kundër nepotizmit në administratën tatimore)” (Raport: f.9). Nga një këndvështrim fakti se përpjekjet e kontrollimit të institucioneve të pavarura kushtetuese nga ana e qeverisë, sikurse rasti i Prokurorisë së Përgjithshme u frenua, të paktën deri më tash, dhe nismat ligjore anti-kushtetuese u hodhën poshtë nga Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera pasi një pjesë e tyre cenonin të drejtat e individëve, tregojnë për prezencën e mekanizmave të reagimit të sistemit demokratik, për një konsolidim të sistemit demokratik. Megjithatë, nga ana tjetër, duke e konceptuar sistemin demokratik dhe funksionimin e tij mbi bazën e disa normave dhe vlerave themelore, pasja e një modeli qeverisës që ndjek praktika qeverisëse dhe nisma në kundërshtim me këto norma, atëherë procesi i demokratizimit, i evropianizimit, i difuzionit dhe përvetësimit të praktikave demokratike do të jetë i papërfunduar dhe jo i qëndrueshëm në rastin e Shqipërisë.

Neglizhimi i shoqërisë civile

Ndërsa vërehet një mungesë e identifikimit me vlerat dhe normat demokratike dhe mospërvetësim të tyre në sjellje konform rregullave, që do të ishin referenca të pakundërshtueshme normative, por një deformim dhe anashkalim të këtyre rregullave dhe normave në elitën politike e qeverisëse shqiptare, shihet nga ana tjetër një “rezonancë”, term në të cilën Schimmelfenning-u përfshin faktorët vendas, të cilët pranojnë dhe janë të hapur ndaj normave të diktuar nga BE-ja (2004, f.20). Pra, përputhja e vlerave të referimit të faktorëve të brendshëm socialë dhe qytetarëve me vlerat dhe normat e BE-së, që ndihmon për pasojë procesin e evropianizimit. Në lidhje me demokratizimin e institucioneve dhe plotësimin e kushteve politike të kriterëve të Kopenhagenit, sikurse vrojton studimi i kryer nga Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, vërehet se qytetarët dhe grupe të caktuara sociale i vënë rëndësi më tepër kriterëve politike se atyre teknike: “Shqiptarët i shohin kriteret politike si më të rëndësishme sesa kriteret ekonomike” (Perceptime dhe realitete: 2006, f.10). Ndërkohë, studimi shkon më tej: “Ky është raporti i katërt që vërteton se faktorët që lidhen me konsolidimin e proceseve demokratike dhe mirëfunksionimi i shtetit ligjor janë më të rëndësishme se ekonomia e vendit” (2006, f.48). Për rrjedhojë ekziston një ndërjegjësim dhe vetëdije e këtyre grupeve të caktuara sociale apo dhe qytetarëve shqiptarë, mbi rëndësinë e normave demokratike që duhet të përçojnë proceset politike dhe funksionimin e shtetit të së drejtës.

Megjithatë, këto bindje të këtyre grupeve shoqërore apo të qytetarëve nuk janë reflektuar në procese që angazhojnë qytetarët ose grupe të interesit apo ato çka quhen *epistemic communities* (komunitete të dijes dhe ekspertizës) në një dialog paralel mes BE-së dhe këtyre grupeve të shoqërisë civile shqiptare, që janë faktorë apo përipiqen të jenë të tillë në procesin e integritimit. Kjo vjen, sikurse u përmend dhe në kornizën teorike të esesë, për shkak të strukturës të mekanizmit të kushtëzimit demokratik, që i jep përparësi raporteve me qeverinë e radhës, përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga qeveria e radhës dhe jo nxitjes së një procesi evropianizimi që përfshin faktorë të tjerë socialë.

Në Raportin e BE-së mbi Shqipërinë, shoqëria civile përmendet nën zërin “Të drejtat politike dhe civile”, (Raport 2006: f. 12) dhe jo si një zë më vete, që tregon për rëndësinë e pakët që BE-ja i kushton rolit të shoqërisë civile në procesin e evropianizimit dhe difuzionit të normave demokratike. Në diskursin e BE-së kundrejt shoqërisë civile dominon parashtimi i gjendjes faktike të ndikimit të organizatave joqeveritare si dhe shprehja e dëshirës për rritje të rolit të tyre, asgjë më tej: “Aktorët e shoqërisë civile në Shqipëri vuajnë nga një mungesë e burimeve të qëndrueshme, aftësive dhe kapaciteteve organizuese. Për pasojë dialogu mes

OJQ-ve dhe Qeverisë së Shqipërisë mbetet i dobët” (Raporti 2006: f. 12). Më tej në raport thuhet: “Shqipëria do të përfitonte nga një politikë qeverisëse që inkurajon në mënyre aktive përfshirjen e OJQ-ve në proceset e vendimmarrjes” (2006: f. 12). Pra, Bashkimi Evropian pret dhe dëshiron që qeverisja në Shqipëri të angazhojë në dialog grupe të caktuara sociale, organizata joqeveritare. Ndërkaq procesi i integritetit që përfshin përshtatje me rregullin dhe kushte politike që duhen përmbushur përballë një mënyre qeverisjeje problematike, që nuk reflekton dhe vepron sipas normave demokratike, do të fitonte më tepër legjitimitet dhe siguri nëse Bashkimi Evropian do të nxiste një dialog të përhershëm me faktorët e shoqërisë civile në Shqipëri. Pasi shoqëria civile, duke shfaqur një rezonancë me normat dhe vlerat demokratike, do të luante rolin e një kundërpeshe ndaj praktikave abuzive të pushtetit dhe shpërfilljes, në të shumtën e herës, së normave demokratike sikurse dhe rolin e aktorëve që do të përhapnin dhe këmbëngulnin në institucionalizimin e këtyre normave.

Rezultati përballë procesit: Ngulmimi për rezultate dhe harresa e normave demokratike

Përveç dimensionit strukturor të mekanizmit të kushtëzimit demokratik, që nuk mundëson suksesin e ndikimit të BE-së në procesin e integritetit, vërehet dhe një prirje e institucioneve të BE-së për të kërkuar me ngulm rezultatin, për të vlerësuar rezultatin sesa procesin përmes të cilit arrihet një rezultat i qëndrueshëm. Proces i cili duhet të nënkuptojë arritjen e rezultatit në përputhje me praktikën demokratike të vendimmarrjes dhe që do të kërkonte monitorimin nga ana e BE-së, nëse rezultati i përbushur, qoftë lufta kundër korrupsionit apo rezultate të tjera të pritshme, bie në kundërshtim me praktikën dhe normat demokratike të përfaqësuar në Kriteret e Kopenhagenit. Sikurse përmendet në partneritetin e BE-së me Shqipërinë, përveç prioriteteve kryesore, ku përfshihen kriteret e Kopenhagenit, përmenden dhe kushte afatshkurtra dhe afatmesme: “Këto përfshijnë përmirësimin e luftës kundër krimit të organizuar, përmirësimin e zbatimit të masave antikorrupsion” (Vendimi i Këshillit: 2005). Ndërsa si kriter të tjera afatshkurtra për kushtet politike përfshihen: “Të përgatiten në mënyrë të rregullt dhe në kohë zgjedhjet lokale 2006... Të sigurohet zbatimi i Ligjit mbi Shërbimin Civil për emërimet në punën e administratës publike” (Partneriteti Evropian: 2005, f.6). Pavarësisht se këto kërkesa apo prioritete janë legjitime dhe do të ndihmonin në forcimin e shtetit ligjor, priorizimi i tyre pengon plotësimin në kohë dhe si duhet të kriterëve dhe kushteve themelore të Kopenhagenit, duke përfshirë më së pari institucione të qëndrueshme demokratike dhe ndërtimin e një shteti ligjor në respekt të ligjit. Për pasojë, mekanizmi i kushtëzimit demokratik që synon më së pari të ndikojë në vendosjen e shtetit ligjor, pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e institucioneve demokratike, në moscenimin e lirive dhe të drejtave të njeriut e minoriteteve, bëhet i padobishëm kur përparësi i është dhënë arritjes së rezultatit konkret, pavarësisht nëse si procesi ashtu edhe vendimmarrja për realizimin e atij rezultati është joligjor apo jodemokratik.

Në një kohë kur normat dhe vlerat demokratike nuk janë përvetësuar sa të konsiderohen si të mirëqena në praktikën qeverisëse, atëherë këto prioritete afatshkurtra nuk do të mund të realizohen apo do të mbeten procese të deformatuara. Prandaj dhe në raportin e saj të 2006-ës, për reformat administrative BE-ja shprehej vetëm me tone konstatuese: “Emërimet politike të nëpunësve të lartë civilë mbeten mbizotëruese, duke kufizuar rritjen e nivelit profesional të shërbimit civil” (Raporti: 2006, f.7). Ndërsa në lidhje me praktikën centralizuese të qeverisë, të cilat analizohen në raport me efikasitetin sesa me prirjen për përqendrim pushteti dhe nuk shihen si shenjë e shpërfilljes së mënyrës demokratike të kryerjes të gjërave, raporti vëren: “Ky centralizim ka sjellë që shumë vendime teknike dhe rutinore të merren në nivelin e kryeministrit, që ka shtyrë veprime kyçe” (2006, f..6). Përsëri kërkohet rezultati i shpejtë dhe efikas, duke lënë në hije procesin herë-herë jo demokratik dhe jo në përputhje me normat dhe praktikën demokratike.

Prioriteti tjetër kyç i kërkuar me ngulm nga BE-ja, që përfshin luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, rezultatet e të cilit pritet të arrihen brenda një afati të shkurtë kohor, bën që praktikën qeverisëse në kundërshtim me ligjin të anashkalohen apo të mos merren seriozisht nga BE-ja, për sa kohë që ka rezultate

ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kështu, një ndër kushtet përfundimtare që duhet arritur në këtë proces drejt integritimit në Bashkimin Evropian, ai i ndërtimit të shtetit ligjor i lë vendin prioritetëve afatshkutra dhe kontradikore me praktikën demokratike. Në raport, për sa i takon nismave ligjore të qeverisë në luftën kundër krimit dhe korrupsionit si dhe përpjekjeve për reforma në drejtësi, vërehet: “Një komision i posaçëm parlamentar vendosi t’i rekomandojë presidentit shkarkimin e prokurorit të Përgjithshëm. Presidenti e hodhi poshtë këtë rekomandim” (2006, f. 8). Një pohim i tillë nuk reflekton aspak shqetësimin për përpjekjet e qeverisë për të kontrolluar institucionet e pavarura kushtetuese, pavarësisht faktit se një qëllim i tillë nuk është arritur, sikurse nuk reflekton as ato debate në hapësirën publike shqiptare mbi përpjekjet jodemokratike të luftës kundër korrupsionit dhe kontrollit të institucioneve.

Konsiderimi parësor i prioritetëve afatshkutra të luftës kundër korrupsionit dhe informalitetit sjellin dhe deformime të tilla të procesit kur flitet për lirinë e ushtrimit të biznesit apo të medias: “Një amendament ligjor pengon sipërmarrësit e mediave elektronike të marrin pjesë në tendera të sektorëve publikë. Kjo do të përbente problem në raport me konkurrencën e biznesit. Sidoqoftë, është një masë e fortë anti-korrupsioni, që do të ndihmojë në lirinë e medias” (Raporti: 2006, f.12). Për rrjedhojë, kushtëzimi demokratik i ushtruar nga BE-ja në institucionet shqiptare, ndaj qeverisjeve të deritanishme rezultoi i paefektshëm jo vetëm për shkak të vijueshmërisë së praktikave qeverisëse jodemokratike, duke mos shprehur një identifikim me normat dhe vlerat e BE-së nga ana e qeverisë shqiptare, as dhe vetëm për shkak të mosangazhimit të faktorëve socialë të shoqërisë civile, që do të ndihmonte në procesin e evropianizimit, por edhe për shkak të prioritizimit të rezultatit në kurriz të procesit përmes të cilit BE-ja do të vëzhgonte arritjen e kushteve të vëna konform normave dhe praktikave demokratike.

Ndërsa nga njëra anë Bashkimi Evropian kërkon të ndikojë në përmbushjen e kritereve politike të Kopenhagenit, sikurse janë ndërtimi i shtetit të së drejtës, stabiliteti i demokracisë dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut përmes mekanizmit të kushtëzimit demokratik, nga ana tjetër, kërkon njëherësh rezultate të pritshme në drejtim të forcimit të shtetit ligjor, të pavarësisë së institucioneve. Vështirë të vihet në dyshim se shteti i së drejtës apo qëndrueshmëria e institucioneve nuk reflektojnë norma themelore demokratike, sikurse respekti ndaj ligjit dhe pavarësia e institucioneve. Megjithatë lufta kundër korrupsionit apo krimit të organizuar mund të merret si tregues i forcimit të shtetit ligjor, rezultati mund të jetë arritur duke mos respektuar ligjin apo liritë e të drejtave të qytetarëve. Pra, krijohet një kontradiktë mes rezultateve konkrete të realizuara në mosrespektim të ligjit apo të kushtetutshmërisë dhe qëllimit të fundëm të ndërtimit të shtetit të së drejtës apo institucioneve të pavarura. Përpjekjet e BE-së për të ndikuar përmes kushtëzimit demokratik në vendosjen e shtetit ligjor në Shqipëri mund të jenë të kota, për sa kohë që mekanizmi i kushtëzimit demokratik nuk vihet në funksion të monitorimit dhe vëzhgimit të proceseve vendimmarrëse, për të parë nëse arritja e rezultateve është kryer në përputhje me normat e respektimit të ligjit, të pavarësisë së institucioneve dhe moscenimit të lirive të qytetarëve.

KONKLuzion

Procesi i sendërtimit dhe forcimit të institucioneve të pavarura demokratike i ndërtimit të shtetit ligjor nuk ka mbetur vetëm një proces brenda kufijve dhe hapësirës publike të vendeve ish-komuniste, që janë integruar apo po integrohen në strukturat e Bashkimit Evropian. Vetë ky organizëm është ndër aktorët kryesorë që synon të arrijë demokratizimin e institucioneve dhe përshtatjen me normat dhe ligjet e legjislativionit të BE-së të vendeve kandidate përpara se të anëtarësohen me të drejta të plota. Kriteret bazë që duhet të plotësohen nga vendet që aspirojnë të bëhen shtete anëtare të BE-së janë përcaktuar qysh herët në Samitin e Kopenhagenit të vitit 1993. Përpos legjitimitetit të kritereve të Kopenhagenit për demokraci të qëndrueshme, respektim të lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe një ekonomi të lirë tregu, BE-ja ka përcaktuar dhe mekanizmat e ndikimit

të saj në nxitjen e demokratizimit të vendeve candidate. Mekanizmi kryesor i ushtruar për të ndikuar në përmbushjen e kriterëve të Kopenhagenit është kushtëzimi demokratik. Mekanizëm i cili nuk është provuar efikas përballë qeverisjeve le të themi “problematike”. Sikurse u vërejt në punim, kjo rrjedh prej një sërë shkaqesh duke nisur nga mosidentifikimi i qeverive të vendit kandidat me normat demokratike tek mosndërthyrja e mekanizmit të kushtëzimit demokratik me një proces të evropianizimit, të përhapjes dhe institucionalizimit të normave dhe vlerave demokratike deri tek prioritizimi i rezultatit përkundër procesit.

Etapa e fundme dhe qëllimi përfundimtar i procesit të integritit si edhe e ndikimit që ushtron Bashkimi Evropian ndaj këtyre vendeve, përfshirë dhe Shqipërinë, është evropianizimi si proces i përhapjes, institucionalizimit dhe përvetësimit të praktikave, normave, rregullave dhe vlerave të gjithëndara dhe të gjithëpranuara brenda hapësirës evropiane në politikën kombëtare të vendeve candidate. Pra, tek e fundit mekanizmi i kushtëzimit demokratik, apo sukcesi i ndikimit të tij, duhet vlerësuar dhe analizuar sikurse bëhet në këtë ese në lidhje me arritjen ose jo të evropianizimit të strukturave politike, të raporteve mes shtetit dhe qytetarëve, të mënyres së funksionimit të gjërave.

Demokratizimi i mëtuar nga Bashkimi Evropian kundrejt vendeve candidate, që zbatohet kryesisht përmes mekanizmit të sipërpërmendur duke u ndihmuar dhe nga raporte të përvitshme apo plane të partneritetit, vërehet se është i mangët apo jo efikas në ato vende candidate, ku identifikimi i elitës politike apo të shoqërisë me normat dhe vlerat demokratike nuk është real dhe ku abuzimi me pushtetin apo prirja për të përqendruar pushtet nuk përbëjnë një praktikë qeverisëse tashmë të tejkaluar. Sikurse u vërejt në rastin e Sllovakisë gjatë qeverisjes së Meciar-it apo më gjerë në rastin e Shqipërisë, ku ende nuk është krijuar mundësia për një legjitimitet të pacenuar të institucioneve demokratike, procesi i demokratizimit të institucioneve mbetet i vështirë për sa kohë që nuk përvetësohen rregulla dhe norma demokratike.

Në të njëjtën kohë, procesi i evropianizimit si qëllim i fundëm i integritit, nuk mund të jetë i suksesshëm kur Bashkimi Evropian nuk angazhon në një dialog me të gjerë, sesa komunikimi me qeverinë e radhës të vendeve candidate, aktorë të tjerë të shoqërisë civile, grupe të interesit, të cilët do të luanin një rol në përhapjen e normave dhe praktikave normale evropiane dhe do të përbënin një siguri më shumë për shmangien e praktikave abuzive dhe jodemokratike qeverisëse apo shprehjen e shqetësimeve dhe debateve publike vendase në institucionet e BE-së. Ndërkaq, orientimi dhe këmbëngulja e institucioneve të BE-së që monitorojnë vendet candidate, dhe në këtë rast vende problematike sikurse Shqipëria, për të arritur rezultate afatshkutra pa i kushtuar rëndësinë e duhur nëse procesi përmes të cilit mbërrihet tek këto rezultate është demokratik dhe në përputhje me shtetin ligjor, deformon qëllimet finale të ndërtimit të institucioneve të pavarura dhe të qëndrueshme, ato kriterë të përcaktuara të Kopenhagenit.

Tek e fundit, nëse do t’i njihnim Bashkimit Evropian rolin apo të drejtën për të ndikuar në proceset demokratizuese në vendet candidate dhe për pasojë në Shqipëri do t’i duhej të kërkonim që të ndryshonte strategjinë e ushtrimit të kushtëzimit demokratik në këto vende në funksion të difuzionit dhe përvetësimit të normave dhe rregullave, çka do të bënte më të qëndrueshme dhe të sigurt rrugën drejt integritit në Bashkimin Evropian.

REFERENCAT

1. Dimitrova, A. & Pridham, G (2004), "International Actors and Democracy Promotion in Central and Eastern Europe: The Integration Model and its Limits", *Democratization*. Vol.11, No.5, pp.91-112.
2. Elbasani, A. (2004) "Albania in Transition: Manipulation or Appropriation of International Norms?" *Southeast European Politics*. Vol.5, No.1, pp. 24-44.
3. Grabbe, H. (2003) "Europeanization Goes East: Power and Uncertainty in the EU Accession Process". in *Politics of Europeanization*, eds. Featherstone and Radaelli. Oxford University Press.
4. Hoffmann, J. (2005) "Integrating Albania: The Role of European Union in the Democratization Process" *Albanian Journal of Politics* I (1), pp.55-74
5. Kajsiu, Blendi. (2006) "Integrimi si Pengesë për Demokratizimin" *Polis* 2
6. Pridham, G (2002) "The European's Union Democratic Conditionality and Domestic Politics in Slovakia: The Meciar and Dzurinda Governments Compared" *Europe-Asia Studies*. Vol.54, No.2 pp. 203-227.
7. Radaelli, C. (2003) "The Europeanization of Public Policy". In *The Politics of Europeanization*, eds. Featherstone and Radaelli. Oxford University Press
8. Raik, Kristi. (2004) "EU Accession of Eastern and Central European Countries: Democracy and Integration as Conflicting Logics" *East European Politics and Societies*. 18: pp. 567-594
9. Schimmelfennig, F. & Sedelmeier, U. (2004) "Introduction: Conceptualizing the Europeanization of Central and Eastern Europe". *Europeanization of Central and Eastern Europe*. Cornell University Press, New York, pp.1-28.
10. Schimmelfennig, F. Engert, S & Sedelmeier, U. 2004. "The Impact of EU Democratic Conditionality on Latvia, Slovakia, and Turkey". In *Europeanization of Central and Eastern Europe*, eds. Schimmelfennig and Sedelmeier. Cornell University Press, New York
11. Vachudova, M. (2001) "The Leverage of International Institutions on Democratizing States: Eastern Europe and the European Union" *European University Institute*. Working Paper, No. 2001/33.
12. Raporti i Bashkimit Evropian mbi Shqipërinë. 2006, (Albania 2006 Progress Report), marrë nga: http://ec.europa.eu/enlargement/archives/pdf/key_documents/2005/package/sec_1421_final_progress_report_al_en.pdf
13. Raporti i Bashkimit Evropian mbi Shqipërinë. 2004, (Third Annual Report: Stabilisation and Association Report 2004), marrë nga: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/cr_alb_en.pdf
14. Raporti i Bashkimit Evropian mbi Shqipërinë. 2003, (Second Annual Report: Stabilisation and Association Report 2003), marrë nga: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/com03_339_en.pdf
15. Raporti i OSBE-së mbi Zgjedhjet Lokale 2007, marrë nga: http://www.osce.org/documents/odihr/2007/06/24859_sq.pdf
16. Raporti i OSBE-se mbi Zgjedhjet Parlamentare 2005, marrë nga: http://www.osce.org/documents/odihr/2005/11/16905_sq.pdf
17. Partneriteti Evropian 2005. (Vendim i Këshillit, Bruksel: Nëntor 2005) marrë nga: <http://mie.gov.al/skedaret/1159431431-Partneriteti%20Evropian%202005-shqip.doc>
18. Programi i Këshillit të Ministrave (2005-2009) marrë nga: <http://www.keshilliministrave.al/shqip/programi/Shqip%20programi.htm>
19. European Enlargement Strategy (2006-2007) marrë nga: <http://europa.eu/scadplus/leg/en/lvb/e50025.htm>
20. Albanian Institute for International Studies. 2006, "Albania and European Union: Perception and Realities 2006". Tiranë, marrë nga: http://www.aiis-albania.org/Perceptions_Realities_2006.pdf
21. Albanian Institute for International Studies. (2004) "Shqipëria dhe Bashkimi Evropian" marrë nga: <http://www.aiis-albania.org/BE.pdf>
22. *Gazeta Albania*, (30 Korrik, 2007). "DAPI bllokuar, të larguarit zero shpresa për t'u rikthyer" marrë nga: <http://www.gazeta-albania.net/news.php?id=14627>
23. *Gazeta Panorama*, (1 Korrik, 2007): "Rikthehen të Diplomuarit nga PAMECA" marrë nga: <http://www.panorama.com.al/index.php?id=1135>
24. Balkanweb, (13 Korrik, 2007). "Tatimoret gjobe kanalit te Top-Channel, reagojne gazetaret"
25. Vendim i Këshillit 2006/54/EC (Janar, 2006) marrë nga: <http://europa.eu/scadplus/leg/en/lvb/r18011.htm>
26. Vendim i Gjykatës Kushtetuese (Vendimi nr. 26, datë 04.12.2006) marrë nga: <http://www.gjk.gov.al/vendimi06.html>

KOSOVA: SHTETI I PAPRECEDENT

Lulzim Peçi
Leon Malazogu
Ilir Dugolli*

Abstrakt. Ky punim shtjellon argumentet për rrugëtimin e Kosovës drejt pavarësisë si një rast unik, që rrjedhimisht i jep tagër Kosovës për t' u pavarësuar pa e cenuar të drejtën ndërkombëtare. Në këtë drejtim, punimi prezanton një sërë argumentesh si nga dinamika politike e veçantë që solli Kosovën deri në gjendjen e saj të sotme, e drejta ligjore dhe morale e saj si ish-njësi federale për t' u ndarë nga ish-Jugosllavia, tentimi i gjenocidit dhe trajtimi i vazhdueshëm brutal i shumicës shqiptare gjatë dekadave. Në këtë punim mbarështrohen një seri të veçorive që e dallojnë pretendimin e Kosovës për pavarësi karshi entiteteve të tjera, të cilat mund të kërkojnë pavarësi, duke e bërë atë një rast të paprecedentë.

HYRJE

Ky punim shtjellon argumentet për rrugëtimin e Kosovës drejt pavarësisë si një rast unik, që rrjedhimisht i jep tagër Kosovës për t' u pavarësuar pa e cenuar të drejtën ndërkombëtare. Në këtë drejtim, punimi prezanton një sërë argumentesh si nga dinamika politike e veçantë që solli Kosovën deri në gjendjen e saj të sotme, e drejta ligjore dhe morale e saj si ish-njësi federale për t' u ndarë nga ish-Jugosllavia, tentimi i gjenocidit dhe trajtimi i vazhdueshëm brutal i shumicës shqiptare gjatë dekadave.

Për shumicën e analistëve, dilema më nuk është se a do të pavarësohet Kosova, por se kur dhe si do të ndodhë kjo. Propozimi gjithëpërfshirës i UNOSEK-ut¹ për statusin e ardhshëm i ka ndihmuar shumicës së hisedarëve ndërkombëtarë të bashkohen rreth qëndrimit konsensual për pavarësinë e mbikëqyrur. Tani, shumica e qeverive publikisht e pranojnë pavarësinë si zgjidhjen e vetme të qëndrueshme për Kosovën. Me përkrahje të plotë të Shteteve të Bashkuara dhe të vendeve të Bashkimit Evropian, sekretari i Përgjithshëm i KB-ve, Ban Ki-moon, e ka përkrahur plotësisht zgjidhjen e statusit, ashtu siç është propozuar kjo në planin e Ahtisarit.

Në këtë punim mbarështrohen një seri të veçorive që e dallojnë pretendimin e Kosovës për pavarësi karshi entiteteve të tjera, të cilat mund të kërkojnë pavarësi. Gjatë tetë viteve të fundit Kosova ka funksionuar si protektorat ndërkombëtar. Para kësaj, shumica e banorëve të Kosovës i janë nënshtruar shkeljeve sistematike të drejtave të njeriut duke kulmuar me spastrim etnik, të cilat iu dha fundi përmes ndërhyrjes humanitare. Për dekada të tëra brenda ish-Jugosllavisë, Kosova ishte krahinë autonome si në kuadër të Republikës së Serbisë ashtu edhe njësi federale e federatës jugosllave, dhe sikundër republikat e tjera kishte të drejtë të vetos.

Në fund të shekullit të kaluar Kosova u pushtua nga Serbia dhe më pas pa pëlqimin e saj u përfshi në Jugosllavi, ndërsa nuk u lejua të ndahet kur kjo e fundit u shpërbë. Përkundër faktit se ish-federata në fjalë përjetoi kolaps të përgjakshëm, territori i Kosovës dhe kufijtë e saj nuk ndryshuan. Sot vendi udhëhiqet nga struktura demokratike dhe shumica dërrmuese e qytetarëve nuk përkrah asnjë zgjidhje tjetër përveç pavarësisë. Kuvendi i Kosovës i ka pranuar detyrimet që dalin nga propozimi i Ahtisarit, përfshirë dispozita të avancuara

* Lulzim Peçi është drejtor Ekzekutiv i Kosova Institute for Policy Development and Research (KIPRED)

Leon Malazogu është senior analyst dhe editor në KIPRED

Ilir Dugolli është senior analyst në KIPRED

¹ I dërguari i posaçëm i sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, ish-kryetari i Finlandës, Marti Ahtisari, i emëruar më 14 nëntor 2005.

për bashkësitë etnike. Kjo tregon përkushtimin e lartë politik për mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe për diskriminim pozitiv. E njëjta shkallë e pjekurisë demonstron edhe me garantimin shprehimor të integritetit territorial të shteteve fqinje. Këto janë vetëm disa prej veçorive të elaboruara në vijim.

Përderisa elemente të ngjashme nuk janë të pranishme në raste të tjera ku shtetësia është kontestuese, asnjë nga këto raste as për së afërmi nuk e përmban tërësinë e karakteristikave të Kosovës. Kjo përmbledhje e paprecedentë dhe e jashtëzakonshme e veçorive e bën Kosovën rast unik apo *sui generis*, siç thuhet shpesh me fjalorin e së drejtës ndërkombëtare.

Përveç dilemave nëse ka Kosova të drejtë në pavarësi, ka të tillë që druajnë se kjo mund të shërbejë si precedent për “territoret” e tjera, të cilat kërkojnë pavarësi – duke e rrezikuar kështu parimin themelor të së drejtës ndërkombëtare, atë të sovranitetit shtetëror. Për pasojë, çështja e statusit ende mbetet e pazgjidhur dhe rrezikojnë pasoja serioze nëse vazhdon gjendja ekzistuese. Në këtë aspekt, në punim pohohet se mënyra në të cilën është duke u adresuar statusi i Kosovës assesi nuk e dëmton sistemin ndërkombëtar.

Në fund të fundit, a do të trajtohet Kosova si përjashtim apo jo, është çështje interpretimi. Vendet me ambicie për të përkrahur aleatët e tyre pasqyrojnë në rrugëtimin e tyre drejt shtetësisë apo të interesuar për të penguar pavarësimin e Kosovës, do të insistojnë se Kosova paraqet precedent. Përderisa kërkesat politike për pavarësim do të vazhdojnë në raste tjera, ky punim përpiket të vërë në pah se, nëse shikohet më me kujdes, Kosova dallohet dukshëm nga rastet e tjera. Për të ilustruar dhe krahasuar vizualisht përjashtueshmërinë e Kosovës, në fund të punimit është dhënë një matricë që përfshin disa nga territoret e kontestuara, që të gjithë të vlerësuar kundruall disa kriterëve relevante për shtetësi (shih Apendiksin).

Themelet e sistemit të sotëm ndërkombëtar qëndrojnë mbi parimet vestfaliane të sovranitetit shtetëror. Ndonëse sovraniteti shtetëror mbetet parimi themelor i së drejtës ndërkombëtare, ai i nënshtrohet trysnisë për evolucion si rezultat i ndikimit gjithnjë e më të madh të vlerave etike në të drejtën ndërkombëtare. Rrjedhimisht, shtetet tani e kanë shumë më të vështirë që të ndërmarrin spastrime etnike në territorin e tyre, për shkak të presionit nga vendet tjera dhe organizatat ndërkombëtare. Sistemi ndërkombëtar së bashku me konceptin e sovranitetit është në evolucion, për disa tejet ngadalë e për disa tejet shpejtë.

Për disa, evolimi i së drejtës ndërkombëtare ka shkuar aq larg sa që ua merr të drejtën shteteve për të qeverisur pjesë të territorit, në rastet të keqtrajtimit të rëndë të popullatës. Pavarësia e Kosovës shihet si zhvillim pozitiv nga disa, shkelje apo stërzgjatje e koncepteve nga të tjerë. Vështirësia për të matur këtë në mënyrë objektive dhe natyral thelbesisht politike bëjnë që vendimi për këtë çështje të jetë i varur nga interesat e anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit. Instrumentalizimi i vendimmarrjes për kriteret politike, siç perceptohet nga shtetet anëtare, shpie në përdorim jokonsistent të parimeve. Bie fjala, Federata Ruse vazhdimisht mbështetet në parime të ndryshme për Abkhazinë dhe në të tjera për Çeçeninë.

Krijimi i shteteve të reja nuk mund të përjashtohet. Ndonëse dera nuk është plotësisht, ajo mbetet pjesërisht e hapur për territoret tjera që potencialisht të pavarësohen, jo si rregull, por duke u bazuar në rrethana të jashtëzakonshme, të cilat duhet t’i përcaktojë e drejta ndërkombëtare nëse dëshiron të mbetet relevante për zgjidhje të konflikteve. Pavarësisht kësaj, duke qenë vendi i vetëm me të gjitha veçoritë e përmendura më poshtë, Kosova duhet të trajtohet tërësisht në vijë me procesin e evolucionit të ngadalshëm të së drejtës ndërkombëtare. Konsensusi në rritje për pavarësinë e Kosovës pjesërisht pasqyron opinionin në rritje se kjo nuk ndryshon thelbesisht njohjen e sovranitetit shtetëror. Përmes këtij punimi, në radhë të parë shpjegohet pse Kosovës i takon pavarësia dhe se kjo pavarësi nuk e vë në pyetje sistemin ndërkombëtar.

Cak i spastrimit etnik dhe i tentimit të genocidit

Regjimi i Serbisë gjatë viteve nëntëdhjetë ndërmori fushata sistematike dhe brutale të dëbimit të shqiptarëve etnikë, përderisa këta të fundit u përgjigjen me rezistencë paqësore. Si pasojë e politikave të

aparteidit të zbatuara nga Beogradi, në vitin 1998, rreth një çerek milioni kosovarë kishin kërkuar strehim jashtë vendit. Kjo fushatë kulmoi me vrasjen e rreth dhjetë mijë personave dhe me dhjetëra mijëra raste të dokumentuara mirë të torturës, dhunimit, shkatërrimit të pronës, etj. Represioni i viteve nëntëdhjetë qartazi buronte nga një strategji për të ndryshuar strukturën demografike të Kosovës. Që kjo nuk ishte një plan i çastit që mund t'i mvishet vetëm Millosheviçit më së miri shihet nga politika konsistente e establishmentit serb, përfshirë partitë politike kryesore, Akademinë e Shkencave dhe të Arteve (Çubrilloviç më 1937 dhe memorandumit i kësaj akademie në vitin 1983) dhe Kishën Ortodokse Serbe për të shndërruar shqiptarët në pakicë në këto hapësira.

Pushtimi fillestar i Kosovës u përcoll me përpjekje të vazhdueshme për të ndryshuar përbërjen etnike të territorit. Përpjekjet e tilla përfshinë dëbimin e shqiptarëve nga Kosova, reformën agrare, gjegjësisht nacionalizimin e dhunshëm të pronave të shqiptarëve, dhënien falas të parcelave të tokës ushtarëve dhe vullnetarëve serbë etj. (Malcolm 1998: 291). Në funksion të politikave të tilla, shqiptarët u projektuan si problem i sigurisë dhe si kërcënim demografik që urgjentisht kërkon “ilaçin” e duhur. Kjo hapi rrugën për përkrahje publike të politikave të dhunshme kundër shqiptarëve. Fushata serbe e spastrimit etnik (1998-1999) rezultoi me rreth një milion kosovarë të dëbuar nga shtëpitë e tyre, shumica prej tyre jashtë vendit, që paraqet dëbimin më të madh të popullsisë në Evropë që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Një numri të tyre iu shkatërruan dokumentet gjatë dëbimit, duke ua bërë kështu të vështirë të vërtetojnë identitetin e tyre më vonë.

Bashkësia ndërkombëtare filloi t'i kushtojë vëmendje këtij procesi, por masat e saj kaluan pa ndikim, duke i mundësuar Serbisë që vazhdimisht të shpërfillë disa rezoluta të Këshillit të Sigurimit. Pas shterjes së të gjitha mjeteve, diplomatike bashkësia ndërkombëtare iu frikësua përsëritjes së skenarit të Bosnjës. Në këtë kontekst, NATO nisi ndërhyrjen humanitare për të parandaluar “gjenocidin kundër shqiptarëve të Kosovës” (Triantaphyllou 2001). Pas përfundimit të luftës, disa zyrtarë të Serbisë (përfshirë dy ish-kryetarë) u akuzuan nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi (ICTY), për krime kundër njerëzimit të kryera në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.

Nga të gjitha territoret e kontestuara, të përfshira në matricën më poshtë, vetëm Sudani dhe Çeçenia i përngjajnë Kosovës për nga shkalla e dhunës dhe e dëbimit të popullsisë. Përkundrazi, disa prej tyre e mbështesin kërkesën e tyre për pavarësi mbi faktin që janë shumicë, ndonëse janë bërë të tillë përmes spastrimit etnik—Republika Serbe, Osetia e Jugut dhe Abkhazia e kanë ndryshuar strukturën etnike të territoreve gjegjëse përmes dhunës. Për dallim prej tyre, shqiptarët e Kosovës kanë arritur të mbesin shumicë përkundër spastrimit etnik të cilit i janë nënshtruar.

Duke qenë në shënjestër të një politike të qëllimshme qeveritare që solli deri tek tentim-gjenocidi, kosovarët vështirë se mund të zhbëjnë mosbesimin e tyre ndaj Serbisë. Megjithatë, vetë vuajtjet e pësuar nuk do ta cilësonin Kosovën për të qenë shtet po të mos ishin edhe argumentet tjera të mbarështuara më tej në këtë punim.

Shpërbërja e shtetit të përbashkët

Siç përkruhet në pjesën paraprake, spastrimi etnik zuri vend gjatë periudhës së shpërbërjes së dhunshme të shtetit të përbashkët, Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë (RSFJ). Në këtë pjesë argumentohet se për shkak të shpërbërjes së shtetit të përbashkët, Kosova ka të drejtë të zgjedhë rrugën e vet. Çështja e Kosovës qartazi duhet parë në “kontekst të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë” (Kosovo Report 2000: 24). Në përgjithësi pranohet se shpërbërja e ish-Jugosllavisë ka filluar me suprimimin e dhunshëm të autonomisë së Kosovës, në vitin 1989.

Asnjë rezolutë nuk e përcaktoi Kosovën si pjesë të Serbisë si të tillë; e vetmja që është në fuqi (1244) e njeh Kosovën si pjesë të RFJ-së. Si pjesë e mbetur e ish-federatës, Republika Federale e Jugosllavisë, më

pas Unioni Serbi-Mali i Zi, gjithashtu u shpërbë në vitin 2006, kur 55,53% të qytetarëve të Malit të Zi votuan për pavarësi. Sipas një juristi ndërkombëtar, transformimi i RSFJ-së në “Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ), të panjohur ndërkombëtarisht dhe transformimi i mëvonshëm i kësaj të fundit në Unionin Serbi-Mali i Zi ka zbehur dhe mjegulluar çfarëdo lidhje juridike ndërmjet Kosovës dhe pjesëve të mbetura të ish-Jugosllavisë” (Williams 2007). Pavarësisht implikimeve ligjore të këtij argumenti, kjo tregon se krijesat shtetërore pasuese nuk i kanë akomoduar bashkësitë tjera, gjegjësisht malazezët, të cilët vendosën të qeverisin vetën pa mbikëqyrje të Serbisë.

Duke mos pasur identitetin e ndonjërit nga grupet etnike të mëdha, Jugosllavia kishte gjasa, sado të kufizuara, për të ruajtur bashkëjetesën e grupeve të ndryshme etnike. Për më tepër, edhe vetë emri i shtetit identifikohet me “sllavët e jugut”, duke lënë kështu shqiptarët si të vetmin grup përmasash të konsiderueshme në gjendje të vështirë për t’u identifikuar me shtetin në fjalë (shqiptarët ishin grupi i pestë për nga madhësia sipas regjistrimit të fundit të besueshëm në ish-Jugosllavi, më 1981: 36.3% serbë, 19.7% kroatë, 8.9% myslimanë, 7.8% sllovenë, 7.7% shqiptarë). Emancipimi i shqiptarëve shtoi vetëdijen se vullneti për të jetuar brenda shtetit të përbashkët varej nga të qenit të barabartë me të tjerët. Kjo u manifestua në një numër protestash dhe kërkesash politike, të cilat më 1974 sollën deri te avancimi i statusit të Kosovës në nivel të përgjegjësive të barabarta me ato të republikave.

Fundi i viteve tetëdhjetë solli kthesë në drejtim të kundërt, me përpjekjet për të shndërruar shqiptarët në pakicë brenda Serbisë, gjë që nxiti trazira dhe fundin e RSFJ-së. Politika luftënxitëse kundër Kosovës u dha sinjalin republikave të tjera se do të ishin më të sigurt të pavarura. Vitet pasuese sollën sqarimin e statusit të të gjitha njësive të tjera të ish-Jugosllavisë dhe njohjen e tyre reciproke, madje edhe nga Serbia. Për ironi, hapësira më e pakënaqur ende nuk ka arritur të zgjidhë çështjen e saj. Prandaj duhet theksuar se vetëm me zgjidhjen e statusit të Kosovës drama e përgjakshme e ish-Jugosllavisë do të gjejë epilogun e saj.

Përfaqësim i barabartë në nivelin federativ të ish-strukturës së përbashkët shtetërore

Kjo pjesë nxjerr në pah se përkundër faktit që Kosova për kah emri ishte krahinë, përgjegjësitë e saj ishin përgjithësisht të njëjta me ato të republikave, ajo ishte e përfaqësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në strukturat federative dhe rrjedhimisht, me shpërbërjen e kësaj të fundit, Kosova ka të drejtë të zgjidhë shtegun e saj të mëvetësisë.

Disa analistë nxjerrin përfundimin se për shkak të emrit “krahinë”, Kosovës nuk do të duhej t’i takonte e drejta në ndarje. Megjithatë, meqë ekziston përdorimi i një numri të madh të emrave të ndryshëm, me të drejtën e mjegullt për ndarje, argumenti këtu duhet të përfshijë për krahasim edhe zgjidhjet federative. Për shembull, niveli më i lartë i njësive të ish-Bashkimit Sovjetik, “republikat e bashkuara” kishin të drejtën për ndarje, ndërsa shkalla e dytë, “republikat autonome”, nuk e kishin një të drejtë të tillë. Kosova është e krahasueshme si me nivelin e parë ashtu edhe me atë të dytën të njësive të ish-Bashkimit Sovjetik: (a) nuk kishte shprehimisht të drejtën për ndarjes, sikundër edhe republikat autonome, por (b) ajo ishte njësi e barabartë federale, ngjashëm me “republikat e bashkuara” të ish-Bashkimit Sovjetik. Rrjedhimisht, mund të përfundohet se në krahasim me zgjidhjet federative të ish-Bashkimit Sovjetik, rasti i Kosovës qëndron ndërmjet dy llojeve të republikave. Për këtë arsye, kërkohet analizë më e thellë e statusit që gëzonte Kosova brenda Federatës Jugosllave.

Në përcaktimin se a kishte Kosova status të barabartë të njësisë federale duhet shikuar: (a) shkallën e përfaqësimit në nivel federativ dhe (b) përgjegjësitë e subjektit në fjalë. Brenda kornizës së ish-Jugosllavisë, autonomia e Kosovës me kohë kishte ardhur duke u zgjeruar dhe statusi i saj u avancua me kushtetutën e fundit para shembjes së RSFJ-së, atë të vitit 1974. Prandaj, për të gjitha vendimet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në nivelin federativ, kërkohet pëlqimi i Kosovës si njësi federale, rast ky pothuajse i paparë në ndonjërin nga federatat tjera, me përjashtim të federatave të avancuara si Kanadaja apo Zvicra. Në të gjitha

aspektet, statusi i krahinave autonome ishte praktikisht i njëjtë me atë të republikave – Kosova u bë element konstitutiv i Jugosllavisë së decentralizuar dhe mbeti pjesë e Serbisë vetëm në emër.

Kushtetuta e vitit 1974 qenësisht i shtoi përgjegjësitë e krahinave autonome, duke u dhënë atyre të drejtën e vetos në vendimet e parlamentit republikan dhe federativ. Kjo, madje, në disa raste interpretohej si diçka që e bënte Kosovën më të fuqishme se vetë Serbia, pasi Serbia nuk mund të vinte veto në vendimet e Kuvendit të Kosovës. Pas vdekjes së Titos, Kosova madje kishte të drejtë në kryesinë me rotacion dhe në 1976-1977, një shqiptar nga Kosova e kryesonte Jugosllavinë. Kosova kishte të drejtë në kushtetutën e vet, në zgjedhjen e përfaqësuesve të vet në kuvendin federativ sipas të njëjtës bazë dhe me të njëjtat të drejta sikundër edhe republikat e tjera federative. Ngjashëm me republikat, Kosova kishte policinë, inteligjencën, forcat e mbrojtjes territoriale, bankën qendrore, gjyqësinë dhe elementet e tjera shtetërore, që i jepnin llogari Kuvendit Krahinor. Organet federative ishin kryesisht të angazhuara në ushtrimin e mbikëqyrjes.

Shumë argumente kundër pavarësisë së Kosovës vënë në pah se ajo nuk gëzonte të drejtën për vetëvendosje ashtu sikur që këtë e gëzonin republikat. Megjithatë, duhet pasur parasysh se as republikat nuk e kishin shprehimisht të njohur këtë, meqë kjo e drejtë nuk mbështetej në territor. Argumenti mbështetej në dallimin ndërmjet kombeve “konstitutive” dhe atyre “jokonstitutive” - *kombeve dhe kombësive*. Se një parim i tillë ishte joadekuat dhe fluid, rrjedhimisht kundërproduktiv, shihet nga pretendimet e Serbisë për të pasur brenda kufijve të vet pjesë të Kroacisë dhe pjesë të tjera të ish-Jugosllavisë. Rrjedhimisht, kjo nuk është marrë për bazë për kombet “konstitutive” kur këto ishin në pakicë në ndonjë republikë tjetër.

Njohja e të drejtës për ndarje të të njëjtit territor dy gupeve të ndryshme ka shkaktuar gjakderdhje. Prandaj erdhi deri tek interpretimi praktik nga ana e Komisionit arbitruar të konferencës së paqes për ish-Jugosllavinë (i njohur si Komisioni i Badinterit), për të drejtën në ndarje të republikave përgjatë kufijve republikanë. Në fund të fundit, ndarja ndërmjet popujve si kombe dhe kombësi është trashëgimi e shëmtuar e së kaluarës dhe nuk do të duhej të merret si kriter, meqë në disa raste shfuqizon shumicën dhe arsyeton aparteidin. Shumica kosovare ishte “komb jo-konstitutiv”, i cili kërkon pavarësinë dhe parimi i lartpërmendur do të duhej të favorizojë këtë interpretim.

Heqja e paligjshme e autonomisë së Kosovës

Për shkak të statusit të fuqishëm brenda federatës, mënyra e vetme për të reduktuar autonominë e Kosovës ishte përmes ndryshimeve të miratuara nga vetë Kuvendi i Kosovës. Fakti se për të reduktuar autonominë e Kosovës kërkohet pëlqimi i Kuvendit tregon më së miri se ku qëndronte sovraniteti përfundimtar. Shumë analiza kanë vënë në pah se autonomia e Kosovës është anuluar në mënyrë të paligjshme, rrjedhimisht bëhet kontestimi i saj mbi bazën e: (a) miratimit joligjor të ndryshimeve kushtetuese gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, (b) kërcënimit dhe (c) shkeljeve thelbësore të procedurës.

Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme nga ana e institucioneve federative hapi rrugën për ndërhyrjen në Kosovë të forcave policore serbe, nën autoritetin e policisë federative dhe pa pëlqimin e vendorëve. Nga ana e policisë serbe është ushtruar trysni ndaj Kuvendit të Kosovës duke e rrethuar këtë të fundit dhe duke çuar drejt anulimit të statusit të autonomisë në mars 1989. Këto ndryshime kushtetuese janë bërë me dhunim të dukshëm të kushtetutës federative dhe të asaj të Kosovës. Procedura e paraparë për miratimin e ndryshimeve kushtetuese nuk është respektuar dhe nuk kishte vota të mjaftueshme në favor të ndryshimeve të propozuara. Për pasojë, kur nën trysni u miratuan ndryshimet, ato nuk u pranuan nga përfaqësuesit dhe qytetarët e Kosovës.

Shpeshherë është konstatuar se Komisioni i Badinterit nuk u ka njohur krahinave të drejtën në pavarësi. Duke mos pasur shprehimisht detyrën për të gjykuar se a kanë të drejtë në ndarje krahinat, Robert Badinter thekson se nuk ka pasur mundësi që të vendosë për një gjë të tillë (2007). Si rezultat, nuk mund të nxirret

përfundimi se Kosova shprehimisht është lënë brenda Serbisë. Gjatë kësaj kohe Kosova ishte nën pushtim të paligjshëm dhe nuk përfaqësohej nga një udhëheqësi legjitime. Në këtë drejtim, nuk mund të kishte kërkesë zyrtare që t'i jetë dorëzuar Badinterit në emër të Kosovës. Duke qenë faktikisht nën pushtim, nuk mund të merrej asfare pëlqimi i Kosovës për të ardhmen e vet. Përfundimisht, duhet dhënë interpretimin se në 1991 nuk është marrë vendim për Kosovën dhe se vendimi që atëbotë është marrë për njësitë e tjera mbetet i hapur për Kosovën sot e kësaj dite.

Përgjithësisht, mund të përfundohet se “sovrانيتi” i takonte popullit të Kosovës. Heqja e autonomisë në vitin 1989 në thelb e privoi Kosovën nga sovraniteti i vet brenda Jugosllavisë. Përderisa në rastin e republikave të tjera, ky sovranitet i brendshëm u shndërrua në të jashtëm, ai i Kosovës u humb. Në këtë vijë, republikat e tjera braktisën federatën, duke e lënë Kosovën nën shtypjen e regjimit të Millosheviçit.

OBJEKTIFIKIMI I KOSOVËS

Në këtë pjesë argumentohet se për shkak të spastrimit etnik dhe trajtimit të shqiptarëve si qytetarë të rendit të dytë në mënyrë të vazhdueshme që nga aneksimi, Serbia e ka humbur të drejtën për të qeverisur Kosovën. Një historiane serbe ilustron trajtimin e shqiptarëve gjatë viteve, kur ajo vë në pah se “përderisa përipiqeshin të ‘çlirojnë dhe bashkojnë popullin serb’ dhe krijimin e një shteti të madh kombëtar, politikanët serbë u treguan të paafte për të qeverisur tokat e pushtuara njësoj sikurse pjesët e tjera të territorit. Kjo është e vërtetë për Serbinë e zgjeruar në vitin 1913, sikundër edhe për Jugosllavitë që pasuan. Qëndrimi i Beogradit karshi shqiptarëve ‘përzjashtonte tolerancën dhe barazinë’” (Stojanoviç 2007).

Rënia e Millosheviçit nuk ishte sihariq për politika më të mira ndaj Kosovës. “Demokratët” e rinj e kanë humbur rastin për të treguar pendim për padrejtësitë e shkaktuara shqiptarëve të Kosovës. Për më tepër, sipas zyrtarëve të lartë të UNMIK-ut, Beogradi paraqet pengesën kryesore për implementimin e plotë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR 1244/1999), duke dekurajuar kthimin e serbëve të zhvendosur në Kosovë dhe pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në institucionet e reja demokratike. Një shembull drastik në kohët e fundit është referendumi për kushtetutën e re të Serbisë (tetor 2006), ku shqiptarët e Kosovës nuk u përfshinë në listat e votuesve, për dallim nga serbët e Kosovës.

Për fat të keq, edhe sot e kësaj dite Partia Radikale Serbe, që angazhohet për “kthimin” e shqiptarëve të Kosovës në Shqipëri, vazhdon të fitojë më shumë vota se cilado parti tjetër në Serbi. Hulumentimet e opinionit publik tregojnë se shumica e serbëve dëshirojnë që Kosova të jetë pjesë e Serbisë, por nuk do të dëshironin të jetojnë pranë shqiptarëve si fqinjë. Nga kjo del përfundimi se Kosova është e dëshirueshme për serbët, por pa shqiptarët që jetojnë aty.

Në anën tjetër, demokratët e vetëshpallur heqin dorë nga përgjegjësia e Serbisë për ngjarjet e mëhershme. “Ka tendencë për të trajtuar 5 tetorin e vitit 2000 [rënia e Millosheviçit] si dita Zero. Ndërsa Serbia duhet të ballafaqohet me të kaluarën e saj si bazë për kthim në normalitet dhe tranzicion demokratik dhe për bashkëpunim ndërkombëtar” (Kosovo Commission, 2001). Pavarësisht nga dallimet e koalicionit demokratik krahasuar me të kaluarën diktatoriale, në qasjen ndaj Kosovës nuk vërehet ndonjë ndryshim.

Në anën tjetër, pavarësisht një ndryshimi të mundshëm të politikave të Beogradit, shumica shqiptare në Kosovë nuk do të pranonte asnjë lloj integrimi në Serbi. Siç ka vënë në pah komisioni ndërkombëtar prestigjioz, pas “asaj që shqiptarët kanë pësuar në duart e autoriteteve të RFJ-së, ata janë tërësisht të pavullnetshëm për të pranuar çfarëdo shprehje të sovranitetit mbi krahinë, qoftë edhe të natyrës simbolike” (Kosovo Report 2000: 9). Sot shumica e diplomatëve pajtohen se qeverisja e Serbisë mbi Kosovën është joreale dhe se Serbia nuk do të ishte në gjendje të rivendoste kontrollin e saj apo edhe të mbante ndonjë prani të lehtë pa shkaktuar gjakderdhje masive.

Paafëzia historike për të qeverisur territorin e banuar nga një grup tjetër etnik, sikundër edhe spastrimi etnik dhe shkelja masive e të drejtave të njeriut, ndikojnë në humbjen e autoritetit moral të shtetit për të qeverisur territorin në fjalë. Ndonëse etika nuk luan rol të drejtpërdrejtë në të drejtën ndërkombëtare, siç është theksuar më lart, vendimet që merren janë politike, prandaj ato ndikohen edhe nga opiniononi publik brenda shteteve. Për pasojë, konsideratat e tilla etike gjithnjë e më shumë po bëhen faktor i rëndësishëm në çështjet që paraqesin shqetësime ndërkombëtare.

Territori i kufizuar qartë me kufij të dallueshëm

Një ndër tri kriteret themelore për shtetësi sipas së drejtës ndërkombëtare është territori i përkufizuar qartë, kriter ky të cilin Kosova e plotëson. Kufijtë e Kosovës janë të përcaktuar me Kushtetutën e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK) të vitit 1974, sipas së cilës, kufijtë e brendshëm (të republikave dhe krahinave) nuk mund të ndryshoheshin pa pëlqimin e njëjësive gjegjëse, ndërsa kufijtë ndërkombëtarë të Jugosllavisë nuk mund të ndryshoheshin pa pëlqimin e të gjitha njëjësive (Kushtetuta e RSFJ 1974: Neni 4.5). Që nga qershori 1999 kufijtë e Kosovës kontrollohen bashkërisht nga autoritetet e Kosovës (IPVQ), UNMIK-u dhe KFOR-i. Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme e vitit 2001 më tutje përkufizon Kosovën si “territori i pandashëm”. Grupi i Kontaktit ka përjashtuar opsionin e ndarjes së Kosovës si mundësi e zgjidhjes së statusit (Grupi i Kontaktit 2006: Neni 6). Ndër vendet tjera që kërkojnë shtetësi, të pakta janë ato që kanë qartësi të kufijve rreth territorit të kontestuar (të tilla janë p.sh. rajoni Bask, Irlanda e Veriut). Ndërsa Transdnistria ka arritur të krijojë një territor të dallueshëm nën kontrollin e vet, por me kufij që asnjëherë nuk janë kodifikuar në kornizë legjitime e të pranuar.

Vullneti i shumicës për t'u ndarë

Si përgjigje ndaj heqjes kundërkushtetuese të autonomisë, udhëheqësit e shqiptarëve të Kosovës në vitin 1991 organizuan referendum. Një pjesëmarrje shumë e lartë e gati të gjithë shqiptarëve (89% e personave me të drejtë vote) rezultoi me 99% të votuesve në favor të pavarësisë së Kosovës. Në dritën e politikave të aparteidit të ushtruara nga Beogradi gjatë viteve nëntëdhjetë, ndjenja propavarësisë si zgjidhja e vetme e pranueshme vetëm sa është konsoliduar. Në përpjekjet për të shmangur ndërhyrjen në vitin 1999, bashkësia ndërkombëtare organizoi bisedimet në Rambouillet. Ndonëse dokumenti i konferencës (i refuzuar nga delagacioni serb) nuk parashihte referendumin si formë të vendimmarrjes, ai bënte me dije se statusi nuk mund të vendoset kundër vullnetit të qytetarëve. Formulime të ngjashme janë përfshirë edhe në deklaratat pasuese të Grupit të Kontaktit.

Dy faktorë shtesë theksojnë karakteristikat e Kosovës, në kontrast me shumicën e pretenduesve për shtetësi. E para, jo vetëm që shumica e shqiptarëve të Kosovës e përkrahë pavarësinë, por këtë vullnet e ndajnë edhe të gjitha pakicat joserbe që jetojnë aty. Vetëm bashkësia serbe (një ndër shtatë bashkësitë e vendit) e ka të vështirë të pajtohet me faktin se ajo nuk është më pakica që sundon. E dyta, për dallim nga disa prej territoreve që kanë arritur të bëhen shumicë përmes konfliktit (Abhazia, Osetia e Jugut, Republika Serbe), shqiptarët e Kosovës kanë përbërë shumicë të padyshimtë gjatë gjithë kohës së ekzistimit të Kosovës si subjekt më vete. Ndonëse ende ka popullatë të zhvendosur, ata kanë të drejtë të kthehen mirëpo edhe sikur të gjithë të ktheheshin kjo nuk do të ndryshonte strukturën etnike as për 3-4%. Vlen të përmendet gjithashtu se Kosova nuk dëshiron bashkim me ndonjë vend tjetër, për dallim nga disa prej vendeve të vetëshpalluara të hapësirës ish-sovjetike. Për dallim nga rastet si Irlanda e Veriut apo Kuebeku, të cilat do të pavarësoheshin sikur të kishin më shumë se 50% të banorëve në përkrahje të pavarësisë, në rastin e Kosovës edhe përkundër një shumice shumë më të madhe kjo nuk është marrë si kriter vendimtar.

Statusi i hapur nën protektorat ndërkombëtar

Për dallim nga shumica e konflikteve “të ngrira”, statusi i Kosovës zyrtarisht është i hapur. Duhet theksuar se të gjithë hisedarët ndërkombëtarë, përfshirë edhe Rusinë, shprehin dëshirën për të zgjidhur statusin e Kosovës. Procesi për zgjidhjen e statusit është në zhvillim e sipër dhe në këtë drejtim nuk ka ndonjë shembull të ngjashëm në rastet e tjera në botë.

Ndërhyrja ushtarake e NATO-s kundër Serbisë në vitin 1999 i dha fund fushatës ushtarake dhe mundësoi kthimin e rreth një milion refugjatëve. Prania ushtarake dhe civile u vendos më pas sipas autorizimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Duke u mbështetur në autorizimet e kapitullit VII të Kartës së OKB-së, Rezoluta 1244 i jep UNMIK-ut pushtetin më të lartë civil në Kosovë, ndërsa forcave të udhëhequra nga NATO (KFOR) u jep pushtetin më të lartë ushtarak. Përkundër paqartësisë për statusin përfundimtar, UNMIK-u mori mbi vete funksione shtetërore, të sqaruara më tej në rregulloren e parë, ku u përcaktua se të “gjitha përgjegjësitë legjislative dhe ekzekutive që kanë të bëjnë me Kosovën, përfshirë administrimin e gjyqësisë, i takojnë UNMIK-ut dhe ushtrohen përmes Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm” (Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1. Neni.1.1).

Ndonëse Rezoluta 1244 e njeh sovranitetin nominal të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) mbi Kosovë, ajo megjithatë i merr të gjitha veçoritë e shtetësisë mbi Kosovën. Për më tepër, Rezoluta e lë të hapur statusin deri në zgjidhjen e statusit të ardhshëm. Aty ku përmendet sovraniteti i RFJ-së, atij i referohet “... në kontekst të periudhës kalimtare deri në zgjidhjen e statusit përfundimtar dhe jo në pafundësi” (Williams 2004: 409). Këmbëngulja e Serbisë në Rezolutën 1244 si garanci për sovranitetin e saj mbi Kosovë është keqinterpretim që injoron faktin se e njëjta rezolutë e shpall të hapur çështjen e statusit, duke vënë në pah kështu nevojën që të gjendet zgjidhja.

Mandati ndërkombëtar i vendosur në Kosovë në qershor të vitit 1999 synonte të ishte i përkohshëm. Për këtë arsye bashkësia ndërkombëtare është ngarkuar me detyrën që të udhëheqë “procesin politik drejt përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës...” (UNSCR 1999: Art.11.e). Në këtë kontekst, UNMIK-u është dashur që përkohësisht të mbajë pushtetin në duart e veta dhe që paralelisht me këtë të fuqizojë Kosovën për vetëqeverisje të efektshme dhe t’i përgatisë për zgjidhje të statusit. Kjo përfshiu ngritjen e institucioneve vendore dhe mbartjen graduale të përgjegjësiave tek ta nga administrata ndërkombëtare.

Në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare ka marrë mbi vete rolin e kujdestarit të përkohshëm, gjë që nuk ka ndodhur në asnjërin nga hapësirat tjera në konflikt ku kontestohet e drejta për shtetformim. Ekzistojnë raste të përfshirjes ndërkombëtare në formë të ndërmjetësimi, mbikëqyrjes së armëpushimit apo të përkrahjes së vendeve drejt pavarësisht, por Kosova paraqet vendin e vetëm që është në kujdestari ndërkombëtare dhe me status të hapur. Për këtë arsye, sekretari i Përgjithshëm i KB-ve nga fundi i vitit 2005 emëroi të Dërguarin e Posaçëm për çështje të statusit të ardhshëm të Kosovës. Mund të pohohet se statusi i përkohshëm i UNMIK-ut, i gërrshuar me ngritjen e strukturave të vetëqeverisjes demokratike dhe dispozitat për përcaktimin e statusit të Kosovës, vetëkuptojnë shtegun e pavarësisht në vend të kthimit nën sundim të Serbisë.

KËMBËNGULJA E SERBISË PËR TË NGRIRË KONFLIKTIN

Siç elaborohet më lart në këtë punim, Serbia asnjëherë nuk ka treguar gatishmëri për të trajtuar Kosovën sipas standardeve bashkëkohore të Evropës, drejt së cilës aspirojnë të dyja vendet. Serbia nuk është e gatshme ta lërë Kosovën në rrugëtimin e saj, por në të njëjtën kohë nuk është në gjendje që ta integrojë atë në çfarëdo forme që do të ishte në pajtim me vlerat moderne. Në vend të pranimit të humbjes dhe të fajësisht të Millosheviçit pas rënies së tij, koalicioni “demokratik” ka shpresuar që ta mbajë atë në gjirin e vet. Tani

udhëheqësit serbë përballen me alternativën e humbjes së Kosovës dhe të fajësohen për këtë. Të paafitë për të pranuar “humbjen apo për t’u pajtuar në mënyrë konstruktive me shqiptarët e Kosovës, serbët tani kanë si dalje të vetme ndershpetuese (a) ndarjen, ose, si mundësi të dytë (b) të ngrijnë konfliktin sa më gjatë që të jetë e mundur.

Kjo ka sjellë deri tek politikat jokoherente të Beogradit. Në njërin anë Beogradi thërret në ndihmë të drejtën ndërkombëtare për të mbajtur Kosovën, por në anën tjetër nuk ka asgjë për të ofruar që kosovarët do të pranohet. E vetmja ofertë e Serbisë deri më tani është ajo e zhvilluar rreth konceptit “më shumë se autonomi, më pak se pavarësi”. Serbia ishte pjesë e bisedimeve për vite të tëra dhe zgjodhi të mos i shfrytëzojë ato siç duhet. Në vend të kësaj, Serbia, e përkrahur nga Rusia, vazhdimisht insiston në bisedime të reja dhe që të dy këto shtete fuqimisht kundërshtojnë çfarëdo afatizimi (në pajtim të plotë me mungesën e opsioneve).

Megjithatë, nuk ka faktorë të rinj, të cilët do t’i bënin bisedimet e ardhshme me më shumë gjasa për të pasur sukses. Në të vërtetë Serbia ka përdorur një numër taktikash për të zvarritur, penguar apo shmangur bisedimet për statusin e Kosovës, gjë që e bën edhe më absurd insistimin e tyre për bisedime të reja. Rrjedhimisht, mund të përfundohet se çfarëdo bisedimesh të sërishme do të shfrytëzohen nga Serbia për ta lënë anash statusin e Kosovës, në mënyrë që të shmangë “humbjen” dhe për t’i ikur përgjegjësisë së ofrimit të një statusi të pranueshëm për Kosovën.

Meqë gjendja në terren është e paqëndrueshme, urgjentisht duhet të adresohet statusi i përhershëm. Kjo është alternativa e duhur, meqë Rezoluta 1244 i ka shërbyer qëllimit të saj dhe Kosova tanimë e ka zhvilluar kapacitetin e vet shtetëror.

KAPACITETI QEVERISËS DHE DEMOKRATIK I UDHËHEQJES SË VENDIT

Sot Kosova paraqet një subjekt funksional që ka dëshmuar aftësinë e drejtimit të shtetit. Ekzistojnë struktura tërësisht legjitime të ngritura nën mandatin e administratës ndërkombëtare dhe më pas, nën këtë administratë, ka krijuar strukturat demokratike vetanake. Me vendosjen e administratës ndërkombëtare në Kosovë, udhëheqësit politikë të Kosovës hoqën dorë nga strukturat e tyre të ndërtuara më parë, gjegjësisht qeveria në ekzil dhe qeveria e përkohshme. Nga viti 2000 deri 2004 u mbajtën katër palë zgjedhje, dy herë në nivelin mbarëkosovar dhe dy herë për kuvendet komunale. Të gjitha këto zgjedhje janë cilësuar të lira dhe të drejta nga OSBE-ja dhe organizatat monitoruese. Në çdo rast zgjedhjet janë pasuar me respektim të jashtëzakonshëm të standardeve ndërkombëtare dhe me bartje të qetë të pushtetit. Sistemi zgjedhor në Kosovë është një ndër sistemet më inkurajues për përfaqësim të pakicave, me sistem të skajshëm proporcional dhe me vende të rezervuara.

Në Kosovë shumica e përgjegjësive më parë të asocuara me sovranitet, janë bartur në duar të institucioneve vendore. Buxheti mbushet tërësisht nga të hyrat vendore. Institucionet pasqyrojnë përbërjen multi-etnike dhe në mbarë sistemin ekzistojnë mekanizma të diskriminimit pozitiv. Kosova ka polici multi-etnike dhe të udhëhequr në mënyrë demokratike, sikundër që ka edhe fuqi të miratimit të konventave ndërkombëtare. Për më tepër, udhëheqësia kosovare u ka rezistuar tundimeve populiste dhe ka dëgjuar këshillat e bashkësisë ndërkombëtare drejt krijimit të ndarjes së pushtetit dhe përgjegjësive të mëdha për pakica. Gjatë njëzet viteve të fundit Kosova është zhvilluar ndaras nga Serbia me strukturë të veçantë institucionale. Ajo ka sistem të pavarur të qeverisjes, sistemin e vet ligjor, është entitet i pavarur doganor, përdor monedhë tjetër, ka politikat e veta fiskale dhe tatimore dhe paraqet vlera, simbole dhe referenca të ndryshme historike. Asnjë nga territoret që ka për aspiratë pavarësinë nuk posedon kapacitetin e ngjashëm për shtetësi siç e ka Kosova.

Për dallim nga vendet e tjera ku pavarësia është kërkesë e artikulluar nga qeveritë marionetë, institucionet e Kosovës qartazi përfaqësojnë vullnetin e kosovarëve, duke qenë se kanë lindur përmes zgjedhjeve të organizuara

nga bashkësia ndërkombëtare dhe të pranuar nga të gjithë si të lira dhe të drejta. Një përjashtim i dukshëm është mospjesëmarrja e serbëve lokalë në zgjedhje, duke vënë kështu në dyshim legjitimitetin e udhëheqësisë së serbëve të Kosovës (të cilët bojkotojnë disa prej institucioneve). Ndryshe nga rasti i Kosovës zgjedhjet e mbajtura në shumicën e vendeve të kontestuara (p.sh. Nagorno Karabah, Transdnistria) nuk janë pranuar nga institucionet ndërkombëtare. Për më tepër, për dallim nga shumica e vendeve me pupullsi të zhvendosur, Kosova mbetet e përkushtuar për t'ua mundësuar të gjithë të zhvendosurve që të votojnë. Në zgjedhjet paraprake, UNMIK-u madje ka hapur qendra votimi në Serbi dhe Mal të Zi. Si për akomodimin e pakicave, ashtu edhe për mbledhjen e tatimeve, ushtrimin e marrëdhënieve me jashtë, ofrimin e shërbimeve, standardet demokratike, aftësinë e drejtimit të shtetit etj, Kosova dallohet kur krahasohet me shembujt e tjerë.

Ndarja e pushtetit, decentralizimi dhe të drejtat e pakicave

Gjatë dekadave të fundit përkushtimi për mbrojtjen e të drejtave individuale dhe kolektive ka fituar peshë të rëndësishme për sa i përket rrugëtimit drejt shtetësisë dhe njohjes ndërkombëtare. Në mesin e pretendentëve të tjerë për shtetësi, Kosova ka demonstruar përkushtim unik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave. Kjo është arritur përkundër së kaluarës dekurajuese dhe kundërshtimeve të fuqishme, duke qenë se gjatë nëntëdhjetës, “prania serbe në qytete si Prishtina është identifikuar me sistemin kolonial” (Rupnik 2000).

Garancitë ligjore të vendosura gjatë administrimit të UNMIK-ut dhe pranimi i propozimit të Ahtisarit demonstroi përkushtimin për të garantuar një shkallë të paparë të decentralizimit dhe të drejtave kolektive. Angazhimi i vazhdueshëm i bashkësisë ndërkombëtare ka ndihmuar elitën politike dhe popullsisë që të arrijë pjekurinë dhe të kuptojë se interesi më i madh i Kosovës është bashkëjetesa paqësore ndërmjet të gjitha bashkësive. Duhet vënë re gjithashtu se autoritetet kanë mirëpritur përfshirjen e drejtpërdrejtë të pranisë së ardhshme ndërkombëtare në Kosovë për të siguruar që standardet në fjalë të arrihen dhe të avancohen.

Më konkretisht, udhëheqja politike është pajtuar me mekanizma të ndryshëm të përfaqësimit, si p.sh. tri poste ministrore janë të rezervuara për pakicat etnike (dy prej të cilave për serbët), vende të rezervuara në Kuvendin e Kosovës (10 nga 120 vende të rezervuara për serbët, si shtesë të të gjitha vendeve që fitohen përmes sistemit proporcional), buxheti proporcional (me kritere etnike), decentralizim i shkallës së lartë, emërimi i komandantëve të policisë nga ana e komunave, mbrojtja e dhjetëra vendndodhjeve të trashëgimisë kulturore dhe fetare të pakicave, statusi i imunitetit për klerin e Kishës Ortodokse Serbe. Këto dhe mekanizma të tjera e bëjnë Kosovën një shembull të jashtëzakonshëm të ndarjes së pushtetit. Asnjë territor tjetër që ka aspirata për pavarësi nuk tregon shkallë aq të lartë të diskriminimit pozitiv siç ka bërë Kosova përmes ligjeve dhe obligimeve të pranuar nga pakoja e Ahtisarit. Në të njëjtin drejtim, asnjë nga territoret nuk është e gatshme sa Kosova që të jetë e mbikëqyrur nga bashkësia ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe t'i lejojë ndërhyrje kur kjo kërkohet.

Aftësia për të zhvilluar marrëdhënie ndërkombëtare

Krahas qeverisjes demokratike, Kosova ka dëshmuar aftësi për të zhvilluar marrëdhënie ndërkombëtare, kriter i përmendur shpesh për shtetësi (p.sh. Konventa për të drejtat dhe detyrat e shteteve, e njohur edhe si “Konventa e Montevideos”²). Si krahinë e ish-Jugosllavisë, Kosova kishte të drejtë, sikundër edhe kapacitete të duhura, për të ushtruar marrëdhënie ndërkombëtare. Brenda kornizës së ish-Jugosllavisë, kuvendi federativ

² “Shteti si subjekt ndërkombëtar duhet të ketë cilësitë vijuese: (a) popullsi të përhershme; (b) territor të përkufizuar qartë; (c) qeveri; dhe (d) aftësi për të hyrë në marrëdhënie me shtete tjera” (Montevideo 1933: Neni 1).

përbënte qendrën e formulimit të interesave të përbashkëta në marrëdhëniet me jashtë. Vendimet merreshin përmes harmonizimit të detajuar të politikave ndërmjet “bashkësive shoqëro-politike, gjegjësisht republikave dhe krahinave autonome” (Hasani 1988: 243). Kosova gjithashtu mund të zhvillonte bisedime me subjekte ndërkombëtare. Gjatë viteve nëntëdhjetë Qeveria e Kosovës në ekzil mbante një numër të “zyrave informative” në shtetet kryesore perëndimore, sikundër edhe në Shqipëri dhe në Turqi. Ndonëse këto nuk kishin karakter diplomatik, ato ushtronin diplomaci publike në nivelin joformal (Peci 2007:6).

Sot, në frymën e Rezolutës 1244 ushtrimi i marrëdhënieve me jashtë është përgjegjësi e rezervuar për UNMIK-un. Megjithatë, UNMIK-u “gjatë viteve të fundit i ka përfshirë Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) në ushtrimin e marrëdhënieve me jashtë dhe ka nënshkruar në emër të Kosovës mbi 20 marrëveshje ndërkombëtare të dyanshme apo të shumanshme” (Buletini i Kuvendit të Kosovës 2007: 13). Korniza kushtetuese e autorizon Kryetarin e Kosovës që të ushtrojë marrëdhënie me jashtë. Zyra e Kryeministrit e ka krijuar zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar. Gjatë procesit për zgjidhje të statusit autoritetet vendore janë angazhuar në fushatë gjithëpërfshirëse të lobimit duke e shtrirë këtë në një numër të madh shtetesh dhe duke vendosur praninë e vet në Nju-Jork dhe në Bruksel. Kapaciteti përmbajtësor i Kosovës për të ushtruar marrëdhënie me jashtë i ka ndihmuar asaj që të integrohet me sukses në kornizën e bashkëpunimit rajonal dhe të krijojë pajtimin rajonal për pavarësinë.

Përkrahja rajonale

Me të drejtë është pohuar se “konflikti në Kosovë nuk mund të shihet jashtë kontekstit të gjerë rajonal” (Kosovo Report 2000: 8). Prandaj, është me rëndësi qenësore fakti se me përjashtim të Serbisë asnjë vend tjetër në rajon nuk sheh kërcënim nga pavarësia e Kosovës. Kosova ndoshta paraqet rastin e vetëm ku pavarësia përkrahet nga shumica dërrmuese e vendeve të rajonit. Një veçori e rëndësishme që mund të ketë ndikuar në një klimë të tillë në rajon qëndron në faktin se Kosova nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjërit prej shteteve fqinje, veçori kjo që në vete paraqet element të rëndësishëm për shtetësi. Autoritetet e Kosovës tanimë kanë ndërmarrë hapa për t’i çimentuar këto garancia në formë të dispozitave në kushtetutën e ardhshme.

Kështu janë adresuar disa nga shqetësimet e rajonit, duke arritur në pikën ku shumica e vendeve të rajonit e shohin status kuonë si armikun e tyre më të madh. Në të vërtetë, përfaqësuesit e shteteve të rajonit janë duke u bërë gjithnjë e më të zëshëm në tërheqjen e vëmendjes kundër status kuosë dhe në përkrahje të hapur të pavarësisë së mbikëqyruar. Në këtë kontekst, shikuar nga këndi i sigurisë ndërkombëtare, pavarësia e Kosovës do t’i sjellë rajonit stabilitet. Prandaj, disa nga vendet e rajonit tanimë janë deklaruar në favor të pavarësisë.

KONKLuzion

Paralajmërimet se Kosova mund të shkaktojë efekt domino padyshim se do të vazhdojnë të dëgjohen. Në paralajmërimet e efekteve të tilla, shumica duket se harrojnë se “të gjitha dominotë e ish-Jugosllavisë tanimë kanë rënë” (Bugajski 2007), përderisa Kosova mbetet pjesa e fundit e mozaikut të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Ky punim është përgatitur me qëllim për të ndihmuar debatin ndërkombëtar dhe për të kuptuar më mirë dallimet ndërmjet Kosovës dhe rasteve të tjera. Lista e dallimeve që elaborohet në këtë punim mbështet argumentin se Kosova është vend unik në plotësimin e një sërë kriteresh për shtetësi. Vendet e ndryshme që aspirojnë për shtetësi sigurisht se do të vazhdojnë të thërrasin në ndihmë sa më shumë argumente në përkrahje të pretendimeve të tyre. Ndër të tjera, ato do të përpiqen ta shfrytëzojnë

pavarësinë e Kosovës si precedent. Por, që të gjitha këto raste duhet të trajtohen duke marrë për bazë veçoritë e tyre individuale. Përmbledhja e veçorive në rastin e Kosovës, siç vë në pah ky punim, e dallon atë nga të gjithë shembujt tjerë. Në këtë frymë, veçoritë dalluese në fjalë lënë një zgjidhje të vetme – pavarësinë e mbikëqyrur – siç propozohet nga Përfaqësuesi Special për statusin e ardhshëm të Kosovës.

BIBLIOGRAFIA

- Badinter, Robert (2007 Mars). Ligjëratë publike, Prishtinë.
- Burns, Nicholas R. Nënsekretar për çështje politike. *The Outlook for the Independence of Kosovo* [Qëndrimi për pavarësinë e Kosovës]. Statement Before the House Committee on Foreign Affairs Washington, DC April 17, 2007, <http://www.state.gov/p/us/rm/2007/83120.htm> (qasur me 6 maj 2007).
- Federal Republic of Yugoslavia: Humanitarian Law Violations in Kosovo. [Shkeljet e së drejtës humanitare në Kosovë] Human Rights Watch. Oct 1998, Vol. 10, No. 9 (D), <http://www.hrw.org/reports98/kosovo/> (qasur me 6 maj 2007).
- Hasani, Enver. October 1988. “Disa çështje lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në dritën e ndryshimeve kushtetuese të RSFJ”, në “Diskutimet për Amendamentet Kushtetuese në Kushtetutën e RS të Serbisë dhe të KSA të Kosovës, II. Prishtinë: Fakulteti Juridik në Prishtinë. Instituti për Kërkime Juridike dhe Shoqërore. pp. 241-246.
- Hoare, Marko Atila. 12 February 2007. Kosovo: the Balkans’ last independent state. [Kosova: shteti i fundit i pavarur në Ballkan] Open Democracy, http://www.opendemocracy.net/conflict-yugoslavia/kosovo_process_4341.jsp
- KIPRED. 2005. Administration and Governance in Kosovo [Administrata dhe qeverisja në Kosovë], <http://www.kipred.net/UserFiles/File/5A%20Web.pdf> (qasur me 6 maj 2007)
- Kosovo Contact Group Statement [Deklaratë e Grupit të Kosovës], 2006, http://ue.eu.int/ueDocs/cms_Data/docs/pressdata/en/declarations/88236.pdf (qasur me 5 maj 2007)
- Kosovo Report [Raporti për Kosovën]. 2000. Independent International Commission on Kosovo. Oxford University Press.
- Kosovo Commission 2001. Why Conditional Independence? [Pse pavarësi të kushtëzuar?] Independent International Commission on Kosovo. Sweden: Global Reporting Books.
- Kullashi, Muhamedin, Besnik Pula. October 2005. Why Independence for Kosovo? [Pse pavarësi për Kosovën] Forum 2015, http://www.cerisciencespo.com/archive/mars06/independence_kosovo.pdf (qasur me 4 korrik 2007)
- National Assembly of Kosova. 15 February 2007. Bulletin of the Kosovo Assembly [Buletini i Kuvendit të Kosovës], No. 15, [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/publikim/Buletini_Buletini15\[1\].qxd.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/publikim/Buletini_Buletini15[1].qxd.pdf), (qasur me 28 mars 2007)
- Natsis, Ioannis. U.N. in Kosovo: 1999-2005. An Assessment of International Administration [KB-të në Kosovë. Vlerësim i Administratës Ndërkombëtare]. Eliamep, Postgraduate Notes 06.02, <http://www.eliamap.gr/eliamap/files/PNO6.02.pdf>.
- NATO Handbook: Human Rights Violations in the Kosovo Area [Doracak i NATO-s: Shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë]. 2002, <http://www.nato.int/docu/handbook/2001/hb050305.htm> (accessed: 6 May, 2007).
- Peci, Lulzim. 2007. Foreign Affairs: Factors, Objectives and Challenges Politika e jashtme e Kosovës: faktorët, objektivat dhe sfidat]. KIPRED & Forum 2015.
- Rupnik, Jacques. Kosovo: Dilemmas of the Protectorate [Kosova: Dilamat e protektoratit]. East European Constitutional Review, Vol. 9 No. ½ (Winter/Spring 2000). http://www.law.nyu.edu/eecr/vol9num_onehalf/special/srjacquesrupnik.html (qasur 5 maj 2007).
- Stojanovic, Dubravka. Kosovo – The Ultimate Myth [Kosova: Miti suprem]. Bosnian Institute, http://www.bosnia.org.uk/news/news_body.cfm?newsid=2266 (qasur me 10 maj 2007)
- The Convention on the Rights and Duties of States (Inter-American) [Konventa mbi të drejtat dhe detyrat e shteteve]. 1933, <http://www.yale.edu/lawweb/avalon/intdip/interam/intam03.htm> (accessed: 6 May 2007)
- Triantaphyllou, Dimitrios (editor). October 2001. *What status for Kosovo?* [Çfarë statusi për Kosovën] Chaillot Paper no. 50. Institute for Security Studies of WEU, <http://www.iss-eu.org/chaillot/chai50e.html#2> (qasur me 5 maj 2007)
- UNSCR 1244 (United Nations Security Council Resolution 1244) [Rezoluta nr 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara]. 1999. <http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N99/172/89/PDF/N9917289.pdf?OpenElement>
- UNMIK 25 July 1999. Regulation 1999/1, on the Authority of the Interim Administration in Kosovo [Rregullorja 1999/1 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë], http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E1999regs/RE1999_01.htm (qasur me 5 maj 2007)
- Williams, Paul. 2004. Earned Sovereignty: Conflict Over Kosovo’s Final Status [Sovraniteti i fituar: konflikti rreth statusit përfundimtar të Kosovës]. Denver Journal of International Law and Policy. Vol. 31:3. pp. 387-430, http://www.law.du.edu/ilj/online_issues_folder/williams.pdf (qasur me 5 maj 2007).
- Williams, Paul. Korrespondencë personale. Maj 2007.

LIBERALIZMI DHE RËNIA E FILOZOFISË POLITIKE*

Sheldon S. Wolin

Abstrakt. Në këtë punim trajtohet rënia e filozofisë politike si pasojë e zhvillimit të doktrinës liberale. Kjo doktrinë gradualisht e eliminoi apo e marginalizoi rolin e politikës si proces dhe të politikës si dimension, duke e zëvendësuar atë me konceptin e shoqërisë. Në ndryshim me qasjet e mëparshme filozofiko-politike, në doktrinën liberale shoqëria i paraprin politikës, e cila është produkt i shoqërisë dhe jo anasjelltas. Implikimet e këtij transformimi kanë ndikuar thellë zhvillimet e shoqërisë moderne dhe vazhdojnë të ndihen edhe sot tek neglizhenca apo përçmimi ndaj politikës. Punimi përqendrohet kryesisht në mendimin e Xhon Lok, si një nga themeluesit më influencues të doktrinës liberale, duke ofruar një analizë që bie ndesh me portretizimin e liberalizmit si një filozofi optimiste që bazohet tek glorifikimi i racionalitetit. Përkundrazi, në këtë punim argumentohet si liberalizmi lindi si një reagim skeptik dhe pesimist ndaj mundësive të kufizuara të racionalitetit njerëzor.

*...Të pasurit kanë ndjenja, nëse mund të shprehem kështu,
në çdo pjesë të zotërimeve të tyre...*

Ruso

*Fitohet shumë nëse arrijmë të shndërrojmë mjerimin
histerik në pakënaqësi të përbashkët.*

Frojd

POLITIKJA DHE SOCIALJA

Nëse do të imagjinonim dy lexues inteligjentë të Hobsit, secili prej tyre larg në kohë prej tij, i pari përfaqësues i mesit të shekullit të pesëmbëdhjetë, tjetri i mesit të shekullit të nëntëmbëdhjetë, natyrisht do të prisnim që secili të bënte kritika thelbësisht të ndryshme për disa çështje, por mund të ishim më pak të përgatitur t' i shihnim të binin dakord mbi disa të tjera. Lexuesi ynë i shekullit të pesëmbëdhjetë do të tronditej nga trajtimi sarkastik që Hobsi i bën fesë dhe mënyra e pamëshirshme si ai e zhveshi filozofinë politike nga të gjitha gjurmët e mendimit dhe ndjenjës fetare. Njeriu i shekullit të nëntëmbëdhjetë, duke e vëzhguar Hobsin përmes këndvështrimit të Marksit dhe ekonomistëve klasikë, do të deklaronte se atij i mungon plotësisht të kuptuarit e ndikimit të faktorëve ekonomikë mbi politikën.¹ Të dy kritikantët do të çonin në përfundimin se Hobsi ka krijuar një teori “të pastër” politike duke hequr elementët fetarë, ndërkohë që ka mbetur i paprekur prej shkencës së ekonomisë.

Gjithsesi, kjo nuk jep rëndësinë e plotë të asaj çfarë Hobsi ka bërë dhe as nuk shteron kritikantët e dy lexuesve tanë imagjinarë. Pavarësisht hendeut prej disa shekujsh dhe idiomave të ndryshme shprehëse, ata do të kishin rënë dakord se Hobsi nuk ka arritur të kapë ndërlidhjen mes faktorëve socialë dhe politikë, dhe për

* Përktheu nga origjinali Elda Papa, *Universteti European i Tiranës (UET)*. Ky material është shkëputur nga: Wolin, Sheldon S., *Politics and Vision: Continuity and Innovation in Western Political Thought, Expanded edition, Princeton University Press, 2004, f. 257-277.*

rrjedhje postulatit i tij për një rend të dallueshëm politik kishte një paraqitje po aq të panatyrshme sa cilido postulat tjetër i krijuar nga bashkëkohësit e tij me orientim teologjik. Nga njëra anë, përfaqësuesi i kohës së Tokëvililit, Komtit dhe Spenserit do të ngrinte akuza se Hobsi nuk ka marrë në konsideratë masën në të cilën praktikatat politike formësoheshin prej marrëdhënieve sociale, duke ngatërruar kështu superstrukturën me bazën. Me një tjetër gjuhë, folësi i një periudhe më të hershme do të rendiste një ankesë të ngjashme. Ai mund të thotë se Hobsi, po të kishte qenë i aftë të kontrollonte dëshirën e tij për të fituar pikë në debatin me Skolastikët, do të mund t'i kishte kushtuar disa mendime të vyera marrëdhënies së ndërsjelltë mes qeverisjes dhe shoqërisë. Përdorimi i metaforës organike** nga shkrimtarët mesjetarë ka qenë, përtej dukjes së saj absurde, tregues i një perceptimi të zhvilluar të ndërvaresive sociale dhe të marrëdhënies funksionale mes aktorëve politikë dhe ekonomikë. Një shkrimtar mesjetar nuk do ta kishte lejuar kurrë veten të bënte gabimin hobsian të trajtimit të institucionit të pronës si një tërësi të thjeshtë marrëdhëniesh juridike mes subjektit dhe sovranit, pa i kushtuar vëmendje ndikimit social të të drejtës së pronës.

Në pamje të parë, këto kritika duken të drejta, pasi Hobsi nuk pati ndonjë teori të vërtetë për shoqërinë, si shkrimtarët më të hershëm ose më të vonshëm. Por në vend që të vazhdojmë të shqyrtojmë këtë pikë ne mund të ndalemi të ngremë pyetjen që lind prej kritikave në fjalë: pse këto kritika duken si të drejta, ashtu edhe qarta? Një arsye është se jemi mësuar aq shumë t'i reduktojmë problemet politike në shkaqe ekonomike, ose tek ndikimi i strukturës klasore, i marrëdhënieve sociale ose te kushtëzimi kulturor, sa që distancohemi menjëherë nga një shkrimtar që nuk e bën diçka të tillë. Ajo që është interesante tek kjo arsye është lidhja e saj me pikëpamjen teorike që mbizotëron pjesën më të madhe të mendimit bashkëkohor në shkencat sociale. Argumenti mbi të cilin bazohet superioriteti i shkencave sociale ndaj filozofisë politike tradicionale qëndron në pothuaj të njëjtat supozime sikurse kritika ndaj Hobsit: që fenomenet politike shpjegohen më mirë si produkt i faktorëve socialë, për pasojë institucionet dhe konceptet politike kuptohen më mirë përmes një metode që shkon "përtej" tyre, tek proceset sociale që qëndrojnë "në themel", të cilat diktojnë formën e fenomeneve politike.

E thënë kështu, debati mes filozofisë politike dhe shkencës sociale me sa duket është metodologjik, pra ka të bëjë me një çështje, së cilës vetëm eksperiencia mund t'i japë përgjigje. Për fat të keq, shumë filozofë politikë, veçanërisht ata që këmbëngulin për një lidhje të ngushtë mes politikës dhe etikës, do ta kundërshtonin një parashtrim të tillë të problemit, për shkak se ai bën që filozofia politike t'i përkushtohet shqetësimit për metodën në dëm të çështjeve morale. Gjithsesi, mund të thuhet se si mbështetësi e shkencës sociale, ashtu edhe filozofi politik me orientim etik, mbrojnë një qasje që ka të njëjtën mangësi. Çështja nuk është vetëm metodologjike dhe madje jo kryesisht me karakter etik, por substanciale; që do të thotë, ajo ka të bëjë me statusin e politikës dhe të politikës. Kur shkenca sociale moderne pohon se fenomenet politike duhet të shpjegohen duke i shpërbërë në komponentët socialë, psikologjikë ose ekonomikë, ajo thotë se nuk ka fenomene të dallueshme politike e kështu asnjë bashkësi të veçantë problemesh politike. Në pamje të parë ky pohim duket si një thënie krejtësisht përshkruese, pa konotacione vlerësuese, ndaj e padëmshme. Në fakt nuk është aspak e tillë. Politika mund të shihet si një formë aktiviteti e prejardhur, që mund të kuptohet në bazë të faktorëve të tjerë më "thelbësorë", në rast se besohet se politikja nuk ka rëndësi të veçantë, ndonjë funksion unik dhe nuk qëndron në një plan më të lartë se, le të themi, ai i ndonjë organizimi në shkallë të gjerë.

Kjo do të thotë se shkenca sociale moderne duket e besueshme dhe e dobishme për të njëjtën arsye që filozofia politike duket anakronike dhe sterile: secila është tregues i një gjendjeje ku ka humbur kuptimi i politikës. Ndërsa njëra lulëzon, tjetra përpëlitet në pasiguri lidhur me çfarë, nëse ka diçka që përbën fushën

** Sipas metaforës organike shoqëria konceptohej si një organizëm i gjallë dhe funksiononte si e tillë. Kështu shtresa të ndryshme shoqërore përkonin dhe kryenin funksionet e organeve të ndryshme të një organizmi të gjallë, p.sh. monarku ishte koka, e kështu me radhë. Më vonë, sidomos pas zhvillimit të shkencës, janë përdorur metafora të tjera, si metafora mekanike sipas të cilës shoqëria dhe universi funksionojnë si një mekanizëm gjigand, p.sh. si një orë. (shën. i red.)

e saj të studimit. Këto zhvillime mund të duken disi të parëndësishme, që kanë të bëjnë ndoshta me ripozicionimin e një numri të vogël akademikësh të shpërngulur. Gjithsesi, nuk është aspak çudi që mungesa e një nocioni koherent mbi çka është vërtet politike tek filozofi të ketë të njëjtat rrënjë me paaftësinë e shoqërive perëndimore për t'i dhënë rëndësi aktivitetit politik, përveçse duke iu drejtuar një përzierjeje konfuzë idesh të zbutura fetare, të spërkatura me pakëz virtyte tregu.

Këto konsiderata na ndihmojnë ta vendosim kontributin e Hobsit nën një dritë më të qartë. Pavarësisht mangësive, ai na tregon çfarë kemi humbur në të kuptuarin e politikës. Për Hobsin, politikja në një shoqëri përfshin tre elementë: autoritetin, detyra ekskluzive e të cilit ishte të mbikëqyrte gjithçka dhe të ushtronte kontroll udhëzues mbi lloje të tjera aktivitete; detyrimet që kishin ata që pranin anëtarësinë; sistemin e rregullave të përbashkëta që qeverisnin sjelljen me rëndësi publike. Në mënyrë po kaq të qartë Hobsi shpalli detyrën kryesore të filozofisë politike: të identifikojë dhe përcaktojë çfarë ishte vërtetë politike. Në këtë pikëpamje, funksioni i teorisë ishte të ndihmonte në identifikimin e një lloji të veçantë të autoritetit dhe fushën e tij të veprimit. Të identifikosh dhe të përcaktosh do të thotë të veçosh disa funksione dhe aktivitete karakteristike, me qëllim përfshirjen e tyre nën një skemë klasifikuese. Çdo klasifikim përmban kufij, të cilët na lejojnë ta dallojmë subjektin nga subjekte të tjerë. Kështu, duke identifikuar çfarë ishte politike, Hobsi po përcaktonte njëkohësisht kufijtë e fushës së saj. Kjo nënkuptonte, për shembull, se veprimtaria politike kufizohej në llojet e të mirave që arrihen përmes mjeteve politike; të tjera të mira mund të ekzistojnë dhe mund të jenë edhe më cilësore, megjithatë, nëse nuk mund të sigurohen përmes metodave politike, ose nëse kur sigurohen rezultojnë shumë të kushtueshme apo shumë të papërfillshme, ato shtrihen jashtë fushës politike. Në mënyrë të ngjashme, ndërsa detyrat politike ishin çështje me rëndësi të madhe për filozofinë politike dhe autoritetin politik, ato në asnjë mënyrë nuk shtronin tërësinë e marrëdhënieve njerëzore dhe as nuk vlerësoheshin si funksioni më i lartë i njeriut. Kështu, shumë fusha të rëndësishme të aktivitetit njerëzor ishin pa ndonjë rëndësi të drejtpërdrejtë politike; ato u bënë subjekt i vëmendjes politike kur pasojat e tyre kërcënuan të çrregullonin marrëdhëniet e vendosura që formonin shoqërinë.

Por mënyra rigoroze si Hobsi parashtrroi karakterin e politikës fshihte një premisë të brishtë, mbi të cilën ngrihej gjithë arsyetimi. Në një masë të madhe identiteti i politikës ishte produkt i besimeve, thuajse një besim. Ai ekzistonte si rezultat i një procesi të vetëprovimit të vërtetësisë; pra, për shkak se njerëzit besonin se ai ekzistonte dhe për rrjedhojë rregullonte veprimet e tyre. Kjo është ajo çfarë Hobsi nënkuptonte me karakterin “artificial” të rendit politik dhe pse ai këmbëngulte se në çdo sistem politik, pavarësisht nga lloji, njerëzit qeverisnin me të vërtetë. Ashtu sikurse tha Hjumi më vonë, “...qeverisja bazohet vetëm në opinion.”²²

Duke tërhequr vëmendjen tek elementi i besimit si pjesë e kompleksit të gjërave politike nuk është se po argumentojmë një pikëpamje naive Berkeliane se politikja është një krijesë e pastër e besimit që nuk ka më shumë realitet nga sa vendosim t'i japim. E pranojmë ose jo, fakte si pushteti politik ekzistojnë; e marrim ose jo në konsideratë një nocion të anëtarësisë politike, askush nga ne nuk mund t'i shpëtojë lehtësisht marrëdhënieve të caktuara me autoritetet publike, aq më pak mund të shmangim barrën dhe sakrificat që mbartim duke jetuar në një shoqëri të organizuar politikisht. Gjithsesi, mbetet e vërtetë se sado të papërpunuara ose të sofistikuara të jenë nocionet tona për këto çështje, besimet tona ushtrojnë një ndikim të ndjeshëm në mënyrën se si i perceptojmë ngjarjet politike dhe si reagojmë në mjediset politike, dhe nga ana tjetër, këto detyrimisht ndikojnë rrjedhën e ngjarjeve. Për shkak të lidhjes që ekziston midis mendimeve (ose qëndrimeve) dhe ngjarjeve, një ndryshim i dukshëm i perspektivës mbi politikën dhe politiken do të ndikonte praktikën e shoqëruara me një traditë të caktuar. Të kuptuarit e drejtimit të këtyre ndryshimeve mund të kontribuonte paksa në të kuptuarit e dilemave të parashtruara. Pak njerëz do të kundërshtonin pohimin se sot shoqëritë perëndimore shfaqin një nivel të ulët ndërgjegjeje politike mbizotëruese tek anëtarët e tyre, edhe më pak do të vazhdonin të vinin në dyshim se gjërat politike shihen kryesisht me sy të keq nga anëtarët e këtyre shoqërive. Konkretisht, pasojat e statusit në rënie të politikës mund të gjenden në të kuptuarit e shfrenuar se

luajaliteti politik është bërë problem; se një gjeneratë ushtarësh, shkencëtarësh dhe zyrtarësh publikë është rritur pa bazat e edukimit qytetar; dhe se shumë lehtësisht do të mund të gjendeshim në pozitat e kryerjes së po atyre veprimeve të jo luajale, në rast se do të ndodheshim në një situatë të ngjashme.

Këto zhvillime kanë ndodhur në më shumë se një shekull e gjysmë. Rrymat kryesore në mendimin politik, pavarësisht variacioneve kombëtare ose ideologjike, kanë pasur të njëjtin synim: erozionin e asaj që është qartësisht politike. Ajo që ngrihet mbi bazat e paqëndrueshme të besimit mund të shkatërrohet pikërisht nga vetë besimi. Përmbysja e besimit mund të realizohet me më efektivitet kur një nocion i pranuar sfidohej nga një ide e përbashkët për një shumëllojshmëri të gjerë këndvështrimesh. Koncepti kryesor që u vendos kundër politikës ishte “shoqëria”. Ky ishte një nocion themelor i përbashkët për ideologji aq kontradiktore sa liberalizmi dhe konservatorizmi, socializmi dhe reaksionarët, anarkizmi dhe manaxherializmi. Sot ai shërben si fokusi i shkencave sociale, veçanërisht në sociologji dhe antropologji dhe kjo ndoshta justifikon përcaktimin e shkencës sociale si pasardhëse të një debati të mëparshëm ku “shoqëria” zuri vendin e politikës.

Rizbulimi i shoqërisë, e cila shumë shpejt u bë shqetësimi kryesor i mendimit post-hobsonian, ndodhi në dy rrugë disi të ndryshme. Njëra u ndoq nga një grup i përzier çuditshëm, ku bënin pjesë Monteskje, Burke, De Maistre, Komte dhe Tokëvili. Pavarësisht disa mosmarrëveshjeve të mprehta, ata ndanin të njëjtën pikëpamje se autoriteti i institucioneve politike bazohej tek një shumësi autoritetesh sociale dhe ushqeje nga një varietet luajalitetesh private. Këta elementë siguronin kohezionin e domosdoshëm që mbante shoqërinë së bashku; nëse ata do të dobësoheshin, sikurse ndodhi nga fundi i *ancien régime*, rendi politik do të shembje për shkak të peshës së vet. Kështu, fokusi i kërkimeve duhet të drejtohej tek sistemi i shkallëzimit social; tek kompleksi i “paragjykimeve” joracionale, i cili i shtynte njerëzit drejt bindjes dhe nënshtrimit; tek lidhjet e thurura nga komuniteti lokal, famullia dhe çifligu në një rrjetë shoqërizimi më të fortë nga sa mund të imagjinojë një mendim i vetëdijshëm.

Rruga e dytë drejt shoqërisë, ajo që do të diskutohet në këtë kapitull, u ndoq nga Loku, ekonomistët klasikë, liberalët francezë dhe utilitarianët anglezë. Ne do të përiqemi të tregojmë se si koncepti i shoqërisë u shfaq në shkrimet e Lokut; se si gradualisht shoqëria filloi të konceptohet njëkohësisht si një entitet i dallueshëm nga rregullimet politike dhe si një simbol për të gjithë orvatjet njerëzore mbarëbotërore; dhe se si këto zhvillime lanë pak vend dhe më pak prestigj për politiken. Politikja filloi të identifikohet me një grup të ngushtë institucionesh, të etiketuar “qeveri”, simbol i ashpër i detyrimit të domosdoshëm për të mbajtur transaksione të rregullta sociale. Zgjidhja qëndron, sikurse thotë Bastiati, mes “*société libre, gouvernement simple*” dhe “*société contrainte, gouvernement compliqué*.”³

Ekonomistët klasikë të shekullit të tetëmbëdhjetë i ndërthurën këto tema brenda një sistemi elegant dhe bindës. Nuk ka karikaturë më flagrante të këtyre shkrimtarëve sesa ajo që thotë se analizat e tyre bazoheshin në pak propozime të thjeshta rreth “njeriut ekonomik” dhe se, si metafizikantë të zotë, ata gjithmonë arritën të “ruanin imazhin” duke u mbështetur në veprimtarinë e një “dore të padukshme,” përzemërsisht konspirative. Në të vërtetë shkrimet e tyre shfaqnin interes të qëndrueshëm për mënyrat si sjellja e rregulluar ekonomike vendoste rendin në marrëdhëniet njerëzore, duke i lidhur ato në kohë dhe hapësirë dhe duke i integruar në një model ritmik pa u mbështetur tek detyrimi.

Ishte kjo cilësi e fundit, mungesa relative e presionit në transaksionet ekonomike, ajo që ngjyrosi modelin e shoqërisë së ekonomistëve me tone antipolitike dhe përfundimisht e bëri atë një alternativë ndaj konceptimit të vjetër të një sistemi të drejtuar politikisht. Kjo është e ilustruar mjaft mirë nga një prej nocioneve të tyre të preferuara, ndarja e punës. Ky princip, shpjegon Adam Smithi, buroi nga prirja natyrore e njeriut “për të dhënë e për të marrë, për të bërë pazar e për të këmbyer një send me një tjetër”. Përmes shtysave dhe jo detyrimit, pa i bërë thirrje ndonjë autoriteti të përgjithshëm mbikëqyrës, ndarja e punës i bashkoi njerëzit në ndërvarësi, duke inkurajuar secilin të zhvillojë talentet e veta në mënyrën më të dobishme për shoqërinë. Ky princip veprroi për të përvijuar topografinë sociale, duke gdhendur një seri rolesh funksionalisht të diferencuara,

duke i përshtatur aktivitetet ndaj njëri-tjetrit dhe duke krijuar rutina përpjekjesh të përbashkëta. Përmes këtij nocioni dhe nocioneve të ngjashme, ekonomistët punuan për përpunimin e një teorie të një sistemi social; që do të thotë një seri funksionesh të integruara, efekti kumulativ i të cilave përngjasonte me alkiminë: duke organizuar aktivitetin njerëzor, pushteti i vogël i individëve bashkohej në një pushtet social të madh dhe të disiplinuar. “Mekanizmi social është shumë krijues dhe shumë i pushtetshëm... Çdo njeri... merr më shumë kënaqësi në një ditë nga sa ai vetë do të mund të prodhonte për një kohë shumë të gjatë”.⁴

Pinjollit i këtij lloji teorizimi ishte një model jopolitik i shoqërisë, i cili duke qenë një sistem i mbyllur forcash bashkëvepruese, duke j i aftë për të mbështetur ekzistencën e tij pa ndihmën e një agjencie politike “të jashtme.” Siç thotë Adam Smithi, nuk nevojitej ndonjë lëvizës politik fillestar, pasi çdo individ “ka një princip lëvizjeje të tijin”. Pasojat e plota të sistemit social për statusin e politikës u shprehën nga bashkëkohësi i Smithit, David Hjumi: ndërkohë që qeveria është e nevojshme, madje e domosdoshme, “nuk është e domosdoshme në çdo rrethanë; as nuk është e pamundur që njerëzit të ruajnë shoqërinë për ca kohë, pa qenë nevoja të përdorin një shpikje të tillë”.⁵

Rënia e kategorive politike dhe epërsia e atyre sociale janë shenjat dalluese të situatës sonë bashkëkohore, ku filozofia politike është eklipsuar nga forma të tjera të njohjes. Në kohët e sotme normalisht ne i drejtohem sociologut ose ekonomistit për të marrë receta për sëmundjet e shoqërisë. Ne marrim të mirëqenë se ata, më mirë sesa teoricienit politik, zotërojnë llojin e duhur të dijes. Komti mund të jetë nxituar duke e kurorëzuar sociologjinë mbretëreshë të shkencave – në atë periudhë ajo shumë mirë mund të kishte qenë mbretëreshë për sa kohë që vështirë të ishte një subjekt – por sot titulli është më pak i diskutueshëm. Sot ne kemi pranuar si një supozim funksional pohimin e sociologjisë të shekullit të nëntëmbëdhjetë se njohja e rendit social “zor se mund të mos ndikojë gjykimet tona për atë se çfarë është progresive dhe çfarë regressive – çfarë është e dëshirueshme, çfarë është e praktikueshme, çfarë është utopike”.⁶ Kur i ndjeri Karl Mannheim emëroi sociologun në rolin e elitës së re intelektuale, ne mund të jemi ndjerë të shqetësuar, por jo të befasuar. Ose kur një antropolog i shquar shpalli se kishte ardhur koha që antropologu të luante një rol vendimtar në politikat publike, pasi krahasuar me shkencëtarin politik dhe social, ai të paktën do të mund të bënte gabime më të mira,⁷ ne mund të çuditemi nga forma naive e argumentit, por e marrim seriozisht substancën e tij.

Kjo situatë, ku teoria politike është shndërruar në një aktivitet të paqëllimtë, roli tradicional i së cilës është përvetësuar nga disiplina të ngjashme, nuk duhet të shpjegohet duke drejtuar gishtin akuzues tek shkeljet e disiplinave të tjera, as në bazë të ndonjë çrregullimi brenda vetë teorisë politike, si për shembull paaftësisë së saj për të pasur një metodologji të përcaktuar. Ne do të mund ta shpjegojmë më mirë problemin, nëse do të pranonim se ky varfërim i përket edhe sipërmarrjes më të gjerë, pjesë e së cilës teoria politike është, pra filozofisë. Edhe filozofët kanë pësuar humbje pasi forma të tjera të njohjes, me njëfarë sovraniteti të banorit të paligjshëm, kanë sfiduar dhe bllokuar fushën e tyre të veprimit. Kjo ngre pyetjen provokative, nëse ekziston ndonjë ndërlidhje mes gjendjes së filozofisë dhe teorisë politike nga njëra anë, dhe karakterit të traditës liberale, nga ana tjetër. Çelësi i gjetjes së përgjigjes qëndron tek figura esenciale e Xhon Lokut, pasi për sa kohë që filozofia moderne është e orientuar drejt empiricizmit dhe analizës së gjuhës, Loku është padyshim një nga themeluesit e saj. Dhe në masën që liberalizmi modern mund të thuhet se është frymëzuar nga ndonjë autor i vetëm, Loku është padyshim kandidati kryesor. Ne do të fillojmë shkurtimisht me këtë sugjerim dhe do të përiqemi të tregojmë lidhjen mes filozofisë dhe liberalizmit së Lokut dhe ndikimin e tyre mbi statusin dhe teorinë politike si disiplinë.

Duke analizuar çfarë vetë liberalët e hershëm kanë shkruar, u detyrova të braktis një sërë paragjykimesh të formësuar nga analizat e bëra më vonë në lidhje me fillesat e liberalizmit. Në fund, arrita në përfundimin se koha kur jetojmë, për një sërë arsyesh, ka humbur lidhjet me shpirtin dhe pikëpamjen origjinale të liberalizmit dhe ndaj është e gatshme të pranojë për të vërtetë karikaturnë vulgare të liberalizmit, të ofruar nga marksistët, konservatorët romantikë, “realistët” dhe teologët neoortodoksë.⁸ Liberalizmi është karakterizuar vazhdimisht

si “optimist”, gjë që arrin deri në naivitet; arrogant përse i takon bindjes së tij se arsyeja njerëzore duhet të jetë autoriteti i vetëm për njohjen dhe veprimin; i magjepsur nga një vizion i historisë si një shkallë lëvizëse që ngjitet pafundësisht lart drejt një progresi më të madh; dhe blasfemues duke e pajisur mendjen dhe vullnetin njerëzor me një pushtet të ngjashëm me atë të Zotit, për t’i ridhënë formë njeriut dhe shoqërisë në tërësi.

Në shumicën e rasteve këto kritika gjejnë pak ose aspak mbështetje në shkrimet e liberalëve. Ato duken bindëse vetëm sepse kritikët kanë bashkuar dy tradita të ndryshme të mendimit politik: radikalizmin demokratik dhe liberalizmin.⁹ Edhe pse e para u frymëzua nga Loku, pikëpamja e saj në masë të madhe, u formësua nga racionalizmi i shekullit tetëmbëdhjetë dhe eksperiencia e Revolucionit Francez. Nga ana tjetër, liberalizmi i ka rrënjët e tij në periudhën përpara Iluminizmit Francez. Edhe ai u mbështet shumë tek principet politike të Lokut, por më të rëndësishme për zhvillimin e tij janë fazat e mëvonshme, ku u filtrua përmes ekonomisë klasike dhe u ekspozua ndaj filozofive të David Hjumit dhe Adam Smithit, dy mendimtarë që shquheshin për një respekt të thellë ndaj kufijve të arsyes dhe rëndësinë e faktorëve irracionale tek njeriu dhe shoqëria. Një nga detyrat tona në faqet në vijim është të shkëputim këtë traditë të dytë nga e para dhe të tregojmë se liberalizmi ishte një filozofi zyrtësisht e kthjellët, e lindur në frikë, e ushqyer nga pakënaqësia dhe e prirur për të besuar se kushtet njerëzore ishin dhe kishte të ngjarë të mbeteshin, kushte të dhimbjes dhe ankthit.

LIBERALIZMI DHE KTHJELLTËSITË E FILOZOFISË

Më parë pamë se periudhat e krizave priren të zgjojnë tek filozofia politike një impuls drejt kontrollit, një besim se mendja mund të na sigurojë formulën për të kontrolluar dinamikën e ndryshimit dhe se i udhëhequr nga kjo dije, pushteti politik mund të transformojë shoqërinë në një komunitet të ngjyrosur nga e vërteta. Por kriza mund të prodhojë edhe druajtje dhe është ky reagimi që ngjyrosi të gjithë zhvillimin e liberalizmit anglez, shumë kohë më parë se Revolucioni Francez. Ne jemi mësuar aq shumë ta pikturojmë liberalizmin si një kredo luftarake, të përgatitur për të sulmuar muret mbrojtëse të privilegjit, sa e kemi të vështirë të pranojmë hipotezën se liberalizmi lokian ishte po aq një mbrojtje kundrejt demokracisë radikale sa edhe një sulm ndaj tradicionalizmit. Në Francë, ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara, liberalizmi u shfaq si një kundërveprim post-revolucionar. Mburrtja e Volterit “*Je suis grand démolisseur*”,¹⁰ ishte e huaj për temperamentin e francezëve të shekullit të nëntëmbëdhjetë, ashtu sikurse edhe teoria e Rusosë për sovranitetin popullor. Në vitet e para të republikës amerikane shkrimtarët liberalë kërkuar një objekt zëvendësues të impulseve patriotike dhe politike të nxitura nga idetë dhe ngjarjet e luftës revolucionare. Kushtetuta i shërbeu qëllimit të tyre dhe ata arritën ta mbështillnin me një legjendë dhe simbolikë të pasur e kështu, në fund, “miti” i vitit 1789 triumfoi mbi atë të 1776-ës.¹¹

Në kujtesën e gjeneratës së Lokut, periudha e Komonuelthit dhe Protektoratit filloi të simbolizonte triumfin e përkohshëm të radikalizmit fetar, social dhe politik. Simbolet tradicionale të autoritetit, si për shembull monarkia, Kisha zyrtare dhe Dhoma e Lordëve, ishin hequr. Përpjekje të njëpasnjëshme ishin bërë për të transformuar Dhomën e Komonëve dhe një eksperiment afatshkurtër, edhe pse i kotë, ishte bërë për të qeverisur Anglinë me një kushtetutë të shkruar. Këto reforma të gjera kishin bërë realitet ndjesinë e mundësive, e cila kishte prekur teoritë politike të kohës. Publiku lexues ishte bombarduar me receta për rinovimin tërësor të shoqërisë, duke filluar nga utopia komuniste e Uinstenleit deri tek plan-projekti i Harringtonit për republikanizmin.

Ishte kjo periudhë e krizës së vashdueshme dhe imagjinatës së shfrenuar politike ajo që i dha sfondin biografisë së Lokut.¹² Babai i tij kishte luftuar në ushtrinë parlamentare dhe arsimimi i tij në Oksford erdhi në një kohë kur dyshimet puritane për zanafillën e kauzave të humbura ishin të larta. Në rini ai kishte përjetuar

përpjekjen për ta shndërruar Anglinë në një komunitet të shenjtë. Së bashku me të tjerë ai kishte mirëpritur rivendosjen e monarkisë në 1660-ën, por gjatë muajve të ethshëm që i paraprinë ardhjes së Xhejmsit II, Lokut iu hoq posti i tij në universitet dhe u ndie i detyruar të largohej nga vendi; së bashku me emigrantë të tjerë politikë, ai u kthye me Uilliamin II në atmosferën e nderë të marrëveshjes revolucionare. Gjatë jetës së tij ai e ka parë Anglinë të përçarë nga divergjencat fetare, të turbulluar nga ndryshimet ekonomike dhe si mik i ngushtë i Shaftesbërit, ai ka qenë pranë qendrës së asaj çka u bë fillesa e politikës partiake angleze.

Loku i përmbloodhi reagimet e tij ndaj “vorbullës marramendëse të zhvillimeve” në fjalë që çuditërisht të kujtonin *Letrën e Shtatë* të Platonit: “Akoma nuk e kisha perceptuar veten time në botë, kur u zgjova në një stuhi, e cila ka zgjatur thujtë deri tani”.¹³ Gjithsesi, paralelja me Platonin mbaron po aq papritur sa edhe fillon, pasi askund në shkrimet e Lokut nuk ka pasur qoftë edhe një gjurmë të lehtë të atij impulsi arkitektonik, i cili ndihet në puhizën e parë të shansit dhe kërkon shpalosje krijuese në bërje planesh për rregullimin e një bote të çrregullt. Përmes studimeve të tij dhe miqësive me shumë nga intelektualët e shquar dhe liderët shkencorë të kohës, Loku ishte mjaft i informuar për vërshimet grishëse në shkencë dhe filozofi. Gjithsesi imagjinata e tij nuk u trazua asnjëherë nga mendimi për t’ia bashkuar dijen e shkencës, në rritje me shpejtësi, disiplinës së filozofisë, dhe për t’i bërë të dyja të ndikojnë shanset e ofruara në një shoqëri politike të shqetësuar dhe të çorientuar.

Që në fillim të *Esesë rreth të kuptuarit njerëzor* ai parashtrroi mundësitë e shkencës dhe filozofisë. Nga njëra anë shkencëtari, përfaqësuar nga “mjeshtër” si Boili dhe “i pakrahueshmi Z. Njuton”; nga ana tjetër, filozofi, ambicia modeste e të cilit ishte të “punësohej si një punëtor krahu për të pastruar paksa terrenin dhe për të hequr mbeturinat që ndodhen në rrugën drejt dijes...”.¹⁴ Kjo ishte një vërejtje e çuditshme në një shekull ku filozofët politikë po u premtonin njerëzve një komunitet të pavdekshëm, të mbrojtur nga një shkencë politike e pagabueshme; ku Spinoza kishte deklaruar se “natyra e arsyes është të perceptojë gjërat në një formë të caktuar përjetësie”; dhe ku shkencëtarët po i jepnin universit një thellësi dhe rend të ri. Megjithatë, tema kryesore që përshkon *Esenë* ishin kufizimet e filozofisë. Libri, shpjegon ai, e kishte zanafillën tek një grup diskutuesish që i kishte vendosur vetes detyrën për të analizuar “me cilat objekte të të kuptuarit tonë ishte ose jo i përshtatshëm të merrej”. Dhe ndërsa *Eseja* mori formë, ajo u bë një kërkim jo për mundësitë më të avancuara të mendjes së njeriut, por për kufijtë e “botës së vogël të të kuptuarit të tij”.¹⁵

Njeriu, sipas përshkrimit të famshëm të Lokut, vjen në botë me një mendje “të zbrazët nga të gjitha tiparet, pa asnjë ide”. Përmes të ndjerit dhe refleksionit idetë fillojnë të shkarravitën në “fletën e bardhë” të mendjes, duke krijuar një botë të kufizuar, nga e cila nuk kishte shpëtim, të paktën jo përmes mjeteve natyrore. Njeriu nuk kishte zgjidhje tjetër veçse të punonte me materialet që i jepeshin nga shqisat.¹⁶ Ai mund t’i sajtojë ato me zgjuarsia në kombinime të reja, t’i vëzhgojë përmes këtij apo atij këndi dhe të analizojë me durim proceset e brendshme të mendjes, por ai nuk do të mund të dilte kurrë nga një botë e kufizuar nga “tingujt, shijet, aromat, cilësitë e dukshme dhe të preکشme”:

Por inteligjenca më e lartë, ose dija më e gjerë, me çfarëdo shpejtësie apo variacioni të mendimit, nuk mund të *shpikë* ose *formojë* në mendje një ide të re, të thjeshtë që nuk është marrë përmes mënyrave të përmendura më parë... Zotërimi i njeriut në këtë botë të vogël të të kuptuarit të tij, të jetë pothuajse si në botën e madhe të gjërave të dukshme; ku pushteti i3 tij sido që të përdoret nga talenti dhe aftësia, nuk shkon më tej se të bashkojë dhe ndajë materialet që i janë vënë në dispozicion; por nuk mund të bëjë asgjë për të krijuar grimcën elementare më të vogël të një lënde të re apo të shkatërrojë një atom të asaj që ekziston...¹⁷

Dhe pothuaj dyqind vjet më vonë, thujtë i njëjti pozicion u ripohua nga liberali kryesor i kohës, Xhon Stuart Mill:

Në këto dhe të gjitha operacionet e tjera artificiale [p.sh., zbatimi i talentit njerëzor tek natyra] detyra e njeriut është... shumë e kufizuar; ajo ka të bëjë me lëvizjen e sendeve në vende të caktuara. Ne i lëvizim sendet dhe duke vepruar kështu vendosim në kontakt gjëra që ishin të ndara, ose ndajmë të tjera që ishin bashkë: dhe përmes këtij ndryshimi të thjeshtë të vendit forcat natyrore që më parë nuk ishin aktive, zgjohen dhe prodhojnë pasojat e dëshiruara. Edhe vullneti që harton, inteligjenca që shpik dhe forca muskulore që kryen këto veprime janë në vetvete fuqi të natyrës.¹⁸

Spektori i kufizuar që iu caktua filozofisë nga liberalët ishte thjesht zbatim i veçantë i një vlerësimi të përgjithshëm për kushtet njerëzore, të cilat ishin përshkruar fillimisht nga Loku dhe më pas ishin pranuar në gjirin e liberalizmit të mëvonshëm. Aty ku Platoni kishte përcaktuar si synim të aspiratave njerëzore “shkrimin më të plotë të mundshme me zotin” dhe Aristoteli u kishte bërë thirrje njerëzve “të shtyjnë vdekshmërinë sa më larg të mundet”,¹⁹ Loku e kishte mbyllur njeriun në një gjendje të mesme, të paaftë për dije përfundimtare ose perfeksion, “një gjendje mediokriteti, e cila nuk është e aftë për ekstreme...”. Filozofia që i përshtatej më shumë mundësive të kufizuara të njeriut ishte ajo që përqendrohej në “muzgun e probabilitetit”, midis “dëshpërimit skeptik” dhe pandehjes kryelartë.²⁰ Ky temperament i nënshtruar dhe i kthjellët pati një ndikim vendimtar në mënyrën si Loku dhe pasuesit e tij i panë problemet e teorisë dhe praktikës politike.

Duke marrë para së gjithash problemin e veprimtarisë politike, shkallën e mundësive dhe llojin e dijes që nënkupton, mund të themi se pavarësisht se nuk ka ndonjë lidhje të domosdoshme logjike mes një teorie të dijes dhe një teorie të veprimtarisë politike, dhe se një shkrimtar mund të besojë në mundësinë për të arritur tek të vërtetat absolutisht të vlefshme dhe sërish të këshillojë një linjë shumë të kujdesshme veprimi, gjithsesi vihet re të ketë një të fortë psikologjike që lidhin mendimin me veprimin. Njerëzit ndihen më të sigurt kur u garantohet se veprimtaria e tyre bazohet në një siguri intelektuale; ata ka më shumë gjasa të angazhohen në plane të mëdha kur besojnë se zotërojnë të vërtetën përreth. Në këtë kuptim mund të themi se rrënjët e divergjencës mes traditës liberale dhe asaj demokratike radikale qëndrojnë në besimin e tyre të ndryshëm në aftësinë e mendjes njerëzore për të kuptuar realitetin dhe për të shndërruar përfundimet në veprime praktike.

Tradita e parë u simbolizua në vërejtjen e Lokut se “mendjet tona nuk janë aq të gjera sa e vërteta, as të përshtatura ndaj shtrirjes së plotë të sendeve”, e dyta nga përkufizimi i Holbakut për të vërtetën si “pajtim i ideve tona me natyrën e sendeve”.²¹ Pohimi i sigurt i Holbakut simbolizon temperamentin filozofik që qëndronte pas skemave madhështore të rikonstruksionit social, të projektuara gjatë Revolucionit Francez,²² ndërsa paralajmërimi i Lokut kundër ngatërimit të të vërtetave të kapshme nga njeriu me tërësinë e të vërtetave të mundshme u pranua në gjirin e mendimit liberal anglez. Aty ai funksionoi për të shkatërruar besimin në mundësinë e filozofisë politike për të siguruar dijen për përparim me hapa të mëdhenj. Kjo nuk ndodhi si pasojë e ndonjë mohimi të qartë të mundësive për dije të vërtetë politike, as si pasojë e ndonjë skepticizmi për efektivitetin e veprimtarisë politike. Përkundrazi, ndryshimi i pikëpamjes që çoi në uljen e statusit dhe prestigjit të teorisë dhe praktikës politike ishte gradual dhe i tërthortë. Në këto drejtime dhe të tjera, ai krijon një paralele të jashtëzakonshme me atë çfarë ndodhi me Kalvinizmin gjatë pothuaj të njëjtës periudhë. Veberi dhe Tonei (Tawney) kanë treguar se në shekujt shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë grupet kalviniste pësuan një ndryshim domethënës në pikëpamje dhe sjellje, deri në një rivlerësim të normave dhe riorientim të aktivitetit. Në vend të shqetësimit lidhur me shpëtimin veprimi u drejtua tek ecja përpara në botë. Forca shtytëse, e cila fillimisht ishte renditur në shërbim të synimeve fetare, tashmë u vu në shërbim të çështjeve ekonomike dhe sociale. E njëjta dëshirë e pashuar aktiviste ishte, siç do të shohim, një tipar i heshtur i imazhit liberal të Lokut për njeriun. Nëse sjellim ndërmend se Loku dhe shumë nga pasuesit e tij më të rëndësishëm nuk ishin as konformistë dhe as rebelë kundër anglikanizmit – dhe na mjafton të përmendim

Adam Smithin, Benthamin dhe Millsin – do të thotë se ndryshimi i ndodhur tek protestantizmi, i analizuar nga Veberi, përfaqësonte diçka më shumë se një paralele ndaj zhvillimeve të caktuara në liberalizëm: ai rrit mundësinë që liberalizmi të ketë shfaqur disa nga të njëtat modele të zhvillimit si protestantizmi.

Kështu, Loku ka argumentuar se filozofia – dhe me këtë ai pa dyshim nënkuptonte një “filozofi” të drejtuar dhe informuar nga vlerat kristiane – duhet të lërë mënjanë shqetësimin për gjendjen e brendshme të njeriut dhe fatin përfundimtar dhe në vend të kësaj t’i drejtohet analizimit të llojit të dijes që do të ndihmonte njerëzit të shfrytëzonin botën natyrore.

Ne nuk kemi lindur në parajsë por në botë, ku qenia jonë duhet të mbahet me mish, pije dhe veshmbathje dhe gjëra të tjera të domosdoshme që nuk kanë lindur me ne, por duhet të merren dhe të mbahen me planifikim, kujdes dhe punë, e kështu nuk mund të jepemi vetëm pas përkushtimit, plot me lutje dhe aleluja, dhe pafundësisht në vizionin e gjërave më lart...²³

I njëjti arsytetim u bë më vonë në mënyrë më lakonike nga Adam Smithi, kur ai vërejti se “soditja sublime” e zgjuarsisë së Zotit nuk duhet të jetë “çështja dhe detyra më e madhe e jetës sonë”.²⁴ Sipas direktivës lokiane, filozofia duhet të promovojë “avantazhet dhe komoditetet e jetës njerëzore”; ajo duhet të shqetësohet për botën e përditshme dhe të kënaqë ambiciet e saj me përmirësimet modeste të realizueshme aty. Rritja e pasurisë dhe komoditeteve siguroi “një fushë të gjerë të dijes; të përshtatshme për t’u përdorur nga njeriu dhe për përparimin e tij në botë... Pse duhet të qahemi se na mungon njohuria për caqe të largëta të universit kur pjesa që na takon shtrihet vetëm në copën e vogël të tokës ku ne dhe të gjitha shqetësimet tona mbyllen?”²⁵ Praktikiteti dhe veprimi – këto u bënë parrullat e filozofisë në një masë aq të madhe sa në fund filozofia filloi të dyshonte për rëndësinë serioze të sipërmarrjes së saj: “spekulimet më sublime të filozofit soditës nuk mund të kompensojnë neglizhimin e detyrës më të vogël aktive.”²⁶

Pasojë e kthimit të filozofisë së jashtme ishte pranimi i shoqërisë ekzistuese si një e dhënë, e ndjeshme ndaj modifikimeve të vogla, por gjithmonë brenda kontekstit të dhënë nga *status quo*-ja. Kjo, nga ana tjetër, nënkuptonte një formë të dijes politike, ku saktësia dhe siguria nuk ishin as të domosdoshme e as të dëshirueshme. Për rrjedhojë, për shkrimtarët liberalë ekzistonte një dallim i qartë mes të vërtetave të veçanta, rezultat i manipulimit të abstraksioneve njerëzore, si në matematikë, dhe një probabilitetit potencial në ato çështje ku njeriu i mungonte një dorë e lirë. Si rezultat, çka është shumë e rëndësishme, liberalët e identifikuan hapësirën e dijes politike me të dytën, radikalët me të parën. Dijsa politike, sipas Lokut, është e ngjashme me maturinë në të qenit e paprovueshme. Ajo varet nga “interesa, gjendje shpirtërore dhe kapacitete të ndryshme dhe të panjohura të njerëzve dhe jo nga ndonjë ide e pranuar e sendeve”. Prandaj njerëzit duhet të mbështeten “në historinë e fakteve dhe gjykimin e shëndoshë për kërkimin e shkaqeve të mundshme dhe gjetjen e një analogjie mes veprimeve dhe pasojave të tyre”.²⁷ Një këndvështrim i njëjtë u rishfaq në shkrimet e Adam Smithit. Në veprën *Teoria e Ndjenjave Morale* ai dalloj një kontrast të thellë mes “njeriut të gjallë publik” dhe “njeriut të sistemit.” I pari “do të respektojë pushtetin dhe privilegjet e pranuar, edhe të individëve e aq më tepër të atyre rendeve dhe shoqërive të mëdha që përbëjnë shtetin”. Gjithsesi, njeriu i sistemit kombinon arrogancën me një vizion estetik dhe hedh poshtë çdo devijim nga ose kundërshtim ndaj realizimit të plotë të “planit ideal” të tij:

Duket sikur ai imagjion se mund të sistemojë anëtarët e ndryshëm të një shoqërie të madhe me të njëjtën lehtësi që dora sistemon gurët e ndryshëm në një fushë shahu; ai nuk mendon se gurët në fushën e shahut kanë parim tjetër lëvizjeje, përveç atij që dora u imponon; porse në fushën e madhe të shahut të shoqërisë njerëzore secili nga gurët ka një parim lëvizjeje të tijin, përgjithësisht të ndryshëm nga ai që ligjëvënësi mund të ngulitë në mendje.²⁸

POHIMET POLITIKE TË TEORISË EKONOMIKE

Në formën e tij të maturuar liberalizmi shprehu të njëjtat dyshime si konservatorizmi për marrjen seriozisht të teorisë politike. Edhe Benthami, mishërimi i teorianit, argumentoi se “prirja për të shtyrë shumë larg teorinë pranohet të jetë pothuajse universale.”²⁹ Dhe në një pasazh plot me analogji të lashta politike ai tregoi se teoria politike duhet të shtypë impulsin estetik me implikimet e tij në formë-dhe-lëndë. Shkenca e ligjit “është për artin e bërjes së ligjeve ajo çfarë shkenca e anatomisë është për artin e mjekësisë: me ndryshimin se subjekt i saj është ajo *me* të cilën artisti duhet të punojë, në vend të asaj *mbi* të cilën ai duhet të veprojë”.³⁰ Ajo çfarë përcaktoi qëndrimin e liberalëve nuk ishte thjesht një besim se kompleksiteti i ndërveprimeve sociale krijonte vështirësi të pakapërcyeshme për veprimin racional ose të qëllimshëm, por ndjesia se aktiviteti politik kishte humbur sharmin dhe grishjen e tij.

Shkrimtarë të temperamenteve aq të ndryshme si Methju Arnold dhe Frederik Bastiat³¹ shprehën të njëjtin reagim estetik kundër politikës si një aktivitet paksa korruptues. Arnoldi, i shqetësuar nga “gjithë kjo veprimtari politike” i këshilloi liberalët e rinj “të mendojnë më pak për makinerinë [organizative], të qëndrojnë më larg fushës së politikës për momentin dhe më mirë të përipiqen të promovojnë... përqendrimin introspektiv”. Bastiati paralajmëroi se edhe shtrirja më e vogël e veprimit të qeverisë përtej minimumit absolut çonte në “*une prépondérance exagérée*” të politikës.³² Por pikëpamja introspektive e Arnoldit nuk gëzonte përkrahje të gjerë dhe shumica e liberalëve ndoqën pikëpamjen se njeriu e afirmonte ekzistencën e tij përmes aktivitetit ekonomik. Çfarë dukej me rëndësi ishte mënyra si njerëzit ecnin me biznesin e bërjes para; ajo çfarë shqetësonte individin ishte strategjia e përparimit social. Kështu, për liberalët aktiviteti nënkuptonte para së gjithash e mbi gjithçka aktivitetin ekonomik.

Përparësia e aktivitetit ekonomik, si dhe tendenca e një pjese të liberalëve për të trajtuar fenomenet ekonomike si identike dhe me shtrirje të përbashkët me fenomenet sociale, u nxit në masë të madhe nga metodat dhe supozimet e përdorura nga ekonomistët klasikë të shekullit të tetëmbëdhjetë. Duke ndjekur përshtjellimet e pafundme të nocioneve të tilla si ndarja e punës, marrëdhënia mes strukturës klasore dhe organizimit të prodhimit dhe shpërndarjes, lidhjet shkakore mes variablave të pasurisë dhe popullsisë dhe pasojat e tyre mbi progresin; dhe duke shpalosur shtysat që i bënë njerëzit të kishin një lloj sjelljeje ekonomike në vend të një tjetre, ekonomistët po krijonin një tërësi dijesh bashkëkohore me tërësinë e jetës së organizuar sociale.

Hapi pasardhës ishte i natyrshëm dhe pothuajse i pashmangshëm. Nëse ekonomiksi ishte dija e shoqërisë, asgjë përveç përlësisë nuk do të mund të pengonte ekonomistin të mendonte se marrëdhëniet shoqërore dhe aktivitetet e shumëllojshme, me pak fjalë jeta e shoqërisë, mund të përmbliidhej në kategori të ndryshme ekonomike. Për shembull, ekonomisti mund të formulonte një koncept si prodhimi vjetor dhe ta përdorte atë si një shkurtim për aktivitetet e anëtarëve të shoqërisë gjatë një viti të caktuar. Në të njëjtën mënyrë, nëse pyetej për elementët përbërës të shoqërisë, ekonomisti përgjigjej se shoqëria ndahej në “pjesë” të përcaktuara si, punëtorët, pronarët dhe sipërmarrësit, dhe këta, sikurse e shprehu dhe Milli “konsiderohen në ekonominë politike sikur përbëjnë të gjithë komunitetin”. Sërisht, ekonomisti supozonte se studimet e tij ofronin përgjigjen për llojin e shtysave psikologjike që vendosnin njerëzit në lëvizje dhe përcaktonin në masë të madhe sjelljen e tyre sociale: ishte dëshira për të përmirësuar statusin e tyre social, një dëshirë që “lind me ne që nga ngjizja dhe nuk na lëshon kurrë derisa shkojmë në varr”, një dëshirë që gjeti shkarkimin e saj natyror në aktivitetin ekonomik.³³

Duke e reduktuar jetën sociale në terma ekonomike, ekonomistët iu drejtuan një teorie të veprimtarisë, e cila kishte domethënie të mëdha për politikën dhe teorinë politike. Aspekti i veçantë i teorisë së tyre ishte argumenti se aktiviteti i qëllimtë mund të ndërmerrej me sukses pa iu referuar ndonjë principi mbështetës ose

¹ Frederik Bastiat (1801-1850) ishte një publicist i famshëm francez, i cili bëri shumë për të përhapur doktrinat e pranuarat klasike ekonomike të liberalizmit. Shënjestrat e tij kryesore ishin socializmi dhe proteksionizmi. Mendimi i tij ishte ndikuar shumë nga Bexhamin Franklin, Adam Smith, dhe ekonomisti amerikan i shekullit nëntëmbëdhjetë, Henri Karei.

autorizues, me përjashtim të atij të “natyrës”. “Njeriu”, shkroi Adam Smithi “përgjithësisht konsiderohet nga burrat e shtetit dhe projektuesit si material për një lloj mekanike politike. Projektuesit ndërhyjnë tek natyra... ndërkohë mjafton që ajo të lihet e qetë”.³⁴ Mësimet, sikurse mekanizmat e kontrollit, të lidhura me autoritetin tradicional të kishës, klasës dhe rendit politik konsideroheshin të panatyrshme. Ndaj ajo çfarë ishte me të vërtetë radikale tek liberalizmi ishte konceptimi i tij i shoqërisë si një rrjet aktivitetesh të ndërmarrja nga aktorë, të cilët nuk njihnin asnjë princip autoriteti. Shoqëria përfaqësonte jo vetëm një rend spontan dhe të vetërregullueshëm, por edhe një gjendje të patrazuar nga prania e autoritetit.

Këto cilësi të veprimtarisë sociale – mungesa e autoritetit, spontaniteti dhe prirja për vetërregullim – nënkuptuan se veprimtarisë sociale i mungonte elementi karakteristik i veprimtarisë politike, domosdoshmëria për t’u drejtuar pushtetit. Industria, deklaroi Spenser, është një formë “spontane” e aktivitetit, e cila vepron në bazë të principit të “bashkëpunimit vullnetar”; njerëzit “punojnë së bashku me pëlqimin e tyre”.³⁵

Funksioni i vjetër i shpërndarjes së të mirave në bazë të një standardi drejtësie u transferua nga sfera politike dhe u caktua gjyqimit të paanshëm të mekanizmit të tregut.³⁶ Ajo pak çfarë mbijetoi nga koncepti i drejtësisë kishte të bënte me konceptin hobsian të paanshësisë ose më gjerësisht me identifikimin e drejtësisë me sigurinë: nuk është për t’u çuditur që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë liberalët filluan të vinin në dyshim ekzistencën e drejtësisë politike. Sikurse pohoi edhe Bastiati, “qëllimi i ligjit nuk është, po të flasim prerazi, të bëjë që drejtësia të mbizotërojë”, por “të pengojë mbretërimin e padrejtësisë. Në fakt, nuk është drejtësia ajo që ka një ekzistencë reale, por padrejtësia. Njëra është rezultat i mungesës së tjetrës”.³⁷ Për liberalët ajo pak çfarë mbetej nga politika e qëllimshme, çuditërisht, identifikoheshin përgjithësisht me funksionin e filozofit të Lokut. Ekuivalenti politik i spastrimit kishte të bënte me shfuqizimin e të gjitha politikave dhe ligjeve të trashëguara, të cilat të ushqyera nga iluzioni se politika ishte në një farë mase një sipërmarrje krijuese, pengonin veprimtarinë sociale dhe ekonomike:

... Kështu siç qëndrojnë gjërat, pothuajse gjithçka ka të bëjë me zhbërjen e asaj që është bërë dhe me shmangien e shqetësimeve që do të sjellë ndërmarrja e këtij procesi të zhbërjes në mënyrë të menjëhershme dhe të pamenduar.³⁸

Tematikat më të vjetra të teorisë politike si një formë mbrojtëse e dijes dhe veprimtarisë politike si mjet rigjenerimi nuk humbën në traditën perëndimore. Ajo çfarë u la nga liberalizmi u mor nga radikalizmi i shekullit tetëmbëdhjetë dhe u rivendos me socializmin revolucionar të shekullit nëntëmbëdhjetë. “Asgjë nuk është e pamundur për një ligjëvënës”, shkroi Mabli, “pasi ai mban, si të themi, zemrën dhe shpirtin tonë në duart e tij; ai mund të krijojë njeriun e ri”. Dhe në zemër të marksizmit ishte pohimi se shoqëria mund të transformohej prej veprimtarisë politike së mirinformuar nga dija e ligjeve historike. Që të marrë kuptim veprimtaria politike duhet të jetë revolucionare në karakter, pasi ndodhi vetëm përmes një akti të shkatërrimit krijues që njeriu “përfundimisht e ndan veten nga bota e kafshëve... dhe kalon në kushte që janë me të vërtetë njerëzore.”³⁹

Mes liberalëve, gjithsesi, mungesa e interesit për veprimtarinë politike, bindja se ekonomiksi përbënte studimin e përshtatshëm të njerëzimit dhe veprimtaria ekonomike synimin e përshtatshëm, përsheptuan rënien e teorisë politike. Kjo, sepse këto besime nxitën imponimin e kategorive ekonomike në mendimin politik e si rezultat roli dhe statusi i teorisë politike filloi të uzurpohej nga teoria ekonomike. Liberalët filluan të pohonin se ekonomiksi jo vetëm ishte forma më e nevojshme e dijes për individin gjatë kërkimit të lumturisë, por ai siguronte edhe recetat e domosdoshme për t’u marrë me punët e zakonshme të shoqërisë. Për të gjetur burimin intelektual të këtyre zhvillimeve ne duhet t’i rikthehemi Lokut dhe më saktësisht pohimit të tij lidhur me qëllimet e rendit politik. Qeveria, tha ai, ekzistonte “për sigurimin, ruajtjen dhe përparimin” e “interesave civile” të njerëzve. Në vijim, këto interesa përfshinin “jetën, lirinë, shëndetin dhe mungesën e dhimbjes dhe zotërimin e sendeve të jashtme”. Kështu mund të thuhet se politikja qëndron në shumën e rregullimeve mbrojtëse, të cilat u dhanë

mundësi njerëzve të “sigurojnë atë çfarë dëshirojnë shtesë”.⁴⁰ Gjithsesi, natyrisht që lloji i dijes që merrej me mbrojtjen e zotërimeve, me t’u shndërruar në garanci praktike, ishte diçka që duhej të merrej e mirëqenë, pothuajse në të njëjtën mënyrë që njohuria e ndërtuesit të gardhit merret e mirëqenë nga pronari i shtëpisë, i shqetësuar vetëm për ta mbajtur gardhin në gjendje të mirë. Nga ana tjetër, forma e dijes që u mundësonte njerëzve të siguronin atë çfarë ata dëshironin gëzonte një tërheqje të menjëhershme dhe të vazhdueshme.

Shkrimtarët e parë si Smith ishin të kënaqur të çonin përpara pohimin e kufizuar se ekonomiksi përbënte një degë ndihmëse të urtësisë qeverisëse që merrej kryesisht me mënyrën si një shoqëri fitonte mbijetesën e saj dhe grumbullonte të ardhura të njaftueshme për shërbimet publike.⁴¹ Megjithatë, në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, po pretendohet një terren më i gjerë, që tregonte se shkenca e re ishte e etur dhe e aftë të pushtonte territorin që fillimisht zotërohej nga filozofia politike: atë të zotërimit të dijes sovraane që lidhet me mirëqenien e komunitetit në tërësi. Ekonomia politike, tha MekKulloku,^{*} ishte studimi i interesave më të mira të shoqërisë. Përderisa ishte një subjekt që shqyrtonte si “të marrim sasinë më të madhe të mundshme të pasurisë me vështirësinë më të vogël të mundshme”, ishte një shkencë, e cila që në përkufizim promovonte interesat e të gjitha klasave.⁴² Për më tepër, ekzistonte një marrëdhënie e drejtpërdrejtë mes pasurisë dhe civilizimit – “një popull i varfër nuk është kurrë i rafinuar, e as një popull i pasur ndonjëherë barbar” – kështu shkenca që studioonte pasurinë cilësohej si master shkenca. “Vendosja e një sistemi të mençur të ekonomisë publike arrin të kompensojë çdo mangësi tjetër”. “Pasuria është e pavarur nga natyra e qeverisë”.⁴³

Kështu gjatë pjesës së parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, teoria ekonomike kishte filluar të kërkonte për vete mantelin e teorisë politike dhe të mbante mbi shpatulla barrën e prononcimit në emër të së mirës së të gjithë shoqërisë. Kjo u ilustrua nga dialogu imagjinar i shkruar nga Xhejms Mill, dialog i shquar për përvetësimin e qëllimit të tonit dhe stilit të filozofit të parë të madh politik – si për ta bërë edhe më të theksuar shpërnguljen e politikës nga teoria ekonomike:

B. “Ne mund... të përcaktojmë, me pëlqimin tuaj, si një propozim të përgjithshëm se kurdo që shumë agjentë dhe veprime kombinohen për prodhimin e një rezultati të caktuar, ose një grupi rezultatesh, një pikëpamje drejtuese e së tërës është absolutisht e domosdoshme për të ndikuar këtë kombinim në mënyrën më perfekte.”

A. “Jam dakord.”

B. Por një pikëpamje komanduese e të gjithë subjektit, në të gjithë pjesët e tij dhe lidhjen e këtyre pjesëve, a është kjo gjë tjetër përveçse një tjetër emër për teorinë, apo shkencën e subjektit? Teoria (*theoria*) është në fakt PIKËPAMJE: dhe shkenca është *scientia*, DIJE; që nënkupton pikëpamje ose dije jo vetëm për këtë dhe atë pjesë, por si në rastin e gjeneralit me ushtrinë e tij, për të tërën.”

A. ... ti do të thuash se teoria ose shkenca e ekonomisë politike është një pikëpamje drejtuese e kombinimeve të gjera të agjentëve ose veprimeve të angazhuara për të prodhuar në shërbim të njeriut, tërësisë së sendeve që ai zotëron dhe konsumon...sendeve që ai i emëron materie të pasurisë – objekti madhështor ndaj të cilit drejtohen të gjitha përpjekjet dhe kujdesi i qenieve njerëzore.”

B. “Më ke paraprirë saktë në mendim.”

A. “Do të vazhdoje të më pyesje... nëse veprimet e panumërta...nuk mund të ndodhin në më shumë se një mënyrë; thënë shkurt, në një mënyrë të keqe ose një mënyrë të mirë? Nëse nuk ka rëndësi që ato të mund të ndodhin në mënyrën më të mirë? Dhe nëse diferenca mes mënyrës më të mirë dhe mënyrës më të keqe nuk ka gjasa të jetë shumë e madhe...Dhe të gjitha këtyre pyetjeve unë duhet t’u përgjigjem pozitivisht.”⁴⁴

^{*} Xhon Ramsei MekKulloku (1789-1864), skocez, ishte një shkrimtar prodhimtar. Krahas një seri studimesh ekonomike dhe statistikore, ai redaktoi Pasurinë e Kombeve të Smithit dhe veprat e Rikardos. Ai ishte më shumë një ndjekës besnik i ideve klasike ekonomike sesa një mendimtar origjinal.

Në ushtrimin e pozitës së tyre sovrane ekonomistët gradualisht filluan t’i shtrinin konceptet dhe teknikat e tyre të specializuara të analizës të fenomenet politike. Duke menduar se rezultatet do të ishin më vlerë në rast se institucionet e qeverisë do t’i nënshtroheshin të njëjtës analizë që kishte rezultuar aq efektive në trajtimin e llojeve të tjera të aktivitetit, ekonomistët ngritën pyetjen e pafajshme: përdërisa të gjitha format e aktivitetit i përkasin njëres prej dy klasave “prodhuese” dhe “joprodhuese,” ku do të duhej të vendosej veprimtaria qeverisëse? Edhe pse nuk mund të thuhej se ishte prodhuese në të njëjtën mënyrë si marrja me bujqësi apo prodhimtari dhe pavarësisht se jetonte në mënyrë parazitare me punën prodhuese të grupeve të tjera, qeveria nuk ishte plotësisht e padobishme sikurse ishin disa aktivitete joprodhuese. Atëherë përse të mos e përfshijmë në parimin e ndarjes së punës? Kjo zgjidhje lejoi që qeverisja të trajtohej si një lloj aktiviteti, e cila edhe pse nuk ishte vetëprodhues, kontribuonte në ruajtjen e kushteve që lejonin shoqërinë të ndërmerre detyrën bazë të prodhimit. Në fund, dikush duhet të ishte përgjegjës për ruajtjen e ligjit dhe rendit, duke garantuar që rrugët të ishin të rregulluara dhe mbrojtja kombëtare ashtu siç duhej.

Si rezultat i kësaj dhe formave të tjera të arsytimit, shumë koncepte tradicionale politike e humbën rëndësinë ose humbën tërësisht. “Teksa shoqëria sendërtohet dhe organizohet,” shkroi Spenseri, “pasuria dhe progresi i saj bëhen gjithnjë e më të pavarura nga secili.” Harmonia sociale në vend që të ishte përgjegjësi e autoritetit qeverisës, ishte plani i askujt; ishte rezultantja që rridhte nga ekuilibri spontan i forcave ekonomike. Statusi i qytetarit u përthith nga ai i prodhuesit dhe pjesëmarrja politike, pavarësisht përpjekjeve heroike të reformatorëve liberalë për të shtrirë të drejtën e votës, dukej më shumë si një masë mbrojtëse sesa si një aktivitet vetëplotësues: “secili është gardiani i vetëm i sigurt i të drejtave dhe interesave të tij” dhe kështu drejtësia kërkonte një të drejtë të barabartë vote ku çdo individ duhej të kishte rëndësi “po aq sa çdo individ tjetër në komunitet”. Të kesh mundësi të votosh do të thoshte të jesh në një pozitë më të mirë për të mbrojtur interesat e tua.⁴⁵

EKLIPSI I AUTORITETIT POLITIK: ZBULIMI I SHOQËRISË

Nga diskutimi i mëparshëm u tregua se, ndërsa mori formë, tufa e supozimeve dhe propozimeve liberale shfaqti cilësi absolutisht antipolitike. Kjo mund të kuptohet më mirë duke analizuar shkurtimisht marrëdhënien mes Lokut, nismëtar i traditës liberale, dhe Hobsit. Një nga tiparet karakteristike të sistemit hobsian ishte pohimi i tij i fuqishëm për veçantinë e politikës. Shprehja më e gjallë e kësaj ishte kontrasti që Hobsi përshkroi mes gjendjes natyrore dhe rendit politik, mes natyres të pakufizuar dhe kufizimeve artificiale që vendosen prej autoriteteve politike në mbështetje të civilizimit. Rendi politik, shoqëria dhe civilizimi krijojnë një trinitet ku shoqëria dhe civilizimi ishin në varësi të rendit politik dhe të treja kishin të përbashkët një karakter artificial dhe antinatyror. Në të njëjtën kohë, Hobsi mori masa të veçanta për të këmbëngulur se ajo çfarë ishte politike gëzonte një identitet të vetin, se për shembull autoriteti politik nuk duhet të ngatërrohej me ose të uzurpohej nga autoriteti fetar ose shoqëror.

Loku jo vetëm që i hodhi poshtë këto antiteza, por ai tregoi se ato ishin të gabuara. Ai e bëri këtë duke parë në gjendjen natyrore një gjendje të paqte politike, me të gjitha të tiparet e ideale të shoqërisë politike dhe asnjë prej të metave të saj.

Çdo shkelje që mund të bëhet në gjendjen e natyrës mund gjithashtu të ndëshkohet po në gjendjen e natyrës dhe sa më tej të mundet në komunitet... (ligji i natyrës është) po aq i kuptueshëm dhe i qartë për një krijesë racionale dhe për studiuesin e atij ligji, sa edhe ligjet pozitive të komunitetit, në fakt ndoshta më i qartë... Mjaft më mirë është në gjendjen e natyrës (sesa në një monarki absolute), ku njerëzit nuk janë të detyruar t’i nënshtrohen vullnetit të padrejtë të tjetrit.⁴⁶

Trajtimi si politike i asaj që Hobsi e kishte konsideruar të ishte jo vetëm parapolitike, por antipolitike solli errësimin e identitetit dhe zhvlerësimin e statusit të politikës. Gjendja e natyrës pohohej të ishte një situatë e “lirisë perfekte,” e paprishur nga “asnjë pushtet superior mbi tokë” apo nga “autoriteti ligjvënës i njeriut.” Ishte gjithashtu një gjendje e barazisë perfekte, “ku i gjithë pushteti dhe juridiksioni është reciprok, askush nuk ka më shumë se tjetri”; ku të gjithë ishin të lirë të vepronin dhe t’i përdornin zotërimet e tyre ashtu si e mendonin më mirë, duke iu nënshtruar vetëm diktatit të përjetshëm moral të ligjit të natyrës. Pushteti politik ishte i pranishëm, por duke qenë i shpërndarë mes të gjithë anëtarëve, ku secili prej tyre kishte një detyrim racional për të ndihmuar të tjerët për të forcuar ligjin e natyrës, atij i mungonte forma e përcaktuar dhe institucionalizuar.⁴⁷ Së fundmi, gjendja e natyrës ishte mbi të gjitha një gjendje shoqërore, ku njerëzit jetonin në “një komunitet të natyrës,” kështu për njeriun lokian rendi politik nuk mund të ishte kursesi një shpikje, por vetëm një rizbulim i natyrores; asnjëherë parakushti vital i një komuniteti, por vetëm superstruktura e tij. Duke mohuar kontrastin mes natyrës dhe rendit politik, ky i fundit humbi cilësinë e tij si një arritje e madhe. Loku e paraqiti atë si një ilaç modest, të arsyeshëm për “parehatshmërinë” e gjendjes së natyrës, si një lloj akomodimi më të mirë për ata që ishin tashmë pronarë shtëpie, në vend të një strehe të ngritur në dëshpërim e sipër nga të pastrehët.

Normave sociale dhe politike të mishëruara në këtë gjendje ideale të natyrës iu dha një paraqitje më e mprehtë përmes kontrastit me një tjetër situatë model, gjendjes së luftës.⁴⁸ Shenjat dalluese këtu ishin një “model i shpallur force” me qëllim vendosjen e dikujt nën pushtetin “absolut” të tjetrit dhe mungesa e një “kreu të zakonshëm në tokë për t’u drejtuar për shpëtim”. Ndërsa gjendja e natyrës ishte e kufizuar brenda një faze tërësisht paracivile, gjendja e luftës përfaqësonte një shmangie të përkohshme nga normaliteti, potencialisht e pranishme si në gjendjen ideale të natyrës, ashtu edhe në shoqërinë civile, shmangie në kuptimin se ajo shkatërronte elementin dallues të komunitetit, i përbashkët për të dy gjendjet: marrëveshjen për të jetuar me një ligj të përbashkët, në njërin rast me ligjin e natyrës dhe në tjetrin me ligjin pozitiv të shtetit.

Hapi vijues në argumentin e Lokut ka paraqitur gjithmonë vështirësi për t’u interpretuar. A e konceptonte Loku shoqërinë politike me zanafillë në gjendjen e natyrës apo në atë të luftës? Nëse merret shpjegimi i parë, vendimi i individit për t’u bërë pjesë e shoqërisë civile duket ose i pashpjegueshëm ose i tepërt. Pasi, nëse shoqëria politike është një përmirësim i natyrës, çfarë mbetet të bëjmë me përshkrimin idilik të gjendjes së natyrës nga Loku? Nëse situata natyrore ishte përgjithësisht e harmonishme, paqësore dhe racionale, përse të largohemi prej saj? Nëse është e prekur vetëm nga “parehatshmëria”, a është ky një shkak i mjaftueshëm për të zgjedhur një tjetër mënyrë jetese? Nga ana tjetër, nëse shoqëria politike do të rridhte prej gjendjes së luftës, si mund t’i rezistojmë logjikës së Hobsit dhe përfundimit të tij se shoqëria politike përfshin domosdoshmërisht një strukturë pushteti dhe autoriteti të mjaftueshëm për të mposhtur anarkinë dhe mundësinë e ripërsëritjes së saj? Meqenëse shumica e interpretimeve e kanë marrë për të mirëqenë se Loku i pa rrënjët e shoqërisë politike në njërin nga këto dy gjendje, ato kanë arritur në përfundimin se gjendja liberale e tij u realizua pavarësisht arsytimit të pakujdesshëm të autorit të tij, që e rendit Lokun si një filozof jo aq për dashamirësi sesa për veprat e tij të mira. Më vonë ka qenë e modës të argumentohej, veçanërisht mes atyre që e shihnin shoqërinë politike të Lokut me rrënjë në gjendjen e luftës, se Loku është në të vërtetë Hobsi me kostum liberal, çka është një lloj versioni politik i debatit Bekon-Shekspir.⁴⁹

Interpretime të tilla më duken të gabuara, pasi nuk arrijnë t’i kushtojnë rëndësinë e duhur gjuhës së Lokut. Ajo çfarë Loku bëri ishte shtimi i një situatë të tretë, të ndryshme nga ato që ai i quajti “gjendja perfekte e natyrës” dhe gjendja e luftës. Për arsye qartësie do ta emërtojmë *gjendja e rënë e natyrës*, sepse ka ngjashmëri sugjestive të caktuara me dallimin që Trolsh (Troeltsch) bën mes konceptimit kristian të ligjit natyror që mbizotëronte përpara rënies në mëkat dhe ligjit “të rënë” natyror që mbretëroi në gjendjen mëkatore që vijoi.

... Po të mos ishte për korrupsionin dhe mëkatimin e njerëzve të degjeneruar nuk do të kishte nevojë për ndonjë [shoqëri] tjetër, asnjë domosdoshmëri që njerëzit të shkëputen nga ky komunitet i madh e natyror dhe përmes marrëveshjeve pozitive të rregullohen në shoqërizime më të vogla dhe të ndara.⁵⁰

Që Loku synonte të përcillte përshtypjen e një situatë të ndryshme nga ajo e gjendjes ideale të natyrës, e sërish një që nuk duhet të ngatërrohet me gjendjen e luftës, shihet edhe nga gjuha kërcënuese që ai përdori në përgatitjen e një konteksti të arsyeshëm për kontratën. Situata natyrore, na thotë ai, është “plot me frikëra dhe rreziqe të vazhdueshme” dhe “pjesa më e madhe” e banorëve të saj duke qenë larg të qenit interpretues racionalë të ligjit të natyrës, sikurse jemi mësuar të supozojmë, janë përshkruar si “vëzhgues jo të vendosur të barazisë dhe drejtësisë”.⁵¹ Njerëzit shtyhen drejt shoqërisë civile për shkak se janë të pushtuar nga ankthi, “të pasigurt” për të drejtat e tyre, “plot me frikë”. Por ndërsa i largohen gjendjes së rënë të natyrës – pasi gjendja ideale sipas përkufizimit nuk ka “shqetësime” – kërkimi prej tyre i një rregullimi më të mirë do të drejtohej domosdoshmërisht nga njohja e situatës ideale; pra nga normat që u lejojnë atyre të dallojnë “të metat” e gjendjes së rënë. Shkurtimisht, “defektet” që e bënin gjendjen e rënë të papranueshme njiheshin vetëm nën dritën e normave të mishëruara në gjendjen ideale. Kjo paraqitet qartë tek “ilaçet” (një pjesë e rëndësishme e përdorimit nënkupton rivendosje e jo shpikje) për gjendjen e rënë. Këto janë: një ligj i përbashkët, një metodë për gjykim të paanshëm e një pushtet detyrues, dhe të treja i referohen rregullimeve që kanë qenë në fuqi në gjendjen ideale.⁵²

Pasoja e argumentit të Lokut ishte errësimi i karakterit politik të shoqërisë civile. Cilësitë e saj politike nuk dukeshin *ab nihilo*; ato ishin paraprirë nga forma politike e dhënë në gjendjen ideale të natyrës. Ata që mund të quhen elementë me të vërtetë politikë në shoqërinë civile u prezantuan përmes marrëveshjes së qartë, ku njerëzit pranonin një trup të përbashkët rregullash dhe premtonin t’i bindeshin vendimeve të shumicës. Por më me rëndësi ishte karakteri minimal i rendit politik. Kjo nuk do të thotë se funksionet dhe juridiksioni i qeverisë ishin ngushtësisht të kufizuara, pasi gjuha e Lokut i la hapësirë të gjerë veprimtarisë qeverisëse, por se Loku nisi një mënyrë të menduar ku shoqëria dhe jo rendi politik ishte faktori kryesor ndikues. Në vend që të shtronte pyetjen tradicionale: ç’lloj rendi politik nevojitet që shoqëria të ruhet, Loku e rrotulloi pyetjen për të dalë në çfarë rregullimesh sociale do të sigurojnë vazhdimësinë e qeverisë?

Loku nisi sulmin e tij kundër modelit tradicional të shoqërisë, ku marrëdhëniet e rregulluara shoqërore dhe institucionet mbështeteshin në direktivat e dhëna nga një qendër politike, duke e zëvendësuar konceptimin e shoqërisë si unitet vetaktivizues, të aftë për të krijuar një vullnet të përbashkët. Në shekullin e pasues Rusoi do ta shpallte në mënyrë më sistematike këtë ide të shoqërisë si një entitet i vullnetshëm, por që tek Loku mund të shquajmë parashtrimin e saj të parë të turbullt, e kështu fillesat e një ndryshimi në mendim që përfundimisht theu monopolin e rendit politik si i vetmi vullnet publik. Një vështrim nga afër i gjuhës që Loku përdori për të përshkruar kontratën bazë na jep disa të dhëna lidhur me këtë prirje.

Akti i marrëveshjes kërkonte dorëzimin nga “çdokush prej anëtarëve” të pushtetit të tij natyror në “duart e komunitetit”. Kjo nënkupton se “komuniteti” ekzistonte përpara se shoqëria civile të krijohej. “... Njerëzit ia dorëzojnë të gjithë pushtetin e tyre natyror *shoqërisë* ku ata bëjnë pjesë dhe *komuniteti* e vendos pushtetin ligjvënës në këto duar pasi ata ndihen mirë me këtë besim...”⁵³ Njohja e pushtetit kolektiv të shoqërisë bëhet edhe më e qartë në përshkrimin e Lokut për çfarë ndodh kur qeveria e vendos veten në një gjendje lufte me qytetarët e saj. Në rastin kur qeveria cenon besimin në të, pushteti i kthehet shoqërisë”. Shoqëria, nga ana e saj, zotëron vullnetin me unitet të mjaftueshëm për të “vepruar si epror dhe mbajtur legjislativin... ose për të ndërtuar një strukturë të re, ose në bazë të strukturës së vjetër për ta vendosur atë në duar të reja...”⁵⁴ Shpesh si kritikë ndaj Lokut është thënë që ai nuk ofroi procedura të përcaktuara, të cilave komuniteti mund t’u drejtohej kur ndihej i justifikuar të ngrihej kundër qeverisë. Kjo pikë nuk qëndron, pasi e

rëndësishme në teorinë e Lokut është se kur një qeveri arbitrare provokon revolucion ajo nuk e gjen veten përballë një mase të paorganizuar individësh, por përpara një “shoqërie”; pra, përballë një grupi koherent.

Konceptimi i Lokut për revolucionin si një akt social shënoi një ndarje të rëndësishme nga tradita e mëparshme. Në shkrimet e shekullit të gjashtëmbëdhjetë, si p.sh. *Vindiciae contra tyrannos*, ose në komentet koncize të Kalvinit për rolin e *ephori-së*, dhe sërish në teorinë politike të Althusiusit, ka pasur një përpjekje të vetëdijshme për të ruajtur të drejtën e rezistencës duke e identifikuar ushtrimin e saj me institucione të veçanta si kisha, asambletë lokale ose gjykatës të caktuar.⁵⁵ Megjithatë, Loku ia dha këtë të drejtë “shoqërisë” ose më konkretisht shumicës.⁵⁶ Duke e paraqitur shumicën si instrumentin përmes të cilit shoqëria vepron, Loku i dha një tjetër goditje rolit të veçantë të rendit politik. Ai e perceptoi shumicën të pavarur nga proceset dhe institucionet politike; një forcë që i jepte shoqërisë një drejtim dinamik, por që e kishte origjinën jashtë proceseve dhe institucioneve politike. “... Meqenëse është e domosdoshme për atë trup të vetëm për të ecur në një drejtim, është e domosdoshme që trupi të shkojë në atë drejtim nga e tërheq forca më e madhe dhe kjo forcë është pëlqimi i shumicës”. Megjithatë, Loku nuk mjaftohej me argumentimin e rolit të shumicës thjesht në bazë të pushtetit të saj superior. Mundësia duhet të vishej me të drejtën; që do të thotë se shumicës duhet t’i jepej autoritet. Kjo sigurohej përmes kontratës bazë: secili “merr përsipër kundrejt të gjithëve në atë shoqëri detyrimin për t’iu nënshtuar vendimit të shumicës dhe për të qenë i përcaktuar prej tij...”.⁵⁷ Në këtë mënyrë autoriteti përfundimtar ishte shoqëria. Kjo pati një ndikim të madh në statusin e rendit politik pasi “shoqërizimi” i autoritetit u realizua duke e zhveshur autoritetin nga institucionet politike dhe duke i vendosur këta të fundit në varësi të shoqërisë. Një ilustrim i mirë i kësaj është trajtimi që Loku i bëri institucionit të monarkisë, e cila tradicionalisht ishte parë si mishërimi më i lartë i autoritetit politik. Loku e transformoi mbretërinë në një detyrë të thjeshtë ekzekutive, pa status të pavarur, agjente e thjeshtë e shoqërisë. Roli i saj ishte ai i “imazhit, shpirtit ose përfaqësuesit të komunitetit, vepronte përmes vullnetit të shoqërisë, të përcaktuar në ligjet e saj... Ajo nuk ka vullnet dhe pushtet tjetër përveç atyre që i jep ligji.”⁵⁸

¹ Kritikët e shekullit të nëntëmbëdhjetë duhet të pranojnë se kapitulli 24 i Leviathanit përmbante një analizë tipike merkantiliste. Megjithatë mbetet e vlefshme kritika se Hobsi nuk perceptoi një marrëdhënie integrale mes faktorëve ekonomikë dhe dukurive politike. Në këtë aspekt ai qëndron më poshtë se paraardhësi i tij Zhan Bodin dhe kritiku bashkëkohës i tij, Xhejms Harrington.

² “Of the First Principles of Government,” në *Essays, Moral, Political, and Literary*, ed. T. H. Green dhe T. H. Grose, vëll. 2. (London: Longmans, 1898), 1:109-110; Adam Smith, *An Inquiry into the Nature and Causes of the Wealth of Nations*, ed. E. Cannan, *Modern Library* (New York: Random House, 1937), bk. 5, kap. 1 (f. 670) (në vijim cituar si *Wealth*). Për një vështrim më të thellë për këtë çështje, shih shënimet e Proudhon, *Oeuvres complètes* (Paris, 1868), 3:43 (par.91).

³ *Oeuvres complètes*, vëll. 7 (Paris, 1862-1878), (në vijim cituar si *Bastiat*, *Oeuvres*).

⁴ *Ibid.*, 7:27, 57-60. Për të njëjtin nocion tek Adam Smith shih *Wealth* 1.1-2 (f. 4-9, 13ff.) Spenseri e shihte ndarjen e punës si “pjesë të një procesi edhe më të përgjithshëm që përshkon krijimin, si joorganik ashtu edhe organik...[Ajo] nuk është krijuar as në mënyrë të veçantë, as nuk është miratuar nga një mbret, por është zhvilluar pa paramendimin e askujt”. *Essays, Scientific, Political, and Speculative*, vëll. 3 (New York: Appleton, 1910), 3:323 (në vijim cituar si *Essays*); *The Study of Sociology* (New York: Appleton, 1899), f. 65.

Ndikimi sociologjik i ekonomistëve klasikë është përshkruar nga A. Small, *Adam Smith and Modern Sociology* (Chicago: University of Chicago Press, 1907); G. Bryson, *Man and Society: the Scottish Inquiry of the Eighteenth Century* (Princeton: Princeton University Press, 1945). Një sondazh i mirë i ideve të Smithit mund të gjendet në J. Viner, “Adam Smith and *Laissez Faire*”, në *The Long View and the Short: Studies in Economic theory and Policy* (Glencoe, Ill., Free Press, 1958), f. 213, 246. Shih gjithashtu veprën e fundit të J. Cropsey, *Polity and Economy: An Interpretation of the Principles of Adam Smith* (The Hague Nijhoff, 1957).

⁵ A Treatise of Human Nature 3.2.8. Një trajtim më i gjerë i kësaj teme gjendet tek Èlie Halévy, *Growth of Philosophic Radicalism*, përkth. M. Morris (London: Faber and Faber, 1928), f. 199-200.

⁶ Spencer, *The Study of Sociology*, f. 64.

⁷ K. Mannheim, *Essays on the Sociology of Culture* (London: Routledge, 1956), f. 91-170, S. F. Nadel, *Foundations of Social Anthropology* (London: Cohen and West, 1951), f. 55. (“The blunders of the anthropologist will be “better” blunders”).

⁸ Tipike të asaj që mund të quhet “koceptim vulgar i liberalizmit” janë si më poshtë vijon: R. Kirk, *The Conservative Mind*

(Chicago: Regnery, 1953), f. 21, 24, 108; P. Viereck, Conservatism Revisited (London: Lehmann, 1950), f. xi-xii; K. Mannheim, Ideology and Utopia (New York, 1936), f. 199-202; R. Niebuhr, The Nature and Destiny of Man, vëll. 1. ed. (New York: Scribner's, 1947), 1:102-107, 2:240; Christianity and Power and Politics (New York: Scribner's, 1940), f. 84, 91-93, 102-103; W. Röpke, The Social Crisis of Our Time (Chicago: University of Chicago Press, 1950), f. 48-53; J. H. Hallowell, Main Currents in Modern Political Thought (New York: Holt, 1950), f. 110-115, 620-624, 669-674; E. H. Carr, The Twenty Years' Crisis 1919-1939 (London: Macmillan, 1951), kap.3, 4; H. Morgenthau, Scientific Man and Power Politics (Chicago: University of Chicago Press, 1946), kap. 2, 8.

⁹ Mbi këtë dallim, shih G. H. Sabine, "The Two Democratic Transitions", Philosophical Review 61 (1952): 451-474, dhe më në përgjithësi, J. L. Talmon, The Rise of Totalitarian Democracy (Boston: Beacon, 1951), f. 1-13, 249-255.

¹⁰ Cituar tek B. Groethuysen, Philosophie de la Révolution française precede de Montesquieu, ed. 4-rt, (Paris: Gallimard, 1956), f. 157.

¹¹ Frank I. Schechter, "The Early History of the Tradition of the Constitution", American Political Science Review 9 (1915): 707-734; Edward S. Corwin, "The Constitution as Instrument and Symbol", American Political Science Review 30 (1936): 1071-1085; Max Lerner, "Constitution and Court as Symbols", Yale Law Review 46 (1937): 1290.

¹² Biografia më e mirë është ajo më e fundit: Maurice Cranston, John Locke (London: Longmans, 1957).

¹³ Cituar tek John Locke, An Essay concerning Human Understanding, ed. A. C. Fraser, vëll. 2, (Oxford: Clarendon Press, 1894) I: xviii.

¹⁴ Essay Concerning Human Understanding, epistle to the reader, 1:14 tek Fraser's edition. Të gjitha referimet nga Essay do të bëhen tek ky botim dhe do të citohen si ECHU.

¹⁵ Ibid., 1:9, 2.2.2.

¹⁶ Ibid., 2.1.2-4, 3.11.23.

¹⁷ Ibid., 2.2.2, 2.1.24.

¹⁸ J. S. Mill, Three Essays on Religion, bot. i 3-të, (London: Longmans, 1885), f. 8.

¹⁹ Theaetetus 176b, Nichomachean Ethics 10.1117b, 33.

²⁰ Lord King, The Life of John Locke, with Extracts from His Correspondence, Journals and Common Place Books, bot. i 2-të, vëll. 2-të, (London, 1830), 1:210; ECHU, hyrja, 6; 4.14.1-2.

²¹ King, The Life of John Locke, 1:161; ECHU, hyrje, 7; 3.4.24; dhe diskutimi tek R. I. Aaron, John Locke, bot. i 2-të, (Oxford: Clarendon, 1955), f. 238; Holbach sikurse cituar tek Talmon, The Rise of Totalitarian Democracy, f. 273.

²² "Qeveria, morali, zakonet të gjitha duhet të rindërtohen. Ç'terren madhështor për arkitektët! Ç'rast i madh për të shfrytëzuar të gjitha idetë e mira dhe të shkëlqyera që kanë mbetur spekulative, për të vënë në përdorim kaq shumë materiale që nuk mund të përdoreshin më parë, për të hedhur poshtë aq shumë të tjerë që për shekuj kanë qenë pengesë dhe të cilat dikush ka qenë i detyruar t'i përdorë". (Cituar tek F. A. Hayek, The Counter-Revolution of Science [Glencoe, Ill., Free Press, 1952], f. 109.)

²³ Cituar tek H. R. Fox-Bourne, The Life of John Locke, vëll. 2, (New York: King, 1876), 1:396.

²⁴ Adam Smith, Theory of Moral Sentiments in Works (London, 1812), 1:516. Kam përdorur botimin e gjashtë të The Theory of Moral Sentiments dhe në vijim do të citohet si TMS.

²⁵ Fox-Bourne, The Life of John Locke, 1:224-226; King, The Life of John Locke, 1:162-165; ECHU 4.11.8.

²⁶ TMS, f. 417.

²⁷ Cituar tek ECHU, 1:xxxi-xxxii.

²⁸ TMS, f. 407-411. Shih edhe Benjamin Constant, Oeuvres politiques, ed. C. Louandre (Paris, 1874), f. 402; dhe Bentham, "Anarchical Fallacies", tek Words, ed. J. Bowring, vëll. 11 (Edinburgh, 1838-1843), 2:498.

Sulmi i Smithit kundër impulsit estetik në mendimin dhe veprimtarinë politike në të vërtetë ishte pjesë e përpjekjes së tij për të ripërcaktuar natyrën e estetikës politike, e kështu për të reduktuar rolin ligjvënës të filozofisë politike. Ai nguli këmbë që qeveria mund të jetë shumë mirë objekt i së bukurës, se "ne marrim kënaqësi duke parë perfeksionin e një sistemi kaq të madh e të bukur dhe nuk ndihemi rehat derisa të heqim çdo barrierë që mund të turbullojë ose pengojë rregullsinë e lëvizjes së tij". Megjithatë, e bukura nuk lidhet me qëllimin e një veprimtarie, por me njetet. Shkurtimisht, një objekt ose një aktivitet mund të quhej i bukur për aq sa ishte i dobishëm nga pikëpamja funksionale: që do të thotë "i përshtatshëm për të promovuar ose turbulluar si lumturinë e individit, ashtu edhe atë të shoqërisë". Edhe pse në çështjet politike e bukura u ktheje pothuaj në një sinonim të efijencës, asnjëherë nuk u pa si qëllim kryesor. Një motiv estetik mund t'i bëjë njerëzit të kërkojnë "barrierat" që pengojnë "rrotat e shumta të makinës së qeverisë" për të lëvizur me "më shumë harmoni dhe lehtësi, pa u fërkuar me njëra-tjetrën", por një qëllim estetik nuk duhet të ndiqet pa marrë parasysh vuajtjet njerëzore. (TMS, f. 309-323.) Edhe Bastiat paralajmëroi të bëhet kujdes ndaj atyre teoricienëve që e shihnin njerëzimin si "une matière inerte recevant du pouvoir la vie, l'organisation, la moralité et la richesse..." (Oeuvres, 4:366-367.).

Mohimi i arkitekturës teorikisht dhe praktikisht ishte pjesë edhe e konservatorizmit të Burkes. Ajo çfarë ndoshta kuptohet më pak është se ky mohim u bë pjesë e sociologjisë moderne. Kjo mund të shihet duke analizuar vlerësimin e Durkheimit për elementë të tillë në mendimin e Montesqujes. Shih esenë e tij Montesquieu et Rousseau, Précurseurs de la Sociologie (Paris: Rivière, 1953), f. 84-85, 96. Kjo prirje nuk është pranuar në mënyrë universale pasi në shkrimet e të ndjerit Karl Mannheim-it, për shembull, shprehet shumë qartë besimi se sociologjisë i përket detyra për të ofruar një program gjithëpërfshirës për reformën e shoqërisë dhe se veprimtaria politike mund dhe duhet të operojë në një shkallë të madhe. Shih në mënyrë të veçantë veprën e tij Man and Society in an Age of Reconstruction (London: Routledge, 1951).

²⁹ Bentham's Handbook of Political Fallacies, ed. H. A. Larrabee, f. 195.

³⁰ An Introduction of the Principles of Morals and Legislation (New York: Hafner, 1948), preface, f. xxxi (me italics në original) (në vijim cituar Morals and Legislation). Shih edhe Bastiat, Oeuvres, 4:364-366.

³¹ Arnold, Culture and Anarchy, ed. J. D. Wilson (Cambridge: Cambridge University Press, 1932), f. 19, 36; Bastiat, Oeuvres, 4:350. Shih edhe esenë e Guizot, Democracy in France, (New York, 1849), f. 81.

³² Smith, Wealth, 1.6.11 (f. 52, 248); 2.1-2, 3 (f. 265-279, 324-325); 4.7 (f. 566); dhe vini re si shoqëria ilustron në bazë të kapitalit (ibid. 1.3, f. 320-321), 4.3 (f. 464). Shih gjithashtu J. R. McCulloch, The Principles of Political Economy (Edinburgh, 1825), f. 244-246 (në vijim cituar si PPE); Nassau Senior, Political Economy, (London, 1850), f. 81 (në vijim cituar si PE);

- J. S. Mill, *Principles of Political Economy*, ed. Sir W. J. Ashley (London: Longmans, 1920), 2.3.1 (f. 23) (në vijim cituar PPE).
- ³³ Shkëputur nga një punim i Smithit, cituar nga Dugald Stewart, *Essays of Philosophical Subjects* (London, 1795), f. lxxxi. Shih gjithashtu studimin e Cropsey, *Polity and Economy*.
- ³⁴ Spencer, *Essays*, 3:450-451; *Economic Writings*, nga Jeremy Bentham, ed. W. Stark, vëll. 3, (London: Allen and Unwin, 1952-1954), 3:333 (në vijim cituar si Econ. Wr.).
- ³⁵ Smith, *Wealth*, 1.7-8, 4.2.
- ³⁶ Bastiat, *Oeuvres*, 4:360-361.
- ³⁷ Bentham, *Econ. Wr.*, 1:223.
- ³⁸ Mably, *De la Législation*, vëll. 2, (Lausanne, 1777), 2:31; shih edhe biografinë nga E. A. Whitfield, Gabriel Bonnot de Mably (London: Routledge, 1930); si dhe diskutimin nga Talmon, *The Rise of Totalitarian Democracy*, f. 54ff; Friedrich Engels, *Herr Eugen Dühring's Revolution in Science*, *Marxist Library* (New York: International Publishers, n.d.), f. 318. Bastiat (*Oeuvres*, 4:367 ff.) mbledhi një tërësi citimesh për të ilustruar të njëjtat rreziqe të mendimit radikal për të cilat kishte folur më parë Talmon.
- ³⁹ The works of John Locke, bot. 12, vëll. 9, (London, 1824), 10:10, 42.
- ⁴⁰ Smith, *Wealth* 4, hyrja (f. 397)
- ⁴¹ McCulloch, *PPE*, f. 7-9.
- ⁴² *Ibid.*, f. 23; J. B. Say, *A Treatise on Political Economy*, përkthyer nga botimi i katërt nga C. R. Prinsep dhe C. Biddle (Philadelphia: Lippincott, 1857), f. xv; *Traité d'économie politique*, vëll. 2, (Paris, 1803), 1:ii.
- ⁴³ Cituar tek Lionel Robbins, *The Theory of Economic Policy in English Classical Political Economy* (London: Macmillan, 1952), f. 175-176. Gjithashtu shih Bastiat, *Oeuvres*, 4:388.
- ⁴⁴ Për dokumentim të këtyre çështjeve shih sa më poshtë: Smith, *Wealth* 2.3 (f. 315-326), 4.2 (f. 424); TMS, F. 405; *Lectures on Justice, Police Revenue, and Arms*, ed. E. Cannan (Oxford: Clarendon Press, 1896), f. 1-4; T. R. Malthus, *An Essay on Population*, vëll. 2, (London: Dent, 1914), 2:87, 192-193; Senior, PE, f. 76, 81; J. S. Mill, *Considerations on Representative Government* (London: Oxford University Press, 1912), kap. 3 (f. 187), kap. 6 (f. 249); Spencer, *Essays*, 3:313. *Natyra joprodhuese e qeverisë u bë temë e parapëlqyer me Saint-Simon; shih pasazhin e famshëm të përkthyer tek Henri Comte de Saint-Simon, Selected Writings*, ed. F.M.H. Markham (New York: Macmillan, 1952), f. 72-73, dhe krahaso me Bentham, *Morals and Legislation*, f. 5n. Një shenjë e rëndësishme që tregon përhapjen e kategorive ekonomike ishte përvetësimi nga Smithi i idesë së vjetër të trupit organik politik për qëllime ekonomike, *Wealth*, 4.7, 9 (f. 571-572, 638).
- ⁴⁵ Two Treatises of Government 2.12, 13. Në vijim të gjitha referencat nga ky burim do të citohen ose First ose Second Treatise.
- ⁴⁶ Second Treatise 4, 22.
- ⁴⁷ Të dy situatat ishin, shkruan Loku, "aq të largëta sa janë nga njëra-tjetra një gjendje paqeje, mirësie, ndihme reciproke dhe mbrojtjeje, dhe një gjendje armiqësie, dashakeqësie, dhune dhe shkatërrimi reciprok". Second Treatise 19.
- ⁴⁸ Shih për shembull, J. Mabbott, *The State and the Citizen* (London: Hutchinson, 1948), f. 20-21; Strauss, *Natural Right and History*, f. 221-222, 227-233. Një sulm tepër kritik dhe përgjithësisht korrekt ndaj interpretimit të Strauss-it është bërë nga J. W. Yolton, "Locke on the Law of Nature," *Philosophical Review* 67, (1958): 477-498.
- ⁴⁹ Second Treatise 128; Works, 5:224, 248. Për dallimin e bërë nga Troeltsch, *The Social Teachings of the Christian Churches*, përkth. O. Wyon, vëll. 2, (London: Allen and Unwin, 1931), 1:152-161, 343 ff.
- ⁵⁰ Second Treatise 123-124, 136; Fox-Bourne, *The Life of John Locke*, 1:174.
- ⁵¹ Second Treatise 4.
- ⁵² *Ibid.*, 87, 136 (me theks të shtuar).
- ⁵³ *Ibid.*, 243. Pranohet që Loku këtu nuk është koherent. Më parë ai kishte argumentuar se përmes pushtetit ligjvënës anëtarët "janë të bashkuar dhe të akorduar në një trup koherent të gjallë" dhe se "ky është shpirti që i jep formë, jetë dhe unitet komunitetit". (Second Treatise 212.) Më vonë, gjithsesi, ai argumenton se kur legjislativi shpërndahet shoqëria mundet sërish të veprojë.
- ⁵⁴ A Defense of Liberty against Tyrants (*Vindiciae contra Tyrannos*), ed. H. J. Laski (New York: Harcourt, Brace, n.d.), f. 93, 97-100, 102-106, 109-111, 126-136; Calvin, *Institutes* 4.20.31; Opera, 29:557, 636-637; C. J. Friedrich, ed., *Politica Methodice Digesta of Johannes Althusius* (Cambridge: Harvard University Press, 1932), 19.7: 20.20-21. Shih diskutimit tek Mesnard, *L'Essor de la philosophie politique au XVIIe siècle*, f. 340 ff., 593 ff.
- ⁵⁵ Second Treatise 96-97, 209, 230. Doktrina e Lokut për qeverisjen e shumicës është diskutuar gjerësisht, në mënyrë të tejgjatur, nga W. Kendall, *John Locke and the Doctrine of Majority Rule* (Urbana: University of Illinois Press, 1941). Interpretimi i Kendallit është kritikuar, por në mënyrë jo të kënaqshme, nga J. W. Gough, *John Locke's Political Philosophy* (Oxford: Clarendon Press, 1950), f. 24 ff.
- ⁵⁶ Second Treatise, 96-97.
- ⁵⁷ *Ibid.*, 151.

DEMOKRACIA, REPUBLIKA, PËRFAQËSIMI*

Jacques Ranciere

Abstrakt. Në literaturën rreth demokracisë, demokracia përfaqësuese shikohet si një produkt i shtimit të popullatës dhe zmadhimit të njësisë politike. Argumentohet se në pamundësi për të pasur demokraci të drejtpërdrejtë, qytetarët qeverisen në mënyrë indirekte nëpërmjet të zgjedhurve. Në këtë artikull argumentohet se qeverisja nëpërmjet zgjedhjes së përfaqësuesve politikë nuk është një produkt i demokracisë moderne, por një trashëgimi e qeverisjes oligarkike nga e kaluara, një qeverisje që vazhdon edhe sot. Demokracia nuk tregon një formë të caktuar qeverisjeje apo shoqërore, ajo nuk është gjë tjetër veç një kuadër i imagjinuar, me qëllimin për të mbështetur një parim të caktuar të mirëqeverisjes. Shoqëritë, sot si dhe dje, janë organizuar nëpërmjet ndërveprimit të oligarkive dhe nuk ka qeveri demokratike në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Gjithmonë pakica qeveris shumicën.

Skandali demokratik ka të bëjë me këtë zbulim: nuk do të ketë kurrë, nën emrin e politikës, një parim të vetëm të komunitetit që legjitimon veprimet e atyre që qeverisin në emër të ligjeve të grupimeve të bashkësive njerëzore. Rusoi kishte të drejtë kur denonconte rrethin vicioz të Hobsit, i cili pretendon të provojë joshqërizimin natyror të njerëzve, duke përdorur si argument intrigat e oborrit dhe shpifjet e salloneve. Por, duke përshkruar natyrën sipas shoqërisë, Hobsi tregoi gjithashtu se është e kotë të kërkohet origjina e komunitetit politik në ndonjë virtut të brendshëm të shoqërizimit. Nëse kërkimi i origjinës përzien lirisht «para» me «pas», kjo ndodh sepse ai gjithmonë vjen me pas. Filozofia që kërkon parimin e qeverisjes së mirë ose arsyet për të cilat njerëzit krijojnë qeveri, vjen pas demokracisë, vetë kjo vjen më pas, duke ndërprerë logjikën e lashtë sipas të cilës komunitetet qeverisen nga ata që kanë të drejtën të ushtrojnë autoritetin e tyre mbi ata që janë të predispozuar t' i binden këtij autoriteti.

Pra, fjala demokraci nuk tregon në vetvete një formë shoqërie as një formë qeverie. «Shoqëria demokratike» nuk është gjë tjetër veç një kuadër i imagjinuar, me qëllimin për të mbështetur njërin ose tjetrin parim të qeverisjes së mirë. Shoqëritë, sot si dhe dje, janë organizuar nëpërmjet ndërveprimit të oligarkive dhe nuk ka qeveri demokratike në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Gjithmonë pakica qeveris shumicën. «Pushteti i popullit» në këtë mënyrë është heterotopik (që nuk ka vetëm një vend origjine) për shoqëritë e pabarabarta ashtu si edhe për shoqëritë oligarkike. Kjo është ajo që ndan qeverinë nga vetja, duke ndarë shoqërinë nga vetja. Kjo është po ashtu ajo që ndan të ushtruarin e qeverisë nga përfaqësimi i shoqërisë.

Njerëzit parapëlqejnë që ta thjeshtojnë këtë çështje duke e shtruar si kundërvënie midis demokracisë së drejtpërdrejtë dhe demokracisë përfaqësuese. Për këtë mund t' i referohesh ndryshimit midis kohëve dhe kundërvënias midis realitetit dhe utopisë. Kështu thuhet se demokracia e drejtpërdrejtë ishte e mirë për poliset në Greqinë e vjetër ose kantonet zvicerane të Mesjetës, kur e gjithë popullsia e njerëzve të lirë mund të mblidhej në një shesh të vetëm. Për vendet tona të mëdha dhe shoqëritë tona moderne, vetëm demokracia përfaqësuese është e përshtatshme. Ky argument nuk është aq bindës sa pretendon të jetë. Në fillim të shekullit të 19-të, përfaqësuesit francezë nuk e patën të vështirë të mblidhnin të gjithë votuesit në kryeqendrat krahinore. Mjaftonte vetëm që zgjedhësit të mos ishin të shumtë, gjë që realizohej duke u dhënë të drejtën për

* Artikulli u përkthye nga origjinali në frëngjisht nga Blerta Hyskaj.

të zgjedhur më të mirëve të kombit, atyre që paguanin një rentë prej 300 frangash. « Zgjedhjet direkte, thoshte Benjamin Constant, përbëjnë qeverinë e vetme që është vërtetë përfaqësuese». Dhe Hannah Arendt mund të shihte ende në 1963 fuqinë e vërtetë të popullit në formën revolucionare të këshillave, ku krijohet e vetmja elitë politike efektive, elitë e vetëzgjedhur e krijuar rreth atyre që e kuptojnë lumturinë si shqetësim për çështjet publike. Me fjalë të tjera, përfaqësimi nuk ishte kurrë një sistem i shpikur për të përballuar rritjen e popullsisë. Ai nuk ishte një formë e përshtatjes së demokracisë me kohët moderne dhe me hapësirat e gjera. Ai është, me të drejta të plota, një formë oligarkike, një përfaqësim i pakicës që është ngarkuar të merret me punët e përbashkëta. Në historinë e përfaqësimit kanë qenë gjithmonë shtresat e larta, urdhrat fetare apo feudet që janë përfaqësuar, qoftë në rastin kur statusi i tyre është konsideruar burimi i të drejtës për të ushtruar pushtet, qoftë kur në raste të veçanta një pushtet sovran i jep atyre votë konsultative. Edhe zgjedhjet në vetvete nuk janë një formë demokratike, me anë të të cilave dëgjohet zëri i popullit. Ato janë fillimisht shprehja e pëlqimit të kërkuar nga një fuqi superiore, dhe pëlqimi nuk mund të jetë veçse unanimitet. Vetë evidenca që shkrin demokracinë me formën e qeverisë përfaqësuese të dalë nga zgjedhjet është historikisht shumë e re. Përfaqësimi në thelb është e kundërta e demokracisë. Të gjithë e dinin këtë në kohën e Revolucionit Francez dhe Amerikan. Baballarët themelues të kombit amerikan dhe shumë nga ndjekësit e tyre francezë panë në të saktësisht një mjet për elitën që të ushtronte në emër të popullit, pushtetin që elita është e detyruar të pranojë se është i tij, por që ai nuk mund ta ushtronte pa shkatërruar parimin e qeverisjes. Dishepujt e Ruso, nga ana e tyre, e pranuan këtë parim vetëm duke refuzuar kuptimin e fjalës përfaqësim, që nënkuptonte përfaqësimin e interesave të veçanta. Vullneti i përgjithshëm nuk mund të ndahet dhe deputetët mund të përfaqësojnë vetëm kombin në përgjithësi. Sot «demokracia përfaqësuese» duket sikur është një pleonazmë, por në fillim ishte një kontradiksion.

Kjo nuk do të thotë se është e nevojshme të kundërvihen vërtetët e demokracisë së drejtpërdrejtë ndaj ndërmjetësimeve dhe derivimeve të përfaqësimit ose të tregohet me gisht aparenca mashtruese e demokracisë formale, në krahasim me efikasitetin e demokracisë së drejtpërdrejtë. Të identifikosh demokracinë me përfaqësimin është po aq gabim sa edhe të refuzosh njërin me anë të tjetrit. Demokracia nënkupton pikërisht këtë: format juridike – politike të kushtetutave shtetërore dhe ligjeve, bazohen në të njëjtën logjikë. Ajo që quhet «demokraci përfaqësuese», por që më saktë duhet të quhet sistem parlamentar ose sipas Rejmond Aron, «regjim pluralist konstitucional», është një formë e përzier: një formë e funksionimit të shtetit që në fillim bazohet te privilegjet e elitave «natyrore» dhe e devijuar nga ky funksion si pasojë e betejave demokratike. Historia e përgjithshme e luftërave për reformën zgjedhore në Britaninë e Madhe është pa dyshim dëshmia më e mirë për këtë, qëllimisht e fshirë nga fantazia idilike e një tradite angleze të demokracisë «liberale».

E drejta e përgjithshme e votës nuk është aspak një rrjedhojë e natyrshme e demokracisë. Demokracia nuk ka pasoja natyrore, pikërisht sepse është ndarja e «natyrës», këputja e lidhjes midis vetive natyrore dhe formave të qeverisjes. E drejta e përgjithshme e votës është një formë e përzier, e lindur prej oligarkisë, e devijuar nga betejat demokratike dhe vazhdimisht e rimarrë nën kontroll nga oligarkia, e cila i propozon votuesve kandidatët e saj dhe ndonjëherë vendimet që preferon, pa qenë asnjëherë në gjendje të eliminojë rrezikun se trupa zgjedhore do të veprojnë si një popullatë e zgjedhur rastësisht.

Demokracia nuk mund të identifikohet kurrë me një formë politiko-juridike. Kjo nuk do të thotë se është indiferente ndaj tyre. Kjo do të thotë se pushteti i popullit është gjithmonë si në themel ashtu edhe përtej të këtyre formave. Në themel, sepse këto forma nuk mund të funksionojnë pa iu referuar në instancë të fundit këtij pushteti të paafëtëve që themelon dhe mohon pushtetin e të aftëve, kësaj barazie që është e nevojshme për funksionimin e makinës së pabarazisë. Përtej, sepse vetë format që e japin këtë pushtet përshtaten vazhdimisht, me anë të lojës së vetë makinës qeverisëse, me logjikën «natyrore» të atyre që qeverisin, e cila është logjika e mosdallimit të publikes nga privatja. Sapo shkëputet lidhja me natyrën dhe sapo qeveritë detyrohen të paraqesin veten e tyre si instancë e gjësë së përbashkët të bashkësisë, të ndara nga logjika e

marrëdhënieve të autoritetit që i përkasin riprodhimit të trupit social, ekziston një sferë publike, në të cilën takohen dy logjikat e kundërvënja të policimit dhe të politikës, midis qeverisjes së natyrshme nëpërmjet kompetencës sociale dhe qeverisjes nga kushdo. Praktika spontane e të gjitha qeverive priret të zvogëlojë këtë sferë publike, ta kthejë atë në çështje të saj private dhe për pasojë, t' i kufizojë ndërhyrjet dhe hapësirat për ndërhyrje të aktorëve joshitetorë, duke i klasifikuar ato si çështje të sferës private. Demokracia në këtë mënyrë, larg të qenit forma e jetës së individëve të përkushtuar ndaj lumturisë private, është procesi i luftës kundër këtij privatizimi, procesi i zgjerimit të sferës publike. Zgjerimi i sferës publike nuk do të thotë, sikurse pretendon ligjërimi liberal, të kërkosh ndërhyrje gjithnjë e më të madhe të shtetit në shoqëri. Do të thotë lufta kundër ndarjes së publikes dhe privates, që siguron një dominim të dyfishtë të oligarkisë në shtet dhe në shoqëri.

Historikisht ky zgjerim do të thotë dy gjëra: njohja e të gjithë atyre që ligji shtetëror i lë në një sferë private ku jeta e tyre është ajo e qenieve apo subjekteve inferiore, dhe pranimi i karakterit publik të hapësirave dhe marrëdhënieve që lihen në dorë të pushtetit të pasurisë. Fillimisht kjo do të thoshte luftë për të trajtuar si zgjedhës dhe të zgjedhshëm të gjithë ata të cilët logjika policore i ka përjashtuar natyrshëm nga ky proces: të gjithë ata që nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në jetën publike, sepse nuk i përkasin «shoqërisë», por vetëm jetës prodhuese dhe shtëpiake, sepse puna e tyre i përket një zotërie ose bashkëshortit: punëtorë shtëpiake, të trajtuar për një kohë të gjatë si shërbëtorë të varur nga zotërinjtë e tyre dhe të paafhtë për të pasur vullnetin e tyre; gra të nënshtruara ndaj vullnetit të bashkëshortëve dhe të detyruara të merren me punët shtëpiake dhe të familjes. Gjithashtu, do të thotë luftë kundër logjikës natyrore të sistemit zgjedhor, i cili e shndërron përfaqësimin në përfaqësim të interesave mbizotëruese dhe zgjedhjen në një mekanizëm që prodhon marrjen e pëlqimit nëpërmjet kandidaturave zyrtare, mashtrim elektoral apo monopol de fakto mbi kandidaturat. Por ky zgjerim përfshin gjithashtu të gjitha betejat për të treguar karakterin publik të hapësirave, marrëdhënieve dhe institucioneve të konsideruara si private. Këto të fundit janë përshkruar shpesh si lëvizje sociale për shkak hapësirave ku janë zhvilluar dhe kërkesave që kanë parashtruar; lufta për pagat dhe për kushtet e punës, beteja për shëndetin dhe sistemin e pensioneve. Por ky përcaktim është ambivalent. Në fakt, kjo luftë merr si të dhënë një shpërndarje të politikës dhe sociale, të publikes dhe privates, që në realitet është një çështje politike e barazisë dhe jobarazisë. Lufta për pagat ishte në fillim një luftë për të shprivatizuar raportin me pagesën, për të treguar se nuk është një marrëdhënie zot-shërbëtor, as një kontratë e thjeshtë që lidhet rast pas rasti mes dy individëve privatë, por një çështje publike që ka të bëjë me kolektivitetin dhe si pasojë prodhon forma aksioni kolektiv, diskutime publike dhe rregullime legjislativë. «E drejta për punë», e kërkuar nga lëvizja punëtore e shekullit të 19-të, para së gjithash donte të thoshte: jo kërkesë për asistencë nga një «shtet i mirëqenies sociale», sikurse u përpoqën ta asimilonin disa syresh, por mbi të gjitha trajtimi i punës si një strukturë e jetës kolektive, e çliruar nga nënshtrimi ndaj ligjit të interesit privat dhe që i imponon kufij procesit të natyrshëm të pasurimit të pakufijshëm.

Sepse, për aq sa i shpëton mosdallimit të parë, dominimi ushtrohet nëpërmjet një logjike të shpërndarjes së sferave, e cila vetë ka dy funksione. Në njërin anë, ai pretendon të ndajë hapësirën publike nga interesat private të qytetarëve. Për këtë qëllim pretendohet se edhe atje ku barazia e « njerëzve » dhe « qytetarëve » është e pranuar, ajo ka të bëjë vetëm me marrëdhënien e tyre me sferën juridiko-politike dhe, edhe atje ku populli është Sovran, ai është i tillë vetëm si pasojë e akteve të përfaqësuesve dhe qeveritarëve të tij. Dominimi funksionon nëpërmjet dallimit mes publikes, që i përket gjithkujt, dhe privates, ku predominon liria e secilit. Por kjo liri e gjithsecilit është liria - domethënë dominimi - i atyre që zotërojnë pushtetet që i përkasin shoqërisë. Është perandoria e ligjit të rritjes së pasurisë. Për sa i përket sferës publike, që pretendon se është e pastruar nga interesat private, ajo është gjithashtu një sferë publike e kufizuar e privatizuar, e rezervuar për lojën e insitucioneve dhe monopol i atyre që i vënë në lëvizje. Këto dy sfera janë të ndara vetëm në parim për t' u bashkuar më mirë nën ligjin e oligarkisë. Baballarët themelues amerikanë dhe francezët partizanë të

r'egime censitaire [që kufizoi të drejtën e votës pas rivendosjes së Bourbonëve më 1815] nuk shihnin ndonjë të keqe në identifikimin e figurës së zotëruesit të pronës me atë të njeriut publik që mund të ngrejë veten e vet mbi interesat meskine të jetës ekonomike dhe sociale. Në këtë mënyrë lëvizja demokratike është një lëvizje e dyfishtë e kapërcimit të kufijve, një lëvizje për të shtrirë barazinë e njeriut publik në sfera të tjera të jetës së përbashkët, në veçanti ndaj atyre që qeverisen nga moskufizimi kapitalist i pasurisë, por edhe një lëvizje për të treguar se kjo sferë publike që privatizohet pa pushim u përket të gjithëve dhe gjithkujt.

Këtu hyn në lojë çështja e shumëdiskutuar e dualitet midis njeriut dhe qytetarit. Ky dualitet është kritikuar që nga Burke deri tek Agamben, duke kaluar nga Marks dhe Arendt, në emër të kësaj logjike të thjeshtë: nëse politikës i duhen patjetër dy parime në vend të njërit, atëherë kjo duhet të jetë për shkak të ndonjë vesi apo si pasojë e ndonjë mashtrimi. Njëri prej tyre duhet të jetë iluzion, në mos të dy. Të drejtat e njeriut janë pa kuptim ose tautologjike thonë Burke dhe Hana Arendt. Ose janë të drejtat e njeriut në vetvete. Por njeriu në vetvete që nuk i përket asnjë komuniteti kombëtar të formuar nuk ka asnjë të drejtë. Të drejtat e njeriut janë në këtë mënyrë të drejtat boshe të atyre që nuk kanë asnjë të drejtë. Ose janë të drejtat e njeriut që i përkasin një komuniteti kombëtar. Atëherë ato janë thjesht të drejtat e qytetarëve të këtij kombi, të drejtat e atyre që kanë të drejta, pra një tautologji e pastër. Marksi në të kundërt sheh në të drejtat e qytetarit ndërtimin e një sfere ideale, realiteti i së cilës konsiston në të drejtat e njeriut që nuk është njeriu në vetvete, por njeriu pronar që imponon ligjin e interesave të tij, ligjin e pasurisë, nën maskën e të drejtës të barabartë për të gjithë.

Këto dy pozicione takohen në një pikë themelore: vullneti, i trashëguar nga Platoni, për të shndërruar dyshten e njeriut–qytetar në çiftin iluzion–realitet, me merakun se politika ka vetëm një parim dhe një të vetëm. Ajo çka të dy pozicionet refuzojnë është se veçantia e politikës ekziston vetëm nëpërmjet suplementit anarkik që do të thotë demokraci. Do t' i japim të drejtë Hannah Arendt-it se njeriu i zhveshur nuk ka të drejta që t' i përkasin, se ai nuk është një subjekt politik. Por qytetari i teksteve kushtetues nuk është më shumë një subjekt politik. Pikërisht, subjektet politike nuk identifikohen as me « njerëzit » ose me grupime njerëzish, as me identitete të përcaktuara nga tekstet kushtetues. Ata përcaktohen gjithmonë nga një interval midis identiteteve, qofshin këto të përcaktuara nga raporte sociale ose nga kategori juridike. Qytetari i « klubeve » revolucionare është ai që mohon ndarjen konstitucionale midis qytetarëve aktivë (që do të thotë të atyre që paguajnë rentën) dhe qytetarëve pasivë. Punëtari si subjekt politik është ai që shkëputet nga përkatësia ndaj botës private, jopolitike që këto terma nënkuptojnë. Subjektet politike ekzistojnë në intervalin midis emrave të ndryshëm të subjekteve. Njeriu dhe qytetari janë të tillë emra të zakonshëm, shtrirja dhe kuptimi i të cilëve është mullë shërr dhe pikërisht për këtë arsye mund të plotësohen politikisht, nëpërmjet një ushtrimi që teston se cilëve subjekte mund t' u vishen këta emra dhe çfarë pushteti mbartin ata.

Kjo ishte mënyra se si dualiteti njeri–qytetar i shërbeu ndërtimit të subjekteve politike që vënë në pah dhe në diskutim logjikën e dyfishtë të dominimit, që ndan njeriun publik nga individ i privat për të siguruar më mirë, në të dy sferat, të njëjtin dominim. Me qëllim që ky dualitet të mos identifikohet më me kundërvënien ndaj realitetit dhe iluzionit, duhet të ndahet përsëri. Veprimi politik i kundërvë logjikës policore të ndarjes së sferave, një tjetër përdorim të së njëjtut tekst juridik, një tjetër vënie në skenë të dualitetit midis njeriut publik dhe privat. Ai trondit shpërndarjen e termave dhe të vendeve duke vendosur njeriun kundër qytetarit dhe qytetarin kundër njeriut. Si emër politik « qytetari » i kundërvë pabarazive që karakterizojnë « njerëzit », që do të thotë individët privatë, të nënshtuar ndaj pushtetit të lindjes dhe të pasurisë, rregullin e barazisë të fiksuar nga ligji dhe nga parimi i tij. Dhe në të kundërt, referimi ndaj « njeriut » kundërvë aftësinë e barabartë të të gjithëve përballë të gjitha privatizimeve të shoqërisë: ato që përjashtojnë nga qytetaria këtë apo atë pjesë të shoqërisë ose ato që përjashtojnë këtë apo atë fushë të jetës kolektive nga mbretëria e barazisë qytetare. Secili nga këto terma luan atëherë në mënyrë polemike rolin e të përgjithshmes (universales) që i kundërvihet të veçantës. Dhe vetë kundërvënia e « ekzistencës në vetvete » ndaj ekzistencës politike është e politizueshme.

Këtë e tregon silogjizmi i famshëm i Olympe de Gouges në nenin 10 të deklaratës së të drejtave të

gruas dhe të qytetares: « Gruaja ka të drejtë të ngjitet në vendin e ekzekutimit, atëherë ajo ka të drejtë të ngjitet edhe në tribunë ». Ky arsyetim është futur çuditërisht në mes të një deklaratë për të drejtën e opinionit të grave, duke u nisur nga e drejta e burrave. (« askush nuk duhet të shqetësohet për opinionet e veta, qoftë edhe personale, për aq sa këto manifestime nuk shqetësojnë rregullin publik të vendosur nga ligji »). Por kjo gjë e çuditshme lë shenjë të fortë edhe në ndrydhjen e raportit midis jetës dhe qytetarisë që prodhon pretendimin se gratë i përkasin sferës së opinionit publik. Ato janë përjashtuar nga përfitimi i të drejtave të qytetarit në emër të ndarjes së sferës publike nga ajo private. Duke i përkur jetës shtëpiake, që do të thotë botës së veçantisë, ato janë të huaja për të përgjithshmen e sferës qytetare. Olympe de Gouges e kthen argumentin duke u mbështetur mbi tezën që e shndërron dënimin në « të drejtë » të fajtorit: nëse gratë kanë të drejtë të « ngjiten në vendin e ekzekutimit », nëse një pushtet revolucionar u jep këtë dënim, kjo ndodh sepse vetë jeta e tyre e në vetvete është politike. Barazia përballë dënimit me vdekje hedh poshtë dallimin evident midis jetës shtëpiake dhe jetës politike. Gratë pra, mund të kërkojnë të drejtat e tyre si gra dhe si qytetare, të drejta identike, por që, megjithatë, mund të kërkojnë vetëm si plotësuese të njëra-tjetrës.

Duke bërë këtë, ato refuzojnë në fakt argumentin e Burke ose të Hannah Arendt. Këta thonë ose të drejtat e njeriut janë të drejtat e qytetarit, që do të thotë të drejtat e atyre që kanë të drejta, gjë që është një tautologji, ose të drejtat e qytetarit janë të drejtat e njeriut. Por, meqë njeriu në vetvete nuk ka të drejta, ato janë të drejtat e atij që nuk ka të drejta, gjë që është një absurditet. Por në buzët e imagjinuara të kësaj pince logjike, Olympe de Gouge dhe shoqet e saj, japin një mundësi të tretë: « të drejtat e gruas dhe qytetares » janë të drejtat e atyre që nuk kanë të drejtat që kanë dhe kanë të drejtat që nuk kanë. Arbitrarisht ato privohen nga të drejtat që Deklarata u jep pa dallim anëtarëve të kombit francez dhe të gjithë llojit njerëzor. Por gjithashtu, me anë të veprimit të tyre, ato ushtrojnë të drejtën e qytetares që u mohohet nga ligji. Në këtë mënyrë ato tregojnë se kanë të drejtat që ligji u mohon. Të kesh dhe të mos kesh, janë terma që dyzohen. Dhe politika është veprimi i këtij dyzimi. Gruaja e re zezake, që një ditë dhjetori 1955 në Montgomery vendosi të qëndrojë në vendin e saj, që nuk ishte i saj në autobus, vendosi aty për aty, se ajo si qytetare e Shteteve të Bashkuara kishte një të drejtë që nuk e kishte si banore e një shteti që i ndalonte këtë vend, kujtdo që kishte më shumë se 1/16 e gjakut jo kaukazian. Dhe zezakët e Montgomery-t që në këtë konflikt midis një personi privat dhe një ndërmarrjeje transportesh, vendosën të bojkotonin transportet, vepruan mirë politikisht, duke nxjerrë në pah raportin e dyfishtë të përjashtimit dhe të përfshirjes, të vendosur në dualitetin e qenies njerëzore dhe qytetarit. Pikërisht këtë nënkupton procesi demokratik: veprimi i subjekteve, që duke punuar mbi intervalin e identiteteve, rikonfigurojnë shpërndarjet e publike dhe private, të së përgjithshmes dhe të veçantës. Demokracia nuk mund të identifikohet kurrë vetëm me dominimin e të përgjithshmes mbi të veçantën. Sepse sipas kësaj logjike e përgjithshmeja privatizohet pa reshtur, shkon pareshtur drejt një ndarjeje të pushtetit midis lindjes, pasurisë dhe « aftësisë » që luan rol si në shtet ashtu edhe në shoqëri. Ky privatizim zhvillohet vullnetarisht madje në emër të pastërtisë të jetës publike që i kundërvihet veçantive të jetës private dhe të botës shoqërore. Por kjo pastërti politike e pretenduar nuk është gjë tjetër veç pastërtia e shpërndarjes së termave, e një gjendjeje të dhënë të raporteve midis formave sociale të pushtetit të pasurisë dhe formave të privatizimit shtetëror të pushtetit të të gjithëve. Argumenti konfirmon vetëm atë që supozon: ndarjen midis atyre që janë ose nuk janë të « destinuar » të merren me jetën publike dhe me shpërndarjen e publike dhe private. Procesi demokratik duhet të hedhë në lojë vazhdimisht të përgjithshmen në një formë polemike. Procesi demokratik është procesi i kësaj hedhjeje në lojë të përhershme, të kësaj shpikjeje të formave të subjektivizimit dhe të momentit të verifikimit që ndrydhin privatizimin e përhershëm të jetës publike. Në këtë kuptim, demokraci do të thotë papastërtia e jetës politike, refuzimin e pretendimit të qeverive për të mishëruar një parim të vetëm të jetës publike, që do të thotë përkufizimin e kuptimit dhe të shtrirjes të jetës publike. Nëse ka një « pakufizueshmëri » tipike të demokracisë, e gjejmë pikërisht këtu: jo në shumëfishimin eksponencial të nevojave apo të dëshirave të individëve, por në lëvizjen që zhvendos pa reshtur limitet e publike dhe private,

të politikës dhe sociale.

Kjo zhvendosje, e cila i përket vetë politikës, e refuzon ideologjinë që quhet republikane. Kjo e fundit kërkon ndarjen me thikë të sferave politike dhe sociale dhe identifikon republikën me mbizotërimin e ligjit, duke qenë indiferente ndaj të gjitha veçantive. Në vitet 1980, në këtë mënyrë ajo argumentoi debatin mbi reformën e shkollës. Ajo përhap doktrinën e thjeshtë të shkollës republikane dhe laike që iu shpërndan të gjithëve të njëjtën dije, pa marrë parasysh ndryshimet sociale. Ajo vendosi si dogmë republikane ndarjen midis arsimit, domethënë transmetimit të dijeve, që është një çështje publike dhe edukimit, që është një çështje private. Ajo gjeti si shkak të « krizës së shkollës » pushtimin e institucionit shkollor nga shoqëria dhe akuzoi sociologët se ishin bërë vegla të këtij pushtimi duke propozuar reforma që shenjtëruan përzjerjen e trajnimit me edukimin. Republika e kuptuar në këtë mënyrë, dukej sikur po vendoste mbretërinë e barazisë e mishëruar në asnjërinë e institucionit shtetëror, që nuk merr parasysh ndryshimet sociale. Sot mund të çuditemi nga fakti që teoricieni kryesor i kësaj shkolle laike dhe republikane e paraqet ligjin e trashëgimisë nga babai te biri të mishëruar tek babai që i nxit fëmijët të lexojnë shkrimet e shenjta, si mbrojtjen kryesore ndaj vetëvrasjes së humanitetit demokratik. Por ky paradoks i dukshëm tregon pikërisht ekuivokun e fshehur në referimin thjesht ndaj një tradite republikane të ndarjes së shtetit dhe të shoqërisë. Sepse fjala « republikë » nuk do të thotë thjesht mbretërimi i ligjit të barabartë për të gjithë. « Republikë » është një term që nënkupton shumë gjëra, i farkëtuar nga tensioni që shkakton vullneti për të përfshirë në format e ngritura të organizimit politik, eksenin e politikës. Kjo përfshirje do të thotë dy gjëra kontradiktore: t' i japësh të drejtë duke e fiksuar në format dhe tekste të institucionit të përbashkët të komunitetit, por edhe ta zhdukësh, duke identifikuar ligjet e shtetit me zakonet e një shoqërie. Nga njëra anë, republika moderne identifikohet me mbretërimin e ligjit të dalë nga vullneti popullor që përfshin eksenin e demos. Por nga ana tjetër, ky ekseni e demos, kërkon një parim rregullator: republikës nuk i duhen vetëm ligje, por edhe zakone ose tradita republikane. Republika është atëherë një regjim që njehson institucionet e shtetit dhe zakonet e shoqërisë. Në këtë kuptim, tradita republikane nuk e ka zanafillën as te Rusoi, as te Makiaveli, por pikërisht e ka zanafillën tek politeia platoniane. Por kjo e fundit nuk është mbretërimi i barazisë para ligjit, i « barazisë aritmetike » midis njësive të njëjta. Ajo është mbretërimi i barazisë gjeometrike që vendos ata që vlejné më shumë mbi ata që vlejné më pak. Parimi i saj nuk është ligji i shkruar dhe i njëjtë për të gjithë, por edukimi që pajis të gjithë dhe çdo klasë me virtytin që i takon sipas funksionit dhe vendit që zë. Republika, sipas këtij kuptimi, nuk kundërvë unitetin e saj ndaj diversitetit sociologjik. Sepse pikërisht sociologjia nuk është kronika e diversitetit shoqëror. Përkundrazi, ajo është vizion i trupit social homogjen, që kundërvë parimin e saj vital të brendshëm ndaj abstraksionit të ligjit. Republika dhe sociologjia janë dy emra për të njëjtin projekt: vendosjen, përtej çarjes demokratike, e një rendi politik që të jetë i njëjtë me mënyrën e jetesës të një shoqërie. Është pikërisht ajo që propozon Platoni: një komunitet, ligjet e të cilit të mos jenë formula të vdekura, por vetë frymëmarrja e shoqërisë: këshillat e dhënë nga të urtët dhe lëvizja e brendësuar që në lindje nga trupi i qytetarëve, i shprehur nga koret valltare të qyteteve. Është ajo çka do të propozojë shkencë sociologjike moderne të nesërmen e revolucionit francez: të gjendej një mjekim për çarjen « protestante » individualiste të pëlhurës së vjetër sociale, të organizuar sipas pushtetit të lindjes; ribërja e një trupi social të shpërndarë si duhet në funksionet e tij dhe hierarkitë natyrore dhe të bashkuar nga besimet e përbashkëta përballë shpërndarjes demokratike.

Pra, ideja republikane nuk mund të përkufizohet si kufizimi i shoqërisë nga shteti. Ajo kërkon gjithmonë që nëpërmjet edukimit të vihen dhe rivihen në harmoni ligjet dhe zakonet, sistemi i formave institucionale dhe gjendja e trupit social. Ka dy mënyra për ta menduar këtë edukim. Disa e shohin sikur është tashmë në veprim brenda trupit social dhe duhet vetëm të nxirret prej andej: logjika e lindjes dhe e pasurisë prodhon një elitë « të aftësive », që ka kohën dhe mundësitë të marrë dije dhe të imponojë rregullin republikan ndaj anarkisë demokratike. Ky është mendimi dominues i baballarëve themelues amerikanë. Për të tjerë, vetë sistemi i aftësive është shpërbërë dhe shkencë duhet të krijojë një harmoni midis shtetit dhe shoqërisë. Ky është

mendimi në bazë të nismës edukative që ndërmoi Republika e Tretë Franceze. Por kjo nismë nuk u njehsua kurrë me modelin e thjeshtë të vizatuar nga « republikanët » e kohës sonë. Sepse ajo ka qenë një luftë në dy fronte. Ajo donte të shkëputte elitat dhe popullin nga pushteti i kishës katolike dhe monarkisë së cilës i shërbente. Por ky program nuk ka asgjë të përbashkët me projektin e ndarjes së shtetit dhe shoqërisë, arsimit dhe edukimit. Republika që po lindte u bë pjesë e programit sociologjik: rindërtimi i një pëlhure sociale homogjene, që të pasojë, përtej çarjeve revolucionare dhe demokratike, pëlhurën e vjetër të monarkisë dhe të fesë. Ja përse ndërthurja e arsimit me edukimin është e domosdoshme për të. Fjalët që njohin nxënësit e shkollës fillore me botën e leximit dhe të shkrimit duhet të jenë të pandashme nga virtytet morale që vendosin përdorimin e tyre. Dhe në anën tjetër të zinxhirit u besohet shembujve të dhënë nga literatura latine të zhveshur nga çdo hollësi filologjike, detyra e dhënies së virtyteve elitës drejtuese.

Për këtë arsye gjithashtu, shkolla republikane u nda menjëherë midis dy vizioneve të kundërvënë ndaj njëri-tjetrit. Programi i Jules Ferry bazohet mbi një ekuacion të ndërtuar midis unitetit të shkencës dhe unitetit të vullnetit popullor. Duke e identifikuar republikën dhe demokracinë si një rend social e politik të pandashëm, Ferry kërkon në emër të Condorcet dhe të revolucionit një shkollim homogjen nga shkalla më e lartë të shkalla më e ulët. Idetë e tij për të hequr barrierat midis arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë, dëshira për një shkollë të hapur ndaj botës së jashtme ku arsimit fillor ka të bëjë më tepër me mësimin zbatues të gjërave, sesa me rregulla të ashpra gramatike dhe për një arsimim modern që hap të njëjtat rrugë si ai klasik, do të tingëllonin keq në veshët e shumë « republikanëve » tanë. Në epokën e tij, ato nxitën armiqësinë e të gjithë atyre që shohin pushtimin e republikës nga demokracia. Këta të fundit militojnë për një arsimim që të ndajë qartë dy funksionet e shkollës publike: arsimimi i popullit për aq sa është e nevojshme për të dhe formimi i një elite të aftë për t'u ngritur mbi utilitarizmin për të cilin janë destinuar njerëzit e thjeshtë të popullit. Për ta, shpërndarja e dijës duhet të jetë gjithmonë në të njëjtën kohë hyrja në një « mjedis » dhe në një « trup » që do t'i familjarizojë ata me fatin e tyre social. E keqja absolute është përzierja e mjedisve. Por rrënjja e këtij ngatërimi buron nga një ves që ka dy emra të njëvlefshëm, egalitarianizëm ose individualizëm. Demokracia e « rreme », demokracia « individualiste » çon njerëzimin nën një stuhi fatkeqësish, të cilat Alfred Fouille i ka përshkruar më 1910-ën, por që lexuesi i vitit 2005 mund t'i njohë pa shumë mundim pasojat katastrofike të majit '68, të çlirimit seksual dhe mbretërimit të konsumimit masiv:

Individualizmi masiv, parimet e të cilit pranohen nga vetë socialistët, kërkon që bijtë të mos kenë aspak solidaritet me familjet, që ata të jenë si një individ X, i rënë nga qielli, i aftë për gjithçka, që për të vetmet rregulla ka dëshirat e tij. Gjithçka që mund të bashkojë njerëzit me njëri-tjetrin i ngjet një zinxhiri servil ndaj demokracisë individualiste.

Ai fillon të revoltohet edhe nga ndarja e sekseve dhe nga ndryshimet që kjo ndarje sjell: përse gratë duhet të rriten ndryshe nga burrat, më vete dhe për profesione të ndryshme? Le t'i vendosim të gjithë bashkë nën të njëjtin regjim dhe në të njëjtin formim shkencor, historik e gjeografik, në të njëjtat ushtrime gjeometrike, t'u hapim të gjithëve dhe të gjithave të njëjtat karriera. Individit anonim, in seksual, pa të parë, pa tradita, pa mjedis, pa asnjë lloj lidhje, ja - Taine e kishte parashikuar - njeriu i demokracisë së rreme, ai që voton dhe vota e tij merret për një, qoftë ai Thiers, Gambeta, Taine, Pasteur ose Voucher. Individit do të përfundojë i vetëm me unin e tij, në vend të të gjithë "shpirtrave kolektive", në vend të të gjithë mjedisve profesionale që përgjatë kohërave kishin krijuar lidhje solidariteti dhe kishin mbajtur gjallë tradita nderi të përbashkët. Ky do të jetë triumfi i individit atomist, që do të thotë i forcës, i numrit, i dinakërisë".

Se si atomizimi i individit arrin të nënkuptojë triumfin e numrit dhe të forcës, mund të mbetet mister

për lexuesin. Por pikërisht këtu qëndron marifeti i madh i kryer me anë të përdorimit të konceptit të « individualizmit ». Që individualizmi mund të mos preferohet nga njerëz që deklarojnë neverinë e tyre ndaj kolektivizmit dhe totalitarizmit, kjo është një enigmë e lehtë për t'u zgjidhur. Denoncuesi i « individualizmit demokratik » nuk mbron me aq pasion kolektivitetin në përgjithësi. Ai mbron një lloj kolektiviteti, atë ku hierarkizohen trupat, mjediset, « atmosferat » që përshtatin dijet sipas rangut nën drejtimin e urtë të një elite. Ata nuk hedhin poshtë individualizmin si të tillë, por mundësinë që kushdo mund të ndajë prerogativat e tij. Denoncimi i « individualizmit demokratik » është thjesht urrejtja për barazinë, me anë të së cilës inteligjencia mbizotëruese konfirmon veten se është ajo elita e kualifikuar për të drejtuar turmën e verbër. Do të ishte e padrejtë të ngatërrohej republika e Jules Ferry me atë të Alfred Fouille. Por nga ana tjetër, është e drejtë të pranohet se « republikanët » e epokës sonë janë më afër të dytës sesa të parit. Shumë më tepër se trashëgimtarë të iluministëve dhe ëndrrës së madhe të edukimit me dije dhe të barabartë të të gjithë popullit, ata janë trashëgimtarë të fiksimit të madh mbi « prishjen e lidhjeve », « të ndarjes » dhe të përzierjes fatale të kushteve dhe të sekseve të prodhuar nga shkatërrimi i rregullave dhe trupave tradicionale. Është e rëndësishme të kuptohet tensioni që përmban ideja e republikës. Republikë do të thotë një sistem institucionesh, ligjesh dhe zakonesh, që eliminojnë eksenin demokratik duke homogjenizuar shtetin dhe shoqërinë. Shkolla, me anë të së cilës shteti siguron elementët e formimit të njeriut dhe qytetarit, paraqitet krejt natyrshëm si institucioni i përshtatshëm për të realizuar këtë qëllim. Por nuk ka përse shpërndarja e dijeve – matematikë, gjuhë latine, shkencë natyrore ose filozofi - duhet të formojë qytetarë për republikën, më tepër se këshilltarë për princat ose kler në shërbim të Zotit. Shpërndarja e dijeve ka efikasitet social për aq sa edhe ajo vetë është një (ri)shpërndarje e pozitave. Për të kuptuar marrëdhënien midis dy shpërndarjeve, duhet një shkencë më shumë. Kjo shkencë mbretërore ka një emër që prej kohës së Platonit, ajo quhet shkencë politike. Ashtu si është ëndërruar, që prej Platonit deri te Jules Ferry, ajo duhet të njësoje dijet dhe duke u nisur nga ky njësim, të përcaktonte një vullnet dhe një drejtim të përbashkët për shtetin dhe shoqërinë. Por kësaj shkencë do t'i mungojë gjithmonë e vetmja gjë e nevojshme për të rregulluar eksenin përbërës të politikës: përcaktimi i raportit të duhur midis barazisë dhe jobarazisë. Sigurisht, ka lloj- lloj rregullimesh institucionale që u lejojnë shteteve dhe qeverive të tregojnë para oligarkeve dhe demokratëve fytyrën që ata dëshirojnë të shohin. Aristoteli, në librin e katërt të vëllimit « Politika », ka parashtruar teorinë ende të pavjetëruar të këtij arti. Por nuk ka shkencë për përcaktimin e raportit të drejtë midis barazisë dhe pabarazisë. Dhe aq më pak mund të ketë një të tillë kur konflikti shpërthen midis moskufizimit kapitalist të pasurisë dhe moskufizimit demokratik të politikës. Republika do të dëshironte të ishte qeveria e barazisë demokratike nëpërmjet shkencës së raportit ose masës së duhur. Por ashtu sikurse Zoti nuk arrin të shpërndajë në mënyrë korrekte nëpër shpirtra arin, argjendin dhe hekurin po ashtu edhe kjo shkencë mungon. Dhe qeveria e shkencës është e dënur të jetë qeveria e elitave « natyrore », ku pushteti social i kompetencave të dijes kombinohet me pushtetet sociale të lindjes dhe të pasurisë, me koston e shkaktimit përsëri të çrregullimit demokratik që zhvendos kufijtë e politikës. Duke anashkaluar këtë tension të brendshëm të projektit republikan për një homogjenitet midis shtetit dhe shoqërisë, ideologjia neorepublikane eliminon vetë politikën. Mbrojtja që ajo i bën arsimit publik dhe pastërtisë politike e kufizon politikën vetëm në sferën shtetërore, duke i kërkuar menaxherëve të shtetit të ndjekin këshillat e elitës së ndriçuar. Qoftë edhe po t'i duhet t'u kërkojë qeverisësve të shtetit të ndjekin mendimin e elitës së ndriçuar. Thirjet republikane në vitet '90 për kthim tek politika shërbyen për të mbështetur vendimet e qeverive, madje edhe aty ku firmosej fshirja e politikës përpara eksigjencave për moskufizimin botëror të kapitalit duke stigmatizuar si « prapambetje » populiste çdo luftë politike kundër kësaj fshirjeje. Atëherë, me naivitet ose cinizëm, moskufizimi i pasurisë iu faturua oreksit gllabërues të individëve demokratikë dhe ta bënte këtë demokraci gllabëruese katastrofën me të cilën njerëzimi do shkatërrojë vetveten.

BIBLIOGRAFI

- Arendt, H.**, *Essai sur la revolution*, Paris, Gallimard, 1985.
- Fouillee, A.**, *Les etudes classiques et la democratie*, Paris, A. Collin, 1898
- Fouillee, A.**, *La democratie politique et sociale en France*, Paris, 1910.
- Laniel, B.**, *Le mot « democracy » et son histoire aux Etats- Unis de 1780–1856*, Presse Universitaire de Saint-Etienne, 1995.
- Robiquet, P.**, *Discours et opinions de Jules Ferry*, A. Collin, Paris, 1893-1898.
- Rosanvallon, P.**, *Le sacre du citoyen : histoire du suffrage universel en France*, Paris, Gallimard, 1992.

RECENCË E LIBRIT «SHOQËRIA PERIFERIKE» I ARTAN FUGËS

Blerta Hyska

Jemi në Shqipërinë e viteve të tranzicionit, kështu është quajtur kjo periudhë që nisi pas rënies së sistemit komunist në fillim të viteve '90 dhe vazhdon ende pas 17 vitesh të gjatë dhe të dhimbshëm. Ndryshimet kanë qenë të pashmangshme, sistemi ekonomik dhe shoqëria kanë pësuar transformime të shumëllojshme. Jeta politike ka qenë herë e tensionuar herë e qetë, por gjithmonë e turbullt dhe politikëbërësit kanë pasur gjithmonë një vështrim tepër të ngushtë drejt së ardhmes. Ngjarjet në rajon kanë pasur jo pak ndikim. Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, që është hap i parë i rëndësishëm drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Sfidë është e rëndësishme, por nisur nga diferenca midis gjendjes aktuale dhe asaj të kërkuar, dita e anëtarësimit duket larg.

Shoqëria shqiptare vazhdon të jetë në tranzicion, kjo është fjalia që dëgjohej prej vitesh në diskursin politik kombëtar dhe ndërkombëtar. Por është e vështirë të kuptohet në këto ditë nëse fjala tranzicion do të thotë fazë kalimtare drejt një faze tjetër, (e shpresuar si më e mirë) apo më tepër si një ngërç i gjithanshëm që ka paralizuar gjithë jetën e vendit? Është vështirë të pranohet, por më tepër situata e tanishme meriton emërimin e dytë. Dhimbjet e mëdha kërkojnë mjekim të fortë, thuhet në një proverb, por para se të nisë mjekimi, duhet kuptuar ku është dhimbja, ku është e keqja. Gjithë amullia që kaploi shoqërinë dhe gjithë proceset që ndodhën: eksodet rurale, emigrimi masiv, ndryshimi i marrëdhënieve ekonomike dhe sociale, ndryshimet politike, janë konsideruar aty-këtu zhvillime normale të tranzicionit, çmimi që duhet paguar për të pasur një jetë më të mirë. Por sakrificat vazhdojnë nga brezi në brez, pa kuptuar qëllimin, pa kuptuar ku po shkohet dhe çfarë duhet të arrihet.

I shkruar në fillim të viteve 2000, libri «Shoqëria periferike», nga profesor Artan Fuga, ngre mjaft pyetje dhe shtron çështje që nuk kanë pasur vëmendjen që meritojnë për nga rëndësia. Libri mund të konsiderohet si një prej analizave më profesionale dhe objektive të problemeve të tranzicionit në Shqipëri. Ai është jo vetëm një shikim kritik, por edhe një analizë e hollësishme e disa prej dukurive më të rëndësishme të këtyre viteve të fundit. Të analizosh shoqërinë shqiptare, që pas rënies së komunizmit i ngjet një kaosi, është një sfidë e vërtetë. Ndryshimet politike janë shoqëruar me ndryshime në shtresëzimin e shoqërisë, të traditave, të formave të bashkëveprimit në shoqëri. Brezi i rritur i viteve '90 duhet të kalojë krizën e ndryshimit të regjimit, të orientohet në botën e re, ku rregullat kanë vështirësi të zbatohen, kurse më të rinjtë, në kushtet e mungesës së çdo shtrëngimi, e kanë të vështirë të gjejnë veten e tyre, të vendosin piketa të forta personale dhe shoqërore. Profesor Fuga analizon disa nga proceset politike, sociale dhe ekonomike me të cilat u përball shoqëria shqiptare dhe përpiqet të shpjegojë ndikimin e tyre jo vetëm në lidhje me njëri-tjetrin, por edhe me gjendjen politike dhe shoqërore në përgjithësi. Kështu, transformimet politike, transformimet ekonomike, reformat për token, për privatizimin, ndryshimi i shtresëzimit të shoqërisë shqiptare, emigracioni dhe ndikimi i tij, eksodi rural, janë vënë në lidhje me kulturën politike dhe sjelljen elektorale. Më tepër se një analizë sociologjike, libri është një analizë shumëplanëshe e raporteve midis ndryshimeve social-ekonomike dhe zhvillimeve politike. Në qendër të analizës është koncepti i periferisë, filli drejtues që do të udhëheqë veprimin me koncepte të tjerë. Ashtu siç pohohet edhe nga autori, libri është një studim mbi marrëdhëniet midis ndryshimeve në zonat rurale dhe urbane të Shqipërisë dhe transformimeve politike të vendit gjatë tranzicionit të tij postkomunist. Kjo është linja kryesore dhe përreth saj zhvillohen linja të tjera, shpjegohen lidhje të tjera dhe faktorë të tjerë hyjnë në veprim. Analizimi i proceseve politike dhe ekonomike është i hollësishëm, i pajisur me fakte e statistika, por aspak monoton. Konceptet janë të qartësuara dhe të përcaktuara që në fillim, çka e bën më të kuptueshëm argumentin.

Në pjesën kryesore të librit analizohen marrëdhëniet dhe ndryshimet në botën rurale, efektet e reformave agrare dhe të privatizimit, çfarë mesazhesh klasa politike donte të përcillte dhe si u interpretuan këto nga fshatarësia, dhe më pas si u interpretua përgjigjja e elektoratit nga klasa politike. Autori do të tregojë se sa realiste dhe të bazuara ishin reformat e ndërmarra në fillim të viteve '90, në kushtet në të cilat ndodhej shoqëria fshatare dhe në gjendjen e vështirë sociale dhe ekonomike në të cilën ndodhej i gjithë vendi. Qëllimi është të tregohet se ka patjetër një lidhje midis ndryshimeve shoqërore në zonat rurale dhe sjelljes politike, dhe si e gjitha kjo përcillet dhe ndikon në jetën politike të vendit. Për të bazuar teorikisht mendimin e tij, autori përdor metodologjinë e një analize të mirëfilltë sociologjike duke iu referuar, kur është e nevojshme, autorëve të tjerë të sociologjisë politike. Përdorimi i të dhënave statistikore jo vetëm e ndihmon autorin për të shpjeguar e mbështetur argumentet, por edhe për të kuptuar faktet dhe shtrirjen e pasojave. Libri është i ndarë në 7 kapituj të strukturuar rreth tematikës kryesore. Disa nga termat çelës të kësaj tematike janë: «shoqëria periferike», «ristrukturim i zonave rurale», «modernizim», «demokratizim» «eksod rural», «sjellje politike», të lidhur me njëri-tjetrin për t' i shërbyer tematikës

Problematika përqendrohet në proceset që kanë shoqëruar tranzicionin, jo vetëm të shumtë në numër, por edhe mjaft komplekse. Shstrukturizmi i pjesëve përbërëse të shoqërisë shqiptare ishte i pashmangshëm. Demokratizimi kërkonte sakrifica dhe reforma radikale. Një prej problemeve ende të pazgjidhura është ai i rikthimit të pronave dhe pasurive ish-pronarëve. Një seri ligjesh dhe masash ligjore janë adoptuar nga qeveria, si edhe miratimi i Kushtetutës. Qëllimi i autorit është të tregojë se çfarë sfidash qëndrojnë në të vërtetë pas gjithë kësaj. Çfarë interesash politike janë në lojë që diktojnë këto apo ato politika? Po vetë konteksti politik, social, ekonomik në të cilin ndodhet shoqëria shqiptare, çfarë sinjale i çon ligjvënësve dhe zbatuesve të ligjit? Cili është roli i sistemit politik-ekonomik që mbizotëroi shoqërinë shqiptare për 45 vjet, dhe si ndikon trashëgimia e tij në proceset e tranzicionit? Gjithashtu, nuk është lënë pa marrë parasysh ndikimi i faktorëve të jashtëm, situata në Ballkan dhe më gjerë. Qëllimi i autorit është të tregojë se për të gjetur shkaqet e ndodhive, duhen kërkuar lidhje midis shumë faktorëve, ata duhen vendosur në veprim me njëri-tjetrin, dhe jo të merren të veçuar. P.sh., kur analizohet sjellja elektorale e fshatarëve, analiza përmban jo vetëm elementë të jetës karakteristike të fshatarit që motivojnë këtë apo atë sjellje politike, si p.sh. lidhja me tokën, natyra psikologjike e fshatarit, por shkohet edhe më tej, në kulturën politike, në trashëgiminë politike dhe kulturore që përmban figura e fshatarit shqiptar.

Më tepër se një orvatje për të gjetur shkaqet e ngjarjeve dhe për të gjykuar fajtorët, apo për të ndarë të mirën nga e keqja, ky libër është një përpjekje për të treguar para lexuesit se tranzicioni nuk është fatalizëm, ka një shpjegim të bazuar në analizën sociologjike për të gjithë dukuritë nëpër të cilat ka kaluar shoqëria shqiptare gjatë këtyre viteve. Koha nuk mund të kthehet pas, por sociologjia politike ka treguar se disa sjellje politike janë të kthyeshme, edhe pse varen ngushtësisht nga faktorë të tjerë. Nëse disa sinjale të dukshme injorohen herë pas here, pasojat mund të jenë të mëdha. Megjithatë, libri «Shoqëria periferike» nuk kërkon të «ndriçojë» politikëbërësit, por të bëjë të kuptojë për çdo lexues se cilët ishin faktorët më me peshë që vulosën ndryshimet politike dhe sociale në këto vite tranzicioni dhe ndoshta kështu të mund të gjejë përgjigje për «pse-të».

NJË RRËFENJË ME NDËRKOMBËTARË DHE BASHKËPATRIOTË: REÇENCË E LIBRIT “NJË RRËFENJË ME NDËRKOMBËTARË” NGA YLLJET ALIÇKA

Alba Cela

Të gjithë sytë në sallë janë përqendruar në fytyrën e imët të një burri. Të gjithë sytë ndjekin lëvizjet paksa nervoze të autorit të një libri ku ironia, humori dhe sarkazma e mbrujtur me shumë mençuri mbushin 180 faqe me komente të thella analitike dhe një paranojë të shëndetshme. Është Ylljet Aliçka dhe libri titullohet “Një rrëfënjë me ndërkombëtarë”, një titull paksa manipulues sipas komenteve të të pranishmëve në sallë. Komentuesit sot po tregojnë shumë respekt ndaj këtij libri duke kërcyer me elegancë larg mesazhit të tij therës.

Libri është një projekt i qartë de-mistifikimi. Konsensusi për këtë konkluzion është gjithëpërfshirës. Por de-mistifikim për çfarë, i kujt? I të huajve që vijnë në Shqipëri? Apo i shqiptarëve që presin këta të huajt? Një farë normalizimi në perceptimin tonë të sëmurë nga ethet e komplekseve? Apo është një pakt paqeje i vështirë me ndërgegjen kolektive shqiptare që shpesh i ka vendosur të huajt majë shkëmbinjve konceptuale të panevojshëm? Ylljet Aliçka, vështron me qetësi komentatorët që i drejtohen përsëri dëshpërimisht ethshëm, por që janë ngatërruar me këmbët e tyre në interpretimin e librit. Sapo merr mikrofonin ai këmbëngul që plani i tij fillestar ishte të shkruante një libër artistik, thjesht letërsi. Tashmë është shumë vonë për këtë. Libri është pothuajse politik. Madje plotësisht politik. Kokat që tundën kolektivisht në sallë e dinë këtë. Mesazhi që vjen përmes librit është kurajoz: t’i marrim gjërat me qetësi dhe ta shohim traun që na ka zënë sytë. Të pranojmë thjeshtësinë dhe vogëlsinë e të gjithë atyre të huajve që vijnë në Shqipëri me misionin e eksportimit të demokracisë, të sjelljes së vlerave dhe praktikave të botës së lirë.

Pikërisht ky është debati që bëhet së fundmi jo vetëm në Shqipëri, por edhe kudo tjetër ku ky eksperiment është zhvilluar. Cili është roli i ndërkombëtarëve në sjelljen dhe rafinimin e demokracisë, bërjen dhe zhbërjen e krizave politike, thurrjen dhe çthurjen e intrigave të korrupsionit, mbrojtjen e interesave të caktuara të bizneseve, marrjen e informacioneve të rezervuara dhe strategjike? Cilët janë këta njerëz që vijnë nga çdo cep i botës me jetën, bagazhin dhe problemet e tyre, me mangësitë e tyre njerëzore që aq shpesh ne bëjmë sikur nuk i shikojmë? Pse ky adhurim i verbër nga ana a mikpritësve të tyre? Servilizëm oportunist apo habitje kompleksesh?

Autori kërkon t’i adresojë këto pyetje në mënyrë të thjeshtë, përmes një historie njerëzore ku përshtypjet e jetës dhe punës tregohen thjesht, por pa asnjë llustër të diktuar nga komplekset. Në këtë kontekst libri i tij është një domosdoshmëri në kurrikulën e studimit të rolit të faktorit ndërkombëtar në zhvillimet e tranzicionit shqiptar. Ai bën atë që asnjë ese akademike e mirëpajisur me terma dhe referenca serioze studimore nuk e bën dot. Ai prek nga shumë afër dinjitetin e lexuesit. Ndërkohë që literatura teorike shtjellon mundimshëm dritëhijet politike dhe konceptuale të vlerave, praktikave dhe makro-intrigave, libri modest, por shpërthyes i Aliçkës përqëndrohet në kontrastet e jetës në mikronivelin e të përditshmes.

Gjithçka në libër është e përzjerë me mjeshtëri kulinare artistike: incidentet e të përditshmes dhe dinjitetit kritik. Është një rrëfënjë e cila flet për ndërkombëtarë dhe bashkëpatriotë, njëlloj e rëndësishme për të dyja palët. Është një libër që duhet përkthyer sa më parë në shumë gjuhë.

Kompleksiteti i marrëdhënieve të shqiptarëve me të huajt duhet mirëkuptuar. Ai rrjedh si pasojë e dy pikënisjeve shumë të ndryshme në aspektin ekonomik dhe social, nga dy lloj axhenda-sh të ngarkuara me

misione dhe nën-misione shpeshherë të errëta dhe të papritura. Këto axhenda shpeshherë kanë brenda elementë të projekteve të deformatuara të zhvillimit, por dhe të kolonializmit. Këto axhenda përballen natyrisht me marrëdhëniet njerëzore dhe problemet e theksuara të kontekstit shqiptar.

Diskutimi i librit sjell paralele interesante nga letërsia botërore, dikush madje përmend Joseph Conrad dhe *Zemrën e Errësirës* ("Heart of Darkness"). Megjithatë folësi më i moshuar dhe më i mençur në sallë, z. Sabri Godo e bën të qartë faktin që ky libër sjell një risi në letërsinë shqiptare. Vetëkritika shpërndahet në sallë si flakë kashte. Të gjithë kanë një histori që do të ishte e denjë për librin. Të tjerë mendojnë të vazhdojnë risinë me libra të tipit "Shqipëria për fillestarë", madje pse jo "Shqipeëia për amatorë."

Ky është një libër indinjimi dhe *indinjimi është reaksioni i ligjshëm i shpirtit ndaj plagëve të arsyes*. Është një reflektim personal i Aliçkës, i cili ka parë dhe i ka shoqëruar të huajt teksa ata provojnë shijen e tokës së shqiptonjave, por dhe të kontradiktave. Ky reflektim personal ka rezultuar në indinjim dhe në një nevojë imediate për të rifituar dinjitetin. Sepse arsyeja e tij është e plagosur nga adhurimet totemistike që bashkëkombasit e tij ju rezervojnë një pashaportë jo-shqiptare. Ndoshta edhe pse e ka parë veten të lëkundur nën presionin e konformitetit jo pak herë. Dhe ju desh të rebelohej përmes armëve të tija më të mira, fjalëve. Ai pret që dhe të tjerët të rebelohen, ta ndryshojnë relievin e tyre mendor ku të huajt janë shtylla referimi në një horizont të paqartë. Është një projekt ndoshta shumë ambicioz për një libër të vogël. Vetëm 180 faqe. 180 faqe me një humor fshikëllues, me një mençuri instruktive.

Një rrëfenjë me ndërkombëtarë e autorit të njohur shqiptar Ylljet Aliçka pothuajse ka fluturuar nga raftet e librari në kryeqytet duke u bërë në pak ditë nga botimi i tij një *bestseller*. Libri, një sajesë artistike aspak larg reales, rrotullohet rreth jetës së disa të huajve që kanë zgjedhur Shqipërinë si vendin e karrierës së tyre. Qarkullues të trafikut diplomatik, të shoqërisë shumëngjyrëshe civile dhe qarqeve të tjera elitare ata shpesh kanë një imazh ad-hoc të vendit ku jetojnë. Libri kokëfortë nuk të lejon ta lëshosh nga dora pa e mbaruar. Personaliteti artistik i autorit e bën atë tejet të ndjeshëm ndaj dinjitetit të shqiptarëve në një kohë kur tranzicioni ka hedhur në erë shumë nga nocionet e dinjitetit.

Suksesi më i madh ndërkombëtar i Aliçkës erdhi me skenarin e filmit Parrullat, me rregji të Gjergj Xhuvanit (një tjetër kryqëtar i dinjitetit shqiptar në botë) i nderuar në festivalin e Kanës. Edhe në atë rast muza e autorit ishte jeta e vet, eksperiencia e tij personale si mësues në fshat.

Gjatë trazirave të trishtueshme të vitit 1997, edhe kultura shqiptare u gjend nën kërcënimin serioz të një shteti të kolapsuar. Në këtë kohë Aliçka ishte drejtues i departementit të jashtëm të Ministrisë së Kulturës. Në një intervistë të atyre ditëve të vështira ai shprehet se "në kohëra të trazuar fatkeqësisht kultura nuk është prioritet as si brenda dhe jashtë vendit, si për ndërkombëtarët ashtu dhe për bashkëpatriotët." Trazirat në Shqipëri janë ende në vazhdim dhe Aliçka duket ende i angazhuar në kohë të plotë për të mbrojtur dinjitetin shqiptar, i cili duhet të jetë pasqyre e kësaj kulture.

